

Universiteti i Evropës Juglindore
Fakulteti i Drejtësisë
Programi: E drejta Civile



Tema e doktoratës:

**Mbrojtja juridike e investimeve të huaja direkte në vendet e BE-së, me theks të
veçantë për Kosovën dhe Shqipërinë**

Kandidati: Albana Pasjaqa

Mentori: Prof. Dr. Alba Dumi

Tetovë, shtator 2018

Përmbajtja

Përmbajtja	II
Hyrje	- 1 -
Natyra e problemit - lënda e kërkimit	- 3 -
Rëndësia e problemit	- 4 -
Kontributi i kërkimit - hulumtimit	- 4 -
Pyetjet kërkimore ose hipotezat	- 5 -
Marëdhënia midis koncepteve, variablave, fenomeneve të cilat hulumtohen	- 6 -
Metodologjia e hulumtimit	- 6 -
Strategjia e kërkimit	- 7 -
Mënyra e shtjellimit të të dhënave të mbledhura	- 8 -
Të dhënat e mbledhura primare dhe sekondare	- 8 -
Pjesa I: Përkufizimi i Investimeve të Huaja Direkte, nocioni juridik i tyre	- 9 -
KAPITULLI I: Investimet e huaja direkte dhe klasifikimi i tyre	- 9 -
1.1 Rëndësia juridike e Investimeve të Huaja Direkte	- 11 -
1.2 Klasifikimi i Investimeve të Huaja Direkte	- 12 -
1.3 Arsyet përse IHD duhet mbrojtur juridikisht	- 15 -
1.4 Mjedi juridik i mbrojtjes së IHD	- 16 -
1.5 Globalizimi ekonomik frenues apo zhvillues për Investimet e Huaja Direkte ...	- 18 -
1.6 Zhvillimi juridik dhe reformimi i sistemit ligjor mbi investimet e huaja direkte .	- 20 -
1.7 Përmirësimet ligjore në vendet në zhvillim dhe vendi që IHD kanë në këtë kontekst	- 22 -
1.8 Problematikat që kanë sot IHD –të në rajon	- 23 -
KAPITULLI II: Kuadri ligjor për mbështetjen e investimeve të huaja direkte	- 24 -
2.1 Mbrojtja juridike e investimeve në vendet e BE-së	- 25 -
2.1.1 Traktatet Multilaterale	- 28 -
2.2 Marrëveshjet bilaterale për mbrojtjen juridike të investimeve të huaja direkte në Kosovë, Shqipëri, e vendet e tjera të rajonit	- 29 -
2.3 Marrëveshjet multilaterale për mbrojtjen e investimeve të huaja direkte në vendet e rajonit, Kosovë dhe Shqipëri	- 31 -
2.4 Kontratat e investimeve	- 33 -
2.5 Mbrojtja juridike e investitorëve	- 34 -

2.6 Mbrojtja shtetërore mbi konfliktet ligjore për investimet e huaja direkte	37 -
2.7 Trajtimi i barabartë me firmat vendëse i IHD-ve në Kosovë, Shqipëri dhe vendet e rajonit	39 -
PJESA II Ecuria e përgjithshme e investimeve të Huaja Direkte në Kosovë dhe Shqipëri. -	41 -
KAPITULLI III: Ecuria e përgjithshme e investimeve të Huaja Direkte në Kosovë dhe Shqipëri	41 -
3.1 Origjina e Investimeve të Huaja Direkte	42 -
3.2 Shpërndarja e Investimeve të Huaja Direkte sipas vendeve dhe sektorëve	47 -
3.3 Zhvillimet rajonale dhe zhvillimet e IHD-ve në vendet e huaja si dhe tendencat juridike drejt rritjes së tyre	54 -
3.4 Investimet e Huaja më të mëdha në Kosovë dhe Shqipëri.....	56 -
3.5 Format bazë të investimeve të huaja direkte.....	57 -
KAPITULLI IV: IHD dhe roli juridik i tyre në lidhje me zhvillimin e marrëdhënieve tregtare	65 -
4.1 Krahasimi me vendet e rajonit	65 -
4.2 Avantazhet e të investuarit në Kosovë dhe Shqipëri	66 -
4.2.1 Avantazhet e të investuarit në Shqipëri	68 -
4.2.2 Avantazhet e të investuarit në Kosovë.....	70 -
4.3 Disavantazhet e të investuarit	71 -
4.4. Marrëdhëniet tregtare të Kosovës dhe Shqipërisë me vendet e Bashkimit Evropian -	72 -
4.5 Hapja tregtare e Kosovës dhe Shqipërisë.....	74 -
4.6 Ecuria e eksporteve dhe importeve me vendet e Bashkimit Evropian.....	75 -
PJESA III: IHD përballë legjislacionit në mbrojtje të institucioneve financiare ndërkombëtare.....	78 -
KAPITULLI V: Ndikimi i institucioneve financiare ndërkombëtare në investimet në vend dhe rajon.....	78 -
5.1 Fondi Monetar Ndërkombëtar dhe investimet në vendet e rajonit me theks të veçantë në Kosovë dhe Shqipëri	79 -
5.3 BERZH - ekonomia e vendeve në rajon dhe Kosova	87 -
5.4 Organizata Botërore e Tregtisë	89 -
5.5 Kompanitë Multinacionale (MNE) investimi i tyre dhe mbrojtja juridike e tyre -	91 -
5.6 Kosova dhe pozicioni i saj në arenën ndërkombëtare.....	92 -
5.7 Roli i proceseve globale në zhvillimin e Kosovës	93 -

5.8 Vendet e rajonit (Shqipëri, Mali i Zi, Maqedoni dhe Kosova) pasojat dhe përparësitë nga institucionet financiare ndërkombëtare	94 -
KAPITULLI VI: Heqja e barrierave dhe forcimi i kuadrit ligjor ndaj qarkullimit global financiar	97 -
6.1 Roli i investimeve të huaja në zhvillimin ekonomik të vendeve të rajonit dhe Kosovës krahasuar me disa nga shtete anëtare të BE-së.....	97 -
6.2 Zgjerimi i tregjeve ndërkombëtare.....	102 -
6.3 Ndërkombëtarizimi i tregtisë financiare dhe zgjerimi i tregjeve ndërkombëtare-	104 -
6.4 Efektet e IHD-ve në vendin pritës	106 -
6.4.1 Ndikimet pozitive.....	107 -
6.4.2 Ndikimet negative.....	107 -
6.5 Mjedis i politiko –ligjor, rregullat për ndërkombëtarizim	108 -
6.6 Pengesat ligjore të IHD në vendin tonë	109 -
6.7 Ndërthurja juridiko-ekonomike për zhvillimin e IHD	109 -
6.8 Përmirësimet e kuadrit ligjor për zhvillimin e IHD-ve	110 -
KAPITULLI VII: Efektet e IHD në Kosovë, Shqipëri, në vendet e BE-së, mbrojtja juridike e tyre	112 -
7.1 Analiza empirike e IHD-ve në Kosovë dhe Shqipëri, krahasuar me vendet e rajonit-	119 -
7.2 Nxitja dhe inkurajimi i investimeve të huaja në vendin tonë.....	112 -
7.3 Mbrojtja dhe sigurimi i të drejtave të investuesve	116 -
7.4 Motivet e investitorëve të huaj për të investuar në vendet e rajonit	117 -
7.4.1 Fuqia e lirë punëtore	118 -
7.4.2 Fitimi në shkallë të lartë.....	118 -
7.4.3 Shmangia nga tatimet e larta në vendet e tyre	119 -
KAPITULLI VIII: Konkluzionet dhe rekomandimet	190 -
BIBLIOGRAFIA	196 -

Lista e tabelave

Tabela 1- Investimet e Huaja Direkte në Kosovë sipas shteteve 2010-2016

Tabela 2 - Investimet e Huaja Direkte në Shqipëri sipas shteteve 2010-2013

Tabela 3 - Investimet e huaja Direkte në Kosovë - sipas aktivitetit ekonomik

Tabela 4 - Investimet e huaja Direkte në Shqipëri - sipas aktivitetit ekonomik

Tabela 5 - Tregtia në Shërbime / Bilanci Prill 2016 – Mars 2017

Tabela 6 – Eksporti i shërbimeve/ Top sektoret Prill 2016 – Mars 2017

Tabela 6 – Ndikimet pozitive dhe negative të IHD-ve

Lista e grafikoneve

- Grafiku 1. Investimet e Huaja Direkte në Kosovë sipas shteteve 2010-2016
- Grafiku 2. Investimet e Huaja Direkte në Shqipëri sipas shteteve 2010-2013
- Grafiku 3. Investimet e huaja Direkte në Kosovë - sipas aktivitetit ekonomik
- Grafiku 4. Investimet e huaja Direkte në Shqipëri - sipas aktivitetit ekonomik
- Grafiku 5. Ndikimet pozitive dhe negative të IHD-ve
- Grafiku 6. Gjinia në hulumtim për Kosovën
- Grafiku 7. Kriteret për tërheqjen e investimeve
- Grafiku 8. Forma e prezantimit të Shtetit
- Grafiku 9. Instrumentet juridike për IHD
- Grafiku 10. Forma e garantimit të IHD-ve
- Grafiku 11. Avantazhet dhe disavantazhet e investimeve në Shqipëri
- Grafiku 12. Origjina e investimeve të huaja
- Grafiku 13. Ndikimi i institucioneve financiare në zhvillim ekonomik
- Grafiku 14. Ndikimi i institucioneve në investimet në vend
- Grafiku 15. Pasojat dhe përparësitë nga institucionet financiare
- Grafiku 16. Motivet e investitorëve për të investuar në rajon
- Grafiku 17. Mosha në hulumtimin për Kosovën
- Grafiku 18. Pozita në institucion
- Grafiku 19. Siguria politike për investitorët
- Grafiku 20. Investimet në Kosovë
- Grafiku 21. Funksionimi i rendit juridik
- Grafiku 22. Përfitimet e Kosovës nga IHD-të
- Grafiku 23. Përmirësimi ekonomik i Kosovës nga IHD-të
- Grafiku 24. Investimet nëpër sektorë
- Grafiku 25. Lehtësitë për investim
- Grafiku 26. Garantimi i investimeve dhe investitorëve
- Grafiku 27. Ndikimi i institucioneve financiare në investime
- Grafiku 28. Ndikimi i IHD-ve në Kosovë

Grafiku 29. Problemet që hasin investuesit e huaj

Grafiku 30. Trajtimi i barabartë i IHD-ve me ato vendore

Grafiku 31. Gjinia tek investimet në Shqipëri

Grafiku 32. Mosha tek investimet në Shqipëri

Grafiku 33. Pozita në institucion

Grafiku 34. Fusha e shkollimit

Grafiku 35. Eksperienca në punë

Grafiku 36. Mbrojtja e konsumatorit

Grafiku 37. Efekti zhvillues i mbrojtjes së konsumatorit

Grafiku 38. Njohuritë për mbrojtjen e IHD-ve

Grafiku 39. Mbrojtja e IHD ndikim pozitiv në ekonomi

Grafiku 40. Siguria që ofron Shqipëria për IHD-të

Grafiku 41. Funksionimet e bizneseve në Shqipëri

Grafiku 42. Vlerësimi i konsumatorëve në shërbim të bizneseve

Grafiku 43. Rëndësia e IHD-ve në Kosovë

Grafiku 44. Mbështetja e rolit të IHD-ve nga qeveria

Grafiku 45. Motivet për investim në Kosovë

Grafiku 46. Mjedisi politiko-ligjor i Kosovës

Grafiku 47. Të drejtat dhe garancitë për IHD-të

Grafiku 48. Trajtimi juridikisht dhe ekonomikisht me qytetarët vendës

Grafiku 49. Zgjidhja e mosmarrëveshjeve

Grafiku 50. Sektorët që ia vlejné për të investuar

Grafiku 51. Investimet që ndikojné në rritjen e kapitalit

Grafiku 52. Udhëheqësi dhe kuptimi i industrisë

Grafiku 53. Lidershipi, pasuesi dhe situata

Grafiku 54. Kërkesat dhe nevojat e konsumatorëve

Grafiku 55. Kënaqësia e konsumatorëve

Grafiku 56. Trajnimi i punonjësve

Grafiku 57. Mbrojtja individuale dhe shoqërore në organizata

Grafiku 58. Ankesat e individëve dhe performanca organizative

Grafiku 59. Lideri dhe përfshirja në sigurinë e inividëve dhe shoqërisë

Grafiku 60. Komponentet kryesor të eksperiencës së konsumatorëve
Grafiku 61. Qëllimet e liderit për të kënaqur përfitimet e konsumatorit
Grafiku 62. Shpërblimi i punës nga udhëheqësi
Grafiku 63. Liderët dhe klientët
Grafiku 64. Formimi dhe disenjimi i lidërshtipit
Grafiku 65. Ndryshimet organizative
Grafiku 66. Përceptimi për liderin
Grafiku 67. Zgjidhja e problemit
Grafiku 68. Lidërshtipi dhe vartësit
Grafiku 69. Liderët dhe planifikimi strategjik
Grafiku 70. Llojet e lidërshtipit
Grafiku 71. Transparenca e organizatave

Lista e Shkurtimeve

BB	Banka Botërore
BE	Bashkimi Evropian
BERZH	Banka Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim
BSH	Banka e Shqipërisë
BQK	Banka Qendrore e Kosovës
IHD	Investimet e Huaja Direkte
FMN	Fondi Monetar Ndërkombëtar
AIDA	Agjencia Shqiptare e Zhvillimit të Investimeve
INSTAT	Instituti i Statistikave
KMN	Kompani shumëkombëshe
OBT	Organizata Botërore e Tregtisë
OECD	Organization for Economic Co-Operation and Development
PBB	Prodhimi i Brendshëm Bruto
SEE	Vendet e Evropës Juglindore
UNCTAD	United Nation Conference on Trade and Development
UNDP	United Nations Development Programme
CMEA	Council for Mutual Economic Assistance

Hyrje

Në këtë punim si qëllim kryesor të këtij studimi do të jenë efektet pozitive të investimeve të huaja në BE, në veçanti në Kosovë dhe Shqipëri. Pretendohet që të hulumtohet mbrojtja juridike e investorëve me qëllim të ofrimit të sigurisë që, ata, të investojnë në Shqipëri dhe Kosovë. Sidomos jemi përqëndruar më shumë në Kosovë si një vend që ende është në tranzicion, si dhe janë përmendur faktorët që e bëjnë vendin tonë një vend më tërëheqës për të investuar.

Rezultatet e pritura nga ky hulumtim do të ofrojmë të dhëna për një vlerësim real në aspektin juridik.

Në fillim të këtij hulumtimi duhet të cekim se investimet përfaqësojnë të mirat materiale të cilat shfrytëzohen për zhvillimin e lëmenjve ekonomik dhe joekonomik.

Zhvillimet e shumta ekonomike dhe joekonomike kanë bërë që t'u kushtohet rëndësi e madhe investimeve të huaja direkte.

Përcaktimi im për këtë temë ka të bëjë me faktin se nuk po bëhen përpjekje të mjaftueshme si në Kosovë poashtu edhe në Shqipëri për të krijuar një mjedis sa më të përshtatshëm për investorët. Qëllim më vete është rritja e sigurisë juridike me qëllim që investorët e huaj të investojnë në ekonomi. Gjithashtu vlen të theksohet se një vend që të ketë investime të huaja do t'i ndihmonte rritjen e stabilitetit politik, ngritjen e nivelit të sigurisë, ekonomi stabile me rritje të vazhdueshme, plotësim të legjislacionit etj.

Me krijimin e një mjedisi stabil makro-ekonomik, sistem të qëndrueshëm financiar, reforma në politikën fiskale në aplikimin e normave më të ulta tatimore besoj që do të arrihet që të tërëhiqen më tepër investorët e huaj.

Vlen të theksohet se në qendër të studimit do të jenë investimet e huaja direkte në Kosovë dhe Shqipëri si dhe mbrojtja juridike e këtyre investimeve dhe investorëve.

Kosova dhe Shqipëria janë vende të rëndësishme për zhvillimin e bizneseve dhe ofrojnë kushte të mira për investorët e huaj, duke filluar nga popullsia e re dhe e kualifikuar, klimë të volitshme, resurse natyrore, taksa të ulta, pozitë e mirë gjeografike e cila ka qasje në tregun rajonal të CEFTA-s dhe të Bashkimit Evropian. Të dyja vendet përveç që janë pjesë e CEFTA-s, janë anëtare gjithashtu edhe e BB (Bankës Botërore) dhe FMN (Fondi Monetar Ndërkombëtar).

Nga ana tjetër, ajo çka është shqetësuese dhe vlen për t'u studiuar dhe për të punuar në këtë drejtim janë Investimet e Huaja Direkte, të cilat teorikisht duhet të transferojnë teknologji e të hapin vende të reja pune, nuk rezultojnë të kenë shkaktuar ndonjë hap pozitiv në punësim. Kryqëzimi i shifrave të punësimit me investimet e huaja tregon një rezultat paradoksi ku kapitali i huaj që investohet në ekonominë e Kosovës dhe Shqipërisë nuk ka gjeneruar punësim në ekonomi, të paktën jo aq sa për të zbutur efektet e mbylljes së ndërmarrjeve publike apo reformave të tjera që shkurtojnë vende pune. Ekonomia mund të jetë në fazë strukturimi, ku rritja e produktivitetit, teknologjitë e reja që sjellin investime të huaja shkurtojnë vendet e punës.

Qëllimi i hulumtimit është arritja e njohurive shkencore, empirikisht të verifikueshme të cilat do të mundësojnë që të ketë një siguri më të madhe për investimet e huaja direkte si dhe ofrimin e mbrojtjes juridike të tyre. Sidomos si qëllim kryesor në këtë hulumtim do jetë Kosova si vend që ende është në tranzicion si dhe me një ekonomi jo mirë të zhvilluar.

Natyra e problemit - lënda e kërkimit

Lëndë e kërkimit shkencor për të cilin jam përcaktuar është trajtimi i aspekteve të caktuara juridiko-civile si dhe aspekti financiar i investimeve të huaja direkte në vendet e BE-së, në veçanti në Kosovë dhe Shqipëri.

Pretendojmë që me aplikimin e metodave dhe teknikave juridike dhe atyre ekonomike të vijë deri te të dhënat e duhura të verifikueshme përkitazi me:

aspektet juridiko-civile (mbrojtja juridike e investitorëve, nxitja dhe inkurajimi i investitorëve për të investuar, rëndësia e IHD-ve dhe zhvillimi ekonomik i vendit, masat që duhet ndërmarrë për ndërtimin e një mjedisi miqësor për afarizmin dhe investimet).

aspektet juridiko-financiare (sistemi i qëndrueshëm financiar, formimi i kapitalit, krijimi i vendeve të punës).

Faktorët motivues për investim (rritja e stabilitetit politik, siguria për të investuar investitorët, ekonomia stabile).

Rëndësia e problemit

Investimet e huaja direkte (IHD) janë një fenomen i përhapur në mbarë botën dhe i dëshiruar nga të gjitha vendet, në çdo stad të zhvillimit, qofshin ato IHD që ndikojnë në zhvillimin ekonomik të vendeve në të cilat ato kryhen.

Investimet e huaja direkte janë një burim shumë i rëndësishëm i zhvillimit të një ekonomie. Në këtë kontekst konsiderojmë se, hulumtimi i investimeve të huaja direkte kërkon një punë mjaft të madhe për të bërë, me qëllim që të arrihet dhe të sigurohen të dhënat e mjaftueshme lidhur me këto investime si dhe të bëhet krahasimi me vendet e rajonit, po gjithashtu edhe me vendet e BE-së.

Investimet e huaja direkte, janë një tregues i rëndësishëm i besimit të investitorëve të huaj në një vend, ato ulen në kushtet e krizave ekonomike dhe politike, rriten në kushtet e përmirësimit të ambientit ekonomik dhe politik. Këtu pra qëndron rëndësia e problemit të IHD-ve, sidomos në vendin tonë. Kjo nënkupton se duhet të ketë së pari stabilitet ekonomik, politik, siguri ligjore, pra mbrojtje juridike për investitorët me qëllim që të investojnë investitorët.

Vlen të theksohet se arsyeja që të hulumtojmë në këtë temë ka të bëjë me problemet e shumta që ka, sidomos vendi ynë në tërheqjen dhe thithjen e investitorëve. Gjatë tërë hulumtimit do të bëjmë përpjekje maksimale që të arrijmë të zgjidhim këtë çështje, sepse si problem kryesor që investitorët e humbin interesimin për të investuar, janë proceset e gjata administrative dhe burokratike, politikat e pafavorshme fiskale, niveli i lartë i korrupsionit si dhe ajo çka është më e rëndësishmja mungesa e sundimit të ligjit.

Në këtë kontekst konsiderojmë se duhet punuar shumë më shumë, sidomos në aspektin ligjor me qëllim që investitorëve t'u ofrohet një siguri juridike me qëllim që të investojnë dhe të ndihmojnë ekonominë, sidomos të vendeve të cilat nuk e kanë kaluar ende tranzicionin.

Kontributi i kërkimit – hulumtimit

Me këtë punim pretendojmë të hulumtojmë dhe analizojmë aspektet juridike dhe financiare të Investimeve të Huaja Direkte në vendet e BE-së, sidomos në Kosovë dhe Shqipëri.

Në këtë kontekst vlen të theksohet se IHD-të luajnë një rol kyç në procesin e integritetit global ekonomik, rritin produktivitetin, ekonomisë, ndikimin dhe hapjen e tregjeve të reja për tregti dhe ajo çka është më e rëndësishme se do të fokusohemi në këtë punim ka të bëjë me atë se sa IHD-të ndikojnë në mirëqenien e popullsisë.

Rezultatet e pritura nga ky hulumtim, padyshim do të mundësojnë një vlerësim real të rëndësisë së investimeve të huaja direkte, mbrojtjen juridike të tyre si dhe avantazhet dhe disavantazhet që një vend mund t'i ketë nga këto investime.

Pyetjet kërkimore ose hipotezat

Realizimi i përkufizimit të thelbit të problemit i cili është objekt i hulumtimit (aspektet juridiko-civile dhe financiare të IHD-ve) si dhe përcaktimi i treguesve që mund të ekzaminohen në mënyrë empirike (indiktorët, koeficientët, etj.) krijon mundësinë e parashtrimit të hipotezave kërkimore.

Arsyet përse investitorët të investojnë, cilat janë kushtet që u ofrohen nga institucionet shtetërore, mbrojtja ligjore, krijimi i një ambienti më miqësor për investitorët, përmirësimi i stabilitetit politik dhe gjendja e sigurisë, rritja e vetëdijësimit të komunitetit të biznesit dhe opinionit publik se sa të rëndësishme për shtetin janë IHD-të, justifikon shqyrtimin, hulumtimin dhe analizën e këtyre dukurive në kontekstin më të gjerë.

Gjithashtu vlerësojmë se hulumtimi i rëndësisë së investimeve të huaja direkte, sidomos në Kosovë dhe Shqipëri janë shumë të rëndësishme dhe ofrojnë mundësi të reja për të investuar. Më lart kemi cekur se janë proceset e gjata administrative dhe burokratike si pengesë që investitorët nuk shprehin interesim të madh për të investuar, mirëpo duhet të përmendim se ky nuk është rasti i Kosovës dhe Shqipërisë, sepse këto dy vende ofrojnë një sërë faktorësh nxitës për të tërhequr investitorët.

Përcaktimi përkritazi me investimet e huaja do jetë i fokusuar, sidomos në Kosovë, do të mundohem maksimalisht që të bëjë një hulumtim mjaft të rëndësishëm me qëllim që të arrijmë tek një përfundim i mirë dhe të ofrojmë fakte përse duhet të investohet në Kosovë. Vendi ynë përveç në sektorin e ekonomisë ofron mundësi të mëdha për investim edhe në

sektorët e tjerë si në: bujqësi, energji, vreshtari, turizëm, nxjerrje dhe përpunim të metaleve etj.

Hipoteza e parë: Sa ndikon sundimi i ligjit në tërheqjen e investimeve të huaja dhe cilët janë faktorët kryesor që ndikojnë tek investitorët .

Hipoteza e dytë: Situata politike dhe ligjore në Kosovë dhe Shqipëri është shkak për humbjen e interesit për investimet e huaja.

Verifikimi i realizimit të këtyre çështjeve (hipotezave) është qëllimi i hulumtimit.

Marëdhënia midis koncepteve, variablave, fenomeneve të cilat hulumtohen

Kemi theksuar se lëndë e hulumtimit janë aspektet juridiko–civile dhe financiare të cilat kanë rëndësi të madhe në aspektin e investimeve të huaja direkte. Që të arrihet një hulumtim sa më efikas duhet të kemi qasje interdisiplinare, në mënyrë që të sigurohen të dhëna të duhura në bazë të të cilave në mënyrë empirike mund të verifikohen indikatorët përcaktues të investimeve.

Aplikimi i metodologjisë përkatëse në rrugën e sigurimit të indikatorëve të nevojshëm, domosdoshmërisht kërkon edhe trajtimin e raportit të variablave–fenomeneve të cilat hulumtohen ashtu që në mënyrë empirike të verifikohen dhe përcaktohet ndikimi i tyre në investime dhe investitorë, rëndësi e investimeve si dhe krijimi i një rruge më të sigurt për të investuar.

Metodologjia e hulumtimit

Trajtimi shkencor i investimeve të huaja direkte kërkon aplikimin e metodave përkatëse për realizimin e qëllimeve të cilat i parashtron punimi shkencor.

Metoda në shkencë, nënkupton zbulimin dhe vërtetimin e të vërtetës shkencore, e cila orienton në realizimin e qëllimit të caktuar, të paraparë në temën e përcaktuar për hulumtim (aspektet juridiko-civile dhe financiare të investimeve të huaja direkte). E gjithë kjo, në rastin tonë, imponon përdorimin e:

- metodologjisë teorike (metodën juridike, metodën historike, metodën krahasuese, sociologjike, psikologjike dhe metodën logjike); dhe
- metodologjisë empirike (metodën statistikore; metodën e analizës dhe sintezës; metodën e vështimit dhe metodën deskriptive). Në kuadër të metodës statistikore do të shfrytëzohen: metoda e ligjit të numrave të mëdhenj (analiza e më shumë rasteve); metoda e modelit (analiza e rasteve tipike); dhe metodat e korelacionit, mesatares dhe përqindjes (raporti në mes të moshës, gjinisë etj.).

Nuk përjashtohet edhe shfrytëzimi i teknikave përkatëse metodologjike, si: anketa, evidencat, pyetësorët, etj.

Në veçanti duhet theksuar se, me përpikëri duhet respektuar parimin logjik të përjashtimit të kundërtënieve në të menduar (definimi dhe klasifikimi i drejtë, etj., i nocioneve dhe përfundimeve të nxjerra), me të vetmin qëllim–arritjen e rezultateve të sakta të hulumtimit shkencor.

Etika kërkimore - Hulumtimi do të bazohet në të dhënat e autorëve kompetent të cilët kanë trajtuar çështjen e Investimeve të Huaja Direkte, gjithashtu do bazohemi edhe në punimet që janë publikuar në ëbsite të ndryshme, literatura më të avancuara, revista shkencore dhe botime ndërkombëtare.

Kërkimet shkencore do të bëhen në bibliotekat e Universitetit Publik të Prishtinës; Fakultetit Juridik dhe Fakultetit Ekonomik; bibliotekat e Universitetit (UEJL); si dhe në biblioteka të tjera në rajon.

Strategjia e kërkimit

Ky material ka për qëllim studimin e IHD-ve në vendet e BE-së, me fokus më të veçantë në Kosovë dhe Shqipëri. Qëllimi i këtij studimi është të shpjegojë efektet e IHD-ve në vendet të cilat i kemi trajtuar më gjerësisht gjatë punimit.

Jemi përpjekur që gjatë këtij punimi të mbledhim material me qëllim që në fund të kemi një punim cilësor.

Kërkimi fillon mbi rëndësinë e IHD-ve, klasifikimin e tyre, mbrojtjen juridike, të gjitha këto bazuar në materiale ekzistuese.

Gjithësesi, duhet të cekim se ky studim përfshin edhe elemente të kërkimit sasior, si analiza e të dhënave statistikore, përpjekje për të shpjeguar ecuritë e për të dhënë strategji të mundshme.

Mënyra e shtjellimit të të dhënave të mbledhura

Gjatë këtij punimi kërkimor është rishikuar një literature e gjerë që fokusohet në shpjegimin e IHD-ve dhe karakteristikave kryesore të tij. Ndërsa të dhënat dytësore kanë ndihmuar që të kuptohen çështjet kryesore që lidhen me IHD-të.

Burime të të dhënave dytësore përfshijnë: studime të mëparshme në këtë fushë, konferenca e materiale pune, artikuj gazeta, baza të të dhënave në internet etj.

Të dhënat mbi flukset e IHD-ve janë marrë nga botime të ndryshme të autorëve që kanë shkruar për IHD-të. Të dhënat për vendet e BE-së janë marrë nga UNCTAD.

Ndërsa të dhënat lidhur me Kosovën dhe Shqipërinë janë më tepër bazë e të dhënave nga institucionet shqiptare si: KIESA, Ministria e Tregtisë dhe Industrisë, Instituti i Statistikave, Banka e Kosovës, Agjencia Shqiptare për Zhvillimin Ekonomik, Ministria e Ekonomisë, Banka e Shqipërisë.

Të dhënat e mbledhura primare dhe sekondare

Përgatitja e këtij punimi kërkon mbledhjen e materialeve dhe të dhënave nëpërmjet literaturës së ndryshme duke u bazuar edhe në revista shkencore, studime dhe burime të tjera etj.

Literatura do të jetë kryesisht në gjuhën shqipe dhe angleze (duke përfshirë edhe atë serbe, maqedonase).

PJESA I

PËRKUFIZIMI I INVESTIMEVE TË HUAJA DIREKTE

NOCIONI JURIDIK I TYRE

Hyrje

Investimet e Huaja Direkte konsiderohen si një e mirë e madhe e vendeve të cilat pranojnë këto investime. Në këtë pjesë kemi bërë përpjekje më tepër të shtjellojmë atë se si i përkufizojnë IHD-të studiues të ndryshëm. Nga përkufizimi i tyre neve kemi ardhë në përfundim se disa kanë mendime mjaft pozitive, mirëpo ka edhe të tillë që mendojnë se IHD-të shkaktojnë dëme ekonomike në vendet ku kooperojnë. Mendojmë se sado që IHD-të mund të kenë aspekte negative në përgjithësi ndikimi i tyre në zhvillimin ekonomik të vendeve pritëse është shumë i madh, mirëpo duhet cekur se dallon ndikimi i tyre dhe kjo duke u bazuar në ligjet që kanë vendet ku ato investojnë.

Të japësh një përkufizim të saktë për investimet e huaja mendojmë se nuk është edhe aq e thjeshtë, duke pasur parasysh se shumë studiues i kanë përkufizuar në mënyra të ndryshme dhe në bazë të aktivitetit ekonomik që ato kanë kryer në shtete të ndryshme. Prandaj ne mendojmë se investimet e huaja direkte janë një e mirë e madhe, si në aspektin ekonomik, kulturor, social, politik për vendet që i pranojnë këto investime.

KAPITULLI I

INVESTIMET E HUAJA DIREKTE DHE KLASIFIKIMI I TYRE

Investimet e huaja direkte pas Luftës së Dytë Botërore filluan të rriteshin më shumë, mirëpo fillimet e para i patën që në fillim të shekullit 19. Zhvillimi i teknologjisë është njëri ndër faktorët kryesor që ndikuan në përhapjen e IHD-ve në gjithë botën, mirëpo ajo që u krijoi

mundësi investitorëve të huaj të shfrytëzonin tregjet e mundshme botërore është globalizimi i cili ndikoi në përhapjen e shpejt të prodhimit¹.

Disa studiues i shohin IHD-të si zgjidhje të problemeve të ndryshme globale, të tilla si: krizat e urisë, kequshqyerja dhe dëmtimet mjedisore, nga ana tjetër, disa studiues të tjerë mendojnë se IHD-të janë vet instrumentet me anë të të cilave shkaktohen këto fatkeqësi globale. Investimet e huaja direkte ndikojnë pozitivisht në zhvillimin ekonomik të vendeve ku investojnë, në hapjen e vendeve të reja të punës, mirëpo disa të tjerë autorë mendojnë se IHD-të kanë ndikim negativ, e këtë e bazojnë duke marrë parasysh faktin se shumë biznese të vogla pësojnë humbje, si pasojë e investimeve të huaja². Duke marrë parasysh se investimet e huaja kanë karakteristika të ndryshme në vende të ndryshme, sepse kryejnë funksionin e tyre në përputhje me legjislacionin e vendit të tyre i cili mund edhe të dallojë nga legjislacioni i vendeve pritëse, prandaj të japim një përkufizim sa i përket investimeve të huaja direkte nuk është aspak e lehtë dhe mund të ndryshojë nga këndvështrimi se si i shohim IHD-të³.

Me investimet e huaja kemi të bëjmë në ato raste kur transferohet kapitali i huaj nga jashtë në një shtet të caktuar dhe kryhet nga individët ose personat juridik për prodhimin e shërbimeve ose të mallrave. Pavarësisht se nga e ka vendbanimin e tij ligjor investitori i huaj ai është person juridik ose fizik.

Raporti Botëror i investimeve i Kombeve të Bashkuara i përcakton IHD-të si “një investim që përfshin një marrëdhënie afatgjate, që pasqyron një interes të qëndrueshëm dhe kontroll të një subjekti vendas në një ekonomi (investitor direkt i huaj ose sipërmarrje mëmë) në një sipërmarrje vendase me një ekonomi të ndryshme nga ajo e investitorit direkt të huaj (sipërmarrja IHD, sipërmarrja degë ose dega e huaj)⁴”.

Sipas Manualit të Bilancit të Pagesave të Fondit Monetar Ndërkombëtar “Investimi Direkt është një kategori e investimeve ndërkombëtare, që pasqyrojnë sigurimin e të ardhurave të qëndrueshme nga një subjekt rezident i një ekonomie në një subjekt që është rezident në

¹ Eduard Connel, David Publishing Review, 2016 year, page 12

² (Sezer, H. (2006) “Foreign Direct Investment”, in Piggott, J. and Cook, M. *Internacional Business Economics: A European*, fq. 186-222, Palgrave Macmillan).

³ Eduard Connel, David Publishing Review, 2016 year, page 13

⁴ (UNCTAD, 1999)

një ekonomi tjetër dhe ka një shkallë të konsiderueshme të ndikimit në menaxhimin të këtij të fundit”⁵

1.1 RËNDËSIA JURIDIKE E INVESTIMEVE TË HUAJA DIREKTE

Në vendet në tranzicion si dhe në ato vende me ekonomitë në zhvillim, hapja e vendeve të reja të punës dhe rritja ekonomike, janë të varura nga dy faktorë:

- a) Zhvillimi i IHD-ve, dhe
- b) Zhvillimi i NVM-ve

Në vendet në zhvillim IHD konsiderohen burimi kryesor i financimeve të jashtme. Ato ndihmojnë në bilancin e pagesave, por gjithashtu rrisin edhe kapitalin.

Nga pikëpamja e ofertës, IHD varet nga disponibiliteti i kapitalit investues i gjeneruar nga fitimet e përbashkëta ose huatë, të cilat varen nga kushtet vendëse ekonomike, përfshirë rritjen. Nga pikëpamja e kërkesës, zgjerimi i tregjeve në vende të huaja bën që TNC (korporatat ndërnacionale) të investojnë më tepër, ndërkohë që tregjet e tëkurrura i frenojnë. Pra, investimet e huaja direkte janë një ndihmës si për vendet e zhvilluara, gjithashtu edhe për ato vende të cilat ende nuk e kanë kaluar tranzicionin⁶.

Rënia e flukseve të IHD-së në 2001 dhe 2002 pasoi me ritme të rritjes së IHD-ve gjatë fundit të viteve 1990. Një prirje e tillë u vu re edhe gjatë fundit të viteve 1980 dhe fillimit të viteve 1990, si dhe në periudhën 1982-1983⁷.

Mendojmë se për tërëheqjen e investimeve të huaja direkte qeveritë duhet të kenë një strategji të lartë e që duhet të jetë gjithpërfshirëse dhe e cila do të ndihmonte në krijimin e një imazhi sa më të mirë për vendet të cilat janë të interesuara në tërëheqjen e investimeve. Mirëpo, duhet të cekim se nëse një vend ka udhëheqje të dobët institucionale, kjo mund të ndikojë negativisht në tërëheqjen e investimeve si dhe mund të vijë deri te përjashtimi në treg.

Investimet e huaja direkte përcaktohen si kategori e investimeve ndërkombëtare të lidhura me një rezident në një ekonomi, i cili ka kontrollë ose një shkallë të caktuar influence në

⁵(FMN, 1993)

⁶ Eduard Connel, David publishing review, 2016 year, page 15

⁷<http://www.osce.org> – Udhëzuesi i praktikave më të mira për një klimë pozitive për biznesin dhe investimet, fq.18).

menaxhimin e një ndërmarrjeje, e cila është rezidente në një ekonomi tjetër. Investimet direkte kërkojnë që investitori direkt duhet të ketë në pronësi 10% ose më shumë të aksioneve të zakonshme ose fuqisë votuese në menaxhimin një ndërmarrje⁸.

Që të kemi sa më shumë investime të huaja është e domosdoshme edhe promovimi i tyre. Promovimi i IHD-ve bëhet nga disa akterë: Oda ekonomike e Kosovës, Qeveria e Kosovës, Sëisscontact, USAID-KBS, si dhe shtetet e huaja me zyrat e tyre përfaqësuese.

Por, aktualisht mungon koordinimi ndërmjet akterëve të ndryshëm, mungon organizimi për koordinim dhe strategjia e promovimit. Është e nevojshme të adresohet kjo situatë në të ardhmen e afërt krahas promovimit të përparësive që i ka Kosova, dhe krijimin e një imazhi të mirë për Kosovën⁹.

1.2 KLASIFIKIMI I INVESTIMEVE TË HUAJA DIREKTE

Investimet e Huaja Direkte janë klasifikuar në forma të ndryshme, sikurse edhe përkufizimi i tyre. Për të bërë sa më të kuptueshme rëndësinë e IHD-ve në zhvillimin ekonomik të vendeve pritëse ka ardhur edhe deri te klasifikimi i tyre. Klasifikimi investimeve të huaja shikohet nga dy këndvështrime, të cilat janë të rëndësishme për zhvillimin e tyre:

- a) Nga këndvështrimi i investitorit
- b) Nga kënvështrimi i vendit pritës

Nga këndvështrimi i investitorit, IHD-të klasifikohen në horizontale, vertikale dhe konglomerat¹⁰.

IHD horizontale – Prodhimi i njëjtë në kompaninë mëmë prodhohet edhe në vendin pritës. Ky lloj është më i përhapuri i IHD-ve, sepse kemi të bëjmë me të njëjtin prodhim vendor që paraqet tipin më të përhapur të IHD-ve.

⁸https://www.bankofalbania.org/web/pub/investimet_e_huaja_direkte_8751_1.pdf, Investimet e Huaja Direkte – Pwrshkrim Metodologjik dhe informacion statistikor pwr vitin 2015) departamenti i statistikave financiare, shtator 2016, fq.4).

⁹<http://riinvestinstitute.org/uploads/files/2016/October/17/shqip1476705266.pdf>

¹⁰Pitelis, Christos; Roger Sugden (2000). *The nature of the transnational firm. Caves (1971). Routledge. p. 74*

IHD vertikale – Këtë lloj të investimit e kemi më tepër të përhapur në industrinë përpunuese dhe është më tepër i përhapur në sektorët dytësor dhe tretësor, me ç'rast një nga fazat e prodhimit transferohet jasht vendit.

IHD konglomerat - Ky lloj i investimeve është përzierje e dy llojeve të investimeve të mëparshme, pra fjala është për ato vertikale dhe horizontale.

Ndërsa sa i përket ndarjes së IHD-ve nga këndvështrimi i vendit pritës, ato ndahen në:

IHD të iniciuara nga qeveritë–Me qëllim të eliminimit të deficitit në bilancin e pagesave qeveritë e shumë vendeve ofrojnë stimuj për investimet e huaja.

IHD zëvendësuese të importit – Mallrat e prodhuara të cilat fillimisht janë importuar në vendin pritës përfshihen tek IHD-të zëvendësuese të importit. Këto përfshijnë prodhimin e mallrave që fillimisht janë importuar në vendin pritës. IHD-të e këtij lloji ndikohen në radhë të parë nga tregu, barrierat e tregut si dhe kostot e transportit.

IHD rritëse të eksportit – Ky lloj i IHD-ve ka të bëjë me kërkimin e lëndëve të para ose mallrave të ndërmjetëm.

Nëse nisemi nga drejtimi i investuesit, atëherë IHD-të do t'i ndajmë në dy tipe: **të brendshme** dhe **të jashtme**.

- Të brendshme quhen ato investime të cilat kryhen nga një sipërmarrës i huaj në ekonominë raportuese. IHD-të e brendshme janë një formë tipike e të ashtuquajturave “investime të brendshme”. Këtu, investimet e kapitalit të huaj ndodhin në burimet lokale¹¹.
- Me investime të jashtme kemi të bëjmë atëherë kur kryhen nga një sipërmarrës vendas në një vend tjetër.

Fluksi neto i IHD-ve lidhet me investimet gjatë një periudhe kohe dhe është kumulativ. Ky fluks (pozitiv apo negativ) është rezultat i investimeve të jashtme dhe të brendshme, i quajtur ndryshe edhe “stoku i investimeve direkte”. Fluksi negativ zakonisht tregon disinvestimet apo ndikimi i rimbursimeve të rëndësishme të huave brenda kompanisë të cilat investojnë në vende të ndryshme.

Fluksi neto i IHD-ve influencohet nga elementet e mëposhtme:

- a) Kapitali aksioner, që është blerja në aksione e investitorit të huaj në një entitet në vendin pritës.

¹¹ <http://www.doktoratura.unitir.edu.al/wp-content/uploads/2012/09/Oltjana-Zoto-Fakulteti-i-Ekonomisw.pdf>

- b) Kapitali ri-investues, i cili përfaqëson atë pjesë të fitimit që nuk ndahet si dividend apo kthehet në vendin e investuesit, por përdoret për t'u riinvestuar në ekonominë pritëse.

Huatë brenda kompanive, që përfaqësohen nga huatë afatshkurtra apo afatgjata midis kompanisë mëmë dhe filialeve të saj¹².

Nisur nga arsyet apo qëllimet që ndikojnë një investitor të investojë jasht vendit, në vend që të eksportojë, sipas një studimi të tre autorëve:¹³ Chryssochoidis, Millar & Clegg, në 1997, IHD ndahen në 5 tipe kryesore:

Tipi i parë i IHD-ve janë ato që përdoren për të fituar akses në faktorët specifik të prodhimit, të tilla resurse, njohuri teknologjike, patenta ose emri i mirë që zotërohet nga një kompani në vendin pritës. Nëse këta faktorë prodhimi nuk gjenden në vendin e origjinës apo nuk janë lehtësisht të transferueshëm, atëherë kompania e huaj duhet të investojë lokalisht për të siguruar aksesin. Në Shqipëri kjo mund të ilustruhet me shembullin e kompanisë turke “Kurum”, e cila merret me prodhimin dhe eksportimin e produkteve të çelikut shqiptar.

Tipi i dytë është zhvilluar nga Raymond Vernon¹⁴, në hipotezën e tij të ciklit të produktit. Sipas këtij modeli kompania investon me qëllim aksesin në faktorë më të lirë prodhimi. Inkurajimi i këtij tipi të investimeve vë pikërisht nga qeveritë e vendeve pritëse duke përdorur një strategji të orientuar drejt eksportit. Në këtë rast kompanitë investuese (investitori direkt) favorizohet me anë të subvencioneve, koncesioneve ose granteve të ndryshme. Rasti i fasonëve gjerësisht i përhapur tek ne.

Tipi i tretë i IHD-ve lidhet me firmat që konkurrojnë në rang ndërkombëtar duke ndërmarrë një sërë investimesh në vendet që i konkurrojnë.

Tipi i katërt IHD-të të cilat sigurojnë akses tek konsumatorët e vendeve pritëse përbëjnë titpin e katërt të IHD-ve. Kompanitë vendase e kanë gati të pamundur eksportin e një lloji shërbimi. Tregtimi i limituar i disa llojeve shërbimesh ka kontribuar në rritjen e IHD-ve të këtij tipi.

Tipi i pestë i IHD-ve lidhet me aspektin e integritetit rajonal dhe tregtimit të diversifikuar.

¹²Moosa Imaad A. “FDI, Theory, evidence and practice”, Palgrave 2002 p. 5

¹³Chryssochoidis, Millar & Clegg, në 1997

¹⁴Vernon, Raymond (1966). *International Investment and International Trade in the Product Cycle*. in: *Quarterly Journal of Economics*.. Cambridge. p. 191),

Avantazhet lokale të cilat paraqiten nga një vend pritës paraqet këtë lloj të IHD-ve, avantazhe të cilat kanë të bëjnë me kompanitë e huaja të cilat duan të investojnë për të fituar qasje në vendin e pritësit. Mirëpo, pengesat e tregtimit dhe të taksimit janë pengesa kryesore e këtyre kompanive në eksportimin e shërbimeve dhe të mirave në këto vende. Kur e konsiderojnë të arsyeshme, kompanitë e huaja kapërcejnë këto barrierë duke themeluar praninë e tyre në vendin pritës me qëllim që të fitojnë pjesë në treg. Pra, nga ajo çfarë është thënë më lartë, IHD-të si përfaqësues i ri i ekonomisë së shek. XXI, kanë tendencën të ndërkombëtarizojnë biznesin dhe tregtinë, duke sjellur përfitime të dyanëshme, si për investuesin ashtu dhe për pritësin. Sipas teorisë kemi disa forma të investimeve:

- a) Marrja (përfitimi) ose shkrirja me një ndërmarrje në një vend tjetër
- b) Krijimi i një ndërmarrjeje të përbashkët me një ndërmarrje në një vend tjetër
- c) Krijimi i një ndërmarrjeje të re (investim në fushë të gjelbër, green-field)

1.3 ARSYET PËRSE IHD DUHEN MBROJTUR JURIDIKISHT

Shteti i cili i pranon investimet e huaja nënkupton që duhet të ndërmarrë masa me anë të të cilave i mbron investitorët e huaj, në radhë të parë nga cënimi i veprimit të tyre dhe pastaj nga paraqitja e rreziqeve të ndryshme komerciale dhe jo komerciale.

- a) Në ligjet mbi investimet e jashtme është mjaft e shpeshtë dispozita mbi garantimin e mos ndryshimit të regjimit juridik, sipas të cilit investimi i huaj është¹⁵. Disa shtete kërkojnë plotësimin e disa kushteve si, regjistrimi paraprak i sasisë së kapitalit i cili vë në gjatësi në organet e pagimit të tatimit i cili është i destinuar ose nga investitori i huaj ose nga ndërmarrja, me ç'rast në regjimet e tyre nacionale i kanë vendos garancitë për transfer të fitimit dhe repatrijimit të kapitalit.
- b) Parimi i drejtshmërisë nënkupton alokimin e ligjit nacional i cili është në harmoni me kërkesat që burojnë nga burimet e pranishme të së drejtës tregtare

¹⁵D.D.Bradlow. *Legal aspects of FDI, Kluwer Law International, 1999: Historical, Constitutional and International Background of Nigeria's FDI Law*, p. 395-412. A. Gazanç Glumak: *Osnivanje mešovitih preduzeća u zemljama u razvoju, Ljubljana, 1987*

ndërkombëtare në këtë lëmi si dhe të drejtës ndërkombëtare në përgjithësi. Kjo nënkupton realizimin e premtimeve të cilat i ka dhënë shteti importues i kapitalit.

- c) Në bazë të ligjeve të brendshme sigurohet aplikimi i standardeve “të tretmanit nacional”, domethënë të barazimit të statusit të investitorëve të huaj me pozitën e cila buron nga të drejtat e pranuar dhe të pozitës juridike të personave të vendit, të cilat ato i kanë në kryerjen e punëve investive.
- d) Secili shtet duhet të sigurojë mbrojtje për investitorët e huaj si dhe trajtim të barabartë me firmat vendëse, sepse kjo është mënyra më e mirë e tërheqjes së investitorëve.
- e) Forma e posaçme e mbrojtjes së investimeve është mënyra strikte në zbatimin e masave nga ana e organeve shtetërore të shtetit pranues në organet e shtetit publik me të cilat pamundësohet kryerja e veprimtarisë investuese-ndërmarrjes së masave të ekspropriimit dhe nacionalizimit.
- a) Me normat e brendshme të së drejtës së shtetit vendosen jo vetëm çështjet e mbrojtjes, por me to sigurohen edhe garancitë për investime të jashtme për të cilat njëkohësisht edhe mjaft shpesh e në mënyrë gjithpërfshirëse këtë formë të sigurimit e ofrojnë ligjet nacionale të shteteve eksportuese të kapitalit. Mirëpo, kjo nuk do të thotë se investitorët nuk duhet të mbështeten edhe në ligjet e shteteve ku eksportohet malli i tyre.
- b) Krahas masave shtetërore të mbrojtjes duhet cekur edhe mundësinë e sigurimit në bazë të kontratës së natyrës juridike private, që me lidhjen e tyre investitori i jashtëm mund të sigurohet nga pasojat e dëmshme dhe nga paraqitja eventuale e rrezikut¹⁶.

1.4 MJEDISI JURIDIK I MBROJTJES SË IHD

¹⁶Mehdi J. Hetemi – *Disa tema aktuale të ekonomisë së tregut*, fq.130-133, Prishtinë 2005

Sa i përket mbrojtjes së investimeve të huaja shteti me autorizimin sovran që ka mundet me akte ligjore në territorin e vet të rregullojë çështjen e investimeve të huaj¹⁷. Nuk duhet lënë anash as obligimet e veta të karakterit ndërkombëtar që ka, mes hapjes së kufizuar të ekonomisë së vet ndaj kapitalit të jashtëm ose investimeve të huaja, ose me të drejtë të hapjes së politikës ekonomike. Investimet e jashtme nuk duhet vetëm të pranohen dhe të mbrohen, mirëpo duhet t'u ofrohet edhe garanci për investimet dhe investitorët si dhe të bëhet sigurimi i tyre, pra e tërë kjo ka të bëjë me çështjen e aplikimit të së drejtës së brendshme.

Kjo problematikë, pra, është objekt i suazës formalo-juridike të cilën e siguron shteti dhe të njëjtin e definojnë shteti dhe eksportuesi i investimeve si dhe shteti pranues. Si pasojë e shfaqjes së disa aspekteve të rreziqeve siç janë ekspropriimi, kufizimi ose ndalimi i konvertimit dhe transferit të mjeteve financiare, nacionalizimi kanë të bëjnë me garancitë dhe sigurimin e investimeve me qëllim që të mos vie deri te shfaqja e ndonjë problemi si pasojë e asaj që u përmend më sipër. Krijimi i klimës për investime vie nga mbrojtja juridike e tyre, e cila në kushtet e tanishme i ka disa aspekte të saj, që do të paraqes bazën e sistematizimit të shpjegimeve tona të mëpastajme nëpërmjet këtyre tërësive:

- a) Regjimit të mbrojtjes së investimeve në territorin e shtetit pranues,
- b) Regjimit të garancive dhe sigurimit të investimeve, të cilat i siguron shteti importues i kapitalit dhe suazat e rëndësishme juridiko-ndërkombëtare për mbrojtjen e investimeve¹⁸.

Gjykojmë se për krijimin e një mjedisi juridik në mbrojtje të Investimeve të Huaja Direkte, nevojitet një sistem ligjor funksional, gjykatat të bëjnë punën e tyre në mënyrën më të mirë të mundshme në këtë aspekt si dhe sistemi politik të jetë stabilizues për vendin i cili i pranon këto investime.

Në gjysmën e parë të viteve 1980, Investimet e Huaja Direkte nuk ishin një kontribues i rëndësishëm në formimin e kapitalit ose në rrjedhat afatgjata të kapitalit. Në periudhën 1980-1984 investimet e huaja direkte përfaqësonin, rreth 3 përqind e formimit të kapitalit bruto në vendet në zhvillim. Ndërsa pjesa e investimeve të huaja direkte në kapitalin

¹⁷ Anreu Stophlen, Oclahoma University Press, year 2006, page 136

¹⁸ Shih, prof.dr. Mehdi J. Hetemi, "Pagesat Ndwrkombwtare", Prishtinw, 2001, fq.5-279

afatgjatë në flukse ishte rreth 17 për qind për vendet në zhvillim në tërësi gjatë viteve 1980-1985, nga rreth 4 për qind në vitet 1975-1979¹⁹.

1.5 GLOBALIZIMI EKONOMIK FRENUES APO ZHVILLUES PËR INVESTIMET E HUAJA DIREKTE

Si term “globalizimi” ka filluar të përdoret qysh në vitin 1944, mirëpo ekonomistët kanë filluar këtë term ta aplikojnë aty kah viti 1981. Termi “fshat global” u afirmua pas botimit të veprës...²⁰. Ndërkaq **Theodore Levitt** është meritori për farkimin e termit ‘globalizim’ përmes një artikulli të tij që ai e shkroi në vitin 1983 për Harvard Business Review të titulluar...²¹.

Meqë ky term ka dy kuptime, edhe teknike edhe politike, është e qartë se grupe të ndryshme do të kenë edhe histori të ndryshme të “globalizimit”.

Në trajtimin e historisë së globalizimit, disa autorë fokusohen në ngjarjet që nga viti 1492, mirëpo shumica e dijetarëve e teoricienëve përqëndrohen në një të kaluar shumë më të afërt. Ndërkaq, shumë më përpara se viti 1492, njerëzit kishin filluar t’i lidhin bashkë vendet e ndryshme të globit me sisteme të gjera komunikimi, migrimi e ndërlidhjeje. Forcë kryesore motivuese në historinë botërore ka qenë formimi i sistemeve të ndërveprimit ndërmjet lokales dhe globales. Të këtilla kanë qenë rastet si: përhapja dhe shtrirja e religjioneve botërore, hinduizmi, budizmi, xhainizmi, sihizmi, taoizmi, konfuçizmi, jehudizmi, krishtërimi, islami etj. ; “rruga e mëndafshhtë” (silk road), ekspansioni i Xhengis Kanit, Aleksandrit të Madh; krijimi i perandorive të mëdha botërore; zbulimi i kontinenteve tjera të botës; përhapja e tregtisë me sklevër; revolucionin amerikan e francez; kolonizimi; luftërat botërore; dekolonizimi etj²².

¹⁹ Anre Stophlen, Oclahoma University Press, year 2006, page 138

²⁰ Understanding Media (Routledge, Londër, 1964) nga autori M. McLuhan

²¹ Globalization of Markets (“Globalizimi i tregjeve”) Mehmet S. Audin: Küreselleşmeye Genel Bir Bakış”, në: grup autorësh, Siyasi, Ekonomik ve Kültürel Boyutlarıyla Kreselleşme, Ufuk Kitapları, Stamboll 2002, fq.13

²² Andre Gunder “A Quick Guide to the World History of Globalization”, (Globalization since the Future Centry) në: (www.sas.upenn.edu/~dlud), fq. 5

Gjykojmë se globalizimi është proces që arrijmë ta shmangim, sepse ka përfshirë gjithë botën, gjithashtu edhe vendin tonë, prandaj neve si shtet që është ende në periudhën e tranzicionit na mbetet ta mirëpresim globalizimin, sepse do ndikojë në zhvillimin ekonomik të vendit.

Globalizimi me efektet e veta, kryesisht zhvillimet teknologjike në fushën e informacionit, i ka shumëfishuar dhe i ka lehtësuar ndërlidhjet midis bizneseve dhe midis vendeve duke bërë të mundur që tregu t'i kalojë kufijtë kombëtar dhe të zhvillohet lehtësisht midis tregjeve të kthyer tashmë në tregje transnacionale²³. IHD-të luajnë rol të rëndësishëm si në vendet e zhvilluara poashtu edhe në ato të cilat janë në zhvillim dhe këtë e bën në disa mënyra me ç'rast vendet që e kanë kapitalin shumë të ulët mund të kenë të mira nga këto investime me zhvillimin e projekteve të ndryshme. IHD-të gjithashtu mund të ndikojnë në shkëmbimin e të mirave materiale dhe të atyre jomateriale, gjithashtu edhe bizneset shumëkombëshe mund të ndikojnë në zhvillimin e bizneseve lokale duke krijuar një presion konkurrues. Fakti që hyrjet e investimeve direkte përfaqësojnë një pjesë të vogël të formimit të kapitalit në vendet pritëse nuk do të thotë që korporatat transnacionale janë të parëndësishme në ekonominë e tyre. Korporatat transnacionale shpesh dominojnë sektorët kryesorë modern, siç janë disa degë të prodhimit që kërkojnë teknologji relativisht përparimtare dhe eksportet e mallrave bujqësore dhe minerale²⁴.

Nga hulumtimet e deritanishme mund të shihet se në vendet e zhvilluara, për arsye të zhvillimeve globale dhe delokalizimit, pasojat negative vërehen në shtresat sociale të pakualifikuara. Duke qenë se tashmë bizneset – mëmë në vendet e origjinës (vendet e zhvilluara) merren me aspektet e projektimit, krijimit dhe marketingut të produkteve dhe shërbimeve, të cilat kanë një përmbajtje të theksuar teknologjike dhe një personel më të arsimuar dhe kualifikuar.²⁵

Shumica e trajtimeve konvencionale të globalizimit hulumton ndërlidhjet e modeleve të stilizuara të sjelljes së pjesëmarrësve të tillë në tregje në kushtet e një ekonomie ku konsiderojmë që janë më të favorshme për ta. Kjo bën që të kuptojmë se niveli i

²³ *Globalizimi ekonomik në Enciklikwn "Dashuria në të vërtetën" Prof Emilian Karma, v.c.fq.13*

²⁴ Anreu Stophlen, Oclahoma University Press, year 2006, page 145

²⁵ *Po aty, fq. 14*

investimeve të huaja brenda një vendi lidhet në fakt pozitivisht e jo negativisht me shpenzimet publike, me ato të mirëqenies sociale, me nivelet e taksimit individual²⁶.

E megjithatë në ç`pikë mund të fillojmë legjitimisht të flasim rreth mundësisë së globalizimit? A mund të quhet një fenomen globalizimi fakti që ekuipazhi i Kristofor Kolombit ua përçoi faktorët patogjen, që ata mbartin, popujve të Amerikës së Veriut? Sigurisht që për pyetje të tilla nuk ka përgjigje “të sakta”; por megjithatë, ekzistojnë zgjedhje që mund të mbrohen dhe që duhet të mbrohen²⁷.

Në ekonominë globale, e cila po rritet gjithnjë e më tepër, vendet në zhvillim përballen me sfida të mëdha në sigurimin e rritjes ekonomike, dhe atë në veçanti për shkak të kursimeve dhe investimeve të papërshtatshme, fuqisë punëtore me nivel të ulët të arsimit dhe aftësive, përkeqësimit të kushteve të tregtisë si dhe institucioneve të dobëta²⁸.

Duhet të njihet se, edhe në rrethanat më optimiste, investimet e huaja direkte nuk kanë gjasa të arrijnë nivele të konsiderueshme në vendet me të ardhura të ulëta, të cilat kryesisht janë anashkaluar nga korporatat transnacionale²⁹. Të gjitha këto janë të rëndësishme për investime afatgjata në rritje, duke përfshirë këtu edhe zhvillimin institucional dhe atë njerëzor. Mungesa e sovranitetit ngrit pasigurinë politike dhe e zvogëlon mundësinë e zgjedhjes³⁰. Në Kosovë ekziston nevoja për forcim të kuadrit të politikave për të tërhequr IJD-të (Investimet e Jashtme Direkte) dhe më shumë investime private vendore, meqë ky do jetë burimi kryesor i krijimit të vendeve të punës.³¹

1.6 ZHVILLIMI JURIDIK DHE REFORMIMI I SISTEMIT LIGJOR MBI INVESTIMET E HUAJA DIREKTE

Siguria juridike dhe efikasiteti i shërbimeve që ofrojnë institucionet është një ndihmesë e madhe dhe shtyllë kryesore në krijimin e një ekonomie funksionale të tregut. Kompanit

²⁶Teoritw e marëdhënieve ndërkombëtare fq. 356

²⁷ Po aty, fq. 348

²⁸Muhamet Mustafa & Alban Zogaj, *Thesis Kosova*, nr. 1, 2009, fq 7-8

²⁹ Anreu Stophlen, *Oclahoma University Press*, year 2006, page 165

³⁰Muhamet Mustafa & Alban Zogaj, *Thesis Kosova*, nr. 1, 2009, fq 10

³¹Po aty fq. 14

të cilat dëshirojnë të investojnë në vendin tonë janë të interesuara të dijnë a ekziston sundimi i ligjit, a ka gjykata efikase, nëse ka ligje të cilat garantojnë pronën si dhe shërbime efikase administrative.

Investitorët e huaj nuk janë të gatshëm që të rrezikojnë investimet e tyre nëse në vendin që ata dëshirojnë të investojnë, nuk funksionon si duhet ligji. Nëse gjykata nuk ju garanton zbatimin e kontratave, apo nëse administrata publike do të jetë e paparashikueshme dhe ngarkon bizneset me procedura të panevojshme. Pengesat e tilla të panevojshme i largojnë investitorët dhe ata investojnë në një vend tjetër ku sundimi i ligjit është në nivelin e duhur dhe ku gjejnë siguri më të madhe juridike dhe efikasitet institucional.

Me qëllim të tërheqjes sa më të madhe të investitorëve së pari duhet të punohet me shumë në fuqizimin e sistemit të drejtave pronësore, që do të thotë se kur një biznes bën blerjen e tokës të jetë i sigurt për të zhvilluar aktivitet ekonomik.

Për të krijuar një klimë sa më të favorshme për tërheqjen e investitorëve institucionet e vendit duhet të punojnë shumë që të kemi efikasitet në gjykata për zgjidhjen e rasteve.

Duke marrë parasysh se niveli i korrupsionit është në një shkallë mjaft të lartë, që do të thotë se kjo ndikon që investitorët mos të investojnë në vendin tonë, duhet të punohet me shumë në këtë drejtim me qëllim të tërheqjes së investitorëve dhe ofrimit të një sigurie më të madhe ligjore. Kjo besoj që do të arrihet me uljen e nivelit të korrupsionit dhe garantimin e trajtimit të drejtë dhe jo-diskriminues për të gjithë operatorët ekonomik.

Gjithashtu për investitorët janë mjaft të rëndësishme edhe procedurat administrative që ata duhet të kalojnë. Me procedura të thjeshtësuara që nënkupton kryerjen e shërbimeve në një vend dhe eliminimin e rregullave të tepërta për dhënien e licencave dhe lejeve për bizneset. Sundimi i ligjit luan rolin kryesor në tërheqjen e investitorëve që do të thotë se duhet të ketë ndëshkime për ata që e shkelin ligjin. Nëse një kompani nuk punon në përputhje me rregullat dhe ligjin ajo duhet të ndëshkohet, mirëpo në të njëjtën kohë kompanitë që punojnë në përputhje me ligjin do të mbrohen prej ndëshkimeve arbitrare.

1.7 PËRMIRËSIMET LIGJORE NË VENDET NË ZHVILLIM DHE VENDI QË IHD KANË NË KËTË KONTEKST

Rritja e investimeve të huaja në vendet në zhvillim është më komplekse se sa në vendet e zhvilluara. Po kështu përse i përket kushteve të punës, investitorët e huaj kërkojnë të investojnë kryesisht në ato vende ku zbatohet legjislacioni. Gjithashtu zbatimi i rregullave dhe të drejtat e pronësisë janë të qarta, ku ka më pak korrupsion, ku forca punuese është më e kualifikuar, pra në ato vende ku qartësia apo sundimi i ligjit është evident. Sikurse, qartësia, poashtu edhe sundimi i ligjit vihet re në ato vende që kanë një demokraci pak a shumë të konsoliduar. Vetë fakti që pjesa më e madhe e investimeve direkte drejtohen në ato vende ku ka një qartësi më të lartë ligjore dhe forcë punëtore më të kualifikuar, tregon se synimi primar i investitorëve të huaj nuk është shfrytëzimi i drejtpërdrejtë i kapitalit njerëzor. Siç mund të kuptojmë pra investimet e huaja përqendrohen më shumë në ato vende ku sundimi i ligjit është në nivelin e duhur si dhe ku shkalla e korrupsionit është nën zero. Kjo do të thotë se Kosova dhe Shqipëria kanë ende punë të papërfunduara sa i përket këtyre dy aspekteve të rëndësishme për investitorët e huaj.

Si shembull mund të marrim rastin e Shqipërisë, edhe pse investimet e huaja kanë pësuar një rritje konstante në vite, çështja e paqartësisë së pronësisë është një pengesë e madhe që i frenon investitorët për të derdhur investimet e tyre në këtë vend.

Gjithashtu mund të themi se edhe në këtë aspekt nuk shihet një lidhje e drejtpërdrejtë mes rritjes së aktivitetit të bizneseve shumëkombëshe dhe përkeqësimit të kushteve të punës së punonjësve³². Ajo që vihet re është se në ato vende ku ka një arsimim më të lartë, ku ka punonjës më të kualifikuar dhe ku ka rregulla të qarta, pra mundësi kontraktimi të qartë dhe të garantuar, janë derdhur më shumë investime dhe bizneset shumëkombëshe kanë pasur një impakt pozitiv në zhvillimin e atyre vendeve, p.sh në vendet e ashtuquajtur *tigrat aziatikë*.

Në këtë aspekt, së pari qeveritë e vendeve në zhvillim së bashku me investitorët e huaj duhet të luajnë rol vendimtar në krijimin e kushteve të arsimit dhe edukimit për t'u liruar

³² Globalizimi- Problemet ndërkombëtare të cilat po shkaktohen si pasojë e Globalizimit (<http://www.forumishqiptar.com/showthread.php>), fq.

nga nevoja e njohurive dhe zhvillimit të teknologjive dhe për të zhvilluar kapitalin njerëzor. Së dyti qeveritë (apo të ashtuquajturit *policy makers*) e vendeve në zhvillim duhet të kujdesen që të krijohen kushte për mbrojtjen e konkurrencës dhe tregut si dhe eliminimin e mundësive për monopol apo koncentrim nga ana e bizneseve që operojnë në ato vende. Së treti, hapjen e tregut, *policy makers* duhet ta ekuilibrojnë me një zhvillim të amortizatorëve socialë, në mënyrë që të mbrohen dhe të rikualifikohen kategoritë e punonjësve që mund të gjenden në vështirësi nga ndryshimet në globalizimin ekonomik³³.

1.8 PROBLEMATIKAT QË KANË SOT IHD –të NË RAJON

Zhvillimi ekonomik i Kosovës poashtu edhe i vendeve të rajonit është i ndërlidhur me investimet e huaja direkte, që do të thotë se, kanë një rëndësi të madhe sa i përket ekonomisë së këtyre vendeve. Mirëpo, për shkak të problematikave që po hasin IHD, sidomos në mbrojtjen juridike të tyre, mund të themi se një zhvillim të tillë nuk po e përjetojmë në masë të duhur, megjithatë themi se IHD-të po luajnë rol të rëndësishëm sa i përket zhvillimit ekonomik të vendit dhe rajonit.

Investimet e Huaja në Kosovë themi se nuk kanë dhënë suksesin e dëshiruar, e kjo vë re si pasojë e respektimit të ulët të rendit dhe ligjit, korrupsionit, problemet e sigurisë, gjithashtu edhe situata e paqartë e tatimeve dhe çështjet e pronësisë kanë bërë që ato të mos jenë tërheqëse. Infrastruktura jo adekuate, duke përfshirë mungesën për furnizimin me energji, ku sistemi energjetik nuk ka arritur të jetë i qëndrueshëm dhe i garantuar në gjashtë vitet e fundit, ka ndikuar edhe më shumë në perspektivën e zymtë për rritje ekonomike dhe përmirësimin e mundësive për punësim³⁴.

Shtetet e rajonit si: Shqipëria, Kroacia, Bosnje-Hercegovina, Serbia, Mali i Zi, Maqedonia kanë potencial të mjaftueshëm për tërheqjen e investimeve të huaja.

Në drejtim të rritjes ekonomike dhe tërheqjes së IHD-ve, rajoni është duke shkuar drejt përmirësimeve të mëdha. Nëse marrim parasysh papunësinë e lartë me qëllim që të kemi një rritje të qëndrueshme ekonomike kuptojmë se ka ende shumë punë për t'u përmirësuar

³³ Dashuria në të vërtetën - Prof Emilian Karma, v.c.fq.4

³⁴http://www.kipred.org/repository/docs/Shqyqrtimi_i_Sektorit_t%C3%AB_Siguris%C3%AB_s%C3%AB_Brendshme_t%C3%AB_Kosov%C3%ABs,_Faza_I&II_737398.pdf

në rajon, dhe kjo është njëra ndër problematikat që hasin IHD-të në vendet e rajonit, pra në vendet se ku dëshirojnë të investojnë kapitalin e tyre.

Në vendet e rajonit investimet e huaja direkte janë më të larta në Kroaci gjatë periudhës 1989-2007 arrijnë në 18.5 miliardë dollarë dhe rritja e vazhdueshme edhe në vitet tjera në vazhdim nëse këtë e krahasojmë me Kosovën, Shqipërinë, Malin e Zi dhe Maqedoninë, por pavarësisht kësaj, përqindja e investimeve të huaja sa vjen e rritet edhe në këto vende.

Tërheqja e investimeve të huaja është një detyrë që duhet ta kryejnë me shumë përkushtim institucionet e vendeve. Qeveritë e vendeve pritëse duhet të punojnë shumë për krijimin e një imazhi sa më të mirë për shtetet e tyre, për një infrastruktur ligjore, për lehtësira në të bërit biznes, me qëllim të tërheqjes së një numri të madh të investitorëve. Kjo nuk do të thotë se krijimi i kushteve të përshtatshme mund të ndikojë në masë të madhe në tërheqjen e investimeve, duhet të kemi një promovim sa më të mirë të shtetit, të krijojmë një imazh sa më të pasur sa i përket vendeve tona. Tek çështja e promovimi duhet të angazhohen promotorët profesionistë që të punojë në këtë drejtim.

KAPITULLI II

KUADRI LIGJOR NË MBËSHTETJE TË INVESTIMEVE TË HUAJA DIREKTE

Hyrje

Mbështetja ligjore e investimeve të huaja është në interes si për investitorin poashtu edhe për vendet pritëse. Investitorëve të huaj vendet pritëse duhet t'u ofrojnë, në radhë të parë, siguri publike, pastaj ligjore duke vazhduar me ofrimin e kushteve sa më të mira për të investuar. Nënshkrimi i traktateve bilaterale dhe multilaterale mendohet se do të ndikojë në tërheqjen e investimeve për vendet që janë pjesë e këtyre traktateve. Një gjë të tillë kanë bërë edhe Kosova dhe Shqipëria, kanë nënshkruar traktatet bilaterale me qëllim të nxitjes së investimeve të huaja direkte. Marrëveshje të tilla krijohen zakonisht në mes të vendeve të zhvilluara dhe atyre në zhvillim duke pasur parasysh që vendet e zhvilluara kapitalin e tyre nëpërmjet investimeve dhe investorëve e derdhin në vendet në zhvillim dhe kjo ndikon në të mirë të vendeve pranuese të kapitalit, por gjithashtu është edhe në të mirë të vendeve investuese, sepse është në interesin e tyre investimi në një vend i cili është në zhvillim e sipër. E tërë kjo na bënë të kuptojmë se për të tërhequr sa më shumë këto investime shteti i Kosovës dhe ai i Shqipërisë duhet të punojnë në atë drejtim që të bëjnë një promovim sa më të mirë në raport me investorët.

2.1 MBROJTJA JURIDIKE E INVESTIMEVE NË VENDET E BE-SË

Ndryshimet në ekonominë botërore që kanë ndodhur gjatë vitit 1980 kanë ndikuar negativisht në zhvillimin ekonomik të kontinenteve socialiste, veçmas të Evropës Lindore. Ngadalësimi i ecursisë ekonomike në tregjet perëndimore e bëri shumë më të vështirë për të rritur ose mbajtur eksportet në këto vende³⁵. Kjo bëri që as investimet e huaja nuk patën ndonjë ndikim të madh në përmirësimin e ekonomisë së këtyre vendeve.

Shumë shtete qofshin ato anëtare të BE-së apo jo kanë interes nga investimet e huaja direkte, ndër to janë edhe SHBA-të. Shumica e shteteve me qëllim të tërheqjes së një numri sa më të madh të investimeve kanë nënshkruar Traktate Dypalëshe të Investimit (Bilateral Investment Treaties - BIT). Kompanitë që janë themeluar në BE, por që kontrollohen nga shtetas të vendeve të treta ose janë në shtetësi të tyre mund të kenë trajtim ndryshe nga

³⁵ Ledvinn Ourin, University of California, year 2017, page 5

kompanitë vendore për arsye të sigurisë publike ose shëndetit publik dhe politikës publike, që do të thotë se investitorët e huaj duhet të jenë të vedëdjshëm për një gjë të tillë.

Korniza themelore ligjore përbëhet nga ligjet që rregullojnë:

- a. kushtet e pranimi të kapitalit të huaj,
- b. procedurat e autorizimit dhe format e sipërmarrjeve,
- c. ligjet, rregulloret ose marrëveshjet e dakorduara reciprokisht, praktikat në lidhje me themelimin dhe funksionimin e ndërmarrjeve të përbashkëta³⁶.

Duke pasur parasysh se kushtet e traktateve të investimeve janë të ndryshme dhe se ekziston një lidhje e mundshme mes ekzistencës së një traktati të investimeve dhe IHD-ve mund të jetë e dobishme të hetohet nëse kushtet specifike të traktateve të investimeve ndikojnë në IHD³⁷. Në të vërtetë të gjitha liritë themelore të tregut të brendshëm (dmth. lëvizja e lirë e mallrave, punëtorëve dhe kapitalit) i nënshtrohen përjashtimit të politikës publike në Traktat. Me anë të tyre shtetet anëtare rezervuan të drejtën për të pezulluar ato liri për të marrë masa rregullatore për të mbrojtur interesat kombëtar në rrethana të jashtëzakonshme, madje në dëm të diskriminimit ndaj shtetasve të shteteve të tjera të BE-së³⁸.

Jo vetëm zbatimi i direktivave të BE-së që koordinojnë kuadrin ligjor për trajtimin e veçantë të investimeve të huaja, por edhe masat rregullatore kombëtare të marra nga shtetet anëtare në mungesë të harmonizimit bien ndesh me trajtimin kombëtar të investimeve³⁹. Duke u përballur me dilemën e zgjedhjes midis respektimit të detyrimeve të tij ose vendit tjetër sipas ligjit ndërkombëtar, ruajtjes së integritetit, të rendit juridik e traktateve të BE-së, një gjykatës i një shteti anëtar të BE-së është në parim i detyruar të vendos në favor të këtij tëfundit⁴⁰. Aktet legjislative të ekonomive të planifikuara në nivel qendror, që autorizojnë dhe rregullojnë operacionet e përbashkëta, zakonisht miratohen në formën e vendimeve ose dekreteve të organeve më të larta legjislative⁴¹.

³⁶ Po aty, fq. 8

³⁷(*Foreign Direct Investment, Investment Treaty Arbitration, and the Rule of Law*, Susan D. Franck, fq. 354).

³⁸(*Komisioni European, Komunikimi për aspekte të caktuara ligjore, lidhur me interesat brenda BE-së (97/C 220/06)*, 1997 220/15, <http://eur-lex.europa>

³⁹Anne van Aaken, ``Ligji Ndërkombëtar i investimeve midis angazhimit dhe fleksibilitetit: Një kontratë Analiza teorike``, *Gazeta e së drejtës ekonomike ndërkombëtare* 507-2009, 523-7

⁴⁰(*Konventa ICSID nenet 53 dhe 54 të cilat detyrojnë çdo shtet kontraktues që të njohë dhe zbatojë çmimet e ICSID*

⁴¹ Ledvinn Ourin, University of California, year 2017, page 11

Ekzistojnë dilema nëse arbitrazhi i traktatit të investimeve pengon zhvillimin vendor të sundimit të ligjit ose ndikon negativisht në nxitjen për të investuar. Disa autorë janë të mendimit se arbitrazhi i traktatit të investimeve ndikon negativisht në sundimin e ligjit në vendet në zhvillim. Për këtë arsye sygjerojnë se ekzistenca e zgjidhjes ndërkombëtare të kontesteve për investimet e huaja pengon zhvillimin e sundimit të ligjit në gjykatat kombëtare duke krijuar një regjim që ofron privilegj për investorët e huaj dhe heq kontestet e investimeve nga gjykata vendore⁴².

Marrëveshja tregëtare në mes të BE-së dhe vendeve të treta siç është, Marrëveshja e Asociimit me Kilin, Marrëveshja e Tregëtisë së Lirë (MTL) me Kaliforninë dhe Korenë e Jugut mbulojnë çështjen e investimeve të huaja direkte. Këto marrëveshje të BE-së, të cilat me ratifikimin e tyre teknikisht bëhen pjesë e së drejtës së BE-së, kryesisht kanë të bëjnë me liberalizimin e investimeve në shërbime dhe sektorë industrial të cilët adresojnë të drejtat e themelimit të investorëve, duke përfshi kufizimet e mundshme që mund të imponojnë palët në MTL. Një shembull për këtë, që pasqyron problemet e papajtueshmërisë me ligjin “vendor” të BE-së mund të gjendet në dispozitat për transferimin e kapitalit në Marrëveshjen e Asociimit me Kilin.

Ato lejojnë palët kontraktuese në rast të bilancit të pagesave serioze dhe vështirësive të jashtme financiare të miratojnë masa kufizuese në lidhje me tregëtinë e mallrave dhe shërbimeve dhe në lidhjen me pagesën dhe lëvizjen e kapitalit, përfshirë ato që lidhen me investime direkte⁴³.

Megjithatë BIT-të e nënshkruar nga shtetet anëtare me Kilin, lejojnë palët kontraktuese në rast të bilancit të pagesave serioze dhe vështirësive financiare të jashtme të miratojnë masa kufizuese në lidhje me tregëtinë e mallrave dhe shërbimeve dhe në lidhje me pagesën dhe lëvizjen e kapitalit përfshirë ato që lidhen me investimet direkte⁴⁴.

Në rast se një investor nuk i përfill kufizimet e lejuara MTL duke u thirrur në dispozitat e BIT, kjo do të zvogëlonte bilancin e përgjithshëm të arritur për këtë regjim tregëtar për të gjitha aktivitetet ekonomike të mbuluara nga MTL. Kjo do t'i mposhtë marrëveshjet e Bashkimit European për të krijuar një fushë të barabartë për investimet e jashtme nga të

⁴²*Foreign Direct Investment, Investment Treaty Arbitration, and the Rule of Law, Susan D. Franck, fq. 366*

⁴³*Marrëveshja e Asociimit BE- Kili, neni 195*

⁴⁴*Po aty, neni 196*

gjitha vendet anëtare të BE-së, në mënyrë që të mos shkaktohet çrregullim në tregun e BE-së si pasojë e mosmarrëveshjeve.

Duhet të cekim se burimet më të rëndësishme të investimeve janë traktatet dypalëshe të investimeve. Prej vendeve të para që kanë hyrë në BIT janë: Gjermania, Zvicra, pastaj kanë vazhduar edhe vendet e tjera, me ç'rast deri në vitin 2008 kanë pasur rreth 2600 BIT në mbarë botën. BIT përmbajnë disa karakteristika: përkufizimi i gjerë për investitorët, përkufizimi i gjerë për investimet, trajtimi i drejtë dhe i barabartë për investimet e huaja, garanci për mbrojtje dhe siguri të plotë, garanci kundër trajtimit arbitrar dhe diskriminues, trajtim kombëtar, garanci në rast të shpronësimit, garancitë në lidhje me transferimin e lirë të pagesave, zgjedhjen e mosmarrëveshjeve ndërmjet shteteve kontraktuese, zgjedhjen e mosmarrëveshjeve midis shtetit pritës dhe investitorit, duke përfshirë arbitrimin⁴⁵.

2.1.1 TRAKTATET MULTILATERALE

Organizata Botërore e Tregëtisë (OBT) dhe Organizata për Bashkëpunim dhe Zhvillim Ekonomik (OECD) kanë filluar krijimin e traktateve shumëpalëshe më herët. Për shkak të frikës së vendeve në zhvillim nuk kanë qenë të suksesshme, sepse mendohej se një traktat i tillë shumëpalësh mund të ndikonte në kufizimin e ekonomive të tyre.

Traktatet shumëpalëshe ekzistojnë në fusha të specializuara të së drejtës së investimeve. Këto përfshijnë Konventën për Zgjidhjen e Mosmarrëveshjeve të Investimeve ndërmjet shteteve dhe shtetasve të shteteve tjera (Konventa e ICSID), e cila ofron një kuadër për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve ndërmjet shteteve pritëse dhe investitorëve të huaj nëpërmjet arbitrazhit dhe pajtimit⁴⁶.

Në epokën e rritjes së veprimtarive ekonomike ndërkufitare, numri i mosmarrëveshjeve në lidhje me investimet e huaja ka rënë ndjeshëm dhe deri tani ka formuar një kategori të dallueshme të mosmarrëveshjeve ndërkombëtare. Këto mosmarrëveshje përfshijnë pohime për dëmtim ose shkatërrim të interesave ekonomike të investitorëve të huaj në shtete

⁴⁵Christoph Schreuer – *Investments, International Protection*, fq.6, Janar 2011

⁴⁶Po aty fq. 10

pritëse. Interesa të tilla ekonomike përfshihen nga termi investim. Investimi mund të kuptohet si transaksion dhe si një aktiv⁴⁷. Shumica e mosmarrëveshjeve të investitorëve të brendshëm dhe të jashtëm sillen përpara gjykatave ndërkombëtare të arbitrazhit në përputhje me dispozitat për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve, të marrëveshjeve ndërkombëtare të zbatimit të investimeve (MNI). Marrëveshjet ndërkombëtare të zbatimit të investimeve kërkojnë të nxisin dhe mbrojnë investimet e huaja të bëra në një vend pritës. Ato përcaktojnë detyrimet thelbësore të shteteve pritëse dhe lejojnë investitorët të sjellin rregullat ndërkombëtare, kur një shtet shkel detyrimet ndaj investitorëve⁴⁸.

2.2 MARRËVESHJET BILATERALE PËR MBROJTJEN JURIDIKE TË INVESTIMEVE TË HUAJA DIREKTE NË KOSOVË, SHQIPËRI DHE VENDET TJERA TË RAJONIT

Sot kur bashkëpunimi ndërshtetëror paraqitet si imperative, shtetet lidhin shumë marrëveshje bilaterale dhe multilaterale, e mund të thuhet se sa më i madh të jetë numri i këtyre marrëveshjeve nërmjet shteteve, është vështirë që punët ndërkombëtare dhe tretmani i tyre juridik të ndahet nga ato vende⁴⁹.

Shqipëria dhe Kosova kanë nënshkruar marrëveshje bilaterale për Nxitjen dhe Mbrojtjen e Investimeve. Qëllimi i marrëveshjes është krijimi i kushteve më të mira për nxitjen e investimeve si dhe inkurajimin e investitorëve duke rritur sigurinë e tyre.

Bizneset të cilat investojnë kapitalin e tyre me nënshkrimin e kësaj marrëveshje garantohen që kapitali i investuar është në mbrojtje të sigurtë.

Sipas Agjensisë për Investime dhe përkrahjen e ndërmarrjeve në Kosovë, shteti ynë ka nënshkruar marrëveshje bilaterale me një numër të shteteve për Mbrojtjen dhe Promovimin e Investimeve, si me: SHBA (OPIC), Austrinë, Turqinë, Shqipërinë, Zvicrën, Belgjikën dhe Luksemburgun, Emiratet e Bashkuara Arabe, dhe Maqedoninë.

Marrëveshjet sigurojnë:

⁴⁷*Damages in International Investment, Sergey Ripinsky, Kevin Williams (2008), fq. 5, British Institute of International and comparative Law*

⁴⁸*Po aty, fq. 21*

⁴⁹ *Mehdi J. Hetemi v.c. fq.93*

- a) Mbrojtje dhe Siguri të investimeve
- b) Transfer të Lirë të Fondeve
- c) Riatdhesim të Lirë të Profitit dhe Dividendës
- d) Mbrojtje nga Aplikimi Retroaktiv i Ligjeve
- e) Mbrojtje nga Shpronësimi

Investimet e huaja direkte luajn rol kyç në zhvillimin kombëtar dhe ndërkombëtar. Mbrojtja juridike e investimeve të huaja direkte sjell dobi në sistemet tregtare botërore, duke ditur se investimet janë motori kryesor i zhvillimit ekonomik dhe kanë shumë rëndësi në qëndrueshmërinë ekonomike. Shqipëria gjithashtu ka nënshkruar Marrëveshje për Mbrojtjen e Investimeve, përveç me Kosovën edhe me shtete të tjera ndër të cilat është edhe Franca, Çekia, Emiratet e Bashkuara, Maqedonia.

Marrëveshje të tilla ka nënshkruar edhe Maqedonia me përmbajtje përafërsisht të njëjtë me këto shtete: Republikën e Shqipërisë, Republikën e Turqisë, Malajzinë, Republikën e Kinës, Republikën Demokratike Popullore të Koresë. Në preambulën e këtyre marrëveshjeve palët kontraktuese përcaktojnë arsyet e lidhjes së kësaj kontrate duke u thirrur në krijimin e kushteve të favorshme për nxitjen e bashkëpunimit në sferën e investimeve⁵⁰.

Investuesit e huaj për të investuar në një vend dëshirojnë siguri juridike për investimet e tyre. Prandaj në rast të mosmarrëveshjeve në mes të palëve kontraktuese bëhet përpjekje që të zgjidhen me negociata apo konsultime. Në rast se nuk arrihet marrëveshje, atëherë mosmarrëveshjet zgjidhen nëpërmjet gjykatës kompetente të palës kontraktuese në territorin e së cilës është bërë investimi. Në rast se mosmarrëveshjet në mes të palëve kontraktuese nuk mund të zgjidhen në Gjykatën Kompetente, çështja shkon në Gjykatën e Arbitrazhit, ku caktohet me kontratë të veçantë sipas rregullave për arbitrazh të Komisionit për të drejtën ndërkombëtare tregtare pranë Kombeve të Bashkuara (UNCITRAL). Vendimi i cili merret në arbitrazh është i obligueshëm për palët kontraktuese.

Marrëveshjet dypalëshe gjithashtu kanë rëndësi edhe mbi tatimin e dyfishtë dhe garancitë e lidhura midis vendeve anëtare të CMEA dhe ekonomive të zhvilluara të tregut. Më tej i

⁵⁰Adnan Jashari- Aspekti juridik i investimeve të huaja në shtetet në tranzicion, Tetovë 2007, fq.157

përforcojnë garancitë të cilat kanë të bëjnë me shpronësimin dhe riatdhesimin e fitimeve dhe kapitalit të investuar nga partneri i huaj⁵¹.

2.3 MARRËVESHJET MULTILATERALE PËR MBROJTJEN E INVESTIMEVE TË HUAJA DIREKTE NË VENDET E RAJONIT, KOSOVË DHE SHQIPËRI

Dokumenti i parë multilateral i aprovuar në lëmin e investimeve të huaja është ai “Trewarld investment (World bank Gudelines) i cili u nxorr më 1990. Edhe pse pa force të obligueshme, ky instrument ndërkombëtar ka pasur ndikim të rendësishëm në formësimin apo sajimin e ligjeve dhe marrëveshjeve të cilat kanë qenë të lidhura me investimet e jashtme në tërë botën⁵².

Investimet e huaja mbrohen juridikisht edhe me rregulla multilaterale përveç atyre që kemi cekur me lartë të cilat janë bilaterale. Pasi që në çdo shtet, përfshirë këtu edhe shtetet e vendeve të rajonit, Kosovën dhe Shqipërinë mund të paraqiten rreziqe të shumta komerciale, por dhe jokomerciale me ç’rast investitorët kërkojnë lehtësime në investimet e tyre. Duke zëvendësuar sistemin e rregullimit bilateral të mbrojtjes së investimeve të huaja, do të mundësohet që rregullat e lojes të jenë për të gjithë të njëjta. Si pasojë e kësaj Komisioni i Unionit Evropian ka shqyrtuar eliminimin e kushteve jo të barabarta për investime direkte si pjesë kryesore e strategjisë së saj për ekonomi të hapur botërore⁵³.

Sa i përket mbrojtjes ndërkombëtare të investimeve të huaja direkte rol tërëndësishëm në këtë aspekt përveç Fondit Monetar Ndërkombëtar (FMN) luan edhe Organizata Botërore e Tregtisë; Marrëveshja e Përgjithshme për Dogana dhe Tregti (GATT); Marrëveshja mbi aspektet tregtare të të drejtave të pronësisë intelektuale (TRIPS); Marrëveshja mbi aspektet tregtare të investimeve të huaja. Këto marrëveshje kanë për qëllim që t’u ofrohet mbrojtje juridike investimeve dhe t’u ndalohej shteteve që masat të cilat i ndërmarrin të kenë efekt negativ në investimet e huaja. Gjithashtu sa i përket mbrojtjes së investimeve të huaja vlen

⁵¹ Ledvinn Ourin, University of California, year 2017, page 32

⁵² Mehdi J. Hetemi – Disa tema aktuale të ekonomisë së tregut, fq.94-95, Prishtinë 2005

⁵³ Po aty, fq. 163

të permendet edhe Banka Botërore (BB), roli i saj dhe agjensioneve të specializuara të saj. Agjensioni më i rëndësishëm konsiderohet të jetë Agjensioni për Sigurinë Multilaterale të Investimeve të Huaja (MIGA). Agjensioni ndërkombëtar për sigurinë e investimeve ka aftësi të plotë juridike dhe afariste. Ajo gëzon statusin e një organizate ndërkombëtare, veprimtaria e së cilës është e rregulluar me Konventë, rregulla të së drejtës ndërkombëtare dhe ligjet e shteteve anëtare⁵⁴. Ky agjension e ka selinë në Vashington D.C. ku edhe i zgjidh kontestet në selinë e agjencionit, nëpërmes Këshillit të Guvernatorëve, Kryetarit dhe Këshillit të Drejtorëve.

Në këtë kontekst mendojmë se për rritjen e investimeve në shtetet e rajonit agjensioni duhet të ndërmarrë hapa të sigurtë, me ç'rast, në radhë të parë ajo çfarë duhet të bëjnë shtete është përmirësimi i klimës investuese. Agjencioni për të funksionuar sa më mirë në këto shtete duhet të lidhë marrëveshje me qëllim të sigurimit të statusit të agjencionit të favorizuar për dallim prej agjensioneve nacionale të cilat punojnë në sigurimin e investimeve në shtetet e tyre.

Shqipëria ka themeluar Agjencinë Shqipëtare të Zhvillimit të Investimeve (AIDA) e cila është themeluar dhe funksionon në bazë të Ligjit nr. 10303, të datës 15 korrik 2010.

Objektivat kryesore të AIDA-s janë:

- a. tërheqja e investimeve të huaja,
- b. rritja e konkurrueshmërisë së ekonomisë shqiptare,
- c. mbështetja e ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme,
- d. inovacioni.

AIDA ofron për investitorët e huaj dhe vendas, mbështetje gjithëpërfshirëse për projektet e tyre të investimeve. Stafi i kualifikuar asiston jo vetëm me analiza mbi tregun, sektorët potencialë për investime, por edhe me këshillime për gjetjen e pronave dhe vendndodhjeve të përshtatshme, ashtu si edhe ndihmon në identifikimin e projekteve të reja dhe ekzistuese për bashkëpunim. Gjithashtu, AIDA ofron shërbime të përkujdesjes së mëtejshme duke synuar të përmbush në mënyrë të suksesshme kërkesat e investitorëve të huaj edhe pas përfundimit të projekteve⁵⁵.

⁵⁴ Po aty, fq. 167

⁵⁵<http://aida.gov.al/faqe/rreth-nesh>

Kosova gjithashtu ka themeluar Agjencinë për Investime dhe Përkrahjen e Ndërmarrjeve në Kosovë (KIESA), qëllimi i së cilës është të promovojë dhe mbështes investimet, si ato vendore dhe të huaja. Kjo është paraparë edhe me Ligjin për investimet e huaja (Ligji Nr. 04/2013)⁵⁶ me ç'rast sigurohet trajtim i barabartë për investitorët e jashtëm dhe ata vendor. Investimet e Huaja të cilat veprojnë në Kosovë biznset e tyre i regjistrojnë në Agjencinë e Regjistrimit të Bizneseve të Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë (ARBK).

2.4 KONTRATAT E INVESTIMEVE

Investitori i huaj, investon në shtetin pritës sipas marrëveshjes që mund të lidh me palën tjetër, marrëveshje e cila bëhet përmes kontratave, e cila mund të ndryshojë varësisht nga forma, përcaktimi apo përmbajtja. Kontratat në mes të shteteve dhe personave në të shumtën e rasteve referohen si koncesione, të cilat përfshijnë: kontratat e shërbimit, ndërtimin, operimin dhe transferimin e kontratave.

Duke pas parasysh që secila palë do të favorizojë sistemin e vet ligjor sa i përket kontratave të investimeve, klauzola shtetërore është tipar i rëndësishëm. Investitori favorizon sistemin juridik me anë të të cilit siguron stabilitet dhe siguri nga ndryshimet e njëanshme që mund të ndodhin, ndërsa sa i përket shtetit pritës, favorizon zgjedhjen e rendit të vet ligjor. Nëse palët në zgjidhjen e një rasti nuk mund të arrijnë një marrëveshje me qëllim që ajo marrëveshje të arrihet në mes të investitorit të huaj dhe shtetit pritës duhet zbatuar rregullat ndërkombëtare të cilat janë në harmoni me ligjin ndërkombëtar. Kështu, nëse vie deri te mosmarrëveshja në mes të palëve, ajo mund të zgjidhet sipas Konventës ICSID. Sipas nenit 42 të Konventës ICSID⁵⁷ dakordimi i palëve do të mbizotrojë në zgjidhjen e mosmarrëveshjeve. Mirëpo, në rast se kemi mungesë të zgjidhjes së mosmarrëveshjeve gjykata është e obliguar të zbatojë rregullat e të drejtës ndërkombëtare si dhe ligjin e shtetit pritës. Sipas të drejtës zakonore ndërkombëtare, shtetet nuk kanë asnjë detyrim të pranojnë investimet e huaja. Një shtet është i lirë të përjashtojë investimet e huaja krejtësisht ose t'i

⁵⁶Ligji Nr. 04/2013

⁵⁷ Konventa ICSID <https://icsid.worldbank.org/en/Documents/resources/2006%20CRR-English-final.pdf>

pranojë ato në disa sektorë ose rajone të caktuara. Gjithashtu është i lirë të pranojë investime që u nënshtrohen kushteve të caktuara⁵⁸.

Mbrojtja e investimeve sipas traktateve, sidomos BIT, bëhet zakonisht përmes standardeve të caktuara. Në këtë standard përfshihen: mbrojtja nga trajtimi arbitrar dhe diskriminues, mbrojtja dhe siguria e plotë, trajtim kombëtar dhe trajtim më i favorizuar.

Mbrojtja e plotë dhe siguria

Klauzolat të cilat i përmbajnë pjesa më e madhe e traktateve kanë të bëjnë me mbrojtjen dhe sigurinë e plotë të investimeve nga efektet negative. Investitorit i ofrohet mbrojtje kundër dhunës fizike, mbrojtje ligjore për investitorin. Kjo nuk do të thotë se vendi pritës i siguron investitorit mbrojtje absolute kundër shkeljes ligjore apo fizike. Shteti pritës duhet të ketë kujdes maksimal dhe duhet të ndërmarrë masa që mbrojnë investimet. Në rast se vet organet e shtetit veprojnë kundër këtyre standardeve kjo do të thotë se shteti në këtë rast do të jetë vet përgjegjës.

2.5 MBROJTJA JURIDIKE E INVESTITORËVE

Nevoja e madhe për investime të kapitalit të huaj në vendet në zhvillim dhe në ato të pazhvilluara sot paraqet një ndër temat më të shpeshta në literaturën juridiko-ekonomike si dhe mbrojtja juridike e investimeve të huaja. Kontributi i korporatave transnacionale në financimin e investimeve në vendet në zhvillim me të ardhura të ulta nuk është edhe aq i rëndësishëm. Nga të dhënat e viteve të mëhershme rreth 40 vende me të ardhura të ulta kanë pasur investime të brendshme bruto nga investimet e huaja direkte diku rreth 9 përqind⁵⁹.

Dispozitat me të cilat janë rregulluar investimet e jashtme rëndomë janë përfshirë në dispozita të veçanta në “Ligjet për investime ose kodekse”. Këto mund të jenë ligje të

⁵⁸ *Po aty, fq. 42*

⁵⁹ Ledvinn Ourin, University of California, year 2017, page 33

përgjithshme (për investimet e huja) ose të veçanta (me të cilat rregullohen investimet në sektorë të ndryshëm siç janë: bujqësia, teknologjia e lartë, turizmi, infrastruktura).

Përveç në ligjet themelore dispozitat mund të gjenden edhe në një sërë aktesh nënligjore nga lëmenj të ndryshëm, që me të drejtë thuhet se të huajve ua vështirëson gjeturinë në to. Përveç këtyre dispozitave të brendshme (nacionale) ekziston nevoja që disa çështje, në veçanti ato që kanë të bëjnë me mbrojtjen e investimeve të huaja direkte, të rregullohen në mënyrë uniforme apo të harmonizuar për dy ose më shumë shtete.

Në vitin 1994 SHBA-të e kanë ofruar modelin e tyre të një marrëveshje të tillë bilaterale në formë të një kontrate⁶⁰.

Ne gjykojmë se marrëveshja rekomandon që të krijohet sistem unik i rregullave lidhur me qasjen e investimeve të jashtme dhe investorëve. Mund të themi se për tërheqjen e investorëve si në Kosovë, Shqipëri poashtu edhe në vendet e rajonit, duhet të kemi një plan strategjik sa i përket kësaj çështjeje, sidomos duhet të përqëndrohemi në mbrojtjen juridike dhe t'u ofrojmë garancione si investorëve, poashtu dhe investimeve të tyre. Mirëpo, deri më tani më tepër është punuar që të ofrohet garancione në lidhje me investimet por jo aq sa duhet edhe për investorët, gjë që bënë që investorët të krijojnë një lloj pasigurie për të investuar. Garancionet të cilat në trajta të ndryshme në (kushtetuta dhe dispozita ligjore) u ofrojnë shtetet pranuese të investimeve, kryesisht kanë të bëjnë me mbrojtjen e investimeve të huaja, e më rrallë edhe me mbrojtjen e pozitës së investorit të huaj. Në rastin e parë garancionet kanë të bëjnë me:

- a) Kompenzimin në rast të nacionalizimit dhe të drejtës së bartjes së mjeteve të këtilla;
- b) Repatrimi i mjeteve në rast të shitjes së ndërmarrjes së vet;
- c) Raportimi i profitit në dividenden e realizuar gjatë afarizmit;
- d) Repatrimin të të ardhurave të tjera, siç janë: royalties, kompenzimi për shfrytëzimin e patentit (licencës) dhe të ngjashme;
- e) Konvertibiliteti i valutës vendore

Garancitë e pozitës së investorit të huaj në territorin vendor sigurohen me dhënien e tretmanit nacional për investorin e huaj. Rregullorja për investimet e jashtme në Kosovë u garanton investorëve të huaj të rejtat në investime. Investorit të huaj i është dhënë e

⁶⁰The 1994 U.S. Prototype Bilateral Investment Treaty – SHBA-BIT)Shih adr. Inter.www.ita.doc.gov/Legal/modelbit.html

drejta dhe liria e plotë që të investojë në të gjitha llojet e veprimtarive, përveç nëse me rregullore nuk është paraparë ndryshe. Me dispozitat e nenit 6 të Rregullores për investimet e huaja në Kosovë, i ndalohet që të ketë mbi 49% të pronës ose kontrollit mbi shoqëritë tregtare që janë prodhuese ose shpërndarëse të produkteve ushtarake.

Në këtë fushë të huajve u është lejuar që të themelojnë kompani ekzistuese, por që nuk mund të kenë mbi 49% të kapitalit apo qeverisjes në suaza të kompanisë. Garancionet në kuptimin e ngushtë të fjalës për investimet e jashtme janë dhënë në dispozitat e nenit 3 të Rregullores për Investime të Huaja, ku garantohet tretmani nacional, siguria juridike, e drejta e konverzionit dhe e pagimit të lirë, mbajtja e librave dhe transferi i fitimit, pasurisë etj⁶¹.

Investitori i huaj në aspektin e pjesës së tij të investuar gëzon pozitë të drejtë dhe obligime të njëjtë si dhe personat tonë fizik dhe juridik, kurse ndërmarrjet me pjesëmarrje të huaj gëzojnë pozitë të njëjtë juridike dhe afarojnë nën kushte të njëjta si dhe kompanitë e Kosovës pa pjesëmarrje (investime) të huaja.

Të gjithë investitorët dhe investimet e huaja garantohen dhe kanë barazinë e kushteve konkurruese me investitorët vendas dhe investimet e tyre⁶².

Propozimi i OECD-se (Anex 3, neni 2)⁶³ u siguron investimeve të huaja dhe investitorëve në territorin vendës “Tretman të njëjtë dhe fer”, “mbajtje të plotë dhe permanente dhe siguri” në aspektin e afarizmit, qeverisjes, mbajtjes, shfrytëzimit ose disponimit me investime të cilat në asnjë rast nuk do të guxonin të ishin më pak të volitshme nga ato që nënkuptohen sipas të drejtës ndërkombëtare. Shkalla e mbrojtjes së tillë është konkretizuar më tutje në lejinin e statusit nacional dhe të statusit të kombit me të privilegjuar për investitorët e huaj në aspektin e themelimit, arritjes, zgjerimit, afarizmit, qeverisjes, mbrojtjes, shfrytëzimit, shitjes ose mënyrës tjetër të disponimit me investime të huaja në territorin vendor.

Politikat kombëtare përdorin standardin jo më pak të favorshme në rastin e trajtimit kombëtar për investimet e huaja si dhe për tërheqjen e investimeve duhet t’u sigurohen

⁶¹Shih Rregulloren Nr. 2001/3

⁶²The Oxford Handbook of INTERNATIONAL INVESTMENT LAW 2008

⁶³ Anex 3, neni 2- <http://www.oecd.org/education/skills-beyond-school/EAG2017-Annex-3.pdf>

kushtet më të mira konkurruese për investimet e huaja në krahasim me investitorët vendas⁶⁴.

Me rregulloren për investimet e huaja në Kosovë në nenin 9 i është garantuar e drejta personit të huaj pasi t'i përmbush obligimet në mënyrë të lirë dhe pa vonesë në valutë konvertibile t'i transferojë në botën e jashtme të gjitha mjetet tjera, e në veçanti:

- a) Fitimin e realizuar në bazë të investimit të jashtëm (profitin, dividendën, etj.)
- b) Pronësinë e cila i takon sipas pushimit të firmës me pjesëmarrje të kapitalit të huaj, respektivisht pas pushimit të kontratës mbi investimin e kapitalit të huaj, pagat plotësuese,
- c) Pagesat në bazë të ekspropriimit.

2.6 MBROJTJA SHTETËRORE MBI KONFLIKTET LIGJORE PËR INVESTIMET E HUAJA DIREKTE

Në rast të mosmarrëveshjeve në mes të palëve Investimet e Huaja direkte mbrohen në bazë të ligjit për investimet e huaja ku parashihen edhe mosmarrëvshjet apo konfliktet që investitori mund të ketë qoftë me palën që kanë lidhë marrëveshje apo edhe me administratën e shtetit. Kështu, pra, mendojmë se rregullimi i këtyre mosmarrëveshjeve me Ligj do ndikojë pozitivisht në tërheqjes së investitorëve të huaj për arsye se do të krijohet një siguri më e madhe sa i përket investimeve të tyre.

Një gjë e tillë parashihet edhe në ligjin për mbrojtjen e investimeve në Republikën e Shqipërisë si dhe në Ligjin për mbrojtjen e investimeve të Republikës së Kosovës.

Sipas nenit 8 të Ligjit për mbrojtjen e investimeve të huaja të Republikës së Shqipërisë zgjidhja e mosmarrëveshjeve për një investim të huaj ndërmjet një investitori të huaj dhe një pale private shqiptare apo një ndërmarrjeje ose shoqëri shtetërore shqiptare, e cila nuk është arritur të zgjidhet me pajtim, atëherë investitori i huaj mund të zgjedh për ta zgjidhur mosmarrëveshjen sipas çdo procedure të rënë dakord më parë dhe të zbatueshme.

⁶⁴*The Oxford Handbook of INTERNATIONAL INVESTMENT LAW 2008*

Në rast se për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve nuk është parashikuar asnjë procedurë, në këtë rast investitori i huaj ka të drejtë t'i drejtohet gjykatës së arbitrazhit kompetent të Republikës së Shqipërisë, në përputhje me ligjet e saj. Mosmarrëveshje ndërmjet investorëve të huaj mund të ketë edhe me administratën shtetërore dhe në rast se nuk mund të zgjidhen me pajtim, investitori i huaj mund t'i drejtohet një gjykate apo arbitrazhi kompetent për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve.

Mosmarrëveshjet ndërmjet investorëve të huaj dhe firmave vendase mund të lindin sa i përket çështjes së shpronësimit apo kompensimit sipas nenit 7 të këtij ligji. Në këtë rast investitori i huaj mund t'i drejtohet edhe Qendrës Ndërkombëtare për zgjidhjen e Mosmarrëveshjeve të investimeve ndërmjet shtetasve dhe shteteve tjera të miratuar në Uashington, me 18 mars 1965.

Në ligjin për mbrojtjen e investimeve të huaja në paragrafin 3 të nenit 8 të këtij ligji ceket se çdo veprim i arbitrazhit është përfundimtar dhe i përvokueshëm për të gjitha palët në mosmarrëveshje.

Ligjet dhe rregullat mbi sipërmarrjen e përbashkët u prezantuan për herë të parë në Rumani, Hungari dhe Bullgari gjatë viteve 1970. Ligjet e reja u miratuan në shumicën e këtyre vendeve gjatë dekadës së tanishme⁶⁵.

Gjithashtu edhe Republika e Kosovës parasheh mbrojtjen e investimeve të huaja në bazë të ligjit për investimet e huaja i cili ka për qëllim inkurajimin dhe mbrojtjen e investimeve të huaja në Kosovë. Duke u bazuar në nenin 16 të këtij ligji, një investor i huaj ka të drejtë të kërkojë që në rast të mosmarrëveshjes për një kontest të investimit, të zgjidhet sipas një kushti apo procedure të aplikueshme me të cilën është arritur pajtimi me shkrim në mes të investorëve të huaj dhe Kosovës.

Në rast se mungon një procedurë e tillë atëherë investitori i huaj ka të drejtë që kontesti i investimit të zgjidhet në procedurë gjyqësore në gjykatën Kompetente të Republikës së Kosovës apo nëpërmjet arbitrazhit vendor dhe ndërkombëtar.

Sikurse shteti i Shqipërisë, poashtu edhe ai i Kosovës parashohin mbrojtjen shtetërore të investimeve të huaja në rast të konflikteve apo mosmarrëveshjeve me anë të Ligjeve të aplikueshme për mbrojtjen e investimeve që kanë të dyja vendet. Mirëpo, në rast se një

⁶⁵ Ledvinn Ourin, University of California, year 2017, page 26

çështje e caktuar nuk mund të zgjidhet me ligj, atëherë mbrojtja bëhet me rregullat e ligjeve ndërkombëtare që mund të jenë të aplikueshme për çështje ndërkombëtare bilaterale ose multilaterale lidhur me investimet e huaja.

Mosmarrëveshjet në rast të konfliktit për investimet e huaja në Bosnjë dhe Hercegovinë zgjidhen në bazë të ligjit. Në nenin 17 të Ligjit mbi Politikën e Investimeve të Huaja Direkte⁶⁶ në Bosnjë dhe Hercegovinë, mosmarrëveshjet zgjidhen nga gjykata përkatëse në këtë shtet, përveç nëse palët e interesuara lidhin ndonjë procedurë tjetër për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve duke përfshirë edhe arbitrazhin vendore dhe ndërkombëtar.

Shteti i Malit të Zi gjithashtu parasheh me Ligj që mosmarrëveshjet për investimet e huaja të zgjidhen nga gjykata kompetente në Mal të Zi, vetëm në rast se marrëveshja për investime parashikon që mosmarrëveshjet të zgjidhen përpara arbitrazhit vendor apo të huaj në përputhje me konventat ndërkombëtare, kjo është e rregulluar me Ligjin për Investimet e Huaja të Malit të Zi⁶⁷ në nenin 30 të këtij ligji.

Konfliktet që mund të lindin në mes të investitorëve të huaj dhe shtetit në të cilin investojnë, pra janë të rregulluara me ligjin e atij shteti në rast se vie deri te mosmarrëveshja në mes të palëve, në atë rast ajo zgjidhet nga gjykata kompetente e shtetit ose nga arbitrazhi vendor apo ai ndërkombëtar ashtu siç janë dokorduar palët më heret me marrëveshje.

2.7 TRAJTIMI I BARABART ME FIRMAT VENDËSE I IHD-VE NË KOSOVË, SHQIPËRI DHE VENDET E RAJONIT

Jemi të mendimit se për tërheqjen sa më të madhe të investimeve të huaja direkte shtetet duhet t'u sigurojnë një trajtim të barabartë investitorëve të huaja me firmat vendase. Kjo është e rregulluar edhe me Ligjin për mbrojtjen e investimeve si në Kosovë, Shqipëri dhe vendet e rajonit. Sipas Ligjit për investime të huaja në Republikën e Shqipërisë nenit 2⁶⁸, investimet e huaja lejohen dhe trajtohen mbi bazën e kushteve jo më pak të favorshme se ato që u njihen investimeve vendase në kushte të ngjashme, me përjashtim të pronësisë mbi

⁶⁶Ligjit mbi Politikën e Investimeve të Huaja Direkte në Bosnje dhe Hercegovinë

⁶⁷Ligjin për Investimet e Huaja i Malit të Zi

⁶⁸Ligjin për Investimet e Huaja të Malit të Zi

tokën e cila rregullohet me ligj të veçantë. Pra, sipas këtij Ligji, investimet kanë trajtim të barabartë si dhe gëzojnë siguri dhe mbrojtje të plotë. Trajtimi i investimeve të huaja do të jetë konformë normave të pranuarra të së drejtës ndërkombëtare.

Trajtim të barabartë me investitorët vendor investimeve të huaja u jep edhe Republika e Kosovës. Në nenin 3 të Ligjit për investimet e huaja në Republikën e Kosovës⁶⁹ i siguron investitorët e huaj dhe investimet e tyre mbrojtje dhe siguri të plotë dhe të vazhdueshme në përputhje me legjislacionin në fuqi. Mbrojtja e investimeve do të jetë në përputhje me normat e së drejtës ndërkombëtare. Investitorët e huaj sa i përket investimeve të tyre gjejnë trajtim të barabartë edhe në Bosnjë dhe Hercegovinë dhe janë të mbrojtura me Ligjin mbi Politikën e Investimeve të Huaja Direkte (1998) në nenin 8 është e rregulluar se investitorët e huaj kanë të njëjtat të drejtat dhe detyrime si banorët e Bosnjës dhe Hercegovinës. Investitorët e huaj dhe investimet e tyre nuk do të diskriminohen në asnjë formë.

Në Aktin për Promovimin e Investimeve (1997) të Republikës së Bullgarisë në nenin 1 rregullohen kushtet e inkurajimit të investimeve në Republikën e Bullgarisë si dhe mbrojtjen e tyre⁷⁰. Trajtimi i tyre është i rregulluar sipas këtij Ligji.

Të kesh një ekonomi të hapur nuk mjafton për tërheqjen e investitorëve. Shtetet duhet të kenë një rregullim të mirë shtetëror, por dhe klimë të fortë të investimeve, institucione të cilat funksionojnë mirë, stabilitet ekonomik dhe politik, dhe respektimi i sundimit të ligjit. Trajtimi i barabartë i investitorëve të huaj dhe vendas duhet të qeveriset nga të njëjtat rregulla për të gjitha kompanitë pavarësisht pronësisë së tyre. Çdo dallim në trajtim duhet të jetë për shkak të madhësisë së kompanive, formës ligjore ose aktivitetit tregtar⁷¹.

Siç e kemi cekur dhe më lartë, investimet e huaja direkte janë një mjete shumë i rëndësishëm për zhvillimin ekonomik të vendeve pritëse. Mirëpo, sa dhe si ndikojnë IHD-të në këto vende kjo varet edhe nga kushtet e këtyre vendeve, duke theksuar se përfitimet nuk janë në të gjitha vendet njësoj. Mbrojtja juridike e IHD-ve luan rol kryesor në tërheqjen e këtyre investimeve, që do të thotë se edhe nënshkrimi i traktateve për mbrojtjen e investimeve të huaja ka një rëndësi të madhe sa i përket tërheqjes së investitorëve. Kosova

⁶⁹Ligjit për investimet e huaja në Republikën e Kosovës

⁷⁰ Akti për Promovimin e Investimeve të Republikës së Bullgarisë

⁷¹<http://iab.worldbank.org/~media/FPDKM/IAB/Documents/Overview-IAB.pdf-BOX2.1:Characteristics of countries that score well on the IAB indicators, fq.12>

dhe Shqipëria kanë nënshkruar traktate si dhe marrëveshje me shumë shtete, të cilat kanë të bëjnë kryesisht me zgjidhjen e mosmarrëveshjeve që mund të hasin shtete në mes veti. Si përfundim në këtë kapitull duhet përmendur se në botën e globalizuar në të cilën ndodhemi, investimet e huaja direkte janë instrument i rëndësishëm për përmirësim dhe zhvillim ekonomik, andaj institucionet tona duhet të punojnë shumë dhe me një seriozitet të lartë në krijimin e kushteve të mira për investitorët e huaj, duke zbatuar me përpikëri ligjin për mbrojtjen investimeve si dhe trajtimin e barabartë me firmat vendase.

PJESA II

ECURIA E PËRGJITHSHME E INVESTIMEVE TË HUAJA DIREKTE NË KOSOVË DHE SHQIPËRI

KAPITULLI III

ECURIA E PËRGJITHSHME E INVESTIMEVE TË HUAJA DIREKTE NË KOSOVË DHE SHQIPËRI

Hyrje

Ky kapitull tenton të japë një pasqyrë rreth investimeve të huaja në Kosovë dhe Shqipëri, nga cili shtet kemi pranuar më shumë investime, cilat shtete investojnë më shumë, si dhe sa ndikojnë në zhvillimin ekonomik këto investime. Për këtë kemi bërë përpjekje ta paraqesim ndër vite, sepse investimet se nga e kanë shtetin e origjinës ndryshojnë, që do të thotë se shtetet të cilat investojnë në vendin tonë mund të rrisin numrin e investimeve apo edhe e kundërta, ky numër mund edhe të bie.

Qeveritë janë faktori kryesor në nxitjen e investimeve duke ndërmarrë veprime që ndikojnë në tërheqjen e tyre. Kur themi veprime të qeverive, fokusi ynë është më tepër në promovimin sa më të mirë të shtetit, që do të thotë se secili shtet duhet të ketë promotorët e vet të cilët luajnë rol të rëndësishëm në nxitjen dhe tërheqjen e investitorëve.

3.1 ORIGJINA E INVESTIMEVE TË HUAJA DIREKTE

Përsa i përket vendeve të origjinës për IHD-të, si vendet e Evropës Qendrore dhe Lindore ashtu dhe ato të Evropës Juglindore, kanë tërhequr më së shumti investime, fqinjtë e tyre evropiano-perëndimorë. Burimi kryesor i IHD-ve në rajon kanë qenë vendet e OECD-së, të cilat përbëjnë mbi 90 për qind të flukseve hyrëse të IHD-ve në Bullgari, Kroaci dhe Rumani⁷². Analiza gjeografike dhe sektoriale e kryer nga BERZH (2004) gjithashtu, tregon se pjesa më e madhe e IHD-ve vjen nga vendet e BE-së, si: Italia, Gjermania, Austria dhe Greqia, me orientim veçanërisht drejt Rajonit të Ballkanit Perëndimor⁷³.

Në aspektin e kuadrit rregullativ, të gjitha vendet e rajonit kanë legjislacion të duhur të IHD-ve (në rastin e Bosnjë dhe Hecergovinës që prej vitit 1998). Në Shqipëri, Bosnjë dhe Hercegovinë e Kroaci janë krijuar Agjenci për Nxitjen e Investimeve të Huaja, ndërkohë që në të gjitha vendet e Evropës Juglindore janë ngritur Zona të Lira të Brendshme Tregtare, të cilat iu ofrojnë investitorëve të huaj mjaft mundësi. Në këto vende, ekzistojnë kufizime që lidhen me pronësinë e huaj, në sektorë të ndjeshëm, si pronësia mbi tokën (për shembull, në ish-Republikën Jugosllave të Maqedonisë) ose pronësia mbi tokën bujqësore (për shembull, në Shqipëri dhe Kroaci)⁷⁴.

Kështu në mënyrë më të përmbledhur mund të themi që: në vitin 2010, investimet e huaja direkte nga Greqia zinin 41% të stokut të IHD-ve, në fushën e telekomunikacionit (61%) dhe ndërmjetësimit financiar (22%). Në vendin e dytë radhitet Turqia me 14% të stokut me rreth 40 kompani investitore turke, ku IHD-të janë të përqëndruara në aktivitetet jo-financiare. Shtetet e Bashkuara radhiten të tretat për nga rëndësia si vend i orgjinës për investime të huaja direkte, duke zënë 12% të stokut të IHD-ve. Austria zë vendin e katërt si vend i origjinës për investimet e huaja direkte në Shqipëri, me 9% të stokut të IHD-ve, kryesisht në sektorin bankar. Italia, me 8% të stokut të IHD-ve hyrëse të përqëndruara në prodhim e ndërtim⁷⁵.

⁷²Anthony Broadman et al, 2004, University of British Columbia, *Journal of Strategic Management Education* 1(2). © 2004, Senate Hall Academic Publishing

⁷³Downloads/Investimi_i_huaj_direkt_ne_vendet_ne_zhvillim_te_Evropes_Lindore

⁷⁴Komisioni Evropian, 2004

⁷⁵<http://www.doktoratura.unitir.edu.al/wp-content/uploads/2012/09/Oltjana-Zoto-Fakulteti-i-Ekonomise.pdf>

Ndërsa sa i përket Kosovës situata e investimeve të huaja direkte ndryshon sipas vendit nga e kanë origjinën.

- a) Në vitin 2007 dhe 2011 pjesa më e madhe e IHD-ve e kanë origjinën nga Britania e Madhe me një vlerë prej 116.16 dhe 80.1 milionë euro. Në vitin 2008 IHD-të më së shumti vijnë nga Austria me një vlerë prej 51.3 milionë euro.
- b) Gjermania është shteti nga e kanë origjinën shumica e Investimeve të Huaja Direkte për vitet 2009 dhe 2010. Gjatë këtyre viteve ky shtet ka investuar në Kosovë përkatësisht 75.15 dhe 91.54 milionë euro.

Për dy vitet e fundit nën analizë 2012-2013, Open Data Albania hulumton se është Turqia e cila ka investuar më shumë në shtetin kosovar. Në vitin 2012 Investimet e Huaja Direkte nga ky vend shënonin vlerën e 65.55 milionë eurove dhe një vit më vonë 82.73 milionë euro.

Më 31 Mars 2014 gjendja e IHD-ve në Kosovë paraqitet: me vendet e Bashkimit Europian ku janë kryer 962.83 milionë euro Investime Hyrëse të Drejtpërdrejta dhe 53.81 milionë euro Investime të Drejtpërdrejta Dalëse; me shtetet e tjera Europiane janë kryer 534.32 milionë euro IHD Hyrëse dhe 75.4 Investime Dalëse dhe me shtetet e tjera Joeuropiane janë kryer 111.31 milionë euro IHD Hyrëse dhe 11.41 IHD Dalëse⁷⁶.

Tabela 5- Investimet e Huaja Direkte në Kosovë sipas shteteve 2010-2016


Vlera në milionë euro

Rajoni/Vendi	2010	2011	2012	2013	2014	2015	2016	Totali
Gjermania	91.5	66.6	49.2	21.7	29.4	45.3	25.7	329.5
Zvicra	35.1	30.9	39.7	41.7	38.2	72.9	61.8	320.3
Turqia	4.9	34.7	62.7	88.6	20.0	55.4	42.7	309.0
Te tjera	67.2	87.1	37.6	27.8	19.8	25.4	30.2	295.1
Shqipëria	20.3	11.2	16.8	19.3	20.4	40.1	28.6	156.6
Britania e Madhe	38.9	80.1	14.3	10.7	-39.5	26.6	13.6	144.6
Austria	21.1	19.6	0.2	10.7	30.3	33.5	9.9	125.3
Shtetet e Bashkuara	12.6	14.3	8.5	12.7	14.7	25.0	23.0	110.8
Sllovenia	34.0	16.2	8.0	7.0	-9.4	5.6	-4.5	56.9
Bullgaria	0.0	3.4	8.1	5.6	14.5	1.6	0.4	33.6

⁷⁶<http://telegrafi.com/turqia-investoi-ne-kosove-82-8-milione-euro/>

Itali	6.6	1.7	3.9	8.7	3.3	5.7	1.9	31.8
Norvegjia	3.3	2.5	2.4	4.7	5.9	2.9	3.4	25.1
Franca	3.8	0.2	6.9	3.8	3.3	3.2	2.8	24.1
Serbia	0.4	0.4	0.5	5.7	2.4	0.8	-0.6	9.6
Maqedonia	1.8	5.8	-9.6	4.6	3.2	0.1	3.2	9.1
Malta	0.9	0.2	4.3	3.1	0.1	0.1	0.1	8.8
Luksemburgu	0.4	0.5	1.3	2.3	1.2	0.1	0.6	6.4
Kroacia	1.8	2.9	0.4	1.3	1.1	0.1	-1.7	5.9
Greqi	5.9	0.4	0.3	-0.4	-0.6	-0.2	-0.4	4.9
Bosnia dhe Hercegovina	0.8	0.1	0.0	0.2	0.3	0.8	1.2	3.4
Qipro	0.0	1.0	0.3	0.3	0.3	0.1	0.4	2.4
Slovakia	0.0	0.0	0.0	0.2	0.1	0.1	0.8	1.2
Holanda	17.2	4.7	-26.7	-0.1	-7.8	-36.4	-23.1	-72.2
TOTALI	368.5	384.4	229.1	280.2	151.2	308.8	220.0	1942.2

Burimi: Banka Qendrore e Kosovës



Grafiku 5- Investimet e Huaja Direkte në Kosovë sipas shteteve 2010-2016

Në gjykimin tonë, por edhe referuar të dhënave të marra nga burimet arrijmë në këtë analizë:

Situata e IHD-ve nga vjen origjina e tyre në bazë të shteteve ndryshon nëpër vite. Në vitin 2010 dhe 2012 investimet më të mëdha ishin nga Gjermania të cilat arrinin vlerën në 91.5 milionë, pastaj prej vitit 2013-2016 shteti që prin për investime në Kosovë është Zvicra me 41.7 dhe 72.9 milionë. Shteti i tretë që njihet për investimet më të mëdha në vendin tonë

është Turqia me investime të cilat arrijnë vlerën në vitin 2013 në 88.6 pastaj në vitet në vijim kishte pak rënie, në 2016 vlera e investimeve në miliona euro ishte 42.7 milionë. Nga viti 2010 e deri në 2016 në total Gjermania ka investuar në Kosovë 329.5 milionë, që do të thotë se investimet hyrëse nga Gjermania arrinin një shumë të konsiderueshme, pastaj Zvicra me 320.3 milionë investime hyrëse në Kosovë si dhe shumë shtete të tjera të Bashkimit Evropian si dhe vende të tjera me origjinë joevropiane. Investimet për këtë periudhë kohore arrijnë shumën në 1942.2 milionë.

Tabela 6 - Investimet e Huaja Direkte në Shqipëri sipas shteteve 2010-2013


Vlera në miliona euro					
Rajoni/Vendi	2010	2011	2012	2013	Totali
Emiratet e Bashkuara Arabe	17.0	10.0	-	-	27.0
Austri	354.0	444.0	387.0	385.0	1570.0
Australi	-	-	1.0	1.0	2.0
Belgjikë	-	-	0.0	0.0	0.0
Bullgari	18.0	13.0	14.0	11.0	56.0
Kanada	270.0	529.0	705.0	797.0	2301.0
Zvicër	68.0	544.0	394.0	97.0	1103.0
Kinë	-1.0	-3.0	-5.0	-1.0	-10.0
Qipro	60.0	129.0	97.0	-230.0	56.0
Çeki	-12.0	-15.0	-220.0	-323.0	-570.0
Gjermani	84.0	84.0	92.0	112.0	372.0
Egjipt	4.0	4.0	4.0	4.0	16.0
Spanjë	0.0	0.0	1.0	1.0	2.0
Francë	40.0	51.0	84.0	84.0	259.0
Mbretëria e Bashkuar	-2.0	0.0	3.0	11.0	12.0
Greqi	601.0	507.0	767.0	1076.0	2951.0
Kroaci	11.0	17.0	13.0	14.0	55.0
Hungari	0.0	0.0	-	-	0.0
Izrael	3.0	1.0	1.0	1.0	6.0
Itali	387.0	427.0	125.0	-128.0	811.0
Japoni	-	-	0.0	0.0	0.0
Kosovë	10.0	5.0	13.0	13.0	41.0
Kuvajt	71.0	9.0	5.0	-6.0	79.0
Ishujt Kajman	-7.0	57.0	58.0	34.0	142.0
Liban	28.0	29.0	39.0	43.0	139.0
Luksemburg	-	-	5.0	9.0	14.0

Monako	2.0	0.0	-	-	2.0
Mali i Zi	1.0	-2.0	0.0	0.0	-1.0
Ish Republika Jugosllave e Maqedonisë	22.0	17.0	9.0	11.0	59.0
Hollandë	223.0	253.0	297.0	389.0	1162.0
Norvegji	13.0	19.0	21.0	0.0	53.0
Panama	-	-	1.0	0.0	1.0
Rumani	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0
Suedi	-	-	-	0.0	0.0
Slloveni	10.0	27.0	5.0	7.0	49.0
Turqi	187.0	188.0	235.0	285.0	895.0
Shtetet e Bashkuara të Amerikës	-98.0	-47.0	36.0	24.0	-85.0
Ishujt Virgin (Britanikë)	-	-	0.0	2.0	2.0
Serbi	7.0	8.0	7.0	4.0	26.0
Organizata Ndërkombëtare	46.0	54.0	64.0	135.0	299.0
Të tjera	21.0	39.0	3.0	-14.0	49.0
Totali i IHD-ve	2436.0	3400.0	3262.0	2850.0	11948.0

Burimi: Banka e Shqipërisë

Sipas gjykimit tim sa i përket të dhënave për pjesën e Shqipërisë: Shqipëria gjithashtu ka përfituar nga investimet e huaja nga shtete me origjinë të ndryshme. Shteti që ka investuar më shumë në Shqipëri për periudhën kohore 2010 – 2013 është Greqia me 2951.0 milionë, pasuar nga Kanada me 2301.0, pastaj nga Austria me investime në vlerë prej 1570.0 milionë si dhe shtetet tjera të cilat janë pjesë e Bashkimit European dhe shtete të cilat nuk janë pjesë e BE-së.

Totali i investimeve për këtë periudhë kohore ka arritur vlerën në 11948.0.



Grafiku 6 - Investimet e Huaja Direkte në Shqipëri sipas shteteve 2010-2013

3.2 SHPËRNDARJA E INVESTIMEVE TË HUAJA DIREKTE SIPAS VENDEVE DHE SEKTORËVE

Qeveritë mund të ndërmarrin veprime specifike për nxitjen e investimeve të huaja direkte (IHD) në vend. Shumë vende kanë vështirësi për të tërhequr investimet e huaja për shkak të tregjeve të vogla ose kosto të lartë të shërbimit si një bazë për eksport. Strategjia për promovimin e investimeve që do të kontribuojë në zhvillim duhet të jetë në sektorë dhe aktivitete të veçanta. Nxitja e investimeve të huaja do të kërkojë jo vetëm një rregullator të

favorshëm mjedisor, por edhe masa të tilla për të tërhequr aktivisht biznesin si zona të veçanta ekonomike⁷⁷.

Përsa i përket shpërndarjes së IHD-ve sipas sektorëve të ekonomisë, pjesa më e madhe e tyre në vendet e Evropës Juglindore përqëndrohen në industrinë përpunuese, shërbimet financiare, telekomunikacion dhe tregti. Analiza e të dhënave nga BERZH (2004), tregon se IHD-të në SEE përqëndrohen në sektorin e industrisë së përpunimit. Sugjeron që ndërmarrjet përpunuese në vendet fqinje të BE, si Italia dhe Gjermania, po i zhvendosin aktivitetet e tyre të prodhimit industrial drejt lindjes, për të përfituar përparësitë e kostos krahasimisht më të lirë të krahut të punës. Në sektorin e industrisë përpunuese një nga industritë ku ka hyrë më shumë investimi i huaj në rajon, është prodhimi i çelikut⁷⁸. Sektori financiar është një sektor tjetër i rëndësishëm në Evropën Juglindore, ku përfshirja e investimeve të huaja është rritur ndjeshëm gjatë viteve të '90. Privatizimi i gjithë sektorit bankar të këtyre vendeve është kryer gjatë viteve të fundit. Sipas Bevan dhe Estrin (2000), në fund të dekadës, bankat e huaja në Evropën Qendrore e Lindore përbënin rreth 70 për qind të bankave. Sektori i turizmit ka tërhequr mjaft investime të huaja në Kroaci dhe Bullgari.

Të dhënat tregojnë gjithashtu, që ka pak ose nuk ka fare investim të huaj në sektorin e agrikulturës, megjithëse ky sektor përbën një pjesë të mirë të PBB-së në shumicën e vendeve të SEE. Ndërkohë, mungesa e ristrukturimit, pasiguria lidhur me të drejtat pronësore dhe infrastruktura e dobët, janë ndër pengesat kryesore të investimeve të huaja në këtë sektor (BERZH, 2004). Përsa i përket vendeve të origjinës për IHD-të, si vendet e Evropës Qendrore dhe Lindore ashtu dhe ato të Evropës Juglindore, kanë tërhequr më së shumti fqinjët e tyre evropianoperëndimorë. Burimi kryesor i IHD-ve në rajon ishin vendet e OECD-së, të cilat përbëjnë mbi 90 për qind të flukseve hyrëse të IHD-ve në Bullgari, Kroaci dhe Rumani⁷⁹.

Analiza gjeografike dhe sektoriale e kryer nga BERZH (2004) gjithashtu tregon se pjesa më e madhe e IHD-ve vjen nga vendet e BE-së, si: Italia, Gjermania, Austria dhe Greqia,

⁷⁷ (Millennium Project, Report to the UN Secretary General, Investing in Development A Practical Plan to Achieve the Millennium Development Goals, first published in the UK and USA 2005, fq. 123-124.

⁷⁸ Bevan dhe Estrin, 2000; Hunya, 2004,

<http://citeseerx.ist.psu.edu/viewdoc/download?doi=10.1.1.124.8766&rep=rep1&type=pdf>

⁷⁹ Broadman et al, 2004 -https://essay.utwente.nl/60162/1/MA_thesis_R_de_Both.pdf

me orientim veçanërisht drejt Rajonit të Ballkanit Perëndimor. Në lidhje me mjedisin e politikës në mbështetjen e IHD-ve, vendet e Evropës Juglindore kanë deri-diku një tregti të liberalizuar. Shqipëria, Kroacia dhe ish-Republika Jugosllave e Maqedonisë janë tashmë anëtare të OBT-së, ndërkohë që Bosnje dhe Hercegovina, Serbia dhe Mali i Zi janë në procesin e anëtarësimit. Për më tepër, sipas Komisionit Evropian (2004), pesë shtetet e lartpërmendura gëzojnë hyrje pa doganë në tregun e BE-së, në sajë të Masave Asimetrike të Tregtisë, dhënë që prej fundit të vitit 2000.

Në aspektin e kuadrit rregullativ, të gjitha vendet e rajonit kanë legjislacionin e duhur të IHD-ve (në rastin e Bosnjë dhe Hercegovinës që prej vitit 1998). Në Shqipëri, Bosnjë dhe Hercegovinë e Kroaci janë krijuar Agjenci për Nxitjen e Investimeve të Huaja, ndërkohë që në të gjitha vendet e Evropës Juglindore janë ngritur Zona të Lira të Brendshme Tregtare, të cilat iu ofrojnë investitorëve të huaj mjaft mundësi. Në këto vende, ekzistojnë kufizime që lidhen me pronësinë e huaj, në sektorë të ndjeshëm, si pronësia mbi tokën (për shembull, në ish-Republikën Jugosllave të Maqedonisë) ose pronësia mbi tokën bujqësore (për shembull, në Shqipëri dhe Kroaci) (Komisioni Evropian, 2004)⁸⁰. “Ndërkohë që flukset hyrëse në SEE të lidhura me privatizimin apo ato zyrtare, parashikohet të bien në të ardhmen, sfida kryesore mbetet krijimi i bazave për të tërhequr kapitalet private të huaja, mundësisht në formën e IHD-së në ndërmarrje të reja. Kalimi i kësaj sfide me sukses nga ky rajon varet nga një sërë faktorësh, përfshirë edhe qëndrueshmërinë politike”⁸¹.

Sipas treguesit të investimeve të huaja për kokë banori, në pozitë më të volitshme ndaj mesatares është Kroacia (328.4%) dhe Bullgaria (108.4%) e që tregon një ndërvarësi midis të nivelit të zhvillimit ekonomik dhe të investimeve direkte të huaja. Vendet që kanë nivel më të lartë të GDP-së për banor në të njëjtën kohë kanë realizuar edhe investime më të larta për kokë banori. Në përgjithësi IJD më së shumti ishin të orientuara në sektorët e industrisë, tregtisë, riparimi i motorëve të kamionëve, dhe në sektorë të ndërmjetësuesve financiar. Industria ka treguar pjesëmarrje të lartë në shumicën e vendeve të rajonit. Në Maqedoni industria ka pjesëmarrje mbi 80%, ndërsa në vendet e tjera kjo pjesëmarrje është: në Kroaci (45.5 %), Bullgari (54.2 %), dhe Bosnje dhe Hercegovinë (42.8%)⁸². Investimet e Huaja

⁸⁰Komisioni Evropian, 2004

⁸¹EBRD, 2004, faqe 10

⁸²<http://www.riinvestinstitute.org/uploads/files/2016/October/17/shqip1476705266.pdf>.

Direkte (IHD) të pranuar në Kosovë shënuan vlerën prej 215.9 milionë euro në vitin 2016, që përbën një rënie kundrejt vlerës së shënuar në vitin paraprak prej 308.8 milionë euro. Në këtë periudhë, rënie e IHD-ve u evidentua pothuajse në të gjithë sektorët, megjithëse me rënie të theksuar u karakterizuan sektori i patundshmërive dhe sektori i shërbimeve financiare⁸³.

⁸³ *Burimi: BQK- Raporti i stabilitetit financiar nr.11, korrik 2017, fq. 15*

Tabela 7 - Investimet e huaja Direkte në Kosovë - sipas aktivitetit ekonomik

(Në milionë euro)

Vitet	Bujqësi a	Miniera t	Industri a	Energjetik a	Ndërtim i	Shërbime t tregtare	Hotele dhe Restorant e	Transporti dhe Kommunikim i	Shërbime Financiar e	Patundshmëria , Qeradhënia dhe aktivitetet biznesore	Shërbim e tjera /1	Aktivite tjera të pa klasifikuar a diku tjetër	Total
2010	0.9	17.7	101.1	...	54.2	6.8	...	-15.9	39.4	75.5	1.3	87.6	368.5
2011	0.6	-5.2	46.9	0.2	133.1	11.6	0.2	29.0	33.0	60.5	11.3	63.2	384.4
2012	0.3	-25.0	27.4	2.2	31.1	9.3	0.5	32.4	22.4	115.7	1.8	11.0	229.1
2013	0.4	-14.1	11.5	48.8	17.3	14.6	0.8	51.0	4.4	136.1	3.3	6.2	280.2
2014	0.2	4.2	-34.0	13.4	-19.9	8.4	0.4	-9.1	41.9	142.1	2.2	1.4	151.2
2015	1.0	-36.9	20.7	11.9	46.3	12.0	0.0	-6.1	64.3	189.6	4.5	1.4	308.8
2016	1.2	-19.1	4.6	3.4	28.2	14.5	0.7	-9.1	19.0	167.6	9.4	-0.6	220.0
Total	4.5	-78.5	178.3	79.9	290.3	77.1	2.6	72.2	224.4	887.1	33.9	170.3	1942.2

Burimi: Banka Qendrore e Kosovës



Grafiku 7 - Investimet e huaja Direkte në Kosovë - sipas aktivitetit ekonomik

Nga analiza në hulumtimin e të dhënave shikuar nga aktiviteti ekonomik ose shpërndarja e investimeve të huaja sipas sektorëve nga viti 2010 e deri më 2016 investimet më të mëdha kanë qenë në patundshmëri, qiradhënie si dhe në aktivitete biznesore të cilat e arrinin shumën prej 887.1 milionë. Investime gjithashtu ka pasur edhe në sektorë të tjerë si në ndërtimtari në shumë prej 290 milionë, pastaj në shërbime financiare në vlerë prej 224.4. Totali i investimeve sipas sektorëve që nga viti 2010 e deri në vitin 2016 është 1942.2 milionë.

Tabela 8 - Investimet e huaja Direkte në Shqipëri - sipas aktivitetit ekonomik

(Në milionë euro)

Vitet	Bujqësia, gjëetia dhe silvikultura	Peshkimi	Industria nxjerrëse	Industria përpunuese	Prodhimi dhe shpërndarja e energjisë elektrike, e gazit, e avullit dhe e ujit të nxehtë	Ndërtimi	Tregtia me shumicë dhe pakicë, riparimi i automobilitave, motoçikletave, i sendeve personale dhe pajisjeve	Hotele dhe restorantet	Transportet, magazinimi dhe komunikacioni	Ndërmjetësimi monetar dhe financiar	Pasuritë e patundshme, dhënia me qira, informatika, puna kërkimore shkencore, të tjera aktivitete	Administrimi publik dhe i mbrojtjes; sigurimi shoqëror i detyruar	Arsimi	Shëndetsia dhe veprimtari të tjera sociale	Aktivitetet të tjera të shërbimit kolektiv, social dhe individual	Shërbime në shtëpi	Aktivitetet e organizmave ndërkombëtare	Të tjera industri	TOTAL
2010	7.0	2.0	311.0	378.0	118.0	-1.0	240.0	76.0	400.0	700.0	63.0	-	4.0	64	12	-	24	38	2436.0
2011	4.0	4.0	612.0	431.0	247.0	11.0	217.0	70.0	389.0	715.0	83.0	-	6.0	47	9	-	36	521	3402.0
2012	2.0	0.0	810.0	388.0	9.0	78.0	153.0	64.0	437.0	753.0	85.0	-	8.0	37	18	-	46	374	3262.0
2013	2.0	0.0	732.0	-187.0	-33.0	84.0	136.0	63.0	784.0	780.0	341.0	-	10.0	33	17	-	60	27	2849.0
TOTAL	15.0	6.0	2465.0	1010.0	341.0	172.0	746.0	273.0	2010.0	2948.0	572.0	0.0	28.0	181.0	56.0	0.0	166.0	960.0	11949.0

Burimi: Banka e Shqipërisë



Grafiku 8 - Investimet e huaja Direkte në Shqipëri - sipas aktivitetit ekonomik

Sipas aktivitetit ekonomik në të dhënat që kemi mbledhur Shqipëria për periudhën kohore 2010 – 2013 investime më të mëdha ka pasur në sektorin e ndërmjetësimit monetar dhe financiar me 2948.0 milionë, pastaj në industrinë nxjerrëse me 2465.0, transport, magazinim dhe telekomunikacion me 2010.0 milionë. Në total investime sipas sektorëve gjatë kësaj periudhe Shqipëria ka pasur 11949.0.

3.3 ZHVILLIMET RAJONALE DHE ZHVILLIMET E IHD-ve NË VENDET E HUAJA SI DHE TENDENCAT JURIDIK DREJT RRITJES SË TYRE

Një ndër faktorët më të rëndësishëm në procesin e globalizimit mbeten investimet e huaja direkte. Ekzistojnë mendime të ndryshme lidhur me investimet e huaja direkte, si negative poashtu edhe ato pozitive.

Për zhvillimin e ekonomisë dhe kompanive vendëse, si mjet më i mirë janë investimet e huaja direkte, andaj për tërheqjen sa më të madhe të investimeve luajnë rol të rëndësishëm

politikat kombëtare, hapja e tregut, rendi ligjor dhe qeverisja e mirë, të gjitha këto janë primare për tërheqjen e investitorëve.

- a) Duke marrë parasysh të dhënat që na japin institucionet financiare ndërkombëtare mund të shohim se IHD-të më shumë lëvizin drejt vendeve të zhvilluara se sa vendeve të cilat janë ende në zhvillim.
- b) Nga kjo mund të kuptojmë se vendi që radhitet si treg kryesor për tërheqjen e IHD-ve janë SHBA.
- c) Ndër faktorët që ndikojnë më shumë tek investitorët e huaj që të investojnë në tregun amerikan janë: tregu i madh konsumator, fuqia punëtore cilësore, sistemi arsimor mjaft cilësor, mjedisi rregullator transparent.
- d) Përveç SHBA-ve është gjithashtu edhe Bashkimi Evropian (BE) që ka thithur nivelin më të lartë të IHD-ve.
- e) Vendet të cilat tërheqin më shumë investitorë janë: Spanja, Britania e Madhe, Gjermania dhe Holanda.

Ndërsa vendi që ka tërhequr shumë pak investitorë është rajoni i Evropës Juglindore (Shqipëria, Kosova, Bosnje Hercegovina, Serbia, Mali i Zi, Maqedonia, Bullgaria dhe Rumania), megjithëse këto dy të fundit nëse marrim parasysh nivelin e investimeve qëndrojnë më mirë se shtetet e tjera të rajonit sa i përket investimeve të huaja direkte.

Qeveritë tërheqin investimet në industri ose rajone të favorizuara, në dy forma kryesore, në stimuj fiskal, bazuar në lehtësira tatimore për investitorët dhe lehtësira financiare bazuar në sigurimin e fondeve direkte për investitorët për të financuar investime të reja ose për të mbuluar kostot kapitale ose operative⁸⁴.

Mirëqeverisja dhe cilësia e institucioneve është faktori më i rëndësishëm në tërheqjen e investimeve të huaja direkte, ndërsa duhet të cekim se niveli i lartë i korrupsionit është arsyeja kryesore e mosinteresimit dhe mbajtjes larg investimeve serioze.

Për tërheqjen e investimeve rol të rëndësishëm luajnë edhe investimet vendëse, kjo për arsye se kompanitë e huaja ndihen më të sigurta të investojnë në vende ku mund të gjejnë rrjet industrive të stabilizuara lokale për zinxhirin e bizneseve të tyre. Nëse kemi parasysh rezultatin e studimeve të shumta në këtë fushë, është i rëndësishëm implementimi i një

⁸⁴The Oxford Handbook of INTERNATIONAL INVESTMENT LAW 2008

legjislacioni të ri dhe efektiv me qëllim që të bëjmë të mundur tërheqjen e investimeve të huaja direkte drejt sektorëve që mundësojnë rritjen ekonomike.

3.4 INVESTIMET E HUAJA MË TË MËDHA NË KOSOVË DHE SHQIPËRI

Ekonomia e Kosovës si vend i cili ende i vuan pasojat e luftës nuk ka mjete të mjaftueshme të investuara krahasuar me nevojat që ka. Vendet të cilat kanë investuar më shumë në Kosovë janë vendet e Evropës si: Turqia, Zvicra, Britania e Madhe, Shqipëria, Austria, Sllovenia, Gjermania, SHBA-të dhe Italia. Këto vende kanë investuar më shumë në tregti, veprimtari shërbyese, telekomunikacion, transport, sektor financiar si dhe në shëndetësi. Gjatë vitit 2016 sektori i jashtëm i Kosovës u karakterizua me rritje vjetore të remitencave të pranuar në vend vlera e të cilave arriti shumën në 691.0 milionë euro. Në anën tjetër investimet e huaja direkte të pranuar në Kosovë shënuan vlerën në 215.9 milionë euro në vitin 2016, që përbën rënie kundrejt vlerës së shënuar në vitin paraprak prej 308.8 milionë eurove.

Në vitet e fundit rënia e IHD-ve u evidentua pothuajse në të gjithë sektorët. Rënie më e madhe ishte tek sektori i patundshmërive dhe sektori i shërbimeve financiare. Sa i përket investimeve të huaja direkte më të mëdha në Kosovë në vitet e fundit, Zvicra paraqet vendin prej nga kanë më së shumti IHD me 61.8 milionë euro pasuar nga Turqia me 44.4 milionë euro, Shqipëria me 28.6 milionë euro, Gjermania me 25.7 milionë euro, etj.⁸⁵

Ndërsa sa i përket investimeve të huaja në Shqipëri fluksi më i madh është regjistruar në sektorin e energjisë, në të cilin janë implementuar dy projekte të rëndësishme, të cilat luajnë rol të rëndësishëm në zhvillimin ekonomik të vendit. Sa i përket investimeve në sektorët e tjerë në vitet e fundit ka pasur më shumë investime në sektorin e bujqësisë, në sektorin e shërbimeve, ndërsa në fusha të tjera si ato juridike, shërbimeve profesionale teknologjike, nuk ka pasur investime në këtë drejtim. Sipas Bankës Botërore IHD-të në Shqipëri për vitin 2018 arrinin në 8.3 përqind nga 8.7 përqind që ishin vitin e kaluar.

⁸⁵<https://www.bqkkos.org/index.php?q=investimet+e+huaja+direkte+ne+Kosove+2017>

Pasi që vitet e fundit IHD-të kanë qenë motori kryesor i zhvillimit ekonomik në Shqipëri, rënia e tyre do të jetë një problem i madh për ekonominë shqiptare.

Më poshtë kemi paraqitur në grafik të investimeve më të medha në Kosovë që nga viti 2007 deri në vitin 2016.

3.5 FORMAT BAZË TË INVESTIMEVE TË HUAJA DIREKTE

Për të investuar në një vend ekzistojnë edhe përcaktuesit të cilët janë shtylla bazë për orientimin e investimeve të huaja direkte.

- a. Kërkimi i burimeve të cilat janë mjaft të rëndësishme për investorët. Sipas Dunning, në kohën e pas Luftës së Dytë Botërore, rreth 60 % e kapitalit të akumuluar të IHD-ve kishte këto pika. Nga mesi i viteve 1980 investimet e huaja të bazuara në kërkesat për burime ranë në rreth 30% në rang global dhe 45% në vendet në zhvillim.
- b. Rëndësi të madhe për të orientuar investimet e huaja direkte ka kërkimi i tregut. Kjo do të thotë se nëse kemi prodhim ndërkombëtar për një firmë që shtrin aktivitetin e vet në vend të huaj mundësohet furnizimi më i lehtë i produkteve.
- c. Kërkimi i efikasitetit është format tjetër bazë që ndikon në realizimin e objektivave të IHD-ve. Dunning këtë e shpjegon në këtë mënyrë: çështja është që të krijohet një strukturë e arsyeshme e investimeve në mënyrë të tillë që kompanitë investuese të përfitojnë nga drejtimi i përbashkët i aktiviteteve të ndara gjeografikisht në vende të ndryshme.
- d. Asetet produktive janë motivuesit e fundit të investimeve të huaja direkte dhe nxisin ato për të investuar në ato vende.

Sipas formës së realizimit të investimeve të huaja direkte, dallojmë këto trajta të investimeve të huaja direkte;

- a. Joint ventures investimet (investimet e përbashkëta);
- b. Greenfield investimet dhe
- c. Koncesionet si trajtë e veçantë e investimeve të huaja direkte⁸⁶.

⁸⁶ Adnan Jashari- Aspekti juridik i investimeve të huaja në shtetet në tranzicion, Tetovë 2007, fq.58

3.5.1 JOINT VENTURES INVESTMENT (INVESTIMET E PËRBASHKËTA)

Një sipërmarrje e përbashkët është një partneritet i përkohshëm strategjik (afatshkurtër, afatmesëm ose afatgjatë) i një kompanie, grupi ose aleance të njerëzve ose grupeve të kompanive që mbajnë individualitetin dhe pavarësinë ligjore duke punuar nën të njëjtin menaxhim dhe rregullore. Për të kryer një operacion të caktuar tregtar me shpërndarje të investimeve, kontrollit, përgjegjësisë, personelit, rreziqeve, shpenzimeve dhe fitimeve. Kjo dinamikë quhet një kompani e përbashkët, një investim i përbashkët ose një bashkëpunim biznesi⁸⁷.

Në punimin tyre ("International Joint Ventures in Developing Countries") autorët R.Miller, J.Glen, F.Jaspersen dhe Y.Karmokolias, e cekun se *edhe pse këto ndërmarrje ofrojnë një mundësi tërheqëse, ato shpesh funksionojnë në mënyrë jo të knaqëshme* pra në të shumtë e rasteve ato nuk arrijnë t'i përmbushim qëllimet e tyre dhe nganjëherë janë edhe *relativisht të paqëndrueshme*, për shkak të mosmarrveshjeve të ndryeshme midis partnerëve.

Sidoqoftë, sot ekzistojnë shumë shembuj, ku kompani të ndryeshme kanë arritur të bashkojnë kapitalin dhe ekspertizën e tyre, për forminin e një ndërmarrjeje të përbashkët, pra nga dy të funksionojë si një kompani e vetme, ku partnerët arrijnë të realizojnë interesta e tyre të përbashkët, të ndajnë fitimin (apo edhe humbjen), riskun me të cilin ballafaqohen, kontrollin mbi ndërmarrjen, etj., mvarsisht prej strukturës së pjesëmarrjes me të cilën janë pajtuar partnerët në marrëveshjen e arritur paraprakisht.

Disa shembuj të Joint Ventures janë: Siemens dhe Nokia, IBM dhe Lenovo, etj. Motivet të cilat çojnë në krijimin e një Joint Ventures, mund të jenë:

- a. Ekonomizimi i shkallës,
- b. Diversifikimi i riskut,
- c. Çasja në tregje të reja,
- d. Pengesat gjeografike, etj.

Në aspektin juridik të këto investime mund të shtrohen disa çështje me rëndësi, por mbi të gjitha rëndësi të veçantë ka çështja e pronësisë mbi mjetet e investuara. Në praktikën

⁸⁷ <https://www.bbva.es/eng/general/finanzas-vistazo/empresas/joint-venture/index.jsp>

ndërkombëtare në aspektin formalo juridik mund të dallojm dy lloje të investimeve joint venture, edhe atë;

- a. Equity joint venture (investimet e përbashkëta ekuivalente) dhe
- b. Non equity joint venture (investimet e përbashkëta jo ekuivalente)⁸⁸.

Tek investimet e përbashkëta ekuivalente apo equity joint venture kemi të bëjm me themelimin e subjektit ekonomik nga personat e huaj dhe dy e më shumë persona të vendit. Që do të thotë se investitori i huaj e humb të drejtën e pronësisë, mirëpo fiton të drejtën e bashkëpronësisë ndaj subjektit në të cilin ka bërë investimin e mjeteve. Te ky lloj i investimeve, të drejtat dhe detyrimet e palëve, rregullohen me kontratën mbi themelimin e subjektit⁸⁹.

Karakteristik kryesore e investimeve të huaja direkte në këtë trajtë, qëndron në lartësinë e vogël të kapitalit të investuar në bazë të një kontrate. Shikuar mesatarisht lartësia e kapitalit të tillë për një kontratë është rreth 40 mij\$. Shikuar sipas shteteve, numër më të madh të kontratave janë lidhur me investitorët Gjerman, Grek, Italianë⁹⁰.

3.5.2 INVESTIMET GREENFIELD

Investimet “greenfield” nënkuptojnë kapital të ri me burim nga fondet e jashtme, i cili investohet në formën e aksioneve në një ndërmarrje apo shoqëri aksionare. Rrjedha e IHD-ve në vendet në zhvillim në dekadat e fundit është rritur dukshëm, duke u bërë kështu burimi kryesor i financimit nga jashtë. Me rritjen e IHD-ve pastaj u ndryshua edhe përbërja e këtyre investimeve, duke shkuar çdo here e më shumë, sidomos në vitet e fundit në blerjen e pasurisë apo asetëve ekzistuese, dhe një pjesë e madhe e këtyre investimeve ka shkuar në drejtim të investimeve “Greenfield”.

IHD-të paraqesin një rrjedhje me burime të ndryshme financiare, duke përfshirë edhe investimet e reja si “investimet greenfield”, të cilat kontribojnë në rritjen e kapitalit në

⁸⁸ A. Jashari-v.c. fq.58

⁸⁹ A. Jashari-v.c. fq.61

⁹⁰ A. Jashari-v.c. fq.64

vendin pritës, dhe investimet e drejtëpërdrejta që shfaqen në formën e përvetësimit ose shkrirjes (të njohura si Mergers & Acquisitions-M&A), të cilat kanë të bëjnë me ndryshimin në pronësinë e ndërmarrjeve ekzistuese në vendein pritës.

Në disa shtete, por sidomos në Hungari në fillimet e viteve të 90-ta IHD-të ishin të lidhura kryesisht me privatizimin, ndërsa në vitet e fundit të 90-tave, pjesa më e madhe e investimeve me burim financimi nga fondet private shkoj në projektet “Greenfield”.

Në Poloni rreth 1/3 e investimeve të huaja direkte janë në trajtë të greenfield investime. Firma Levi Strauss është shembull për investimin e kapitalit në trajtë të greenfield investime në qytetin Plock (Poloni)⁹¹.

Si në shumë vende në tranzicion, ashtu edhe në Kosovë kapitali i huaj kryesisht është realizuar deri me tani dhe vazhdon përmes procesit të privatizimit, ndërsa më pak janë investimet e reja “Greenfield”. Në Kosovë duhet të bëhet një promovim më i madh i mundësive për bashkëpunim me investitorë nga jashtë për të tërhequr më shumë investime të përbashkëta.

Investimet greenfield dallohen nga trajtat tjera të investimeve të huaja direkte, edhe atë ;

- a. Trajatat tjera të investimeve realizohen në bazë të privatizimit, kurse investimet greenfield nuk kanë lidhje me privatizimin;
- b. Greenfield investimet vijnë në shprehje në ato raste kur bëhet fjalë për industry intensive punuese, për dallim nga trajtat e tjera që vin në shprehje te industria kapitale punuese⁹².

Nga e gjithë kjo që u tha më lartë mund të konstatojmë se që nga viti 1988 ka filluar rënia drastike e investimeve të huaja direkte në trajtë të investimeve të përbashkëta, kurse investimet e huaja direkte, në formë të greenfield investimeve dhe akuizicioneve direkte shënojnë tendencë të rritjes⁹³.

⁹¹ A. Jashari-v.c. fq.67

⁹² A.Jashari, v.c. fq.66

⁹³ A.Jashari, v.c. fq.68

3.5.3 KONCESIONET

Koncesioni është institut i vjetër juridik. Gjatë kohës koncesionet vetëm çka kanë fituar rëndësinë e tyre. Në 124 shtete ekzistojnë ligje të posaçme ose dhënia e koncesioneve praktikohet në bazë të dispozitave të përgjithshme. Dispozitat më së shpeshti kanë të bëjnë me koncesione për hulumtimin dhe eksploatimin e naftës⁹⁴.

Koncesioni është autorizim të cilin shteti ose pushteti tjetër publik (koincidenti) i jep ndonjë personi, fizik ose juridik, vendës ose të jashtëm ose të shtetit të jashtëm (koncesionarit) për të shfrytëzuar ndonjë pasuri natyrore ose të kryerjes së ndonjë shërbimi publik. Koncesionet më së shpeshti janë në xehetari, bujqësi, transport, furnizim me energji dhe shërbime komunale⁹⁵.

Nga kontrata për koncesion duhet dalluar kontrata BOT (Build Operate and Transfer). Këto janë kontrata të tilla të cilat një person i jep personit tjetër që me shpenzime të veta ta ngrisë ndonjë repart ose objekt, ta shfrytëzoj atë për një kohë të caktuar dhe pas skadimit të asaj kohe ta bartë në pronën e repartit ose të objektit⁹⁶.

Një numër i caktuar i autorëve qëndron pranë mendimit se emërtimi “Kontratë mbi koncesionin”, kur si konsident paraqitet shteti i vendit në zhvillim, e si koncesionar ndërmarrja e jashtme, duhet ndryshuar emërtimin në “Kontratë për bashkëpunim ekonomik” (economic development agreement), sepse ky emërtim më mirë e shprehë qëllimin dhe natyrën e kontratës⁹⁷.

Në shumë kontrata të koncesionit kërkohet nga konsidenti që të kontribuojë drejtpërsëdrejti në zhvillimin ekonomik nacional. Nga konsidenti për shembull kërkohet që të furnizohet me mall dhe me pajisje të prodhimit vendor, që ta angazhoj dhe ta shkollojë fuqinë punëtore

⁹⁴ Barrows, H.G., *Worldwide Concession Contracts and Petroleum Legislation*, Tulsa, 1986, fq.34.

⁹⁵ M. Hetemi-v.c. fq.316

⁹⁶ M. Hetemi-v.c. fq.318

⁹⁷ Nwogugu, E.I., *Foreign investment in Developing Countries*, Manchester, fq.166-167

lokale, si dhe të lejojë që objektet infrastrukturore të cilat i ka andërtuar t'i shfrytëzojnë edhe të tjerët⁹⁸.

Në literaturën juridike koncesionet definojnë si leje e veçantë që pushteti u`a jep qytetarëve të një shteti të caktuar dhe shtetasve të huaj, për shkak të ushtrimit të veprimtarisë industriale, tregëtare ose veprimtarisë së përgjithshme ekonomike⁹⁹.

Marrëdhëniet kocesionare në Republikën e Kosovës nuk janë në një vëllim të madh edhe pse ka raste kur institucionet shtetërore kanë lidhur kontrata të tilla me operatorë të caktuar. Në anën tjetër doktrina e të drejtës kontraktore kosovare lidhur me trajtimi e kontratave koncesionare është tejte e varfër¹⁰⁰.

Shqipëria në vitin 1995 ka miratuar ligjin për koncesionet. Ligji për Koncesionet i Republikës së Shqipërisë ka për qëllim të krijojë një kuadër të favorshëm dhe të qëndrueshëm për nxitjen, thithjen dhe krijimin e lehtësive për investimet që realizohen si koncesione/partneritete publike private¹⁰¹. Ky ligj rregullon kompetencat e autoriteteve kontraktuese për të hyrë në marrëveshje koncesionesh/partneritetesh publike private, për investime të bazuara në koncesione/partneritete publike private, procedurat për dhënien e kontratave të tilla, si nënshkrimi, ndërprerja dhe ndryshimet e marrëveshjeve të koncesionit/partneritetit publik privat, çështjet që kanë të bëjnë me rregullimet financiare dhe mbështetjen, në lidhje me koncesionet/partneritetet publike private, politikën e këtyre koncesioneve e autoritetin për zbatimin e tyre, si dhe çështje të tjera që lidhen me koncesionet/partneritetet publike private¹⁰².

Strategjia për zhvillimin dhe inkurajimin e investimeve të huaja u jep koncesioneve rendësi të madhe. Koncesioni paraqet edhe një nga format e sigurimit të mjeteve të investimit meqë parashihet që koncesionar mund të jetë edhe partneri i jashtëm. Subjekti i jashtëm i cili mund të jetë koncesionar është subjekti juridik me seli jashtë shtetit pritës, person i huaj fizik ose shtetasi i shtetit mëmë me vendbanim gjegjësisht vendqëndrim jashtë vendit në

⁹⁸ Krešimir Sajko, Ugovor o koncesiji I osnivanju, N. zakonitost, 5/70, fq.363

⁹⁹ A.Jashari, v.c.fq. 69

¹⁰⁰https://www.researchgate.net/publication/305342633_koncesionet_dhe_kontratat_koncesionare_ne_sistemin_juridik_te_republiken_e_kosoves

¹⁰¹ Ligji për Koncesionet dhe Partneritetin Publiko Privat i Republikës së Shqipërisë

¹⁰² LIGJ Nr. 125/2013 PËR KONCESIONET DHE PARTNERITETIN PUBLIK PRIVAT

një periudhë më të gjatë se një vit¹⁰³. Shikuar në planin e bazës juridike koncesionet kryesisht bazohet në dy ligje sistemore. I pari është Ligji për prokurimin publik i cili garanton efikasitetin, transparencën dhe rregullon të drejtë të shfrytëzimit të fondeve publike, burimeve publike si dhe të gjitha fondeve dhe burimeve të tjera dhe Ligjit për Partneritetin Publiko Privat dhe koncesionet në infrastrukturë dhe procedurat për dhëniet e tyre¹⁰⁴.

Në ligjin për partneritet publiko-privat dhe koncesionet i Republikës së Kosovës parashihet krijimi i kornizës ligjore për partneritet publiko privat duke përfshirë procedurat për të hyrë në një partneritet publiko privat, përmbajtjen dhe strukturën e marrëveshjeve për Partneritet Publiko Privat si dhe strukturën institucionale përgjegjëse për menaxhimin dhe zhvillimin e Partneritetit Publiko Privat në Republikën e Kosovës¹⁰⁵.

Pavarësisht nga paragrafi 2. i nenit 7 të këtij ligji, Autoriteti Publik i cili zhvillon një procedurë e cila rezulton në dhënien e një koncesioni të punëve vlera e të cilit është e barabartë ose tejkalon shumën gjashtë milion e dyqind e dyzet e dymijë (6.242.000) Euro duke përjashtuar tatimin mbi vlerën e shtuar zbaton gjithashtu edhe kërkesat për publikim dhe shpallje të përcaktuara në Ligjin për Prokurimin Publik në Republikën e Kosovës¹⁰⁶.

Në të drejtën ndërkombëtare koncesioni nënkupton dhënien e lehtësimeve personave fizik ose juridik të huaj për ushtrimin e disa të drejtave ekskluzive, të cilat parimisht nuk i`u takojnë të huajve, siç janë: eksploatimi i pasurive nëntokësore (naftës ose xeheve etj.) shërbimeve publike, etj. Këto kontrata si zakonisht nuk kanë karakter ndërkombëtar, nëse kjo nuk sanksionohet me marrëveshje plotësuese bilaterale për mbrojtje¹⁰⁷.

¹⁰³https://www.researchgate.net/publication/305342633_koncesionet_dhe_kontratat_koncesionare_ne_sistemin_juridik_te_republiken_e_kosoves

¹⁰⁴ Po aty, fq. 62

¹⁰⁵ **LIGJI NR. 04/L-045 PËR PARTNERITET PUBLIKO PRIVAT**

¹⁰⁶ LIGJI Nr. 04/L-045 PËR PARTNERITET PUBLIKO PRIVAT

¹⁰⁷ A.Jashari v.c. fq.69

Si përfundim: nga gjykimi ynë sa i përket këtij kapitulli themi se Kosova si vend që ende nuk e ka kaluar fazën e tranzicionit, ende vërehen pasojat e luftës, nuk ka një ekonomi stabile mirë të zhvilluar. Prandaj nevoja për të investuar në vendin tonë është e madhe krahasuar me investimet që janë bërë deri tani për arsye se nuk mund të themi se ka një zhvillim të kënaqshëm ekonomik ose më mirë të themi jo në përmasat e dëshiruara. Sektorët në të cilët janë fokusuar më tepër investuesit e huaj që të investojnë kapitalin e tyre kanë qenë kryesisht në tregti, veprimtari shërbyese në energjetikë. Sektorët tjerë mbeten ende në një pozitë jo të kënaqshme duke pasur parasysh nevojën e madhe edhe në shumë sektorë të tjerë. Me investime që do bëheshin në këta sektorë ndikimi i madh do të ishte në hapjen e vendeve të reja të punës për të rinjtë në Kosovë që është një problem që dita ditës shtohet edhe më shumë. Një gjë të tillë mund ta themi edhe për Shqipërinë, e cila si një vend që ka kaluar më shumë se 100 vite shtet nuk ka zhvillim të kënaqshëm ekonomik, kjo mund të vie si pasojë e mosfunksionimit si duhet të organeve shtetërore sa i përket promovimit të vendit në tërheqjen sa më të madhe të investitorëve.

KAPITULLI IV

IHD DHE ROLI JURIDIK I TYRE NË LIDHJE ME ZHVILLIMIN E MARËDHËNIEVE TREGTARE

Hyrje

Në këtë kapitull kemi paraqitur avantazhet dhe disavantazhet e të investuarit në Kosovë dhe Shqipëri, cilat janë përparësitë në këto dy vende, si dhe a mund të ketë pasoja për bizneset vendore nga investimet e huaja, gjithashtu sa është interesuar, hulumtimin rreth marrëdhënieve tregtare që kanë këto dy vende me disa nga vendet e BE-së. E rëndësishme është të përmendim edhe rëndësinë që ka hapja tregtare e tyre dhe ndikimi i kësaj hapje në ekonominë e shteteve të cilat si fokus kryesor kanë integrimin në familjen evropiane. Mirëpo, krijimi i marrëdhënieve tregtare nuk do të jetë i mundur poqese Kosova dhe Shqipëria nuk kanë një rend juridik të sigurt, sundim të ligjit, efikasitet në gjykata, si dhe një politik të drejtë dhe jo të korruptuar.


4.1 KRAHASIMI ME VENDET E RAJONIT

Në këtë kapitull jemi fokusuar më shumë në krahasimin e tërheqjes së investimeve të huaja në mes të Kosovës me gjashtë vende të rajonit. Në vitet e fundit fluksi i IHD-ve ka arritur vlerën në 22.6 miliardë dollarë në Shqipëri, Kosovë, Mal të Zi, Maqedoni, Bosnjë e Hercegovinë dhe Serbi. Në këto vende shpërndarja e flukseve të investimeve të huaja nuk ishte në mënyrë të barabartë. Vendi që ka tërhequr deri më tani më shumë investime të huaja është Serbia, sidomos në dy vitet e fundit, vlera e të cilave arrin në 2.3 miliardë dollarë. Serbia është vendi në rajon me ekonomi relativisht më të madhe si dhe popullsi me rreth 7 milionë banorësh që ndikon në tërheqjen më të madhe të investimeve të huaja. Në dominimin e Serbisë sa i përket tërheqjes më të madhe të investimeve të huaja, sidomos viteve të fundit kanë ndikuar perspektivat e BE-së, zonat industriale më të zhvilluara. Vendin e dytë në tërheqjen e shumave relativisht më konstante të IHD-ve në

vitet e fundit diku rreth 1 miliardë dollarë është Shqipëria. E tërë kjo është bërë fal projekteve energjetike që ka pasur Shqipëria viteve të fundit.

Vendet e tjera si: Kosova, Mali i Zi, Maqedonia dhe Bosnja e Hercegovina kanë tërhequr më pak investime të huaja përgjatë viteve.

Vlen të përmendet se në mesin e këtyre vendeve, IHD-të nga brenda në Maqedoni ka shënuar një trend të rritjes së mprehtë, ndërsa në Mal të Zi ka ndodhur e kundërta. Vëllimi i flukseve të IHD-ve në vitin 2016 ishte rritur me rreth 70 përqind krahasuar me vitin 2012; ndërsa në këtë të fundit, ulja e regjistruar ka qenë rreth 63 përqind. Trendi pozitiv në Maqedoni mund të shpjegohet me lulëzimin e parqeve industriale që ofrojnë stimuj shumë tërheqës për investitorët ndërkombëtarë. Nga ana tjetër, trendi negativ në Mal të Zi është kryesisht për shkak të rrjedhjes të dividendave nga telekomi¹⁰⁸.



Burimi: Banka Botërore 2017

Grafiku 5 - IHD-të në vendet e rajonit në miliona euro

4.2 AVANTAZHET E TË INVESTUARIT NË KOSOVË DHE SHQIPËRI

¹⁰⁸http://d4d-ks.org/wp-content/uploads/2018/03/D4D_Analize_5_SHQ_FIN.pdf fq.17 28.07.2018

Investimet e huaja direkte kanë shumë avantazhe, si për investitorin, poashtu edhe për vendin pritës. Investimet e huaja direkte mundësojnë përparimin dhe hapjen e ekonomive në nivel ndërkombëtar, duke ndihmuar në zhvillimin ekonomik të vendit pritës. Gjithashtu vlen të theksohet se IHD-të mundësojnë krijimin e vendeve të reja të punës dhe ndikojnë në një cilësi më të lartë me ç'rast ofrojnë paga të kënaqshme dhe kushte më të mira për punëtorët¹⁰⁹.

Mirëpo, përveç avantazheve, IHD-të kanë gjithashtu edhe disavantazhet e tyre, investimet e huaja direkte, përveç anës pozitive kanë edhe “mangësi” të cilat i shoqërojnë duke përfshirë problemet gjuhësore dhe kulturore, mundësinë e dështimit që bën investitorët të kenë kujdes të madh para se të investojnë në një vend dhe ajo që është më e rëndësishmja, marrëdhëniet tregtare që ka vendi ku investitorët dëshirojnë të investojnë me shtetet fqinje luan një rol vendimtar për të investuar¹¹⁰.

4.2.1 AVANTAZHET E IHD-ve

- a) Një ndër përfitimet më të mëdha është se mundëson bizneset të operojnë atje ku kanë perspektivë më të madhe dhe që ndikon në rritjen e biznesit të tyre, kudo në botë.
- b) Paratë lëvizin më lehtë në të gjithë botën dhe më shpejt sjellin mallra dhe shërbime,
- c) Investimet e huaja direkte ndikojnë gjithashtu edhe në uljen e ryshfetit, në efekte të këqia të politikës, natyrisht pa mundur të eliminojnë në tërësi,
- d) Sigurimi i një standardi më të mirë të jetesës për punonjësit të cilët punojnë në kompanitë e huaja duke iu mundësuar paga dhe shpërblime të larta se në ato vendore,
- e) Në një farë mënyrë detyrojnë qeveritë lokale të ndjekin trendin dhe të mos zbatojnë politika të varfëra.

¹⁰⁹ <https://aab-edu.net/assets/uploads/2018/03/Libri-i-abstrakteve-2017-Final.pdf> Avantazhet dhe disavantazhet e investimeve të huaja direkte dhe roli tyre në Kosovë dhe Shqipëri, qasje krahasuese, Albana Pasjaqa, phd, Ylber Prekazi, PhD, fq.53

¹¹⁰ Po aty, fq. 5

- f) Një tjetër avantazh e që është shumë i rëndësishëm ka të bëj me shtimin e taksave të cilat marrin qeveritë nga investimet e huaja direkte. Në disa raste për të tërhequr investitorë kjo mund të mos ndikojë, pasi që qeveritë bëjnë uljen e taksave për tërheqjen e tyre.

4.2.1 AVANTAZHET E TË INVESTUARIT NË SHQIPËRI

Për ndërtimin e një strategjie pozicioni në tregun global është mjaft i rëndësishëm analiza e avantazheve dhe disavantazheve. Duke pasur parasysh se Shqipëria ka një ekonomi me kosto të ulët, mundësia për tërheqjen e investitorëve është shumë e madhe, vetëm se për të qenë sa më të suksesshme në këtë drejtim nevojiten politikat e duhura dhe mjetet. Krijimi i një klime miqësore ndaj investitorëve do të ndikojë në përmirësimin e burimeve njerëzore, sepse përveç hapjes së firmave të mëdha do të hapen edhe vende të reja të punës gjë që do ndikojë shumë në përmirësimin e nivelit të jetesës, për shumë familje si në Kosovë, poashtu edhe në Shqipëri.

Disa nga avantazhet më të rëndësishme për tërheqjen e investitorëve janë:

a) Popullsia e re dhe e arsimuar

Mbi 1.071.948 të rinj janë pjesa që e përbejnë popullsinë e Shqipërisë, ndërsa nën moshën 35 vjeçare janë 57% e popullsisë. Në sistemin e arsimit janë të përfshira: gjuha angleze, italiane, franceze dhe gjermane.

b) Taksa konkurruese

Taksat në Shqipëri janë më liberale se sa në vendet e tjera në rajon. Legjislacioni shqiptar parashikon një taksë prej 10% si dhe tatimi mbi të ardhurat personale është po në të njëjtën masë prej 10%.

c) Klimë liberale dhe reformiste investive

Shqipëria është anëtare e Organizatës Botërore të Tregtisë dhe zbaton rregullat e saj për licencimin e importit. Përmes Paktit të Stabilizim Asociimit ka nënshkruar marrëveshje të Tregtisë së Lirë me Bashkimin Evropian.

d) Pozicioni strategjik gjeografik

Lidhja me Rrjetin Evropian të Transportit si dhe vendndodhja e saj midis korridoreve të Tranzitit i jep Shqipërisë një pozicion strategjik gjeografik shumë të favorshëm për shërbimet tregtare.

e) Potencial i madh i investimeve

Shqipëria është e pasur me naftë dhe gaz, bakër, hekur dhe xehrore si dhe ka potencial të pashfrytëzueshëm si në aspektin e energjisë së rinovueshme, infrastrukturës, dhe shërbimeve dhe turizmit.

f) Cilësia e mirë e jetës

Me qëllim të tërheqjes së investimeve të huaja direkte si dhe t'u bëjë mënyrën e jetës sa më të lehtë për tërë familjen që investojnë në vendin tonë, Shqipëria ka shkolla dhe universitete të mira ndërkombëtare. Gjithashtu posedon një mjedis të sigurtë për të jetuar më mundësi argëtuese dhe zbavitëse. Klima e biznesit dhe investimeve përbëhet nga një hapësirë ligjore miqësore.

Kjo shërben si bazë për kompanitë e huaja dhe vendëse që të bëjnë biznes dhe të kërkojnë fitime.

- a) Të gjithë sektorët janë të hapur për investimet e huaja direkte. Ligji garanton trajtim të barabartë dhe të paanshëm sa i përket investimeve dhe investitorëve. Sikurse për investitorët vendës poashtu edhe për ata të huaj ligji lejon të njëjtat kushte.
- b) Investitorët të cilët duan të krijojnë një kompani, nuk iu kërkohet autorizim paraprak, ligji respekton parimin e trajtimit kombëtar. Kufizimet janë për sektorë të veçantë si p.sh. shërbime të noterisë dhe përbarimit si dhe prodhimit të armëve.
- c) Në rastet kur e kërkon interesi publik si dhe në ato raste të cilat janë të përcaktuara me ligj investimet e huaja direkte mund të nacionalizohen apo shpronësohen ndërsa në raste tjera një gjë e tillë nuk është e mundur. Në rastet kur lejohet nacionalizimi procedura zhvillohet pa diskriminim.
- d) Për të drejtat të cilat lidhen me investimet e tyre, investitorët gëzojnë të drejtën e mbrojtjes gjyqësore. Palët në mosmarrëveshje mund të merren në konsideratë nga një institucion arbitrazhi. Në rast të mosmarrëveshjes për shkak të diskriminimit investuesi mund ta dërgojë çështjen në Qendrën Ndërkombëtare për zgjidhjen e Mosmarrëveshjeve të Investimeve (ICSID).

- e) Epërsi juridike mbi legjislacionin vendas kanë marrëveshjet e ratifikuara ndërkombëtare.
- f) Kompanitë që investojnë në Shqipëri , do të thotë, shtetasit e huaj kanë të drejtë pa asnjë kufizim të blejnë tokë, si dhe të punësojnë shtetas të huaj.
- g) Për ta bërë vendin sa më tërheqës për investitorët janë parashikuar një sërë reformash administrative, fiskale dhe gjyqësore.

4.2.2 AVANTAZHET E TË INVESTUARIT NË KOSOVË

Investitorët potencial të huaj kanë shumë mundësi që të investojnë në Kosovë duke pasur parasysh se Kosova ka: taksa të ulta, ambient përkrahës të biznesit dhe resurse të pasura. Me gjithë këto resurse të pasura që ka Kosovës i nevojitet më shumë promocion në këtë drejtim me qëllim që të tërheqim sa më shumë interesimin e investitorëve të huaja dhe kjo gjykojmë se arrihet duke prezantuar vendin në formën sa më të mirë të mundshme. Ndër avantazhet e shumta që ka vendi ynë më poshtë kemi cekur ato të cilat janë të domosdoshme:

a. Sistemi tatimor

Krahasuar me shtetet fqinje taksat në Kosovë janë shumë të ulta si dhe sistemi tatimor është mbajtur shumë i thjeshtë:

b. Popullata e re

Mbi 70% të popullsisë në Kosovë janë nën moshën 35 vjeçare, që do të thotë se vendi ynë ka një popullatë të re dhe të motivuar për punë, të cilët posedojnë njohuri të përgjithshme të shumicës së gjuhëve evropiane.

c. Resurset natyrore

Kosova është e pasur me toka pjellore bujqësore, me linjit, plumb, zink dhe ferronikel me që rast mund të cilësohet si vend me mundësi të mëdha për investime duke përfshirë edhe vreshtarinë, turizmin, nxjerrjen dhe përpunimin e metaleve.

d. Sistemi i regjistrimit të bizneseve.

Përbën një faktorë të rëndësishëm në tërheqjen e investitorëve, pasi që Kosova ka procedura të thjeshta dhe të shpejta për regjistrimin e bizneseve të reja (brenda 3 ditëve). Ligji për investimet e huaja i mbron investitorët e huaj dhe i trajton të barabartë me investitorët e brendshëm. Për të pasur biznesin legjitim ndërmarrjet vendore dhe të huaja duhet të regjistorhen në Agjensionin e Regjistrimit të Bizneseve në Ministrinë e Tregtisë dhe Industrisë në njërën nga këto kategori:

- a) Biznese individuale,
- b) Ndërmarrje shoqërore,
- c) Ndërmarrje publike,
- d) Shoqëri aksionare,
- e) Ortakëri e përgjithshme,
- f) Ortakëri e kufizuar,
- g) Kompani e huaj,
- Ndërmarrje tjera nën juridiksionin e AKM-së.

e. Sistemi Doganor

Procedurat e avancuara në zhdoganimin e mallrave përmes sistemit elektronik – TIMS (Trade Information Management System) e bëjnë Kosovën vend tërheqës për të investuar ku koha mesatare për zhdoganim të mallrave në kalimet kufitare është 3 orë.

4.3 DISAVANTAZHET E TË INVESTUARIT

Disavantazhet e investimeve të huaja direkte janë gjithashtu ana tjetër e medaljes. Ato ndodhin kryesisht në rastin e çështjeve që lidhen me funksionimin dhe shpërndarjen e fitimeve nga investimet e huaja. Një nga disavantazhet jo të drejtpërdrejta të IHD-ve është se sektorët ekonomik më pak të zhvilluar të vendit pritës janë gjithmonë të papërshtatshëm kur niveli i IHD-ve ndikon në mënyrë negative¹¹¹.

- a) Kompanitë e huaja duke u përqëndruar në sektor strategjik të rëndësishëm, mund të krijojnë çrregullime në aspektin sektorial,

¹¹¹ <http://www.doktoratura.unitir.edu.al/wp-content/uploads/2012/09/Oltjana-Zoto-Fakulteti-i-Ekonomisw.pdf>

- b) Përdorin në disa raste njohuritë dhe mjeshtërit që gjejnë në kompanitë vendëse ndërsa nuk ua shtojnë aspak vlerën atyre,
- c) Gjithashtu mund të shesin një pjesë të kompanisë që nuk sjell aspak përfitime investitorëve vendës të cilët nuk janë aq të kualifikuar për t'i kuptuar si duhet këto gjëra,
- d) Çdo herë e më shumë ekonomia e vendeve në zhvillim është e varur nga investimet e huaja direkte,
- e) Një tjetër disavantazh e që duhet të kemi kujdes të shtuar ka të bëjë me raportin në mes të “kapitalit të huaj dhe kapitalit vendës”, sepse mund të krijohet varësi nga vendi pritës nga investimi i huaj dhe mund të vie deri tek ndikimi në politikë apo vendimmarrje të qeverive pritëse.

4.4. MARËDHËNIET TREGTARE TË KOSOVËS DHE SHQIPËRISË ME VENDET E BASHKIMIT EVROPIAN

Bazë kryesore për zhvillimin ekonomik të çdo vendi është tregtia. Bashkimi Evropian është krijuar në bazë të këtij parimi, institucioni të cilin e aspirojnë të dy vendet, sikurse Kosova ashtu edhe Shqipëria. Për fatin e mirë të Kosovës dhe Shqipërisë, dy vendet kanë një bashkëpunim të mirë në mes vete, prandaj nuk ballafaqohen me nevojën për të investuar në ndërtimin e marëdhënieve të mirëfillëta ekonomike pasi që një gjë e tillë është realitet. Përderisa në Kosovë janë regjistruar 23 biznese shqiptare kryesisht në sektorin e ndërtimtarisë, prezenca e bizneseve kosovare në Shqipëri është shumë më e vogël dhe kryesisht kemi të bëjmë me biznese mikro.

Dallimet më të mëdha në mes të dy vendeve janë në sistemet fiskale respektive të aplikuara në territoret e tyre. Përveç dallimeve në shkallën e TVSH-së, e cila në Shqipëri është 20% përderisa në Kosovë është 16%, ka dallime edhe në bazën e taksueshme. Po ashtu, duke filluar nga 1 janari 2014, Shqipëria aplikon taksë progresive për Tatimin mbi Fitim dhe të Ardhura, përderisa në Kosovë aplikohet sistemi i taksës gjysmë progresive në funksion të tavanit. Për më tepër, të dy vendet kanë të ndërtuar sistemin ligjor i cili është i përshtatur për nevojat individuale, por që kurrësi nuk kontribuon drejt asaj që këto dy vende të kenë më të lehtë bashkëveprimin e tyre në fushën e tregtisë.

Dallimet e llojit të tillë në mes të dy vendeve e vështirësojnë edhe më tutje mundësinë e bashkëpunimit tregtar në një nivel më të hovshëm. Duke iu rikthyer edhe njëherë faktit që të dyja vendet janë vende që individualisht nuk është se paraqesin fuqi të mëdha dhe të rëndësishme ekonomike, si dhe duke marrë shkas nga efektet pozitive të promovimit të tregtisë së lirë, veprimet konkrete drejt ngritjes së nivelit të bashkëpunimit dhe bashkërendimi i aktiviteteve drejt një qëllimi të tillë mund të thuhet se është një prej hapave më racionale në këtë stad të zhvillimit të dy ekonomive fqinj¹¹²

Marëdhëniet ekonomike Kosovë-Shqipëri kufizohen me shkëmbime tregtare të profilit eksport-import. Pa ndonjë avancim të dukshëm në drejtim të tërheqjes së investimeve direkte në mënyrë të përbashkët apo respektive. Po qe se krahasojmë investimet respektive, vërejmë që afaristë shqiptarë kanë tendencë më të madhe për të investuar në Kosovë. Sipas të dhënave, kulmi i investimeve në Kosovë nga afaristët nga Shqipëria është regjistruar në vitin 2010, kur gjithsejt u regjistruan 108 ndërmarrje të reja shqiptare në Kosovë. Në bazë të profilit të këtyre ndërmarrjeve, dominojnë ndërmarrjet tregtare si dhe një numër i konsiderueshëm i subjekteve që fokusohen në sektorin e ndërtimtarisë e së fundmi kemi edhe investime në sektorin e barnave. Edhe pse numri i bizneseve të ardhura nga Shqipëria nuk është për t'u injoruar, ajo çka është brengosëse është fakti që shumica e këtyre bizneseve kanë kapital zero, përderisa vlerësohet që diku jo më shumë se 10 kompani nga Shqipëria në Kosovë e përbëjnë 98,9% të kapitalit të të gjitha ndërmarrjeve të regjistruara në vend¹¹³.

Kosova në vitin 2013 hyri në një fazë të re të marëdhënieve me BE –në. Në qershor, Këshilli i Bashkimit Evropian autorizoi Komisionin Evropian që të nis negociatat për Marrëveshje të Stabilizim Asociimit (MSA) mes Kosovës dhe BE-së. Sipas BE-së, MSA-ja definon të drejtat dhe detyrimet e palëve deri në realizim të anëtarësisë së plotë në BE¹¹⁴

¹¹²http://indep.info/wp-content/uploads/2015/01/14039_INDE2015_MARRËDHËNIET-TREGTARE-KOSOVË-SHQIPËRI.pdf

¹¹³Shehu, e., *shqiperi – kosove, tregu qe nuk funksionon, e qasshme tek: <http://www.gazetadita.al/shqiperi-kosovetregu-qe-nuk-funksionon/>*

¹¹⁴http://kfos.org/wp-content/uploads/2015/04/Marr%C3%ABdh%C3%ABniet-Tregtare-mes-Kosov%C3%ABs-dhe-Bashkimit-Evropian_E-KOMPLETUAR.compressed.pdf

4.5 HAPJA TREGTARE E KOSOVËS DHE SHQIPËRISË

Kosova është vend i vogël që nuk ka dalje në det dhe kufizohet me Shqipërinë, Serbinë, Malin e Zi dhe Maqedoninë. Kosova ka popullsinë më të re në Evropë, numri i përgjithshëm i popullsisë në vitin 2015 është vlerësuar të jetë 1.797 milionë banorë, ku më shumë se 70% e saj është nën moshën 35 vjeçare. Sipas Agjensisë së Statistikave të Kosovës (ASK), BPV-ja është rritur gjatë periudhës 2014-2016 nga 5.567.5 milionë euro në 6.046.8 milionë euro. Aktiviteti ekonomik i Kosovës në vitin 2015 është udhëhequr pothuajse i tëri nga pozita e investimeve ku shënoi rritje prej 10.7%. Zhvillimi ekonomik është mjaft i rëndësishëm për shoqërinë kosovare e cila ende ballafaqohet me një sërë problemesh të cilat kanë të bëjnë me bashkangjritjen e rrjedhave aktuale të zhvillimit ndërkombëtar sa i përket sferës ekonomike.

Gjendja aktuale ekonomike ndërlidhet me tregtinë e jashtme të Kosovës si dhe situatën e përgjithshme tregtare, ose më mirë të themi shkallën e zhvillimit ekonomik që shprehet edhe nga treguesit e tregtisë së jashtme e cila nxjerr në pah gjendjen reale të sektorëve prodhues në Kosovë. Në sektorin e mallrave bilanci i tregtisë së jashtme është mjaft negativ i përcjellur nga viti në vit. Duke marrë për bazë se sektori i tregtisë së jashtme ka një rëndësi të veçantë në zhvillimin ekonomik, andaj politika tregtare është një nga instrumentet kryesore të politikës së përgjithshme ekonomike. Mbi të gjitha shifrat japin një pasqyrë të qartë për bilancin tregtar të Kosovës e cila ka një deficit të lartë tregtar evidente për vite të tëra duke tejkaluar 2 miliardë euro. Situata tjetër kemi te sektori i shërbimeve ku nga viti në vit, bilanci i tregtisë në shërbime është pozitiv, duke gjeneruar të hyra në buxhetin e Kosovës dhe duke e bërë më konkurrues këtë sektor¹¹⁵.

Ndërsa Shqipëria sa i përket hapjes tregtare është e fokusuar në rritjen dhe promovimin e liberalizimit tregtar që të arrijë objektivin final, integrimin në familjen evropiane.

Me përqafimin e procesit të globalizimit si dhe Marrëveshjeve me Organizatën Botërore të Tregtisë, Shqipëria vazhdon të implementojë politika ekonomike që promovojnë rritjen ekonomike më afatgjatë. Shkëmbimet tregtare me Bashkimin Evropian zënë 66% të gjithë tregtisë së Shqipërisë. Për të dyja vendet hapja tregtare konsiderohet si pjesë e procesit të

¹¹⁵<https://mti.rks-gov.net/desk/inc/media/6a8ce0e5-202d-4c98-92b1-153e4353c9a7.pdf>

globalizimit dhe së bashku me liberalizimin tregtar janë të rëndësishme për integrimin në ekonominë globale.

- a) Në kuadër të hapjes tregtare së bashku me hapjen ndaj investimeve të huaja direkte Kosova dhe Shqipëria mund të përfitojnë një zhvillim më të madh ekonomik.
- b) Hapja tregtare me vendet e rajonit ndikon pozitivisht në rritjen e ekonomisë së dy vendeve. Ndërsa hapja ekonomike me vendet e Bashkimit Evropian mund të ndikojë në rritjen e bashkëpunimit ekonomik me vendet e BE-së dhe një veprim i tillë ndikon në rritjen e ekonomisë shqiptare në përgjithësi.

4.6 ECURIA E EKSPORTEVE DHE IMPORTEVE ME VENDET E BASHKIMIT EVROPIAN

Rreth 56% e totalit të eksporteve Kosova ka eksportuar në dy produkte (metali i pa përpunuar dhe produktet minerale) në vlerë prej 175 milionë euro. Gjithashtu produktet ushqimore 14.4 përqind mbulojnë eksportet e përgjithshme. Sektori i ushqimit është mjaft premtues nëse i kemi parasysh të dhënat e vlerës së eksporteve për mallrat e këtij sektori ku në vitin 2014 kemi pasur një rritje prej 35%, ndërsa në vitin 2015 8.7%. Sipas Ministrisë së Industrisë dhe Tregtisë rënie të eksporteve kemi pasur në metalet bazë 35.9% të totalit të eksporteve në 2016 dhe rënie për 29.5% krahas vitit 2015. Pjesa më e rëndësishme e shkëmbimeve tregtare të Kosovës është me vendet e BE-së dhe vendet e rajonit, ku përbëhet rreth 70% e tregtisë së jashtme. CEFTA është partner i rëndësishëm tregtar e cila mbulon 29% të shkëmbimeve tregtare. Rreth 46% të mallrave me origjinë kosovare eksportohen në CEFTA. Mallrat kosovare gjithashtu eksportohen edhe në këto vende: Shqipëri, Maqedoni, Bosnje dhe Hercegovinë, Mali i Zi dhe Serbi.

Sa i përket pjesës tjetër të botës mallrat kosovare eksportohen në Zvicër, Turqi, Kinë dhe Indi. Tregtia në shërbime në Kosovë për periudhën prill 2016 – mars 2017 ka arritur në total prej 1.5 miliardë euro. Nga kjo shumë, totali i eksportit përfshin një shumë prej 1.04 miliardë euro, ndërsa importi një shumë të përgjithshme prej 437.1 milionë eurove. Kjo tregon një bilanc tregtar pozitiv prej 567.5 milionë euro. Nëse e krahasojmë me periudhën e njëjtë prill 2015-mars 2016, shohim se eksporti i shërbimeve ishte 966.7 milionë euro,

përderisa importi rezultoi me 478.2 dhe bilanci tregtar 478.2 milionë euro në tregtimin ndërkombëtar të shërbimeve.

Duke u bazuar në këto shifra, vërejmë se ka një trend pozitiv të rritjes së bilancit të shërbimeve në një shumë prej 89.3 milionë euro. Sektorët kryesorë të cilët kontribuan drejt një bilanci tregtar pozitiv për periudhën prill 2016 – mars 2017 janë: udhëtimet (turizmi) me eksport në vlerën prej 809.6 milionë euro, e ndjekur nga shërbimet profesionale dhe të biznesit me 64.4 milion euro, shërbimet e komunikimit (ICT) me 48.6 milionë euro; dhe shërbimet qeveritare me 35.8 milionë euro; shërbimet e ndërtimit me 10.6 milionë euro. Shërbimet e udhëtimit dhe turizmit kryesisht i atribuohen diasporës së Kosovës dhe shtetasve të huaj që punojnë në Kosovë¹¹⁶.

Tabela 5 Tregtia në Shërbime / Bilanci Prill 2016 – Mars 2017

Viti	Eksporti i shërbimeve	Importi i shërbimeve	Bilanci
2016-2017	milion euro	milion euro	milion euro
	1,040.70	437.1	567.5

Burimi: Banka Qendrore e Kosovës

Tregtia në shërbime përbën një pjesë të madhe të BPV-së, kryesisht falë prezencës së donatorëve në vend. Vlerësim i përgjithshëm i kontributit të shërbimeve në BPV ishte 73% në vitin 2015, sipas një vlerësimi nga Banka Botërore.

Tabela 6 Eksporti i Shërbimeve / Top Sektorët Prill 2016 – Mars 2017

Viti 2016-2017	milion euro
Udhëtimi	809.6
Shërbime tjera të biznesit	64.4
Shërbimet kompjuterike, informative dhe te telekomunikimit (ICT)	48.6
Mallra dhe shërbime qeveritare	35.8

Burimi: Banka Qendrore e Kosovës

¹¹⁶<https://mti.rks-gov.net/desk/inc/media/6A8CE0E5-202D-4C98-92B1-153E4353C9A7.pdf>

Kosova në masë të madhe është e varur nga importet. Struktura e importeve në vitin 2016 është pothuajse e njëjtë me atë të vitit 2015, që ka qenë 12.3%.

Tabela 7 Importi i shërbimeve / Struktura e importeve

Viti 2015 – 2016	milion euro
Produktet minerale	24
Produktet ushqimore	373
Mjetet e transportit	55.9

Burimi: Banka Qendrore e Kosovës

Importet dominojnë më shumë nga produktet minerale (nga nafta dhe derivatet e saj) dhe kategoria e makinerive të cilat përfshijnë 24% të totalit të importeve. Në strukturën e importeve gjithashtu kemi edhe produktet ushqimore të cilat gjatë vitit 2016 janë importuar në vlerë prej 373 milionë. Rritje të madhe të importeve ka pasur tek mjetet e transportit në vlerë prej 55.9 milionë euro dhe nëse e krahasojmë me vitet paraprake mund të shohim një rritje të lartë për këtë kategori mallrash. Sa i përket importit në Shqipëri, mallrat importohen nga vende të ndryshme, nga vendet fqinje si dhe nga vendet e tjera më të largta. Rreth 29% e importeve vijnë nga vendi fqinj që është Italia, mirëpo për herë të parë në vitin 2009 importet nga ky vend kanë shënuar rënie ku në Shqipëri filloi të reflektohet kriza botërore ekonomike. Nga Italia importohen ushqimet, makineri, veshje, paisje etj. Gjithashtu importohet edhe nga vendet e tjera siç janë: Greqia, Gjermania, Kina, Turqia, SHBA, Serbia etj.

Mallrat të cilat importohen më së shumti në Shqipëri janë: makineri, paisje dhe pjesë këmbimi, ku vlera arrin në 23%, si dhe ushqim, pije duhan në një vlerë prej 17%, ndërsa importe të tjera ka më shumë në minerale, lëndë djegëse me 8.6%, produkte kimike 13.8%, tekstil dhe këpucë 13.8%¹¹⁷.

¹¹⁷Raporti_Statistikor_janar_17.pdf<http://open.data.al/sq/lajme/lajm/lang/sq/id/1939/Eksportet-importet-dhe-bilanci-tregtar-sipas-grupmallrave-2016>

PJESA III
IHD PËRBALLË LEGJISLACIONIT NË MBROJTJE TË INSTITUCIONEVE
FINANCIARE NDËRKOMBËTARE

Hyrje

Sipas insitucioneve financiare ndërkombëtare, investimet e huaja më shumë janë të fokusuara drejt vendeve të zhvilluara, ndërsa mungon interesimi i tyre në vendet në zhvillim. Kjo dëshmohet edhe për atë se Shtete e Bashkuara të Amerikës janë përfituesit më të mëdhenj të investimeve të huaja direkte, të cilat prej shumë vitesh kanë statusin e mjedisit më atraktiv në gjithë globin për të thithur investime të huaja. Vendet tona duhet të marrin si model kryesor SHBA-të për tërheqjen e investimeve, sepse modelet e mira mund të ndihmojnë shumë në tërheqjen e investimeve të huaja.

Institucionet financiare ndërkombëtare ndikojnë në tërheqjen e vëmendjes së investuesve të huaj nga Kosova dhe Shqipëria duke rritur besimin se këto dy vende që janë të sigurt për të investuar. Të dyja vendet tanimë janë anëtarësuar në disa nga institucionet financiare ndërkombëtare dhe kjo dotë ndihmojë në vlerësimin më të mirë edhe nga investimet e huaja direkte, sepse anëtarësimi në këto institucione do të thotë se të dyja vendet janë vende të cilat kanë shumë anë pozitive dhe përparësi për të investuar.

KAPITULLI V

**NDIKIMI I INSTITUCIONEVE FINANCIARE NDËRKOMBËTARE
NË INVESTIMET NË VEND DHE RAJON**

Qëllimi i antarësimit të Kosovës në institucionet financiare ndërkombëtare ka të bëjë me rritjen e besimit tek investitorët se Kosova është një vend i sigurt ku mund të investohet, si dhe është parë edhe si mundësi e mirë për zhvillimin ekonomik të vendit. Kosova është anëtarësuar në institucionet financiare ndërkombëtare, fillimisht në Fondin Monetar Ndërkombëtar dhe Bankën Botërore në vitin 2009, pastaj në vitin 2012 u bë pjesë edhe e Bankës për Rindërtim dhe Zhvillim.

Institucionet financiare ndërkombëtare kanë një ndikim të rëndësishëm edhe në vendet e rajonit si: në Maqedoni, Shqipëri, Malin e Zi, Serbi etj. Sikurse Kosova edhe këto shtete kanë parë anët pozitive dhe negative që nga anëtarësimi në këto institucione. Duke qenë se këto institucione luajnë rol shumë të rëndësishëm, sidomos në ekonomi të shteteve anëtare, është e rëndësishme që të flasim edhe për arsyen e themelimit të tyre.

Format kryesore të manifestimit të këtyre organizatave janë proceset financiare, proceset investive dhe tragtare, ndërsa strategjia e tyre referohet si strategji e karakterit lokal dhe global. Kjo strategji konsiderohet si parakusht i themelimit dhe i ndërtimit të rrjedhave globale. Në kuadrin e këtyre partneriteteve të procesit të globalizimit, kryesisht do të ndalemi në analizën e FMN-së, BB-së si dhe BERZH-it. Ideja dhe qëllimet burimore për formimin e institucioneve ekonomike ndërkombëtare qëndronin në përmirësimin e vazhdueshëm ekonomik¹¹⁸.

5.1 FONDI MONETAR NDËRKOMBËTAR DHE INVESTIMET NË VENDET E RAJONIT, ME THEKS TË VEÇANTË NË KOSOVË DHE SHQIPËRI

Fondi Monetar Ndërkombëtar (FMN) është një institucion ndërkombëtar i themeluar më 22 Korrik 1944 në Konferencën e Breton Woods, që sot ka 189 vende anëtare. Roli i FMN është të “nxis bashkëpunimin monetar ndërkombëtar, të garantojë qëndrueshmërinë financiare, të lehtësojë shkëmbimet ndërkombëtare, të kontribuojë për një nivel të lartë punësimi, qëndrueshmëri ekonomike dhe ulje të varfërisë”¹¹⁹.

Qëllimi parësor i FMN-së është të sigurojë stabilitetin e sistemit monetar ndërkombëtar - sistemin e kursit të këmbimit dhe pagesat ndërkombëtare që u mundëson vendeve (dhe qytetarëve të tyre) të bëjnë njëra-tjetrën. Mandati i Fondit u përditësua në vitin 2012 për të përfshirë të gjitha çështjet e sektorit makro-ekonomik dhe financiar që mbajnë stabilitetin global¹²⁰.

¹¹⁸ (Selman Selmanaj: *Globalizimi dhe tranzicioni - dilemat dhe sfidat, Prishtinë 2006, fq.35*).

¹¹⁹ <http://shtetiweb.org/2012/09/28/fondi-monetar-nderkombetar/>

¹²⁰ <http://www.imf.org/en/About>

Vendet e rajonit sikurse edhe Kosova kanë një ekonomi të re dhe dinamike, prandaj është e mirëseardhur që këto vende të jenë të antarësuar në FMN. Mbikqyrja e FMN-së ofron vlerësim të specializuar të zhvillimeve ekonomike dhe financiare rajonale që ka një rëndësi të madhe për ekonominë e këtyre vendeve. Sipas Joseph E. Stiglitz qëllimi primar i FMN-së është që të pengojë paraqitjen e një depresioni global ekonomik. Detyra themelore e FMN-së që nga themelimi i saj ishte që përmes dhënies së huave të sigurojë likuiditetin në ato vende që kishin rënie ekonomike dhe nuk kishin aftësi ekonomike dhe mjete të mjaftueshme për stimulimin e kërkesës agregate. Në rast krize, FMN-ja angazhohet për aplikimin e një politike restriktive monetare dhe fiskale. Kjo arrihet, veçanërisht përmes rritjes së normave të interesit (kamatës), ndonjëherë deri në 20%, ndonjëherë mbi 50% dhe ndonjëherë deri në 100%, të këtyre normave¹²¹.

Ndërsa autori Selman Selmanaj thekson se FMN-ja është një institucion publik, i cili financohet në bazë të parave të taksapaguesve nga mbarë bota. Kjo ka një rëndësi të veçantë, sepse për hapat që i ndërmerr ky institucion në fushëveprimin e tij nuk i informon as qytetarët të cilët e financojnë dhe as ata qytetarë, jeta e të cilëve varet nga hapat dhe vendimet e këtij institucioni. Në vend të kësaj, FMN-ja kryesisht i informon ministrinë e financave dhe bankat qendrore të shtetit. Prandaj, gjatë gjithë kohës së ekzistimit të tij, Fondi ka ndryshuar diametralisht idetë dhe qëllimet burimore të funksionimit të tij, duke i dhënë përparësi absolute tregut. Këtu shihet edhe mungesa e transparencës së këtij institucioni. FMN-ja në shumicën e rasteve ka ndërmarrë hapa të gabuar për shkak të mungesës së transparencës si në aspektin e zhvillimit ekonomik, ashtu edhe në aspektin e tejkalimit të recesionit të ekonomive të veçanta, si dhe në tejkalimin e recesionit global¹²².

Së pari trajtuam rolin e Fondit Monetar Ndërkombëtar, për të vazhduar në atë çka neve na intereson më shumë, ndikimi që ka FMN-ja në zhvillimin ekonomik të Kosovës.

Duke pasur parasysh se Kosova si vend i ri dhe i vogël në pothuajse të gjitha aspektet duke përfshirë edhe ekonominë, objektivat e saj afatgjate synon t'i realizojë me ndihmën e institucioneve financiare ndërkombëtare, si FMN-ja dhe BB-ja, BERZH-i etj. Kosova u antarësua shpejt pas pavarësisë në FMN-në dhe BB, duke sjellë optimizëm për zhvillimin ekonomik të vendit. Nëse marrim parasysh krizën rajonale, evropiane e mbi të gjitha

¹²¹ Joseph E. Stiglitz: *Globalization and its Discontents*

¹²² Selman Selmanaj: *(Globalizimi dhe tranzicioni – dilemat dhe sfidat*

globale, nuk mund të themi se ka ndikuar pozitivisht në ekonominë e Kosovës anëtarësimi në këtë institucion financiar ndërkombëtar, edhe pse tani më janë bërë disa vjet nga anëtarësimi. Si anëtare e Fondit sikurse edhe shtetet e tjera edhe Kosova paguan kuotën e anëtarësisë që do të thotë se ka të drejtat dhe obligimet e saja si çdo vend tjetër anëtar, por gjithashtu në raport me kuotën ka edhe përqindjen e votimeve. Kosova ka 0.05% të votave në Fond dhe për këtë ajo paguan 0.03% të Fondit.

Nëse marrim parasysh mangësitë apo kritikën drejtuar FMN-së, për Kosovën gjatë tërë këtyre viteve që është anëtare e FMN-së si dhe duke marrë parasysh Kosovën si një shtet i ri, mund të themi se është e vështirë analiza e mirëfillët. Mirëpo, kreditë e Fondit mund të thuhet se kanë ndikuar në stabilitetin makro-ekonomik të Kosovës sa i përket kësaj periudhe nëse shikojmë edhe përvojat e shteteve tjera. Nuk mund të parashikojmë se çfarë mund të ndodhë pas disa viteve dhe sa do të ndihmojë FMN-ja në uljen e papunësisë dhe të varfërisë e poashtu edhe në rritjen ekonomike. Duke pasur parasysh që kreditë e marra nga FMN-ja kthehen me anë të kuotës që duhet të paguaj Kosova për të qenë pjesë e FMN-së, por gjithashtu duhet të zbatohen politikat e FMN-së në mënyrë rigoroze.

Përveç mendimeve pozitive për këtë institucion ndërkombëtar ka të tillë që kanë vërejtje dhe sygjerime shumë të ashpra lidhur me të. Kështu p.sh. një ndër ekonomistët më të mëdhenj të shek. të kaluar, profesori i njohur Xhim Sakston (Jim Saxton) konsideron se FMN-ja është institucioni më arrogant, më kontraproduktiv dhe më destabilizues që kanë mundur ndonjëherë t'i ndodhin botës së civilizuar.

Megjithkëtë një numër i madh i vendeve të tranzicionit, adresën kryesore kur është në pyetje zhvillimi ekonomik i vendit e kanë FMN-në. Disa nga këto vende shpeshherë kanë hasur në atë që ndihma e FMN-së më shumë është e natyrës politike se ekonomike, me ç'rast ka ardhur deri te zhgënjimi i madh sa i përket besimit në këtë institucion financiar. Nga të dhënat që mund të marrim nga FMN-ja mund të shihet shumë qartë se të ardhurat në Ballkanin Perëndimor janë ngadalësuar ndjeshëm nëse i krahasojmë me vendet e BE-së.

Këto vende si: Kosova, Shqipëria, Maqedonia, Bosnja dhe Hercegovina, Mali i Zi dhe Serbia, rrjetin e transportit nuk e kanë të zhvilluar si duhet, gjithashtu edhe atë të energjisë dhe telekomunikacionit nëse krahasojmë me mesataren e Bashkimit Evropian (BE). Infrastruktura publike dhe zhvillimi i saj do jetë një ndihmesë e madhe për rajonin që të

arrijë standardet e jetesës së Evropës Perëndimore. Mirëpo, për tërë këtë shtrohet pyetja se për të arritur këtë qëllim nga do të vijnë paratë? Kjo do të thotë se është më se e nevojshme për realizimin e këtyre planeve të jetë rritja e financimit si nga burimet vendore gjithashtu edhe nga ato të huaja. Një ndër pengesat për rritjen ekonomike, por edhe për tërëheqjen e investimeve është përmirësimi i infrastrukturës publike, prandaj vendet e rajonit sikurse edhe Kosova duhet të punojnë në përmirësimin e kësaj infrastrukture. Fondi Monetar Ndërkombëtar luan rol të rendësishëm edhe në sigurimin e sundimt të ligjit, luftimin e terrorizmit, korrupsionit si dhe nxit qeverisjen e mirë në shtetet anëtare.

Qëllimi i Fondit ka të bëjë me sigurimin e qëndrueshmërisë në sistemin monetar ndërkombëtar, mbështetjen e bashkëpunimit monetar global si dhe ndikimi në rritjen ekonomike.

Shqipëria është anëtare e FMN qysh prej 15 tetor 1991. Marrëveshja e parë nëpërmjet së cilës Shqipëria ka përfituar një kredi nga Fondi, ka qënë ajo 12-mujore, e nënshkruar më datë 26 gusht 1992, në shumën 32 milionë dollarë. Në korrik 1993, Bordi Ekzekutiv i FMN miratoi një kredi 3-vjeçare, në shumën prej 66 milionë dollarë, me qëllim mbështetjen e programit ekonomik dhe financiar të viteve 1993-1996. Ndërkaq, në vitin 1997, si pasojë e trazirave të ndodhura, FMN miratoi kredinë EPCA, për mbështetje emergjente në shumën e 13.5 milionë dollarë. Për të vazhduar me ndihmën e tij, FMN i ka akorduar Shqipërisë në vitet 1998-2001, edhe një kredi në shumën 69 milionë dollarë, si dhe një kredi të re më 27 janar 2006, e cila ka qënë edhe kredia e fundit 3-vjeçare, me shumën prej 26 milionë dollarë. Pas kësaj, marrëdhëniet e Shqipërisë me FMN janë përqëndruar kryesisht në konsultime, të cilat janë edhe pjesë e punës monitoruese që kryen FMN¹²³.

¹²³ (<http://shtetiweb.org/2012/09/28/fondi-monetar-nderkombetar/>), 19.06.18

5.2 ROLI I BANKËS BOTËRORE NË ZHVILLIMIN EKONOMIK TË VENDEVE TË RAJONIT DHE KOSOVËS

Banka Botërore është një tjetër institucion i rëndësishëm që ndikon në zhvillimin ekonomik të vendeve të rajonit, por gjithashtu edhe të Kosovës. Banka Botërore luan një rol të rëndësishëm për vendet në zhvillim, sepse ndihmon përmirësimin e standardeve të jetesës dhe ndihmon në luftimin e varfërisë. Me kërkesë të qeverisë në vendin nga i cili kërkohet financojnë projekte, ofron kredi dhe këshillon në lidhje me ndihmat politike.

Banka Botërore (BB) grupon dy institucione ndërkombëtare (Bankën Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim (BIRD) dhe Shoqatën Ndërkombëtare të Zhvillimit (IDA). Këto institucione janë krijuar për të luftuar varfërinë duke dhënë ndihma, financime dhe këshilla për shtetet që janë në vështirësi. Grupi i Bankës Botërore është në vetvete i përbërë prej pesë institucioneve. Selia e saj është në Ëashington. Presidenti zgjidhet për 5 vjet prej Këshillit të Administratorëve të Bankës, me një mandat të rinovueshëm. Sipas një rregulle të pranuar në heshtje, drejtori i FMN caktohet prej qeverive evropiane. Ndërsa presidenti i BB caktohet prej qeverisë amerikane, meqenëse Shtetet e Bashkuara janë aksionari kryesor i BB. Ajo bën pjesë në institucionet e specializuara të sistemit të Organizatës së Kombeve të Bashkuara¹²⁴.

Ndihma e parë e Bankës Botërore ndaj Kosovës ka arritur vlerën prej 24.3 milionë euro, kjo ka ardhur duke e vlerësuar pozitivisht gjendjen makrofiskale të Kosovës, por kanë vazhduar edhe ndihmat e tjera gjatë tërë këtyre viteve që Kosova është anëtare e BB-së, ndaj vendit tonë. Nëse e krahasojmë me ekonominë e vendeve të rajonit, Kosova mbetet vendi më i varfër sa i përket këtij aspekti, me varfëri në nivel të lartë, papunësi të madhe. Një gjë e tillë po ndikon shumë që një pjesë e madhe e të rinjve dëshirojnë të largohen nga Kosova. Numri i të papunëve arrin në 45% për dallim nga vendet e rajonit që është më i vogël, gjithashtu sektor shumë i vogël i eksporteve, ndërsa varësi të madhe ndaj importeve. Nëse marrim parasysh bruto të hyrat kombëtare (BHV) për kokë banori ato llogariten në 3.520 \$, që na bënë të radhitemi në vendin e 93 në botë, prapa edhe vendeve të rajonit. Vendet në Ballkanin Perëndimor kanë parë një rritje të vendeve të punës, ndërsa rritja po rritet në të gjithë rajonin. Rritja rajonale ka arritur deri në 2.6 përqind në 2017, duke

¹²⁴<http://shtetiweb.org/2012/09/28/banka-boterore/> 20.06.2018

rezultuar në krijimin e 230,000 vendeve të punës deri në qershor të vitit 2017 - një rritje prej 3.8 përqind gjatë vitit të kaluar. Me gjithë papunësinë e lartë në gjashtë vendet e rajonit, normat e punësimit janë kthyer në nivele para vitit 2008 në Shqipëri, Kosovë, ish-Republikën Jugosllave (IRJ) të Maqedonisë, Malit të Zi dhe Serbisë. Më shumë se gjysma e vendeve të punës të krijuara në rajon ishin në sektorin privat¹²⁵.

Sikurse Kosova poashtu edhe Shqipëria përveç përfitimeve kanë edhe detyrime si ndaj Bankës Botërore, poashtu edhe ndaj Fondit Monetar Ndërkombëtar, kjo nënkupton edhe borxhet të cilat i ka trashëguar Kosova nga ish Federata Jugosllave. Serbia deri pas pavarësisë i ka paguar këto borxhe duke konsideruar Kosovën si pjesë të veten, ndërsa pas pavarësisë është mbajtur një raund i gjatë i bisedime sa i përket kësaj çështjeje si dhe shumë të tjera, mirëpo nuk është arritur një marrëveshje adekuate për ndarjen e borxheve, na mbetet të shpresojmë se do të arrihet deri te ndonjë marrëveshje. Tranzicioni është një proces i gjatë dhe mjaft i mundimshëm, andaj shpëtimi i vetëm në gjithë këtë proces janë investimet e huaja për rritjen dhe zhvillimin ekonomik të Kosovës.

Të gjitha shtetet, e në veçanti shtetet e tranzicionit kanë nevojë për investimet e huaja direkte. Mirëpo, këto shtete kanë pësuar rënie të prodhimit industrial dhe prodhimit shoqëror, rritje drastike të papunësisë dhe inflacionit dhe kjo si pasojë e ndikimit negativ të fazës së tranzicionit^{Fusnote A. Jashari fq.25}. Me gjithë anët negative si pasojë e procesit të tranzicionit, sidomos në vendet e ish Jugosllavisë nuk mund të themi se nuk ka pasur anë pozitive në disa nga këto vende për arsye se të ardhurat janë përmirësuar, mirëpo jo të gjitha vendet kanë shfrytëzuar mundësinë për të reduktuar deficitet fiskale. Serbia dhe Bosnja dhe Hercegovina regjistruan tepricat në vitin 2017, por në pjesën tjetër të rajonit vazhduan deficitet, të nxitura nga shuma e lartë e shpenzimeve korrente, shpesh në përfitime sociale të dobëta dhe subvencione. Shqipëria, Mali i Zi dhe Kosova tani po punojnë për të ringjallur investimet kapitale për shtimin e rritjes. Investimet e kujdesshme financiare, publike dhe të buxhetit do të ndihmojnë që të minimizohen rreziqet fiskale që lidhen me investimet, të cilat duhet të lehtësojnë presionet mbi qëndrueshmërinë afatmesme të borxhit. Dobësitë e jashtme intensifikohen në disa vende. Deficitet e llogarisë korrente u zgjeruan në disa vende, pavarësisht rritjes së eksporteve sepse përveç në Kosovë dhe IRJ të Maqedonisë, importet kanë tronditur eksportet. Një analizë e

¹²⁵(<http://www.worldbank.org/en/news/press-release/2017/11/16/wbrer12>)20.05.2018

qëndrueshmërisë së llogarisë rrjedhëse sugjeron që vendet e Ballkanit Perëndimor duhet të reduktojnë deficitet e jashtme në periudhën afatmesme¹²⁶.

Në vitin 1991 Shqipëria u bë anëtare e Bankës Botërore dhe Fondit Monetar Ndërkombëtar. Që nga antarësimi në këto institucione financiare Shqipëria ka pasur mbështetje nga Banka Botërore e cila është fokusuar më shumë në bujqësi, infrastrukturë, asistencë sociale e teknike, ndërsa në vitin 1997 nuk u miratua asnjë hua e re. Në vitin 1999 gjatë krizës së Kosovës, përfitoi fonde të cilat arritën vlerën prej 125 milionë brenda vitit. Përveç infrastrukturës për zhvillimin ekonomik të një vendi rëndësi të veçantë kanë institucionet dhe ligjet e atij vendi.

Ndihma ndaj Shqipërisë nga Banka Botërore është fokusuar edhe në sektorin privat si dhe në bizneset e vogla. Projekt mjaft i rëndësishëm është krijimi i 450.00 fermave të cilat arrinin madhësinë prej 1.1 hektarësh. Përmirësime janë bërë edhe në sektorin e energjetikës, infrastrukturën e rrugëve dhe të portit. Por e rëndësishme është edhe reformimi i administratës publike si dhe reforma ligjore dhe ajo gjyqësore. E rëndësishme për shtetin shqiptarë është anëtarësimi në Bashkimin Evropian, rrugë të cilën Shqipëria është duke e ndjekur që disa vite. Banka Botërore për vitin 2018 ka parashikuar një rritje ekonomike për Shqipërinë prej 3.6%, ndërsa sa i përket kuadrit ligjor të shpresojmë që do të ketë përmirësime më të mëdha për vitin 2018 në krahasim me vitet 2016-2017.

Ndërsa sa i përket Kosovës sipas Bankës Botërore, ka bërë reforma në biznes, mirëpo nëse nuk arrin t'i përmbahet atyre reformave mund të ndikojë negativisht sa i përket tërheqjes së investitorëve. Në vitin 2017 Kosova nënshkroi marrëveshjen financiare me Bankën Botërore në vlerë prej 34.3 milionë euro. Marrëveshja e parë ka të bëjë me Gatishmërinë për Eksportin dhe Projektin e Aftësisë Konkurruese në vlerë prej 14.3 milionë euro, duke vazhduar pastaj me marrëveshjen e dytë e cila ka të bëjë me Projektin për financimin shtesë për bujqësi dhe zhvillim rural, shuma e kredisë në këtë marrëveshje arrin 20.80 milionë euro. Pasi që Kosova është anëtare e FMN-së dhe BB-së besohet se ka arritur një siguri ekonomike si dhe kjo ndikoi në rritjen e imazhit edhe në tregjet financiare me ç'rast do të ndikojë pozitivisht në tërheqjen e investimeve të huaja direkte.

¹²⁶ <https://www.worldbank.org/en/region/eca/publication/western-balkans-regular-economic-report-20.06.2018>

Strategjia më e re e Bankës Botërore për Kosovën synon të ndihmojë vendin në lëvizjen drejt një rruge më të qëndrueshme, të orientuar nga eksporti. Në mënyrë që qytetarëve t'u ofrohet më shumë mundësi për një jetë më të mirë, duke u fokusuar në tre shtylla:

- a. përshpejtimin e rritjes së sektorit privat dhe krijimin e vendeve të punës;
- b. promovimi i energjisë së besueshme; dhe
- c. përmirësimin e ofrimit të shërbimeve publike¹²⁷.

Menaxherja e Bankës Botërore për Kosovën, Marco Mantovanelli ka potencuar se " *Banka Botërore, së bashku me partnerët e tjerë të zhvillimit, është e përkushtuar që ta ndihmojë Kosovën. Ndiham do jetë në mënyrë që të zgjidh mungesat e saj të energjisë përmes një strategjie gjithëpërfshirëse që përfshin rritjen e efikasitetit të energjisë, zhvillimin e burimeve të ripërtëritshme të energjisë, integrimin në tregjet rajonale të energjisë dhe mbështetjen për gjenerimin e ri të energjisë që është e besueshme dhe e përbalueshme për qytetarët.*

Gjithashtu edhe **Drejtori i Bankës Botërore për Ballkanin Perëndimor, Ellen Goldstein thotë se:** "*Banka Botërore mbetet e përkushtuar për të ndihmuar Kosovën që të arrijë qëllimin e saj afatgjatë për pranimin në Bashkimin Evropian dhe ndërtimin e një vendi të begatë". "Me këtë strategji të re, Banka Botërore po mbështet reformat që do të përshpejtojnë rritjen dhe të nxisin punësimin - veçanërisht për të rinjtë dhe gratë"*¹²⁸.

Strategjia e tanishme e rritjes dhe reduktimit të varfërisë në Kosovë duhet të adresojë problemet e infrastrukturës, veçanërisht në energji. Krijimi i një ambienti më të favorshëm për zhvillimin e sektorit privat; pajisjen e popullsisë së saj të re me aftësitë e kërkuara nga punëdhënësit; të sigurojë mbrojtje financiare për qytetarët për të arritur rezultate më të mira shëndetësore, si dhe të ndërtojë qeverisjen dhe sundimin e ligjit për të përfituar plotësisht përfitimet nga integrimi në BE, të shpëtojë fitimet e produktivitetit dhe të krijojë vende pune cilësore që nxisin përfshirjen. Boshllëqet gjinore në qasjen në mundësitë ekonomike mbeten një nga sfidat kryesore për Kosovën. Veprime të mëtejshme nevojiten gjithashtu

¹²⁷ <http://www.worldbank.org/en/news/press-release/2017/05/23/kosovo-cpf-2017-20-10.12.2017>

¹²⁸ <http://www.worldbank.org/en/news/press-release/2017/05/23/kosovo-cpf-2017-20>

për të nxitur qëndrueshmërinë e mjedisit, duke përfshirë përmbushjen e *acquis* të mjedisit në BE¹²⁹.

5.3 BERZH - EKONOMIA E VENDEVE NË RAJON DHE KOSOVA

Banka Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim (EBRD) u themelua në vitin 1991, me qëllim të financimit të projekteve strukturore në vendet ish-socialiste nga Evropa Qendrore dhe Lindore, duke i mbështetur ato në fazën e tranzicionit drejt ekonomisë së tregut. Banka është në pronësi të 60 shteteve dhe 2 institucioneve ndërqeveritare (Bashkësisë Evropiane dhe Bankës Investuese Evropiane), me kapital të shënuar prej një shume më të madhe se 20 miliardë euro. Banka Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim nuk e shfrytëzon direkt këtë bazë të fortë kapitale për financim të projekteve, por huazon nga tregjet ndërkomëtare të kapitalit, duke u bazuar vazhdimisht në principet e shëndosha bankare.¹³⁰

Përveç FMN-së dhe BB-së ndikim mjaft të rëndësishëm në zhvillimin ekonomik si të vendeve të BE-së, po ashtu edhe të vendit tonë ka edhe Banka Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim. Ky institucion financiar mbështet projekte të cilat kanë të bëjnë me rindërtimin dhe zhvillimin e vendeve të cilat janë anëtare të BERZH-it, sidomos është e fokusuar në mbështetjen e projekteve në vendet e Azisë Qendrore dhe në Evropë. BERZH u themelua si rezultat i marrëveshjes e cila është nënshkruar në Paris në vitin 1990, ndërsa aktivitetin e vet e ka filluar në janar të 1991.

Në bazë të Nenit 1 të marrëveshjes për themelim, qëllimi i Bankës është që të kontribuojë në zhvillim dhe rindërtim, të nxit tranzicionin në ekonomi të tregut dhe të promovojë sektorin privat në shtetet e Evropës Qendrore dhe Lindore. BERZH ka për synim të promovojë një ekonomi e cila është funksionale me ç'rast bizneset do të konkurrojnë me njëra tjetrën, si rezultat do të ketë rritje të punësimit. Banka financohet nga shtetet anëtare nga mbarë bota të cilat janë pjesë e bankës si dhe dy insitucione ndërqeveritare të cilat janë: Banka Evropiane për Investime dhe Banka Evropiane. Kosova në nëntor të vitit 2012 me

¹²⁹<http://www.worldbank.org/en/country/kosovo/overview> 10.05.2018

¹³⁰<http://www.sep.gov.mk/sq/content/?id=232#.Wy41ZaczblU> 23.06.2018

vendim të Bordit të Guvernatorëve është bërë anëtari i 66-të, pranuese e fondeve të BERZH-it. Synimi i anëtarësimit ka qenë ndihma që Kosova të marrë si për sektorin privat po ashtu edhe për atë publik, pritshmëritë sa i përket kësaj kanë qenë shumë më të mëdha se sa janë realizuar deri më sot.

Banka Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim deri tani ka nënshkruar disa projekte në Kosovë, shuma arrihet në miliona eurosh. Gjithashtu edhe bizneset e vogla dhe të mesme kanë përfituar shërbime këshilluese nga BERZH, për të krijuar vende të reja të punës si dhe për të zgjeruar bizneset. Duke marrë parasysh që bizneset në Kosovë janë kryesisht të vogla, BERZH financon projekte duke filluar nga shuma prej 1 milionë euro. Në këtë mënyrë BERZH mundohet që t'i ndihmojë bizneset, sidomos ato të vogla për zgjerimin e tyre. Nga e tërë kjo që u tha vijmë në përfundim se anëtarësimi në këto institucione financiare është mjaft i rëndësishëm për vendin tonë, dhe Kosova mund të përfitojë shumë. Mirëpo, sa do ketë anë pozitive nga anëtarësimi i Kosovës në FMN, BB gjithashtu edhe në BERZH mbetet të shihet në vitet e ardhshme, sepse deri më sot nuk kemi pasur ndonjë përfitim aq të madh. E gjithë kjo mund të jetë si pasojë e keqqeverisjes nga ana e institucioneve tona, sepse është mjaft i rëndësishëm raporti që këto institucione dhe që e bëjnë ndaj shtetit tonë. Kështu për investuesit e huaj rëndësi të madhe ka përveç raportit edhe mbrojtja juridike e investimeve që do të investohen. Nëse nuk do të ekzistojë mbrojtja juridike e investimeve, patjetër që do lind situata e mosbesimit e cila do i largojë investitorët për të mos investuar në vendin tonë, një situatë e tillë do të thotë se kur investitori i huaj, në rast se do ketë ndonjë mosmarrëveshje dhe situatë e cila kërkon ndërhyrjen e ligjit nuk e ka të përcaktuar mbrojtjen e tij dhe as të kapitalit të investuar. Për shkak të kësaj lind nevoja që të kemi një mbrojtje juridike për investimet dhe investitorët të cilët janë të interesuar që të investojnë në vendin tonë.

Banka Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim ka ofruar mbështetje për kompanitë shqiptare për financimet afatmesme dhe afatgjata. Shqipëria ka nënshkruar marrëveshjen për ndarjen e riskut në vlerë deri në 6 milionë euro me BERZH. Nga kjo marrëveshje kanë përfituar GSA Itd Albania e cila është e specializuar në sektorin e energjisë, si dhe Intesa Sanpaolo Bank Albania. Kjo Bankë është e para në vendet e Ballkanit Përendimor që BERZH ofron garanci të pjesshme në mbulimin e riskut.

Që nga fillimi i antarësimit në BERZH, Shqipëria ka përfituar gati 1 miliardë investime në rreth 70 projekte për sektorë të ndryshëm ekonomik. Qëndrueshmëria ekonomike, sfidat globale dhe rajonale janë një ndër prioritet me rëndësi për BERZH në kuadër të Planit të Implementimit Strategjike të Bankës për periudhën 2016-2018. Banka Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim mbështet projektet në shtetet e Evropës dhe ato të Azisë Qendrore. Në bazë të statistikave të BERZH-it, sektori në të cilin është investuar më së shumti përgjatë viteve të prezencës së BERZH-it në shtetet në rajon mbetet transporti me 1.2 miliardë euro. Investimet kryesisht dominohen nga infrastruktura rrugore, megjithëse edhe format tjera si hekurudhat, aeroportet zënë vend të rëndësishëm. Në sektorin e huadhënies bankare pjesa më e madhe e fondeve ka shkuar në mbështetjen e biznesit të vogël dhe të mesëm dhe financim të tregtisë. Investimet e energjisë janë orientuar në rritje të efikasitetit dhe në investime të energjisë së ripërtitshme¹³¹.

5.4 ORGANIZATA BOTËRORE E TREGTISË

Organizata Botërore e Tregtisë është një organizatë ndërkombëtare me qendër në Gjenevë të Zvicrës, e cila merret me nxitjen dhe vënien në zbatim të ligjeve dhe rregulloreve tregtare ndërkombëtare¹³². Kur dy e më shumë vende kanë mosmarrëveshje në mes veti OBT ka mandatin në zgjidhjen e plotë të atyre mosmarrëveshjeve. Përveç anëve pozitive të cilat ndikojnë në përmirësimin ekonomik të vendeve anëtare në këtë organizatë, OBT-ja ka edhe aspekte negative duke u nisur nga fakti se vendet e zhvilluara janë më superiore se vendet në zhvillim dhe kjo për shkak të ekonomive të tyre më të zhvilluara.

Në të vërtetë OBT-ja nuk ka fuqi të shtrëngojë ndonjë vend të bëjë veprime kundër interesave të veta kombëtare, forma e vetme e “ndëshkimit” është të lejojë vendin i cili ka vuajtur prej barrierave tregtare, ilegale, që të ndreq barrierat e veta (zakonisht në formë tarifash). Për shembull, kur ranë në një mendje se ekonomia amerikane po vuante prej refuzimit të BE-së për të lejuar importin e pakufizuar të barnave, Shtetet e Bashkuara u

¹³¹ [kosid.org/file/respository/BERZH dhe Kosova.pdf](https://www.kosid.org/file/respository/BERZH_dhe_Kosova.pdf)

¹³² <https://www.scribd.com/doc/75607323/Organizata-Boterore-e-Tregtise-tema>

lejuan të impononin tarifa mbi një numër të madh mallrash të BE-së. Në këto tarifa është përfshirë edhe djathi Roqueforte dhe kërpudhat italiane, këto tarifa ndëshkuese synonin të lejonin një vend të dëmtuar të rimëkëmbej nga humbjet e shkaktuara nga pala “fajtores”¹³³. Anëtarësimi i Kosovës në Organizatën Botërore të Tregtisë do të luaj rol shumë të rëndësishëm në zhvillimin ekonomik të vendit. Lidhur me anëtarësimin në OBT diskutimet kanë filluar qysh në vitin 2007, mirëpo edhe pas 12 viteve përgatitje për t’u anëtarësuar në këtë Organizatë, Kosova ende nuk është pjesë e saj. Rëndësia e anëtarësimit në këtë organizatë ka të bëjë me përfitimet që mund të ketë Kosova, duke pasur një qarkullim të mirë të mallrave dhe bashkëpunim doganor me shtetet tjera për tregtimin e produkteve të ndryshme. Ekspertë për çështje ekonomike theksojnë se Kosova me anëtarësimin në këtë organizatë do të ketë të hapur rrugën e zhvillimit më të mirë ekonomik.

Ndërsa sa i përket Shqipërisë, ajo është anëtare e OBT-së që prej vitit 2000 dhe aplikon regjimin e saj mbi procedurat e licencimit të importit, si rezultat i liberalizimit të tregut dhe procesit të vazhdueshëm të përafrimit të kuadrit rregullator doganor me standardet e sistemit të BE-së, importi dhe eksporti i mallrave, si rregull i përgjithshëm nuk varen nga ndonjë autorizim i veçantë¹³⁴.

Nga vendet e rajonit shtetet të cilat janë anëtare në organizatën botërore të tregtisë janë: Shqipëria, Greqia, Maqedonia, Mali i Zi dhe Bullgaria, ndërsa Bosna dhe Hercegovina dhe Serbia janë shtetet vëzhguese të cilat janë në pritje të antarësimit të plotë.

Shqipëria është anëtare e OBT-së që nga viti 2000 dhe ka aplikuar për një regjim liberal tregëtar. Shqipëria është duke punuar për integrimin në BE, dhe në këtë drejtim ka nënshkruar shumë marrëveshje:

- a. Marrëveshja e Stabilizim Asociimit (MSA) e cila parashikon krijimin e një zone për tregti të lirë ndërmejt BE dhe Shqipërisë e cila u ratifikua në vitin 2009.
- b. Marrëveshja e Tregtisë së Lirë së Evropës Qendrore (CEFTA), kjo marrëveshje përfshin tetë vende: Shqipëria, Kosova, Serbia, Maqedonia, Kroacia, Mali i Zi, Bosnje dhe Hercegovina dhe Moldavia. Qëllimi kryesor i CEFT-as është nxitja e

¹³³(Po aty, fq., 72)

¹³⁴aida.gov.al/faqe/marreveshjet_tregetare

investimeve, zgjerimi i tregtisë në shërbime dhe mallra, mbrojtja e duhur e pronësisë intelektuale.

- c. Marrëveshja me Shtetet e Shoqatës Evropiane të Tregtisë së Lirë (EFTA), në të cilën bëjnë pjesë këto shtete: Zvicra, Lihtenshtajni, Islanda dhe Norvegjia. Kjo marrëveshje ka për qëllim tregtinë e lirë të mallrave.
- d. Marrëveshja e Tregtisë së Lirë me Turqinë, sipas kësaj marrëveshje dy vendeve u krijohen mundësi për rritjen e shkëmbimeve tregtare.

5.5 KOMPANITË MULTINACIONALE (MNE) INVESTIMI I TYRE DHE MBROJTJA JURIDIKE

Për të kuptuar fenomenin e korporatave shumëkombëshe më parë duhen analizuar investimet e drejtëpërdrejta të huaja. IHD-të, përfaqësojnë një element të fluksit të organizatave ndërkombëtare dhe përfshijnë startin e shumë operacioneve të reja dhe shitjet e më shumë se 10% të kompanive ekzistuese.

Më 1974, as në SHBA, për shembull, nuk kishte një listë të firmave që investonin në ata vend. Asnjë nuk dinte se sa firma ishin në të vërtetë pronë e huaj si dhe kishte pasaktësi për të dhënat e investimeve të huaja. Duke ditur se sistemi informativ në SHBA është shumë i sofistikuar, mendohet se vendet e tjera mund të kenë shumë më pak informacione për IHD-të¹³⁵.

Sipas Organizatës për Kooperim dhe Zhvillim Ekonomik (OECD) dhe Fondit Monetar Ndërkombëtar (FMN), investimet e huaja direkte (IHD) janë rritur në mënyrë të jashtëzakonshme dhe janë bërë rrugë e rëndësishme për depërtimin e shitjeve në tregjet e huaja.

Firmat të cilat operojnë më shumë se një vend janë pjesë e Kompanive Shumkombëshe. Për Kompanitë Shumëkombëshe ka emërtime të ndryshme, këtë e kemi hasur në botime të ndryshme. Këto kompani emërtohen edhe si: korporata sipërmarrje, shoqëri. Qëllimi kryesor i tyre është kryerja e veprimtarive të ndryshme nëpërmjet filialave në shtetet të cilat kryejnë veprimtarinë e tyre. Luajnë rol të rëndësishëm në tregjet ndërkombëtare, të

¹³⁵ Prof.Dr. Ilia Kristo - Biznesi ndërkombëtar, Tiranë 2004, fq. 264

cilat ndikojnë dukshëm në ekonominë e vendeve pritëse. Megjithëse investojnë në vende të ndryshme sipas ekonomistëve, ndikimi i tyre dallon nga vendet e zhvilluara tek ato në zhvillim. Marrë në përgjithësi kompanitë shumëkombëshe ndikojnë mjaft mirë në zhvillimin ekonomik të vendeve duke marrë parasysh transferimin e teknologjisë nga ana e tyre në vendet të cilat investojnë, kualifikimi dhe trajnimin i punonjësve, pasi që këto kompani kanë një personel të organizuar i cili ofron ndihmën e vet në menaxhimin e veprimtarive të ndryshme.

Sipas Freeman, (1981) pasi kompanitë shumëkombëshe kryejnë investime të shumta, një ndër efektet pozitive të tyre është rritja e numrit të të punësuarve. Prandaj kjo është një nga arsyet e shumta pse qeveritë e vendeve pritëse janë përkrahës të këtyre kompanive. Vlen të përmendet gjithashtu se përveç efekteve pozitive nga studiues të shumtë këto kompani konsiderohet të kenë edhe efekte negative. Njëra ndër këto efekte është teknologjia e tyre mjaft e avancuar për dallim prej kompanive vendëse, prandaj ato mund të ndikojnë negativisht në konkurrencën ndërmjet firmave vendëse. Kompanitë vendëse mund të dalin edhe nga tregu, për arsye të pamundësisë së konkurrencës ndaj KMN dhe kjo do të sillte fuqizim të madh të këtyre kompanive, gjë e cila mund të ndikonte mjaft negativisht për firmat vendëse. Me gjithë diskutimet të cilat ekzistojnë për kompanitë shumëkombëshe një gjë është e sigurtë se ato janë rritur shumë në vitet e fundit me ç'rast kanë punësuar edhe një numër të madh punonjësish.

5.6 KOSOVA DHE POZICIONI I SAJ NË ARENËN NDËRKOMBËTARE

Antarësimi i Kosovës në organizatat ndërkombëtare si: FMN, BB, OKB, NATO, BE, OBT, është mjaft i rëndësishëm. Mendojmë se institucionet tona me aq sa kanë pasur mundësi kanë bërë përpjekje për t'u anëtarësuar në këto organizata. Mirëpo, kjo nuk do të thotë se nuk ka ende për të bërë dhe kanë arritur të japin maksimumin në këtë drejtim. Integrimi dhe antarësimi në shumë mekanizma ndërkombëtar i jep mundësi vendit tonë që të ec përpara në shumë aspekte, sidomos në zhvillimin ekonomik.

Kosova duhet të bëjë përpjekje të vazhdueshme në antarësimin edhe në BE dhe OBT, sepse anëtarësimi në këto organizata të rëndësishme do ja hap dyert edhe për proceset e tjera integruese dhe globale, si dhe të jetë e vetëdijshme edhe në plotësimin e kriterëve të cilat i ka parashtruar BE-ja dhe të bëjë hapa të duhur në këtë drejtim. Përveç karakterit politik Kosova duhet të punojë edhe nga aspekti ekonomik, kulturor, social etj., me ç'rast do të kemi një zbutje të papunësisë, një zhvillim ekonomik të qëndrueshëm, stimulimin e investitorëve për të investuar në vendin tonë, uljen e shkallës së varfërisë, promovimin e vlerave kulturore etj. Kosova duhet të ketë gjithashtu edhe një agjensi doganore, mirëpo mosfunksionimi si duhet i doganave në disa pjesë të territorit të Kosovës vështirëson anëtarësimin në këto organizata. Prandaj gjykojmë se pa plotësimin e kushteve të parapara nga këto organizata anëtarësimi i vendit tonë do të jetë mjaft i vështirë.

5.7 ROLI I PROCESEVE GLOBALE NË ZHVILLIMIN E KOSOVËS

Thënia e ish-presidentit Kennedy *se mos pyet se çfarë bëri shteti për mua, por çfarë bëra unë për shtetin*, mund të themi se ka kontinuitet. Që Kosova të ketë zhvillim të gjithmbarshëm duhet të risocializohet me këto procese globale, të ketë një koordinim me partnerët ndërkombëtar, e tërë kjo mund të arrihet me projekte konkrete, me punë në ekip, me ide konstruktive, shoqëri civile koherente, sundim të ligjit dhe të demokracisë dhe sidomos mediat të jenë të lira dhe të pavarura. Roli i këtyre proceseve është i rëndësishëm në zhvillimin ekonomik të Kosovës si dhe ka dimensione të ndryshme, ndërsa ne do të fokusohemi më shumë në ato të cilat do ndihmojnë Kosovën të ketë një pasqyrë sa më të mirë ndërkombetare si:

Shteti – Përkrahja ndërkombëtare për Kosovën si dhe njohja e e saj si shtet i pavarur dhe demokratik janë prioritet mbi prioritetet për shtetin e Kosovës, kjo do të thotë se duhet të dëshmohet praktika e sui generis-it. Që nga shpallja e Kosovës shtet kemi pasur përkrahje të madhe nga shumë shtete, sidomos nga Shtetet e Bashkuara të Amerikës, mirëpo nevoja për njohje edhe nga shtetet tjera është ende e madhe dhe duhet punuar më shumë në promovimin e shtetit në këtë drejtim.

Kultura – Element mjaft i fuqishëm për promovimin e një shteti është kultura, sepse nëpërmjet të saj paraqiten të gjitha normat dhe vlerat të cilat janë të krijuara nga mendja e njeriut apo nga dora e tij. Kultura është gjithashtu element i fuqishëm që identifikon një popull, një komb, shoqëri, por edhe vet individin. Kjo na bën të kuptojmë se promovimi i kulturës është shumë i rëndësishëm pasi që paraqet një ikonë të madhe për qytetarët e Kosovës.

Zhvillim ekonomik – Zhvillimi i qëndrueshëm ekonomik i Kosovës është i ndërlidhur me proceset globale. Kriter kryesor në botën e kapitalizmit dhe të modernitetit është qëndrueshmëria ekonomike, duke pasur parasysh se motori i një shteti është ekonomia. Kosova që të promovojë më shumë veten përveç dimensioneve që kemi cekur ka edhe dimensione të tjera të cilat do ndihmonin më shumë për një integrim ekonomik global. Ne cekëm në pika të shkurtëra dimensionet pozitive që mund të paraqet Kosova në lidhje me proceset globale duke marrë gjithashtu në konsiderat atë se globalizimi është proces që nuk mund ta shmanget dhe i cili me një dorë jep dhe me tjetrën merr.

5.8 VENDET E RAJONIT (SHQIPËRI, MALI I ZI, MAQEDONI DHE KOSOVA) PASOJAT DHE PËRPARËSITË NGA INSTITUCIONET FINANCIARE NDËRKOMBËTARE

Shqipëria – Fillimisht duhet të kuptojmë se sa janë efikase parimet e globalizimit për Shqipërinë. Sa i përket globalizimit ekzistojnë shumë diskutime rreth asaj se globalizimi a është një fenomen i vërtet i cili e ka përfshirë mbarë botën apo është një mit analitik. Globalizimi me gjithë efektet negative që mund të ketë, mund të themi se ka ndihmuar shumë sa i përket shpikjes së rrjeteve komunikuese të cilat kanë lehtësuar shumë komunikimin. Me globalizim nuk kuptojmë vetëm heqjen e kufijve dhe krijimin e një bote pa kufi, por gjithashtu rritet edhe qëndrueshmëria e shumë korporatave ndërkombëtare, të cilat kanë synime të caktuara. Orientimi i Shqipërisë drejt vendeve të përparuara pa bërë përpjekje për të kuptuar thelbin e zhvillimit mund të ndikojë negativisht në ekonominë

shqiptare që do të thotë se nuk mund ta fajsojmë globalizimin për gjithë të këqiat që mund t'i ndodhin vendit. Po që se nuk do shfrytëzoheshin si duhet burimet lokale dhe të bëhej menaxhimi i tyre ashtu siç duhej Shqipëria do të zhytej në borxhin e Fondit Monetar Ndërkombëtar, borxh i cili mund ta kthej vendin në skllavëri të skajshme.

Gjithashtu, globalizmi ka efekte negative edhe në fushën e kulturës vendase, ku mediat në përgjithësi janë vendimtare në eliminimin ose dobësimin e vlerave të kulturës vendase kundrejt asaj perëndimore. Në dy dekadat e fundit, është vënë re, rritja e divorcit e problemeve të ngjashme shoqërore. Gjithashtu, në shoqërinë e këtij vendi kanë filluar të dobësohen mardhëniet familjare e farefisnore, duke u shtuar ata në bazë të interesit¹³⁶.

Mali i Zi—Procesi i globalizimit është duke u ndjer edhe në shtetin e Malit të Zi në të gjitha sferat e jetës e sidomos në tregun e këtij shteti. Korporatat multinacionale dhe investimet e huaja po luajnë rol shumë të rëndësishëm në këtë shtet sa i përket zhvillimit ekonomik. Por, edhe tregtia me vendet fqinje ndikon në aspektin ekonomik si dhe prania e korporatave multinacionale. Malit të Zi i mungon vizioni për të ardhmen dhe kjo mund të jetë edhe arsyeja pse nuk ka zhvillim ekonomik të mirë edhe përkundër faktit që ka lidh marrëveshje bilaterale dhe multilaterale me shtetet e rajonit, gjithashtu edhe me shtetet anëtare të Bashkësisë Evropiane.

Në fund mund të themi se duke pasur parasysh resurset në nivel shtetëror të Malit të Zi si dhe interesimin e investitorëve të huaj për to, atëherë është e nevojshme dhe urgjente hartimi i politikave zhvillimore ekonomike në mënyrë që përmes kapitalit të huaj dhe vendas që do të investohej në Mal të Zi të krijohet mundësia e përfshirjes së Malit të Zi në proceset integruese evropiane dhe botërore¹³⁷.

Maqedonia – Maqedonia ende nuk ka arritur të anëtarësohet në BE dhe kjo si pasojë e mungesës së implementimit të reformave në sistemin e drejtësisë sipas rekomandimeve të marra nga Komisioni Evropian për fillimin e negociatave për anëtarësim në BE. Maqedonia në të ardhmen medoemos duhet të hapet ndaj vlerave demokratike dhe principeve që ofron Bashkimi Evropian, sepse vetëm ashtu do të ketë edhe më shumë liri për vete dhe aspiratat

¹³⁶<http://strategalb.org/globalizmi-vendet-ne-zhvillim-dhe-shqiperia/>

¹³⁷ http://www.ulqini-online.com/index.php?option=com_content&id=828:tregtia-nderkombetare-dhe-globalizmi&Itemid

e saj për anëtarësim në familjen evropiane do të jenë më shpresëdhënëse. Edhe përkundër krizës globale financiare, biznesmenët slloven po shqyrtojnë mundësinë për të investuar në Maqedoni. Shkëmbimi tregtar i Maqedonisë me Slloveninë vitin e kaluar arriti shifrat prej 306 milionë \$, prej të cilave 253 milionë \$ i takojnë importit të mallrave sllovene në vend, ndërsa 53.6 milionë \$ exportit. Qeveria e Shkupit dhe njerëzit që punojnë në këtë drejtim janë jashtëzakonisht fleksibël për sa i përket çështjes së investimeve të huaja. Me këtë është duke shkuar drejt globalizimit, këtë e tregon më së miri KOF se Maqedonia radhitet në pozitën e 74 të globalizimit, pra kjo një mesatare e këtij vendi¹³⁸

Kosova - Ekonomia në Kosovë vazhdon të gjenerojë rritje dhe stabilitet solid makroekonomik, sidomos në kushtet fiskale dhe financiare. Rreziqet më të mëdha vijnë nga normat në rritje nga sektori i jashtëm, ekonomia e Kosovës ka shënuar rritje pozitive në vitin 2012. Megjithatë, duke qenë një ekonomi e hapur, ajo nuk është kursyer nga efektet e krizës globale që vijnë nga disa nga vendet më të zhvilluara, dhe veçanërisht ato në Eurozonë, të cilat kanë ulur normën e rritjes në krahasim me vitet e kaluara.

Sektori bankar ka mbetur solid, me Depozitat e sektorit privat dhe kredive vazhdon të rritet në vitin 2009 dhe 2010. Nuk ka ende prova edhe pse, që janë bërë bankat më të kujdesshme në kredi zgjerimi, kryesisht për shkak të faktit se kreditë e këqia janë rritur me një ritëm të ngadalshëm. Ndikimet negative të krizës globale financiare janë kompensuar nga një politikë ekspansioniste fiskale e miratuar nga Qeveria, duke siguruar norma të mesme të rritjes¹³⁹.

¹³⁸<http://www.slideshare.net/guest873eb3/globalizimi-3238659>

¹³⁹<http://connection.ebscohost.com/c/articles/95718846/impact-globalization-kosovos-economy>

KAPITULLI VI

HEQJA E BARRIERAVE DHE FORCIMI I KUADRIT LIGJOR NDAJ QARKULLIMIT GLOBAL FINANCIAR

6.1 ROLI I INVESTIMEVE TË HUAJA NË ZHVILLIMIN EKONOMIK TË VENDEVE TË RAJONIT DHE KOSOVËS KRAHASUAR ME DISA NGA SHTETE ANËTARE TË BE-së

Duke u bazuar në të dhënat e gjetura gjatë hulumtimit mund të themi lirisht se investimet e huaja direkte kontribuojnë në rritjen e mirëqenies së vendeve, qoftë atyre të zhvilluara, apo atyre në zhvillim në disa mënyra: vendet të cilat kanë kapital të ulët, mund të kenë dobi nga investimet e huaja direkte duke bërë të mundur investimin e projekteve të ndryshme të cilat mund të kenë ndikim në rritjen ekonomike të këtyre vendeve si dhe zvogëlimin e kostove të transaksioneve ndërkombëtare. Në këtë rast u mundësohet shkëmbyrimi i të mirave materiale gjithashtu edhe i atyre jomateriale, si dhe bizneset e jashtme mund të krijojnë një frymë konkurruese për bizneset vendore duke e mundësuar zhvillimin e bizneseve lokale.

Efektet e rritjes së investimeve të huaja në vendet e zhvilluara sipas evidencave empirike nuk shihet se kanë ndikuar pozitivisht në shtresat sociale të pakualifikuara, sepse bizneset mëmë në vendet e origjinës (vendet e zhvilluara) merren me aspektet e projektimit, krijimit dhe marketingut të produkteve dhe shërbimeve, që kanë personelin më të arsimuar si dhe teknologji më të avancuar.

Disa shtete si p.sh. Japonia apo Suedia, duke trajnuar apo ritrajnuar punonjësit e tyre mundohen që të mos i nxjerrin nga tregu i punës.

Në vendet në zhvillim çështja e efekteve të rritjes së investimeve direkte të huaja është më komplekse. Mund të evidentohen raste në dukje të një impakti pozitiv, sikurse edhe raste të një impakti negativ i hapjes së tregjeve të vendeve në zhvillim ndaj investimeve të huaja.

Përsa i përket prodhimit vendas dhe eksportit vërehet një rritje. Gjithashtu bizneset shumëkombëshe ofrojnë paga më të larta për punonjësit lokalë se sa vet bizneset lokale, e cila i shtyn edhe bizneset lokale të kenë një tendencë të tillë në paga, edhe pse jo në nivelin e pagave në bizneset shumëkombëshe. Po kështu përsa i përket kushteve të punës, evidencat empirike tregojnë se investitorët e huaj kërkojnë të investojnë kryesisht në ato vende ku zbatohet legjislacioni, ku zbatohen rregullat, ku të drejtat e pronësisë janë të qarta, ku ka më pak korrupsion, ku forca punuese është më e kualifikuar, pra në ato vende ku qartësia apo sundimi i ligjit është evident. Dhe, qartësia, sikurse edhe sundimi i ligjit vihet re në ato vende që kanë një demokraci pak a shumë të konsoliduar. Vet fakti që pjesa më e madhe e investimeve direkte drejtohen në ato vende ku ka një qartësi më të lartë ligjore dhe forcë punëtore më të kualifikuar, tregon se synimi primar i investitorëve të huaj nuk është shfrytëzimi i drejtpërdrejtë i kapitalit njerëzor.

Po të marrim si shembull rastin e Shqipërisë, edhe pse investimet e huaja kanë pësuar një rritje konstante në vite, çështja e paqartësisë së pronësisë është pengesë e madhe që i frenon investitorët për të derdhur investimet e tyre në këtë vend. Pra, edhe në këtë aspekt nuk shihet një lidhje e drejtpërdrejtë mes rritjes së aktivitetit të bizneseve shumëkombëshe dhe përkeqësimit të kushteve të punës së punonjësve. Ajo që vihet re është se në ato vende ku ka një arsimim më të lartë, ku ka punonjës më të kualifikuar dhe ku ka rregulla të qarta, pra mundësi kontraktimi të qartë dhe të garantuar, janë derdhur më shumë investime dhe bizneset shumëkombëshe kanë pasur impakt pozitiv në zhvillimin e atyre vendeve, p.sh. në vendet e ashtuquajtur “tigrat aziatikë”. Sigurisht nuk mungojnë edhe rastet të cilat shfrytëzohen për qëllime oportuniste dhe spekuluese nga bizneset shumëkombëshe (së bashku me bizneset lokale), të cilat synojnë fitimin afatshkurtër duke mos marrë parasysh respektimin e dinjitetit të njeriut dhe të ambientit ku shoqëria lokale ka ndërtuar jetesën e vet, pikërisht në ato vende ku lulëzon korrupsioni, mungesa dhe forca e ligjit për të vepruar. Si rrjedhim impakti i investitorëve të huaj mbi vendet në zhvillim nuk zhvillohet në mënyrë automatike, pa pjesëmarrjen e aktorëve të tjerë vendimmarrës politikë në vendet në zhvillim. Në këtë aspekt, së pari qeveritë e vendeve në zhvillim së bashku me investitorët e huaj duhet të luajnë rol vendimtar në krijimin e kushteve të arsimimit dhe edukimit për t’u liruar nga nevoja e njohurive dhe zhvillimit të teknologjive dhe për të zhvilluar kapitalin njerëzor. Së dyti qeveritë (apo të ashtuquajturit policy makers) e vendeve në zhvillim duhet

të kujdesen që të krijohen kushte për mbrojtjen e konkurrencës dhe tregut si dhe eliminimin e mundësive për monopol apo koncentrim nga ana e bizneseve që operojnë në ato vende. Së treti, hapjen e tregut, policy makers duhet ta ekuilibrojnë me një zhvillim të amortizatorëve socialë në mënyrë që të mbrohen dhe të rikualifikohen kategoritë e punonjësve që mund të gjenden në vështirësi nga ndryshimet në globalizimin ekonomik. Investimet e huaja direkte janë me interes të përgjithshëm për shumë shtete, qofshin anëtare të BE-së apo jo, si p.sh. SHBA-të. Për të tërhequr investime, shumica e shteteve kanë nënshkruar më parë Traktatet Dypalëshe të Investimit (Bilateral Investment Treaties - BIT). Investitorët duhet të jenë të vetëdijshëm se kompanitë e themeluara në BE, por që janë në shtetësi ose kontrollohen nga shtetas të vendeve të treta, për arsye të politikës publike, sigurisë publike ose shëndetit publik mund të kenë trajtim ndryshe nga kompanitë vendore. Në të vërtetë të gjitha liritë themelore të tregut të brendshme (dmth. lëvizja e lirë e mallrave, punëtorëve dhe kapitalit) i nënshtrohen përjashtimit të politikës publike në Traktat, me anë të të cilave shtetet anëtare rezervuan të drejtën për të pezulluar ato liritë për të marrë masa rregullatore për të mbrojtur interesat kombëtare në rrethana të jashtëzakonshme, madje në dëm të diskriminimit ndaj shtetasve të shteteve të tjera të BE-së¹⁴⁰. Jo vetëm zbatimi i direktivave të BE-së që koordinojnë kuadrin ligjor për trajtimin e veçantë të investimeve të huaja, por edhe masat rregullatore kombëtare të marra nga shtetet anëtare, në mungesë të harmonizimit, bien ndesh me trajtimin kombëtar të investimeve¹⁴¹.

Duke u përballur me dilemën e zgjedhjes midis respektimit të detyrimeve të tij ose vendit tjetër sipas ligjit ndërkombëtar ose ruajtjes së integritetit, të rendit juridik e traktateve të BE-së, një gjykatës i një shteti anëtar të BE-së është në parim i detyruar të vendos në favor të këtij të fundit¹⁴².

Marrëveshja tregtare në mes të BE-së dhe vendeve të treta, siç është Marrëveshja e Asociimit me Kilin, Marrëveshja e Tregtisë së Lirë (MTL) me Kaliforninë dhe Korenë e Jugut mbulojnë çështjen e investimeve të huaja direkte.

¹⁴⁰ *Komisioni European, Komunikimi për aspekte të caktuara ligjore, lidhur me intereset brenda BE-së (97/C 220/06), 1997 220/15, <http://eur-lex.europa>*

¹⁴¹ *Anne van Aaken, "Ligji Ndërkombëtar i investimeve midis angazhimit dhe fleksibilitetit: Një kontratw Analiza teorike", Gazeta e shqiptarëve ekonomike ndërkombëtare 507-2009, 523-7*

¹⁴² *Konventa ICSID nënë 53 dhe 54 të cilat detyrojnë çdo shtet kontraktues që të njohë dhe zbatojë çmimet e ICSID*

Këto marrëveshje të BE-së, të cilat me ratifikimin e tyre teknikisht bëhen pjesë e së drejtës së BE-së, kryesisht kanë të bëjnë me liberalizimin e investimeve në shërbime dhe sektorë industrial të cilët adresojnë të drejtat e themelimit të investitorëve, duke përfshirë kufizimet e mundshme që mund të imponojnë palët në MTL. Një shembull për këtë, që pasqyron problemet e papajtueshmërisë me ligjin “vendor” të BE-së mund të gjendet në dispozitat për transferimin e kapitalit në Marrëveshjen e Asociimit me Kilin. Ato lejojnë palët kontraktuese në rast të bilancit të pagesave serioze dhe vështirësive të jashtme financiare të miratojnë masa kufizuese lidhur me tregëtinë e mallrave dhe shërbimeve dhe lidhjen me pagesën dhe lëvizjen e kapitalit, përfshirë ato që lidhen me investime direkte.¹⁴³ Megjithatë BIT-të e nënshkruar nga shtetet anëtare me Kilin, lejojnë palët kontraktuese në rast të bilancit të pagesave serioze dhe vështirësive financiare të jashtme të miratojnë masa kufizuese në lidhje me tregëtinë e mallrave dhe shërbimeve dhe në lidhje me pagesën dhe lëvizjen e kapitalit përfshirë ato që lidhen me investimet direkte ¹⁴⁴.

Në rast se një investitor nuk i përfill kufizimet e lejuara MTL duke u thirrur në dispozitat e BIT, kjo do të zvogëlonte bilancin e përgjithshëm të arritur për këtë regjim tregëtar për të gjitha aktivitetet ekonomike të mbuluara nga MTL. Kjo do t'i mposhtë marrëveshjet e Bashkimit European për të krijuar një fushë të barabartë për investimet e jashtme nga të gjitha vendet anëtare të BE-së, në mënyrë që të mos shkaktohet çrregullim në tregun e BE-së si pasojë e mosmarrëveshjeve. Duhet të cekim se burimet më të rëndësishme të investimeve janë traktatet dypalëshe të investimeve. Prej vendeve të para që kanë hyrë në BIT janë: Gjermania, Zvicra, pastaj kanë vazhduar dhe vendet e tjera meqë rast deri në vitin 2008 kanë pasur rreth 2600 BIT në mbarë botën.

BIT përmbajnë disa karakteristika: përkufizimi i gjerë për investitorët, përkufizimi i gjerë për investimet, trajtimi i drejtë dhe i barabartë për investimet e huaja, garanci për mbrojtje dhe siguri të plotë, garanci kundër trajtimit arbitrar dhe diskriminues, trajtim kombëtar, garanci në rast të shpronësimit, garancit në lidhje me transferimin e lirë të pagesave, zgjedhjen e mosmarrëveshjeve ndërmjet shteteve kontraktuese, zgjedhjen e mosmarrëveshjeve midis shtetit pritës dhe investitorit, duke përfshirë arbitrimin¹⁴⁵.

¹⁴³*Marrëveshja e Asociimit BE- Kili, neni 195*

¹⁴⁴*Po aty, neni 195*

¹⁴⁵*Christoph Schreuer – Investments, International Protection, fq.6, Janar 2011*

Një ndër faktorët shumë të rëndësishëm në zhvillimin ekonomik të vendeve konsiderohen investimet e huaja direkte. Në vendet në zhvillim IHD-të luajnë rol shumë të rëndësishëm në integrimin ekonomik global. Por, gjithashtu edhe në vendet e zhvilluara janë një ndër faktorët e rëndësishëm në zhvillimin ekonomik të tyre. Shembull kemi marrë disa nga shtetet anëtare të BE-së sa i përket rolit të IHD-ve në këto shtete.

Gjermania konsiderohet një vend mjaft tërheqës sa i përket tërheqjes së investimeve të huaja. Ka një rrjet industrial shumë të fuqishëm, fuqinë punëtore mjaft mirë të kualifikuar me njohje shumë të mirë të gjuhës angleze, me një infrastrukturë të mirë, legjislacion të qëndrueshëm (i cili për investitorët është mjaft me rëndësi, sepse sigurohen që investimet e tyre do të jenë mirë të mbrojtura sipas ligjit). Mirëpo, përveç anëve tërheqëse Gjermania si dobësi kryesore ka normën e lartë tatimore. Gjermania ka një ekonomi mirë të zhvilluar sa i përket edhe vendeve të tjera të BE-së, kjo mund të jetë edhe meritë e investimeve të huaja në këtë shtet. Ajo gjithashtu ka nënshkruar marrëveshje dypalëshe me shumë vende (BITs), numri i të cilave arrin diku 155 vende.

Gjermania siguron trajtim kombëtar për investitorët e huaj me qëllim të inkurajimit të investimeve. Mirëpo, ka disa kufizime sa i përket armatimit dhe paisjeve kriptografike për arsye të politikës së jashtme si dhe rendit publik.

Suedia gjithashtu konsiderohet një vend tërheqës për të investuar. Suedia tashmë ka një ekonomi më të integruar ndërkombëtarisht në botë. Fluksi i IHD-ve në Suedi u ngadalësua në 2009, për shkak të recensionit global, pastaj u rikthye dhe ky trend vazhdon tani. Suedia është mjaft tërheqëse për investitorët e huaj për disa arsye: fuqisë punëtore mirë të kualifikuar me njohjen e shumë gjuhëve, me një ekonomi dhe teknologji të reja si dhe regjim të favorshëm tatimor¹⁴⁶.

Flukset e investimeve të huaja kanë përfshirë edhe shtetin e Italisë, në vitin 2016 arritën në 28.9 miliardë dollarë, duke e bërë Italinë si vendin më të preferuar për investimet e huaja përpara shumicës së vendeve me ekonomi të mëdha në botë duke përfshirë Francën, Meksikën, Spanjën, Japoninë. Italia ka nënshkruar marrëveshje bilaterale me 50 vende. Për tërheqjen e investitorëve shteti i Italisë ka fuqi punëtore të kualifikuar me njohuri teknike

¹⁴⁶(<https://www.globaltrade.net/international-trade-impact-exports/f/business/sweden/investing.html>).

dhe përvojë në prodhimin e cilësisë së lartë, një strukturë të mirë të eksportit dhe një sektorë të fortë të prodhimit¹⁴⁷.

Sipas Raportit Botëror të Investimeve 2017, botuar nga UNCTAD, Franca humbi disa pikë në renditjen e përfituesve më të medhënj të IHD-ve në botë, duke u zhvendosur nga vendi i 9-të në vendin e 14-të. Prurjet e IHD-ve kanë rënë nga afërsisht 47 miliardë dollarë në 28.3 miliardë dollar midis 2015 dhe 2016. Pikat e saj të forta për tërheqjen e investimeve janë: fuqia punëtore shumë e kualifikuar, baza e madhe industriale, burimet bujqësore dhe vendndodhja gjeografike në qendër të Evropës. Franca ka nënshkruar marrëveshje bilaterale me 91 vende¹⁴⁸.

6.2 ZGJERIMI I TREGJEVE NDËRKOMBËTARE

Procesi i globalizimit nuk barazohet me tregtinë në mes të shteteve, sepse ajo nuk është diçka e re, mirëpo ky proces po ndihmon më shumë, sidomos pas zhvillimit të komunikacionit si dhe përgjithësisht me zhvillimin e teknologjive dhe infrastrukturës iu është mundëuar popujve dhe njëzëzve të bëjnë tregti me njëri tjetrin. Se sa është e aftë tregtia e lirë të luftojë varfërinë janë ngritur debate të shumta sa i përket kësaj çështjeje. Shumë hulumtime që janë bërë sa i përket tregtisë së lirë si dhe ndikimit të saj në luftën kundër varfërisë vijmë në përfundim se tregtia e lirë mund të krijojë më shumë të ardhura. Po të marrim si shembull Shqipërinë (por në tërësi edhe vendet e bllokut socialist, një pjesë e të cilave është anëtare tashmë në BE) integrimet tregtare me BE-në, por edhe me tërë vendet e tjera rezultojnë të jenë pozitive në vlerë absolute.

Në të njëjtën kohë rezulton se nga heqja e kontrolleve ndaj qarkullimit global financiar kanë më tepër avantazh vendet në zhvillim se sa vendet e zhvilluara¹⁴⁹. Në vendet e tranzicionit ekzistojnë pengesa të cilat ndikojnë që investitorët e huaj të mos investojnë në këto shtete. Arsyeja e mosinvestimit ka të bëjë me një qëndrim të gabuar ndaj pronësisë si dhe ndaj ekonomisë së tregut dhe kategorive të tjera të cilat kanë rëndësi në zhvillimin

¹⁴⁷<https://en.portal.standardtrade.com/establish-overseas/italy/foreign-investment>

¹⁴⁸<https://enportal.standertrade.com/establish-overseas/france/foreign-investmen>

¹⁴⁹ Globalizimi ekonomik në Enciklikën “Dashuria në të vërtetën” Prof Emilian Karma, (http://www.kishakatolikeskoder.com/Arqipeshkvia/Cikel,Kumtesash_mbi_Dashuria_ne_te_verteten.htm), fq.14

e një shoqërie. Sipas gjykimit tonë mundësitë për të luftuar këto pengesa janë duke u zvogëluar, sepse hendeku i krijuar i të adhurave në mes të të pasurve dhe të varfërve po rritet çdo herë e më shumë, që do të thotë se po zvogëlohet mundësia për të luftuar varfërinë.

Vendet të cilat janë ende në zhvillim nuk kanë ende stabilitet sa i përket çmimeve të cilat luhaten pothuajse vazhdimisht dhe të cilat konkurrojnë në tregjet ndërkombëtare me pak produkte, vlera e të cilave është shumë e ulët. Një gjë të tillë e përjeton edhe BE-ja sa i përket produkteve të veta bujqësore, mirëpo edhe përkundër kësaj ajo nuk lejon hapjen e këtyre tregjeve me tregjet e vendeve në zhvillim. Kjo na bën të kuptojmë se kur është në interesin e tyre vendet e zhvilluara kërkojnë me domosdo hapjen e tregjeve ndërkombëtare, mirëpo nëse një gjë e tillë nuk është në interesin e tyre ato nuk i hapin fare tregjet e veta. Një gjë mund ta kuptojmë se efektet pozitive ndaj qarkullimit të lirë global financiar nuk shfaqen automatikisht, kjo do të thotë se nuk shkaktohet ndonjë dëm nga heqja e kontrolleve.

Globalizimi ka të bëjë me shkallën e zgjeruar të pushtetit i cili ushtrohet në mënyrë të organizuar, gjithashtu është shtrirje e gjerë hapësinore e rrjeteve dhe qarqeve të pushtetit¹⁵⁰ Pasoja të mëdha për kombet në procesin e globalizimit mund të ketë ushtrimi i pushtetit nëpërmjet veprimeve, vendimeve apo mosveprimeve nëpërmjet agjencive në një kontinent. Në fakt, shtrirje e marëdhënieve të pushtetit do të thotë ushtrimi i pushtetit po bëhet gjithnjë e më i madh. Në këtë drejtim, globalizimi përfshin strukturimin dhe ristrukturimin e marëdhënieve të pushtetit në një distancë. Modelet e shtresimit global ndërmjetësojnë qasjen në faqet e pushtetit, ndërsa pasojat e globalizimit janë me përvojë dhe ndahen në mënyrë të pabarabartë¹⁵¹

¹⁵⁰David Held and Anthony McGrew, David Goldblatt and Jonathan Perraton, Global Transformations: Politics, Economics and Culture, Polity, 1999, ch. 1

¹⁵¹Po aty., fq.1

6.3 NDËRKOMBËTARIZIMI I TREGTISË FINANCIARE

DHE ZGJERIMI I TREGJEVE NDËRKOMBËTARE

Ndërkombëtarizimi dhe globalizimi i tregtisë financiare paraqet njërën nga karakteristikat themelore të tregjeve financiare bashkëkohore, sepse globalizimi reflekton procesin e vazhdueshëm të integritimit të tregjeve financiare kombëtare në një treg global botëror. Ky trend duhet të sigurojë që:

- Oferta për kapital të jetë përafërsisht e barabartë me kërkesën, mos të ketë mungesë ose tepriçë të madhe,
- Kapitali ekzistues të alokohet me efikasitet, me më shumë saktësi.

Që nga fillimi, kur bota për herë të parë filloi të merret me tregti ndërkombëtare, kanë bashkëjetuar dy rryma, ajo që e favorizon ndërkombëtarizimin e tregtisë dhe ajo që e kundërshton atë. Sot shumica e ekonomistëve në botë, njësoj si Adam Smithi, vlerësojnë se tregtia e lirë ndërkombëtare në teori sjell më së shumti përfitime për të gjithë ata që marrin pjesë në të, sepse secili shtet apo secila kompani përqëndrohet në specializimin e prodhimit të një produkti që mund ta bëjë më së miri.

Me këtë pajtohemi plotësisht, por rrethanat reale në botën e sotme e bëjnë tregtinë ndërkombëtare një çështje shumë komplekse për ta favorizuar në praktikë. Pse? Një nga arsyt kryesore është kur kemi të bëjmë me tregtinë e lirë në botë, jo gjithmonë hasim në konkurrencë të drejtë, sepse ka edhe aspekte të tjera që nuk neglizhohen¹⁵². Gjatë viteve të fundit, debati publik për përfitimet dhe të metat e tregtisë së lirë arritën një pikë kulmore plotë me ethe, kur vendet e pasura të Veriut i shtuan përpjekjet e tyre për të krijuar një treg të vetëm global, nëpërmjet marrëveshjeve rajonale dhe ndërkombëtare të liberalizimit të tregtisë siç janë: NAFTA dhe GATT-i. Ithtarët e tregtisë së lirë janë të mendimit se eliminimi i pengesave tregtare në mes të popujve mundëson zhvillimin ekonomik dhe shton pasurinë në gjithë globin si dhe teknologjitë e reja do të shpërndahen më shpejt.

Në përmirësimin e kushteve ekonomike të shumë shteteve ka ndikuar tregtia e lirë në shtimin e prodhimtarisë dhe zhvillimin më të mirë ekonomik. Gjithashtu shoqërive u shtohen përfitime edhe nëpërmjet përhapjes së teknologjisë dhe konkurrencës.

¹⁵²Besjan Hajrullahu-Proteksionizmitregtarë(<http://www.qendra.info/opinione/648-proteksionizmi-tregtar.html>), fq.1.

Nëse marrim parasysh zhvillimin ekonomik të shteteve mund të shohim se hendeku midis vendeve të pasura dhe atyre të varfëra dita ditës po zgjerohet me shpejtësi.

Ndërkombëtarizimi i tregtisë ka ecur krah më krah me liberalizimin e transaksioneve financiare. Përbërësitë e tij kyç përfshijnë humbjen e kontrollit të përqindjeve të interesit, heqjen e kontrollit të kreditit dhe privatizimin e bankave që janë pronë e shtetit e të institucioneve financiare. Globalizimi i tregtisë financiare lejon lëvizjen e shtuar midis segmenteve të ndryshëm të industrisë financiare me kufizime të pakta dhe mundësi më të mëdha investimi. Kjo infrastrukturë e re financiare lindi në vitet 1980 me heqjen graduale të kontrollit të kapitalit dhe të tregjeve të sigurimeve në Evropë, Australi, Amerikën e Veriut dhe atë të Jugut, në Azinë Lindore, Zelandën e Re. Një dekadë më vonë, vendet e Azisë Juglindore, India dhe disa vende afrikane e pasuan këtë ecuri.

Miliona investitorë individual i përdorin rrjetet elektronike globale të investimeve jo vetëm për të bërë porositë e tyre, por edhe për të marrë informacion të vlefshëm për zhvillimet përkatëse ekonomike dhe politike. Në vitin 2000, e-business, dot.com firms, dhe pjesëmarrës të tjerë në ekonominë e re të mbështetur mbi informacionin elektronik kanë bërë një tregti prej 400 miliardë dollarësh me anë të Eëb-it vetëm në Shtetet e Bashkuara. Spekulatorë globalë, shpeshherë përfitojnë nga rregulloret e dobëta financiare dhe bankare për të nxjerrë shuma astronomike fitimesh në tregjet e reja të vendeve në zhvillim. Sidoqoftë, meqenëse këto rrjedha ndërkombëtare të kapitalit mund të rezervohen shumë shpejtë, ata janë në gjendje të krijojnë bume ciklesh artificiale, që rrezikojnë mirëqenien sociale të rajoneve të tëra. Kriza e Azisë Juglindore e viteve 1997-98-të, parqet një nga këto përmbysje ekonomike të kohëve të fundit e shkaktuar nga globalizimi i transaksioneve financiare¹⁵³. Liberalizimi i tepërt i tregjeve financiare dhe tregjeve kapitale me gjasë, ishte shkaktari kryesor i krizës edhe pse politikat e gabuara në vendet e prekura kanë luajtur një rol jo adekuat që ka përkeqësuar krizën financiare. Sot, FMN-ja pranon shumë, por jo të gjitha gabimet e veta, zyrtarët e FMN-së e kuptojnë se sa i rrezikshëm mund të jetë për shembull, liberalizimi tejet i vrullshëm i tregut të kapitalit por, ndryshimi i këndvështrimit të saj ndodh shumë vonë për të ndihmuar vendet e prekura nga kriza¹⁵⁴.

¹⁵³ Manfred B. Steger: *Globalizimi – Hyrje e Shkurtër, Co-PLAN, Tiranë, 2005 v.c. fq. 71.*

¹⁵⁴ Joseph E. Stiglitz: *Globalization and its Discontents W W Norton Company, v.c. fq. 36.*

Ndërsa eksportet globale dhe marrëdhëniet tregtare janë më të rëndësishme se kurrë më parë në ekonominë botërore, prodhimi transnacional është edhe më i rëndësishëm. Sot, 60,000 korporatat shumëkombëshe (MNCs), me pothuajse 820,000 filialeve të huaja, shesin mallra dhe shërbime me vlerë 15.680 miliard \$ në të gjithë globin çdo vit, dhe do të punësojë dy herë më shumë njerëz sot, krahasuar me vitin 1990 (UNCTAD, 2001). Korporatat multinacionale kanë marrë ekonomi të nivelit të ri. Ata përbëjnë rreth 25 përqind të prodhimit botëror dhe 70 për qind e tregtisë botërore, ndërkohë që shitjet e tyre janë ekuivalente me pothuajse gjysmën e GDP-së botërore (Held et al., 1999; UNCTAD, 2001). Një e katërta në një të tretën e tregtisë botërore është tregtia intrafirm mes degëve shumëkombëshe¹⁵⁵.

6.4 EFEKTET E IHD-ve NË VENDIN PRITËS

Qeveria mikëpritëse duhet të ketë marrëdhënie të ngushta me investitorët e huaj të drejtpërdrejtë. Nga njëra anë ato duhet të vlerësojnë kontributet e ndryshme, sidomos ato ekonomike që sjellin IHD-të. Nga ana tjetër frika e dominimit, vartësisë, ndërhyrjes janë të dukshme në mjaft vende¹⁵⁶. Ndikimet pozitive dhe negative të IHD-ve janë paraqitur më poshtë në tabelën nr.7.

Tabela 7 – Ndikimet pozitive dhe negative të IHD-ve

Pozitive	Negative
1. Formimi i kapitalit	1. Dominimi individual
2. Shprehite teknologjike	2. Vartesia teknologjike
3. Zhvillimi gjeografik dhe rajonal	3. Shqetësimet në plane ekonomik
4. Siper marrja dhe konkurrenca e brendshme	4. Ndryshimet kulturore
5. Sigurimi i pagesave	5. Shmangia e qeverisë vendese
6. Punësimi	6. Korporatat shumëkombëshe

Burimi: Ilia Kristo – Biznesi Ndërkombëtar, fq.269

¹⁵⁵ Anthony MCGrew and David Held – *Globalization Theory: Approaches and controversies*, Feb. 2007.

¹⁵⁶ Ilia Kristo – *Biznesi nderkombetar* fq. 268

6.4.1 NDIKIMET POZITIVE

Investimet e huaja direkte kanë pasur ndikim pozitiv në zhvillimin botëror në vitet e fundit. Ndikimi pozitiv i tyre është vërejtur në transformimin e teknologjisë, uljen e papunësisë, bilancin e pagesave, krijimin e vendeve të reja të punës. Gjithashtu edhe zhvillimi gjeografik regjional, sigurimin e pagesave dhe punësimi janë pjesë e ndikimeve pozitive të investimeve të huaja direkte.

Të gjitha efektet pozitive të përmendura për IHD-të të cilat ndikojnë në përmirësimin cilësor të standardit të jetesës mund të jenë edhe negative.

6.4.2 NDIKIMET NEGATIVE

Duke nxituar drejt IHD-së si një zgjidhje efikase dhe e shpejtë për ekonomitë e Evropës Qendrore, në të shumtën e rasteve është anashkaluar fakti se IHD potencialisht kanë efekte pozitive dhe negative në zhvillimet rajonale të ekonomisë, varur nga lloji i aktivitetit ekonomik dhe strategjia e ndjekur nga ndërmarrje shumëkombëshe të ndryshme, në varësi të kushteve të ndryshme vendase dhe rajonale¹⁵⁷.

Efektet negative të investimeve të huaja direkte në vendet pritëse janë tek vartësia teknologjike. Shumë vende mikëpritëse kanë shprehur shqetësime mbi mundësinë e ndërhyrjes ekonomike dhe politike. SHBA kanë përdorur korporatat me qendër në Amerikë, për ekspansion të kapitalit, kontrolleve të teknologjisë dhe konkurrencës¹⁵⁸.

Ndikim negativ të IHD-ve mund të ketë edhe tek ndryshimet kulturore, investuesit e huaj mund të ndikojnë në vendin pritës edhe nga aspekti kulturor, si dhe Kompanitë Shumëkombëshe ndikojnë jo vetëm në mënyrën se si drejtohet biznesi, por shkaktojnë ndryshime edhe në stilin e jetesës dhe sjelljes së klientëve në tregje. P.sh. futja e Fast Food-it në vende të ndryshme ndikon në ndryshimin e mënyrës së të ngrënit tek adoloshentët.

¹⁵⁷ Pavlínek, P., (2004), Regional Development Implications of Foreign Direct Investment in Central Europe, London: SAGE Publications, fq.63

¹⁵⁸ Ilia Kristos – v.c. fq., 272

6.5 MJEDISI POLITIKO –LIGJOR, RREGULLAT PËR NDËRKOMBËTARIZIM

Situata politike e një vendi luan rol të rëndësishëm në tërheqjen e investimeve të jashtme në atë vend. Funksionimi efikas i politikës së një shteti jep imazh të mirë tek investitorët për atë shtet.

Institucionet e vendit, sidomos strukturat administrative, që kanë të bëjnë me investimet duhet të krijojnë një politik rreth krijimit të lehtësirave duke bërë të qartë se investimet kanë prioritet të lartë në vendin tonë. E tërë kjo vlen si për Kosovën poashtu edhe për Shqipërinë me qëllim të tërheqjes sa më të madhe të investitorëve.

Për të qenë sa më atraktivë për IHD një gjë e tillë varet gjithashtu edhe nga legjislacioni i vendeve i cili duhet të sigurojë barazi për të gjitha investimet si dhe siguri, mos të jetë diskriminues por edhe të jetë transparent ndaj investimeve.

Legjislacioni i aprovuar lidhur me investimet është në favor të barazisë së investitorëve të vendit dhe të jashtëm në të gjitha aspektet e qasjes, si në privatizim, treg dhe informata.

Efikasiteti i gjykatave luan rol shumë të rëndësishëm dhe ngrit besimin e investitorëve të jashtëm.

Sipas Ligjit për Investimet e Huaja në Kosovë, ky ligj inkurajon investimet e huaja në vendin tonë dhe u ofron investitorëve të huaj të drejta dhe garanci themelore, u japin siguri investitorëve që investimet e tyre mbrohen dhe trajtohen në mënyrë të drejtë dhe në pajtim me standardet dhe praktikën e pranuar ndërkombëtare.

Pra, një investitor i huaj sipas Ligjit në fuqi që kryen aktivitetin e tij në Republikën e Kosovës do të veprojë në pajtim me të gjitha ligjet dhe standardet e aplikueshme në Republikën e Kosovës në baza të barabarta me investitorët vendas.

Shqipëria ka hartuar Ligjin për Investimet e Huaja që të ketë një ambient të përshtatshëm për investitorët. Qëllimi i këtij Ligji është që të krijojë kushte të favorshme sa i përket Investimeve të Huaja, hapje të çdo sektori ndaj investimeve të huaja, siguron investitorët e huaj se kapitali i tyre nuk konfiskohet apo nacionalizohet, përveç rasteve që janë me interes politik apo janë të specifikuar me ligj. Sipas Ligjit në fuqi investimet e huaja kanë trajtim të barabartë e të paanshëm dhe gëzojnë mbrojtje e siguri të plotë në të gjitha rastet që iu njihen edhe investimeve vendës.

6.6 PENGESAT LIGJORE TË IHD NË VENDIN TONË

Investimet e huaja konsiderohen të domosdoshme për një zhvillim të mirë ekonomik të vendit. Shqipëria dhe Kosova gjatë viteve të fundit kanë pasur rënie të investimeve të huaja si dhe një zbehje të interesimit të kompanive të huaja që kapitalin e tyre ta shtrijnë në vendin tonë. Sipas Bankës Qendrore në Republikën e Kosovës shuma e investimeve në dy vitet e fundit ka pësuar rënie për dallim nga vitet paraprake ku investimet e huaja ishin 320 milionë euro. Nga hulumtimet kemi vërejtur se shtetet e rajonit kanë qenë shumë më të mira në tërheqjen e investimeve të huaja. Përparësia e këtyre shteteve qëndron në përmirësimin e imazhit politik, si dhe lehtësirat në të bërit biznes.

Miratimi i Ligjit për investimet Strategjike në Kosovë konsiderojmë se do të rris interesimin e investitorëve që kapitalin e tyre që të investojnë në vendin tonë. Të gjitha pengesat ligjore duhet të eliminohen që investuesve të huaj t'u jepet siguri më e madhe juridike, pra të shtohet interesimi i tyre për të investuar. Për investitorët e huaj të cilët dëshirojnë të investojnë në Shqipëri dhe Kosovë është mjaft e rëndësishme qartësia dhe korrektësia e ligjeve dhe rregulloreve, funksionimi i mirë i sistemit gjyqësor, stabiliteti politik, mungesa e korrupsionit. Viteve të fundit qeveritë e të dyja vendeve kanë bërë përpjekje të vazhdueshme për të përmirësuar klimën e investimeve. Sistemi ligjor tregtar është faktor i rëndësishëm që u jep siguri firmave të investojnë në vendin tonë.

6.7 NDËRTHURJA JURIDIKO-EKONOMIKE PËR ZHVILLIMIN E IHD

Investimet e huaja direkte në shumicën e vendeve të BE-së rregullohen përmes një kuadri ligjor të veçantë. Shtetet bien dakord që investitorët e huaj do të trajtohen juridikisht dhe ekonomikisht të barabartë me qytetarët vendës. Rregullimi i marrëdhënieve në mes të dy vendeve të ndryshme në çështjen e mbrojtjes juridike, të investimeve të huaja direkte bëhet edhe nëpërmjet traktateve dypalëshe të investimeve. Këto traktate janë nënshkruar zakonisht në mes të vendeve me standarde të ndryshme ekonomike, ku njëri prej tyre zakonisht është vend në zhvillim. Shtetet bien dakord që investitorët e huaj të trajtohen sa

më mirë dhe të trajtohen në mënyrë të barabartë si shtetasit e vendeve pritëse ose aplikojnë trajtim më të mirë të mundshëm për investorët e huaj.

Çdo shtet hap dyert për investime të huaja direkte në të gjithë sektorët, me përjashtim në sektorë të caktuar, nëse jo tërësisht në disa sektorë që janë me rëndësi për shtetin. Sektorë të tillë janë prodhimi i armëve si dhe industria kimike. Vendet të cilat kanë nevojë urgjente për investimet e huaja direkte janë vendet në zhvillim dhe vendet në tranzicion, për dallim nga vendet e zhvilluara që për shkak të pozitës së tyre në tregun rajonal botëror, mund të kufizojnë hyrjen e investimeve të huaja direkte për sektor të caktuar. Mekanizmat e zgjidhjes së mosmarrveshjes në mes të investorëve dhe shtetit u japin të drejtë investorëve të huaj që të kërkojnë dëmshpërblim për dëmet që dalin nga shkeljet e marrëveshjeve nga ana e qeverive pritëse¹⁵⁹.

Është e vërtetë se, për disa konteste, zhvillimi i mekanizmave për të zbatuar në mënyrë efektive parimet e marrëveshjes mund të sjellë reforma ligjore dhe kosto financiare¹⁶⁰. Në këtë kontekst dispozitat e transparencës mes vendeve mund të jenë të rëndësishme, jo vetëm për gjenerimin e një klime më të parashikueshme të biznesit në favor të investorëve të huaj. Më e rëndësishme është nxitja e një praktike administrative më të ligjshme që është interes i përgjithshëm i popullsisë së vendit pritës¹⁶¹.

6.8 PËRMIRËSIMET E KUADRIT LIGJOR PËR ZHVILLIMIN E IHD-ve

Zhvillimi i IHD-ve është i rëndësishëm për secilin shtet andaj rregullimi i sjelljes së shtetit ndaj investimeve të huaja është shumë i rëndësishëm për investorët. Qindra traktate dypalëshe dhe shumëpalëshe përpiqen ta rregullojnë atë sjellje, qoftë ekskluzivisht ose në kombinim me çështje të tjera, zakonisht marrëdhënie tregtare. Megjithatë, numër i madh i traktateve të investimeve mundohen të kontribuojnë në zhvillimin e të drejtës

¹⁵⁹*Arbitration Under International Investment Agreements, 2010 – A guide to the key Issues – Katia Yannaca-Small, OXFORD, University press).*

¹⁶⁰*Po aty, fq., 21*

¹⁶¹*Po aty, fq., 22*

ndërkombëtare mbi të drejtat e investorëve të huaj në përgjithësi dhe detyrimet e shteteve ndaj tyre¹⁶²..

Investitorët e huaj shpeshherë marrin trajtim ligjor më të favorshëm në vendet në zhvillim se sa investorët vendor. Kjo mund të ndikojë negativisht sa i përket klimës së investimeve vendore. Megjithatë përmirësimi i kuadrit ligjor mund të ketë ndikim pozitiv në Investimet e Huaja Direkte. Vendet e zhvilluara në përgjithësi nuk kanë ligje specifike për inkurajimin dhe promovimin e investimeve të huaja edhe pse ligje të tilla ekzistojnë në vende të tilla si: Austria, Kanadaja dhe Zelanda e Re, në të kundërtën, ligjet specifike që rregullojnë investimet e huaja janë të shumta në vendet në zhvillim¹⁶³.

Zhvillimi ekonomik i një vendi ndërlidhet direkt me rritjen e investimeve të huaja. Tërheqja e këtyre investimeve bëhet përmes përmirësimit të vazhdueshëm të kuadrit ligjor që është një ndër objektivat kryesore dhe prioritet i qeverive. Trajtimi i paanshëm ndaj investorëve të huaj rregullohet me anë të kuadrit ligjor të shteteve pritëse me ç'rast zbatohet parimi i trajtimit kombëtar. Vendet në zhvillim i mirëpresin IHD-të, sepse luajnë rol të rëndësishëm në ekonominë e këtyre vendeve, pra në promovimin dhe zhvillimin e tyre. Kosova dhe vendet e rajonit duke marrë në konsideratë ndikimin pozitiv që mund të kenë IHD-të në zhvillimin ekonomik të vendeve janë duke punuar në politikat favorizuese për të nxitur IHD-të, ndër to më e rëndësishmja është përmirësimi i kuadrit ligjor.

¹⁶²<https://www.eolss.net/sample-chapters/RegulationofForeigninvestment, fq.2>

¹⁶³Po aty, fq.3

KAPITULLI VII

EFEKTET E IHD NË KOSOVË, SHQIPËRI, NË VENDET E BE-së, MBROJTJA JURIDIKE E TYRE

Hyrje

Në këtë kapitull kemi paraqitur më shumë efektet e IHD-ve në Kosovë, Shqipëri dhe vendet e BE-së, si dhe mbrojtjen juridike të tyre dhe ndikimin në zhvillimin ekonomik të këtyre vendeve. Qëveritë e vendeve duhet të ndërmarrin masi sa i përket nxitjes dhe inkurajimit të investitorëve të huaj që investimet e tyre t'i derdhin në vende të cilat punojnë në këtë drejtim. Legjislacioni është faktori kryesor që luan rolin kryesor sa i përket tërheqjes së investimeve duke marrë parasysh atë që secili investitor është i interesuar që investimet t'i bëjë në një vend të sigurtë dhe që mbrohen me ligj. Këtu duhet përmendur edhe shërbimet publike të cilat kanë rëndësi të madhe për investitorët e huaj, por gjithashtu edhe rregullimi i tregut dhe konkurrenca jolojale ndikojnë mjaft në efektshmërinë e IHD-ve në vendin tonë, por edhe në Shqipëri dhe vendet e BE-së.

7.1 NXITJA DHE INKURAJIMI I INVESTIMEVE TË HUAJA NË VENDIN TONË

Me qëllim të inkurajimit të investitorëve të huaj që të investojnë në vendin tonë, duhet të ndërmerren masa të cilat kanë për qëllim krijimin e një mjedisi miqësor për afarizëm dhe investime. Nxitja dhe rritja e investimeve të huaja direkte dhe krijimi i një mjedisi sa më të favorshëm biznesi ka për qëllim zhvillimin e qëndrueshëm ekonomik, stabilitet financiar dhe ligjor¹⁶⁴. Në këtë drejtim duhet të punohet më shumë nga qeveria e vendit duke u mundësuar investitorëve të huaj lehtësira në të bërit biznes dhe mbrojtje juridike në kapitalin e investuar. Pra, ne do bëjmë përpjekje që të shtrojmë disa nga çështjet më me rëndësi për ndërtimin e një rrethine të tillë në vijimësi të kësaj teme.

¹⁶⁴https://www.bankofalbania.org/rc/doc/Investimi_i_huaj_direkt_ne_vendet_ne_zhvillim_te_Evropes_Lindore_Rasti_i_Shqiperise_3127_1_6738.pdf

7.1.1 LEGJISLACIONI

Për inkurajimin e investimeve, zbatimi i ligjit është mjaft i domosdoshëm dhe luan rolin kryesor që të investohet në Kosovë. Moskompletimi i legjislacionit dhe mungesa e fuqisë për t'i zbatuar ligjet dhe parimet e shtetit ligjor ndikojnë mjaft negativisht dhe shkojnë në dëm të vendit për inkurajimin e investorëve. Prandaj duke marrë parasysh që shteti nuk funksionon pa një kuadër ligjor të mirëfilltë dhe pa ligje të aplikueshme, ne si shoqëri dhe institucione të vendit na mbetet të punojmë më shumë në këtë drejtim, sidomos në kompletimin e kuadrit ligjor dhe nxjerrjen e ligjeve që ende mungojnë.

Qëllimi i ligjit është të rregullojë mbrojtjen, promovimin dhe inkurajimin e investimeve të huaja në Republikën e Kosovës, t'u ofrojë investorëve të huaj të drejta dhe garanci themelore, që u japin siguri investorëve të huaj që investimet e tyre të mbrohen dhe të trajtohen në mënyrë të drejtë, në pajtim me standardet dhe praktikën e pranuar ndërkombëtare¹⁶⁵.

Në bazë të ligjit për investimet e huaja në Republikën e Kosovës, investorët e huaj dhe investimet e tyre trajtohen në mënyrë të barabartë me një investor vendor dhe investim vendor. Investorëve të huaj u duhet mbrojtje dhe siguri e plotë dhe e vazhdueshme në përputhje me legjislacionin në fuqi.

7.1.2 PRIVATIZIMI DHE REFORMA E SHËRBIMEVE PUBLIKE

Në ditët e sotme kur diskutojmë për reformën në sektorin publik na bëjnë të kuptojmë disa nga konceptet që ndërlidhen me këtë e që janë privatizimi, liberalizimi, derregullimi dhe decentralizimi. Reformimi i ndërmarrjeve publike ka rëndësi të madhe pasi që

¹⁶⁵ <https://gzk.rks-gov.net/ActDocumentDetail.aspx?ActID=8982>

infrastruktura publike, telekomunikimi si dhe disa nga shërbimet publike mund të jenë atraktive për investitorin.

Nuk është një koinçidencë e rastësishme që liberalizimi është në krye të synimeve brenda BE, duke u zhvilluar kështu si një kuadër institucional i tregtisë së lirë dhe konkurrencës së hapur. Edhe atje ku konkurrenca në operacionet publike nuk është e mundur, qeveria e stimulon me anën e tenderimit publik, koncensionëve dhe kontraktimit¹⁶⁶.

Nga ana tjetër, shteti (apo bashkia dhe më tej komuna) duhet të garantojë kuadrin bazë rregullator duke shmangur arbitraritetin e operacioneve të padrejta të organizatave që qëndrojnë në zonën gri ndërmjet sektorit publik dhe privat. Krahas dimensioneve të njohura teorike, ekspertët identifikojnë edhe dy tendeca në reformat e sektorit publik brenda vendeve të OECD:¹⁶⁷

- a) Reforma bazuar në privatizimin (objektivi bazë për një ekonomi tregu)
- b) Reforma bazuar në de/rregullimin

Por, të dy tipet synojnë të rregullojnë kuadrin ligjor dhe aktivitetet e sektorit publik me mjedisin e sotëm social që bëjnë të mundur bashkimin (kooperimin) e sektorit publik me atë privat¹⁶⁸.

7.1.3 RREGULLIMI I TREGUT DHE KONKURENCA LOJALE

Zhvillimi ekonomik i vendit tonë ndërlidhet me hartimin e një politike të mirë kombëtare, me objektivat zhvillimore të cilat janë: të mbrohet veprimtaria ekonomike e vendeve të cilat janë pjesëmarrëse në treg, por gjithashtu edhe largimi i të gjitha pengesave të mundshme për hyrje në treg, si dhe krijimi i një klime dhe mjedisi të përshtatshëm për investimet e huaja direkte.

Duke e rritur konkurrenshmërinë në ekonominë e vendit tonë, konkurrenca dhe politikat e saja do të gjenerojnë zhvillim, do të kenë ndikim në permiresimin e tregueseve makroekonomik si në nivelin e çmimeve, në nivelin e punësimit dhe rritjen ekonomike në

¹⁶⁶Public sector efficiency A.Afonso Perkthyer V.Tanzi Janar 2008 faqe 373

¹⁶⁷Po aty fq.374

¹⁶⁸Po aty, fq.375

përgjithësi¹⁶⁹. Pra, konkurrenca lojale ndikon në përmirësimin e ekonomisë së vendit duke mundësuar një rritje më të madhe ekonomike. Duke zhvilluar një politikë e cila krijon kushte dhe ambient besnik midis investitorëve të ndryshëm, sidomos për investitorët e rinj që hyjnë në treg.

Konkurrenca lojale në mënyrë të qartë sjell përfitime domethënëse për ekonominë e vendit dhe mundëson zgjerimin e sektorëve të biznesit aty ku ekziston ky lojalitet. Më tej, për të arritur qëllimet themelore të ekonomisë, të mbijetesës dhe rritjes, politikat qeveritare kërkojnë mënyrat për të tërhequr dhe mbajtur investitorët në afat sa më të gjatë.

Tregjet e globalizuara dhe rrjedha pa kufij e informacionit ka rezultuar në një konkurrencë intensive, ku presionet dhe pritjet e konsumatorëve janë çdoherë në rritje.

Në rast se kemi konkurrencë jolojale – mes bizneseve, pra është jo e ndershme, konkurrencë që përhap informata jo të sakta për kualitetin cilësinë e prodhimeve dhe shërbimeve të konkurrentit, gënjen konsumatorët me qëllim që të mposhtë konkurrencën¹⁷⁰.

Kjo lloj konkurrence e pengon hyrjen e investitorëve të rinj dhe mbijetesën e atyre ekzistues, dhe në këtë kontekst ngadalëson edhe zhvillimin e ekonomik të vendit. Prandaj duhet përkrahur lojalitetin në kuadër të konkurrencës, për të përfituar të gjithë, pasi në të kundërtën shumica do të pësojnë si rezultat i mungesës së besnikërisë.

7.1.4 NDËRTIMI I STABILITETIT MAKROEKONOMIK

Sektori financiar i Kosovës vazhdon të karakterizohet me qëndrueshmëri të lartë. Treguesit kyç të stabilitetit të sektorit financiar, si shkalla e likuiditetit dhe kapitalizimit, si dhe cilësia e portofolit kreditor mbeten në nivel të kënaqshëm, ndërsa niveli i zgjerimit të këtij sektori përmes aktivitetit kreditor ka shënuar ngadalësim të lehtë¹⁷¹. Përderisa rreziqet e drejtpërdrejta që i kanosen sektorit financiar në vend janë menaxhuar mirë dhe mbesin në nivel të ulët, zhvillimet negative në sektorin real dhe atë fiskal në nivel global kanë pasur implikime në ekonominë e Kosovës dhe rrjedhën e zhvillimit në sektorin financiar¹⁷²

¹⁶⁹<https://ak.rks-gov.net/?cid5>

¹⁷⁰ <http://detyrakursitmeporosi.blogspot.com/2014/02/mikro-ekonomi-konkurrenca-e-lire.html>

¹⁷¹ http://www.mei-ks.net/repository/docs/Material_Diskutues_Stabiliteti_Makrofinanciar.pdf

¹⁷² BQK – Raporti i stabilitetit financiar nr.3, fq.13

Kosova sfidohet me norma të larta të varfërisë dhe papunësisë (sidomos të rinisë, gjinisë femrore dhe pakicave). Modeli ekonomik i Kosovës është i bazuar në investime publike dhe ndihma të jashtme (remitencat dhe donatorët të cilat janë në rënie), model i cili është i paqëndrueshëm në afat të gjatë. Prandaj nevojitet revitalizimi i sektorit privat për t'u krijuar vende të reja pune dhe gjeneruar rritje të qëndrueshme¹⁷³.

7.2 MBROJTJA DHE SIGURIMI I TË DREJTAVE TË INVESTUESVE

Tërheqja e investitorëve çdo ditë e më shumë po bëhet një e mirë e domosdoshme për vendin tonë, prandaj insitucionet duhet të punojnë më shumë në këtë drejtim.

Investuesi duhet të bindet që investimi i tij është i sigurt, dhe trajtohet në mënyrë të drejtë, pa diskriminim, dhe në rast të mosmarrëveshjeve ato zgjidhen në mënyrë të drejtë. Investuesit pretendojnë që të trajtohen në mënyrë të barabartë me ndërmarrjet vendëse, një gjë të tillë e bëjnë vendet me shvillim të lartë ekonomik, pra i trajtojnë investuesit e huaj njëjloj me ndërmarrjet vendëse dhe kjo bën që të sigurojnë një mjedis më konkurrues.

Këto janë disa nga mbrojtjet dhe garancitë themelore që kërkojnë investuesit. Parimet kryesore të investuesit përfshijnë të drejtën për:

- a. Trajtim të barabartë dhe jodiskriminues të investuesve vendas dhe të huaj, veçanërisht në zbatimin e kontratave dhe pagimin e borxheve ndaj shtetit;
- b. Investim në të gjithë sektorët, nën të gjitha strukturat e biznesit dhe nën cilëndo formë që lejohet dhe rregullohet me ligj;
- c. Garanti kundrejt privatizimit, shpronësimit apo masave të tjera me efekt të ngjashëm, dhe kompensim të drejtë në rast se këto rrethana ndodhin për shkak të sigurisë kombëtare;
- d. Transferim të fitimeve jasht vendit në valutë të huaj pas pagimit të taksave dhe tarifave të vendosura me ligj;
- e. Pronësi mbi tokën;
- f. Mbrojtje të pronësisë intelektuale dhe industriale; dhe

¹⁷³ www.mei-ks.net/repository/docs/Material_Diskutues_Stabiliteti_Makrofinanciar.pdf

- g. Zgjidhje të mosmarrëveshjeve në Gjykata vendore që janë të drejta dhe të pavarura, ose të kërkojnë arbitrazh vendas ose ndërkombëtar¹⁷⁴.

Investitorët duhet të kenë siguri ligjore që të investojnë, pra duhet ndërmarrim masa se investimet e tyre do të trajtohen të barabarta me investimet vendëse si dhe do kenë mbrojtje ligjore.

Duhet të hartohen shumë marrëveshje ku garantohen mbrojtja dhe siguria për investimet dhe hartimin e ligjeve specifike të cilat rregullojnë masat e shpronësimit, që të këtë kompenzim të drejtë në rast se vie deri te shpronësimi.

Sigurimi i kushteve për investitorët për të blerë ose marrë me qira afategjatë tokë, është mjaft e rëndësishme dhe luan rol të madh në tërheqjen e investitorëve.

7.3 MOTIVET E INVESTITORËVE TË HUAJ PËR TË INVESTUAR NË VENDET E RAJONIT

Motivet që investitorët e huaj të investojnë në vendet e rajonit janë të shumta, ku veç motiveve ekonomike duhet përmendur edhe ato politike dhe juridike. Në lidhje me motivet e investitorëve të huaj që të investojnë në vendet e rajonit ekzistojnë mendime të ndryshme, mirëpo ajo çka vlen të veçohet më tepër janë përfitimet e larta që mund të kemi si rezultat i investimeve të huaja. Pozita e volitshme gjeografike si dhe zonat e lira tregtare është edhe një motiv tjetër që i nxit investitorët e huaj për të investuar.

Paralelisht me motivin kryesor është edhe siguria e investimeve, për të cilën investuesit janë shumë të interesuar që investimet e tyre të jenë të sigurta në vendet ku ata investojnë. Vlen të theksohet se motivet e investitorëve të huaj për të investuar në vendet e rajonit janë të shumta, por ne do të fokusohemi vetëm në disa prej tyre:

- a) fuqia e lirë punëtore;
- b) fitimi në një shkallë të lartë;
- c) shmangia nga pagesa e tatimeve të larta në vendet e tyre¹⁷⁵.

¹⁷⁴<http://www.osce.org/sq/eea/19771?download=true>

¹⁷⁵ Adnan Jashari- Aspekti juridik i investimeve të huaja në shtetet në tranzicion, Tetovë 2007, fq.157

Fuqia e lirë punëtore

Nëse kihet parasysh fakti se në regjionin e Europës Qendrore dhe Lindore jetojnë diku rreth 350 milion njerëz dhe në krahasim me shtet e tjera, fuqia punëtore jo vetëm që është shumë e lirë por edhe me strukturë kualifikuese më të mirë, atëherë nuk ka dyshim se ky motiv përse të mos jetë arsye për tërheqjen e investimeve të huaja direkte .

Fuqia e lirë punëtore në vendet e rajonit për shumë kompani të huaja nuk ka rëndësi të madhe, sepse mendojnë që nuk kanë aftësi kualifikuese, pra nuk janë në nivelin e kërkuar. Në këtë drejtim, i pamohueshme është prioriteti i Hungarisë dhe Sllovenisë ndaj shteteve të tjera të rajonit. Në Hungari përveç bazës solide teknologjike edhe fuqia punëtore paraqet një përparësi komparative të subjekteve lokal. Fakt që mundësoi rritjen e efikasitetit në prodhim të kompanisë multinacionale amerikane General Electric e cila ishte investitori i parë me rëndësi në firmën lokale Tungsram në vlerë prej 550 mil. \$¹⁷⁶.

Kjo ishte një ndër motivet kryesore që shumë kompani multinacionale investuan kapitalin e tyre në Hungari.

Përparësia e Sllovenisë ndaj vendeve të rajonit është se posedon fuqi kualitative punëtore me aftësi të lartë menaxheriale që shumë shtete të rajonit nuk e posedojnë.

Nga sa u tha më lartë sa i përket motivit të investitorëve të huaj për të investuar në vendet e rajonit e ndër to, pra, ishte fuqia punëtore, vlen të përmendet se në shtetet e rajonit krahasuar me vendet e zhvilluara të ardhurat personale të punëtorëve janë shumë më të vogla krahasuar me vendet e zhvilluara me ç'rast edhe kontributet që paguhen janë shumë më të vogla.

Fitimi në shkallë të lartë

Investitoret e huaj që të investojnë në vendet e rajonit janë të motivuar, në radhë të parë nga shkalla e lartë e fitimit. Investitorët kanë për qëllim që fitimin të cilin mund ta

¹⁷⁶ Po aty, fq.

realizojnë ta transferojnë në shtetin nga i cili është investuar kapitali. Investitorët e huaj janë më tepër të interesuar që të investojnë në sektorin e prodhues dhe kjo për arsye se duke investuar në këtë sektor mund të sigurojë pozitë monopolistike në tregjet lokale.

Realizimit të fitimit nga ana e investorëve të huaj, i paraprinë disa veprime paraprake, kështu para së gjithash sigurohet tregu, dhe vetëm pas realizimit të pozitës dominante në treg, lind vullneti për realizimin e fitimit afatgjatë ¹⁷⁷.

Pra, investorët me sa mund të shohim nuk janë të interesuar në fitimin “afatshkurtër”, por në realizimin e fitimit “afatgjatë”.

Shmangia nga tatimet e larta në vendet e tyre

Tatimet e larta në shtetet e tyre është edhe një nga motivet që investorët e huaj, investimet i realizojnë jasht shtetit. Shtetet e rajonit parashohin lehtësime në tatime për investimet e huaja. Lehtësimet tatimore parashihen për një periudhë më të shkurtër kohore e cila mund të jetë 2-5 vjetë. Përveç lehtësimeve tatimore disa shtete parashohin edhe lehtësime doganore gjatë eksportit apo importit të lëndës së parë. Kjo ndikon pozitivisht në tërheqjen e investimeve të huaja duke pasur parasysh se shmangia nga tatimet e larta që mund të kenë në vendet e tyre u mundëson një fitim më të lartë në vendet ku investojnë ku tatimet janë më të ulëta.

7.4 ANALIZA EMPIRIKE E IHD-ve NË KOSOVË DHE SHQIPËRI, KRAHASUAR ME VENDET E RAJONIT

Teoria na ndihmon të organizojmë mendimet tona rreth mënyrës se si reagojnë njerëzit ndaj ndryshimeve në mjedisin e tyre ekonomik. Por, zakonisht, ajo nuk tregon madhësinë e ndikimeve të tilla. Në të vërtetë në rastin e ofertës së punës, vetëm teoria nuk parashikon

¹⁷⁷ Po aty, fq.

drejtimin e ndryshimeve të dëshiruara. Bëhet e nevojshme puna empirike. Tre llojet e strategjisë empirike janë: intervistat personale, anketat me personat kompetent si dhe eksperimentet. Me secilën teknike lidhjet me teorinë janë shumë të rendësishme. Teoria në mënyrën se si është organizuar studimi, se cilat pyetje bëhen dhe se si interpretohen rezultatet¹⁷⁸.

Investimet e huaja direkte janë shumë të rendësishme në zhvillimin ekonomik të vendeve. Shumë autorë të ndryshëm në analizat e tyre empirike kanë nxjerrë në përfundim se IHD-të ndikojnë pozitivisht në rritjen ekonomike të vendeve pritëse. Kjo është një nga arsyet kryesore se përse qeveritë e këtyre vendeve përpiqen shumë në tërheqjen e investimeve. Shqipëria në vitet e fundit ka punuar shumë në këtë drejtim. Gjithashtu edhe Kosova po përpiqet të nxis ardhjen e investitorëve dhe kjo po bëhet duke u siguruar përparësi të mëdha. Prandaj është shumë e rendësishme analiza empirike me që rast mund të trajtojmë përparësitë, dobësitë, sigurinë politike, garantimin e investuesve, mbrojtjen ligjore të tyre si dhe mundësitë që ofrojnë vendet tona. Duhet theksuar që në këtë hulumtim kemi bërë përpjekje që të analizojmë sa më shumë përparësitë që ju ofrohen investitorëve të huaj.

Pozita gjeografike

Pozita gjeografike është përparësi që mund të shfrytëzohet nga ana e investitorëve të huaj. Në thithjen e IHD-ve mjaft ndikon përmirësimi i vazhdueshëm i infrastrukturës.

Niveli i ulët i pagave

Krahasuar me vendet e tjera të rajonit Shqipëria dhe Kosova kanë nivel të ulët të pagës minimale gjë që është edhe faktor nxitës për IHD-të, për arsye se kostoja e prodhimit është më e ulët me ç'rast edhe niveli i pagave është i ulët dhe fuqia punëtore në moshë më të re. Duke u bazuar në statistikat zyrtare Kosova ka popullatën në moshë më të re në rajon. Kjo do të thotë që fuqia punëtore është edhe një tjetër faktor nxitës në tërheqjen e investitorëve. Gjatë viteve të fundit është bërë progres në fusha të ndryshme që ka ndikuar në tërheqjen e investimeve, mirëpo në këtë drejtim ende ka shumë punë për të bërë. Ndër to pa dyshim

¹⁷⁸Harvey S. Rosen, *Public Finance*, Tirane 2016 fq., 27

është edhe zbatimi i ligjit, zvogëlimi i shkallës së korrupsionit, zbatimi i kontratave, rregullimi i lejeve të ndërtimit. Nga anketat e realizuara pengesë kryesore në tërheqjen e investitorëve është fuqia e ulët e blerësve dhe madhësia e vogël e tregut. Një ndër faktorët e rëndësishëm është funksionimi i sistemit ligjor tregtar që është vlerësuar nga firmat lidhur me sigurinë për të investuar në vendet tona.

Faktor tjetër është vlerësuar nga firmat e huaja edhe mungesa e korrupsionit. Një numër i madh i firmave e konsiderojnë faktor shumë të rëndësishëm për zhvillimin ekonomik të vendeve.

Origjina e investimeve të huaja direkte në Kosovë vie kryesisht nga vendet e Bashkimit Evropian. Investimet e huaja vijnë më tepër nga këto shtete: Gjermania, Zvicra, Austria, Britania e Madhe, Maqedonia, Slovenia. Investitorët e jashtëm më të mëdhenj deri tani janë: Raiffeisen, Viena Insurance Group, Telekom Slovenia BNP Paribaj, Nova Lubljanska Banka.

ANALIZA E PYETËSORËVE DHE HULUMTIMI SHKENCOR

Pasi kemi studiuar literaturën kemi ndërtuar modelin teorik, në të cilin kemi shtjelluar se investimet e huaja kanë efekt në zhvillimin ekonomik të vendeve. Gjithashtu në pjesën teorike kemi dhënë shpjegime se për tërheqjen e investimeve rëndësi të madhe ka mbrojtja dhe siguria e investitorëve dhe investimeve të tyre.

Për të kuptuar sa më mire si dhe për të parë efektet e IHD-ve në Kosovë dhe Shqipëri kemi ndërtuar tre lloje të pyetësorëve, mesatarisht me nga 15 pyetje: për individët, për firmat e huaja si dhe për institucionet. Këta pyetësorë janë shpërndarë dhe pasi kemi marrë opinionet e tyre kemi ndërtuar këto të dhëna. Pasi që kemi mbledhur pyetësorët kemi bërë bazën e analizës cilësore dhe sasiore.

ANALIZA E PYETËSORËVE PËR INDIVIDË NË KOSOVË

Kemi menduar të ndërtojmë këtë pyetësor për arsye se duhet të dijmë nëse këta individ në Republikën e Kosovës janë të prekur nga investimet dhe a janë të ndjeshëm, sepse janë pikërisht ata të cilët paguajnë taksa.

Pyetja 1: Cilat kritere duhet të plotësohen për të tërhequr investitor të huaj?

- a) Tërheqja e investitorëve të huaj referuar resorseve të Kosovës?
- b) Tërheqja e investitorëve të huaj referuar rritjes së të ardhurave reale për frymë në Republikën e Kosovës
- c) Rritja e treguesve në tregun e punës
- d) Rritja e nevojave për më shumë burime monetare
- e) Përmirësimi i standarteve dhe kushteve të punës në Republikën e Kosovës

Përgjigjja:

Tërheqja e investitoreve të huaj referuar resorseve të Kosovës si pyetje e hulumtimit tonë gjithsej ka pasur 20 respondente nga i gjithë territori i Republikës së Kosovës, grupmoshat nga 18-65 vjet dhe dominon gjina mashkullore 64%, ndërsa ajo femrore 40%, nga përgjigjet që kemi marrë nga secili prej tyre kemi arritur të përkufizojmë këtë pyetje në këtë mënyrë.

Një numër i madh i të anketuarve mendojnë se në bazë të ligjit të për Investime strategjike 05/L-079 të gjitha investimet e propozuara duhet të përmbushin kriteret e poshtëshënuara:

- a. Subjekti investues në momentin e aplikimit për marrjen e statusit të investimeve strategjike duhet të paraqes dëshmi për aftësinë e tij të mjaftueshme financiare për realizimin e investimeve;
- b. Investimet e propozuara duhen të jenë në pajtueshmëri me standardet mjedisore të përcaktuara me legjislacionin e Republikës së Kosovës dhe të Bashkimit Evropian;

- c. Investimet e propozuara nuk duhet të jenë në kundërshtim me Kushtetutën dhe me obligimet e Republikës së Kosovës të përcaktuara me konventat dhe marrëveshjet ndërkombëtare.

Ndërsa një pjesë e të anketuarve mendojnë se kriteret që duhet plotësuar për tërheqjen e investimeve të huaja, në radhë të parë janë: tërheqja e investitorëve të huaj referuar rritjes së të ardhurave reale për frymë në Republikën e Kosovës, pastaj edhe përmirësimi i standarteve dhe kushteve të punës në Republikën e Kosovës.

Pyetja 2: Cila është forma e prezantimit të shtetit për të tërhequr investime të huaja?

- a) A ka Kosova dhe Shqipëria kushte më të mira për tërheqjen e IHD?
- b) Sa janë plotësuar dhe si janë realizuar këto tërheqje të IHD?
- c) Në çfarë mënyre aplikohen?
- d) Cilat janë aspektet reformuese të shtetit në tërheqjen e IHD?

Në pyetjen se cila është forma e prezantimit të shtetit për të tërhequr investime të huaja nga anketat që kemi realizuar kemi marrë përgjigje pozitive, mirëpo ka disa prej të intervistuarve të cilët mendojnë se nuk kemi prezantim të duhur të shtetit sa i përket tërheqjes së investimeve të huaja. *Në vijim ne do japim një përmbledhje të asaj që janë shprehur shumica e të intervistuarve.*

Forma e prezantimit të shtetit për të tërhequr investime të huaja duhet të bazohet në disa pika kryesore. Duke filluar nga përmirësimi sistematik i stabilitetit politik dhe gjendjes së sigurisë së shtetit. Gjithashtu rritja e vetëdijësimit të bizneseve dhe në përgjithësi opinionin publik për rëndësinë dhe rolin e sektorit privat, mbrojtjen e konkurrencës, ndërmarrjen e masave sistematike kundër korrupsionit, hyrja në marrëveshje me shtetet e tjera për të lehtësuar eksportin, si dhe kompletimi i kornizës ligjore.

Në aspektin institucional, rolin e prezantimit të mundësive investive në Kosovë e bart Agjensioni për Investime dhe Përkrahje të Ndërmarrësisë në Kosovë e cila është e themeluar dhe funksionon në kuadër të Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë të Kosovës.

Agjensioni, përmes publikimeve, organizmin e forumeve investive në botën e jashtme bënë prezantimin e mundësive për investime në Kosovë si dhe ofron mbështetje konkrete

institucionale për investitorët e interesuar për tregun e Kosovës. Këto publikime bëhen të qasshme për investitorët potencial përmes Ambasadave të Kosovës në botën e jashtme, konferenca a panaire të ndryshme, por edhe me publikimin e tyre në magazina apo ëeb-faqe të specializuara nëpër botë.

Dhe forma tjetër e prezantimit të mundësive investive është edhe ajo e Ambasadave apo organizatave të specializuara ndërkombëtare, të cilat organizojnë vizita dhe takime të drejtpërdrejta në mes bizneseve të huaja dhe vendore në formë B2B (business to business) ku në mënyrë të drejtpërdrejt bëhet vënia e kontakteve të drejtpërdrejta për bashkëpunimin eventual dhe shkëmbimin e përvojave të ndërsjella.

Pyetja 3: Cilat janë instrumentet juridike për zgjidhjen e kontesteve të IHD-ve dhe a mendoni se sa më shumë IHD të përthithen nga qeveria e Kosovës, kjo do jetë shumë e dobishme për vendin tonë?

Sa i përket kësaj pyetje shumica nga të anketuarit janë pro investimeve të huaja, sepse mendojnë se do jenë shumë të dobishme për vendin. *Në vazhdim mund të shihet një përmbledhje nga përgjigjet që kemi marrë prej të anketuarve:*

Instrumenti kryesor për zgjidhjen e kontesteve të IHD është vet Ligji për Invetimet e Huaja i cili i mundson investitorit që t'i drejtohet forumeve të arbitrazhit të huaj për zgjidhjen e mosmarrveshjeve eventuale.

Në instrument tjetër i cili është shumë i përhapur në praktikën ndërkombëtare është edhe nënshkrimi i Marrëveshjeve Bilaterale për Mbrojtjen e Investimeve (BIT) dhe në këtë drejtim edhe Kosova ka të nënshkruara disa marrëveshje të këtilla, siç janë:

- a. Me Unionin Ekonomik të Belgjikës-Luxemburgut për Përkrahjen Reciproke dhe Mbrojtjen e Investimeve
- b. Marrëveshje për Promovimin dhe Mbrojtjen e Investimeve me Austrinë
- c. Marrëveshja për Nxitjen e Investimeve në mes SHBA dhe Kosovës
- d. Marrëveshja për Mbrojtjen e Investimeve mes Zvicrës e Kosovës.

Përveç këtyre, Kosova me shpalljen e Pavarësisë ka marrë përsipër zbatimin direkt të një mori Marrëveshjeve për Mbrojtjen e Investimeve të shteteve të ndryshme të botës me Federatën e Jugosllavisë.

- a. Me Unionin Ekonomik të Belgjikës-Luxemburgut për Përkrahjen Reciproke dhe Mbrojtjen e Investimeve
- b. Marrëveshje për Promovimin dhe Mbrojtjen e Investimeve me Austrinë
- c. Marrëveshja për Nxitjen e Investimeve në mes SHBA dhe Kosovës
- d. Marrëveshja për Mbrojtjen e Investimeve mes Zvicrës e Kosovës.

Përveç këtyre, Kosova me shpalljen e Pavarësisë ka marrë përsipër zbatimin direkt të një mori Marrëveshjesh për Mbrojtjen e Investimeve të shteteve të ndryshme të botës me Federatën e Jugosllavisë.

Pyetja 4: Në çfarë forme shteti i Kosovës dhe ai i Shqipërisë i garanton investimet e huaja?

Pothuajse 70% e të të anketuarve janë shprehur në atë mënyrë se Kosova ka filluar t'i garantojë investimet e huaja dhe përgjigjen që kemi marrë është si më poshtë:

Në përgjithësi mund të themi se Kosova ka filluar të garantojë investimet e huaja duke u përpjekur që të sigurojë një ambient të sigurtë për investorët dhe të i'u sigurojë të drejtat për fillimin dhe përfundimin e investimeve si dhe tërheqje të fitimit. Sa i përket rregullativës ligjore, Kosova ka Ligjin Për Investimet e Huaja nga viti 2003, ndërsa Ligji aktual Nr. 04/L-220 për Investimet e Huaja është miratuar nga Parlamenti i Kosovës me 12 dhjetor 2013.

Përmes këtij ligji, Kosova në mënyrë shprehimore garanton investorët e huaj me këto të drejta:

1. Investimet e huaja i nënshtrohen procedurave të nacionalizimit apo të eksproprijimit
2. Investitori i huaj ka të drejtë të bëjë transferimin e fitimeve të veta jasht Kosovës
3. Për zgjidhjen eventuale të mosmarrëveshjeve që lindin në Kosovë, Investitori i Huaj mund t'i drejtohet Gjykatave apo Arbitrazheve të huaja.

Përmes këtij ligji, Kosova pranon jursidikcionin e Qendrës Ndërkombëtare për Zgjidhjen e Mosmarrëveshjeve Investive (ICSID) sipas Rregullave të ICC (Dhomës Ndërkombëtare

të Tregtisë) apo UNCITRAL, ndërsa çdo vendim i nxjerrë nga këto forume të Arbitrazhit pranohet dhe është i ekzekutueshëm në Kosovë.

Përveç kësaj, në Kosovë aktualisht janë edhe dy forume vendore të Arbitrazhit, njëra pranë Odës Ekonomike të Kosovës si dhe tjetra pranë Odës Ekonomike Amerikane në Kosovë dhe edhe këto janë forume të cilat ofrojnë mundësi për Investitorët e Huaj që të zgjidhin mosmarrëveshjet eventuale në Kosovë. Këto dy forume Arbitrazhi kanë rregulat e procedurës, listën e Arbitrave të akredituar si dhe resurset e nevojshme për të udhëhequr procedurat e arbitrazhit.

Përkundër kësaj, aktualisht ngecja më e madhe e cila paraqet vështirësi reale edhe për Investitorët e Huaj është mosefikasiteti i Gjyaktave të Kosovës për të udhëhequr dhe përfunduar procedurat për zgjidhjen e kontesteve të ndryshme ekonomike të cilat lindin mes Investitorëve të Huaja dhe kompanive vendore.

Në këtë kuadër, vlen të ceket se Kosova ka nevojë për reformimin e sistemit gjyqësor dhe sundimin e ligjit si një nga elemente vitale për përmirësimin e ambientit të bërit biznes në Kosovë dhe klimës miqësore për rritjen e investimeve të huaja në Kosovë.

Pyetja 5: A ka përfituar Kosova dhe Shqipëria nga investimet e huaja direkte?

- a) Nëse po, cilat janë të mirat e përfituara?
- b) Nëse jo, cili mendon se është shkaku?

Në këtë pyetje përgjigjet që kemi marrë kanë qenë shumë interesante, sepse shumica e të anketuarve kanë mendim pozitiv sa i përket kësaj, mirëpo ka edhe të tillë të cilët mendojnë se nuk kemi pas përfitime të kënaqshme sa i përket investimeve të huaja. *Në pika të shkurtëra kemi bërë përpjekje që të paraqesim disa nga mendimet e të anketuarve, të cilat i kemi paraqitur edhe në grafikon.*

Investimet e huaja në Kosovë sjellin përfitime të shumëanshme ndër të tjera si në vijim:

- a) Zvogëlimi i papunësisë në Kosovë;
- b) Ngritja dhe përmirësimi i standardit të jetesës;
- c) Përmirësimi i infrastrukturës dhe ambientit të jetesës;
- d) Avancimi i sistemit arsimor dhe cilësisë së mësimi;
- e) Ngritja e shkathtësive të punës përmes transferimit të dijes dhe metodave të punës apo siç përshkruhet transferi i “knoë hoë”.

Pyetja 6: Cila do të ishte mënyra e zgjidhjes së kontesteve në mes të investitorit dhe shtetit të vendit?

Në këtë pyetje mbi 50% e të intervistuarve mendojnë se kontestet duhet të zgjidhen me anë të arbitrazhit edhe pse disa prej tyre shprehen se ekzistojnë gjykatat vendore dhe lënda nuk është e nevojshme të shkojë në arbitrazh. Ndërsa një numër i vogël nuk japin mendim sa i përket kësaj pyetje ose mendojnë se me mirëkuptim mund të vie deri te zgjidhja e rasteve. *Në vazhdim kemi bërë një përmbledhje të asaj se çfarë mendojnë shumica e të intervistuarve.*

Mënyra për zgjedhjen e kontesteve në mes të një investitori dhe një shteti është përmes arbitrazhit pra, përmes gjykatave ndërkombëtare të cilat janë edhe kompetente dhe kanë përvojën e duhur për zgjedhjen e kontesteve në çështje komerciale. Në këtë drejtim, ky konstatimi është dominant në Kosovë meqë të gjithë investitorët e huaj në Kosovë në të gjitha rastet përmes kontraktimit vendosin që mosmarrëveshjet eventuale në Kosovë t'i zgjedhin përmes arbitrazhit ndërkombëtar.

Pyetja 7: Nga cilat vende e kanë më shumë origjinën investimet e huaja në Kosovë?

Përgjigjen që kemi marrë në këtë pyetje e kemi paraqitur më poshtë në të cilën mund të shihet se të anketuarit janë bazuar në statistikat e Bankës Qendrore të Kosovës.

Sipas përgjigjes së respondentëve të cilët bazohen sipas statistikave të dhëna nga Banka Qendrore e Kosovës: në vitin 2017 sipas pozitave gjeografike investimet e huaja në Kosovë vijnë nga: Shtetet Anëtare të Bashkimit Evropian/EEA (me theks të veçantë Austria, Gjermania, Britania e Madhe, Sllovenia, Zvicra), Turqia, SHBA.

Pyetja 8: Cilat janë avantazhet dhe disavantazhet e të investuarit në Kosovë?

Sa i përket pyetjes se cilat janë avantazhet dhe disavantazhet e të investuarit në Kosovë më shumë se gjysma e të intervistuarëve ose 55% e tyre shprehen se Kosova është një vend i cili ka avantazhe të shumta për të investuar nga investitorët e huaj, 35% të tyre mendojnë se faktori politik është një disavantazh i madh që po jep imazh negativ për sigurinë ndaj investitorëve të huaj. Ndërsa një përqindje më e vogël e respondentëve japin mendime të

ndryshme sa i përket avantazheve dhe disavantazheve për të investuar në Kosovë. *Me poshtë kemi paraqitur një përmbledhje të disa nga përgjigjet që kemi marrë:*

Ndër avantazhet kryesore të të investuarit në Kosovë janë:

- a) Pozita dhe lokacioni strategjik i Kosoves në Evropë;
- b) Resurse njerëzore dhe potencial i madh i rinisë së shkathtë për punë;
- c) Mjedisi relativisht i favorshëm për investime të huaja;
- d) Marrëveshja e tregtisë së lirë me Evropën Qendrore (CEFTA)
- e) Stabiliteti ekonomik dhe financiar
- f) Kosto e ulët e operimit, TVSH -18%, Tatimi në Korporata 10%, Dividentat 0%.

Ndërsa disavantazhet janë, kryesisht të natyrës politike, sistemore, efikasiteti i ulët i sistemit gjyqësor, burokracia e cila e rëndon biznesin e huaj, përceptimi i lartë i korrupsionit në Kosovë si dhe ekonomia joformale e cila është pengesa më serioze e konkurrueshmërisë dhe lirisë së tregut.

Pyetja 9: Cilat janë marrëdhëniet tregtare të Kosovë me vendet e Bashkimit Evropian?

Nga të intervistuarit 80% mendojnë se Bashkimi Evropian është investitori kryesor që kemi në Kosovë, ndërsa një numër i vogël i tyre mendojnë se edhe Shtetet e Bashkuara të Amerikës janë investitorët kryesor në Kosovë. *Ne kemi paraqitur shkurtimisht një përmbledhje të mendimeve të tyre:*

Bashkimi Evropian mbetet ende një ndër investitorët më të mëdhenj në Kosovë. Sidoqoftë në krahasim me vitet e kaluara Raportet e Bankës Qendrore tregojnë se këto investime kanë rënë dukshëm viteve të fundit. Rrjedhimisht mund të konstatojmë se marrëdhëniet tregtare në këtë aspekt kanë pasur rënie.

Pyetja 10: Çfarë është ecuria e eksporteve dhe importeve me vendet e BE-së?

Disa nga të intervistuarit shprehen se *Kosova mbetet një vend importues*, ndërsa shumica nga ta shprehen se nuk kanë ndonjë informacion të saktë sa i përket importeve dhe eksporteve edhe pse në përgjithësi *Kosova është vend që më tepër importon e më pak eksporton*.

Pyetja 11: Çfarë ndikimi kanë institucionet financiare ndërkombëtare në investimet në vend?

1. Zhvillues të burimeve të brendshme vendore
2. Promotor për më shumë vende të reja pune
3. Promotor për nxitjen e tregut të brendshëm dhe zhvillues të resurseve
4. Mbeshtetës të fuqishëm financiar
5. Pengues ose skllavërues të investimeve të reja

Në këtë pyetje kemi marrë përgjigje të ndryshme nga të intervistuarve të cilët 65% e tyre mendojnë se institucionet financiare ndërkombëtare janë zhvillues të burimeve të brendshme vendore, promotor për më shumë vende të reja pune, ndërsa 25% e tyre shprehen se institucionet financiare ndërkombëtare janë mbështetës të fuqishëm financiar, ndërsa 10% e tyre mendojnë se janë pengues të investimeve të reja. *Ne kemi bërë një përmbledhje të asaj që shumica e të intervistuarve janë shprehur ndaj institucioneve financiare ndërkombëtare:*

Marrë parasysh që investimet e institucioneve financiare ndërkombëtare janë të fokusuara në lloje të ndryshme të projekteve në përgjithësi mund të themi që janë promotor për më shumë vende të reja pune, dhe për nxitjen e tregut të brendshëm dhe zhvillues të resurseve. Po ashtu, inkurajojnë zhvillimin e burimeve të brendshme vendore dhe në anën tjetër sigurojnë mbështetje të fuqishme financiare.

Përparësia tjetër është se institucionet financiare ndërkombëtare (IFC dhe EBRD) përveç se sjellin financime konkrete në projekte dhe kompani të ndryshme ata edhe sjellin përvojat e menaxhimit të avancuar të korporatave dhe kjo sjellë përfitime indirekte për kompanitë vendore pasi që ngrisin cilësinë e sistemit menaxherial dhe përgjegjësi të kompanive kosovare.

Pyetja 12: Cili prej këtyre institucioneve mendoni se ndikon më shumë në zhvillimin ekonomik të Kosovës:

- Fondi Monetar Ndërkombëtar
- Banka Botërore
- Banka Për Rindërtim dhe Zhvillim
- Organizata Botërore e Tregtisë

Përgjigjen që kemi marrë sa i përket kësaj pyetjeje është se 80% e të intervistuarve mendojnë se Fondi Monetar Ndërkombëtar dhe Banka Botërore ndikojnë më shumë në zhvillimin ekonomik të Kosovës, ndërsa 15% të tyre mendojnë se Banka për Rindërtim dhe Zhvillim ka ndikim në ekonominë e vendit tonë dhe mbetet një përqindje e vogël prej 5% të cilët mendojnë se këto institucione vetëm e dobësojnë ekonominë e Kosovës, duke e futur në borxhe.

Sipas Raportit të BQK për vitin 2017, Kosova ndaj Institucioneve të lartëpërmendura ka borxh të jashtëm bruto si në vijim: Fondi Monetar Ndërkombëtar 233.8, Banka Botërore 197.4, EBRD 158.3, e më pas kreditorë të tjerë. Rrjedhimisht, Fondi Monetar Ndërkombëtar dhe Banka Botërore i paraprinjë listës së investitorëve të huaja sa i përket zhvillimit ekonomik në Kosovë.

Pyetja 13: A kanë Kosova dhe vendet e rajonit pasoja dhe përparësi nga Institucionet Financiare Ndërkombëtare?

Nëse po cilat janë ato?

Nëse jo, cilat janë përparësitë?

Duke u bazuar në përgjigjet që kemi marrë sa i përket kësaj pyetje shumica e respondentëve janë shprehur se nuk kanë ndonjë informacion të saktë për pasojat nga këto institucione, ndërsa përparsitë mendojmë se janë të shumta, të cilat i kemi përmbledhur në pika të shkurtëra si më poshtë:

Vendet e rajonit dhe Kosova kanë përparësi nga Institucionet Financiare Ndërkombëtare si: Banka Botërore, Fondi Monetar Ndërkombëtar apo Banka Për Rindërtim dhe Zhvillim, pasi këto institucione financiare kanë dhënë dhe do japin ndihmë nëpërmjet rekomandimeve, ekspertizave, financimeve të projekteve të rëndësishme qeveritare, financimeve për nxitjen e tregut të brendshëm dhe zhvillimit të resurseve, sidomos ndihmave të akorduara nga BE për përshpejtimin e procesit të aderimit në BE.

Pyetja 14: Si duhet të bëhet nxitja dhe inkuraimi i IHD-ve në Kosovë?

Investimet e huaja direkte jane të domosdoshme për vendin tonë prandaj dhe nxitja dhe inkurajimi i tyre është një detyrë e rëndësishme që duhet ta kryjenë me shumë përgjegjësi, sidomos institucionet e vendit dhe kjo bëhet duke përmiresuar stabilitetin politik, gjendjen e sigurisë, parandalimin e korrupsionit, e që janë disa nga përgjigjet që kemi marrë nga intervista, të cilat më poshtë janë të përmbledhura në pika të shkurtëra:

Nxitja dhe inkurajimi për investime në përgjithësi duhet të bëhet duke përmirësuar stabilitetin sistematik politik dhe gjendjen e sigurisë së shtetit. Kjo arrihet duke rritur vetëdijësimin e bizneseve dhe në përgjithësi opinionit publik për rëndësinë dhe rolin e sektorit privat, mbrojtjen e konkurrencës, ndërmarrjen e masave sistematike kundër korrupsionit, hyrja në marrëveshje me shtetet e tjera për të lehtësuar eksportin, si dhe kompletimi i kornizës ligjore.

Pyetja 15: Cilat mendoni se janë motivet e investitorëve të huaja për të investuar në vendet e rajonit?

Përgjigjet që kemi marrë sa i përket motiveve janë të ndryshme, kemi bërë përpjekje që shkurtimisht t'i paraqesim disa prej tyre:


Qëllimi i investitorëve të huaj dhe veçanërisht i Institucioneve Financiare Ndërkombëtare është mbështetja financiare dhe këshillimi profesional për çështje ekonomike dhe sociale ndaj shteteve në zhvillim. Rrjedhimisht ajo çka i motivon këto institucione apo edhe bizneset e tjera për të investuar në shtete në zhvillim është lehtësimi i procedurave, rregullimi i kornizave ligjore si dhe bashkëpunimi me institucionet.

ANALIZA E PYETËSORËVE PËR INDIVIDË NË SHQIPËRI

Në pjesën e pyetësorëve sa i përket Shqipërisë jemi bazuar në të dhënat e mbledhura dhe varësisht nga përgjigjet që kemi marrë kemi arritur të japim një përkufizim të shkurtër për secilën pyetje, me ç'rast i kemi paraqitur në formë të grafikoneve dhe shpjegimeve për secilën veç e veç.

Pyetja 1: Cilat kritere duhet të plotësohen për të tërhequr investitorë të huaj?

- a) Tërheqja e investorëve të huaj referuar resurseve të Shqipërisë?
- b) Tërheqja e investorëve të huaj referuar rritjes së të ardhurave reale për frymë në Republikën e Shqipërisë
- c) Rritja e treguesve në tregun e punës
- d) Rritja e nevojave për më shumë burime monetare
- e) Përmirësimi i standardeve dhe kushteve të punës në Republikën e Shqipërisë



Grafiku 7 –Kriteret për tërheqjen e investimeve


Për tërheqjen e investorëve të huaj secili shtet duhet të plotësojë disa kriteret të cilat janë me rëndësi dhe kanë ndikim pozitiv tek investorët duke iu referuar resurseve, rritjes së të ardhurave reale për frymë në Republikën e Shqipërisë, nevojave për burime monetare më të mëdha si dhe kushtet e punës të jenë më të avancuara. Nga përgjigjet që kemi marrë prej respondentëve mund të shihet edhe në grafikun se 10 përqind e tyre janë të mendimit se tërheqja e investorëve të huaj varet nga resurset që ka Shqipëria. Nëse i referohemi të ardhurave reale në Shqipëri 15 përqind e të anketuarve mendojnë se ndikojnë në tërheqjen e investimeve të jashtme, ndërsa për rritjen e treguesve në tregun e punës janë përgjigjur 23 përqind e respondentëve, 12 përqind janë për më shumë burime monetare dhe 12 përqind për përmirësimin e standardeve të punës.

Pyetja 2: Cila është forma e prezantimit të shtetit për të tërhequr investime të huaja?

A ka Shqipëria kushtet më të mira për tërheqjen e IHD?

a) Po

b) Jo




Grafiku 8 – Forma e prezantimit të Shtetit

Shqipëria ka kushte të mira për tërheqjen e investimeve të huaja, mirëpo duhet ditur shfrytëzuar në mënyrë më të mirë nga institucionet e vendit si dhe shteti duhet të ketë më shumë aspekte reformuese në tërheqjen e investimeve. Në hulumtimin të cilin e kemi realizuar me respondentë 80 përqind e tyre mendojnë se Shqipëria ka kushte të mira për tërheqjen e investimeve, ndërsa 20 përqind e tyre mendojnë se nuk ofron kushte të mira për investitorët.

Pyetja 3: Cilat janë instrumentet juridike për zgjedhjen e kontesteve të IHD-ve dhe a mendoni ju se sa më shumë IHD të përthithen nga qeveria e Shqipërisë, kjo do jetë shumë e dobishme për vendin?

Po

Jo




Grafiku 9 – Instrumentet juridike për IHD

Instrumentet juridike që parashikohen në zbatimin e së drejtës ndërkombëtare tregtare si dhe legjislacioni juridik i Republikës së Shqipërisë. Shqipëria si një vend me ekonomi në zhvillim dhe në pritshmëri për një rritje të qëndrueshme është një treg mjaft atraktiv për thithjen e investimeve të huaja. Sipas përgjigjeve që kemi marrë 86 përqind e të anketuarve janë të mendimit se IHD-të nuk ndikojnë pozitivisht në të mirë të vendit, ndërsa 14 përqind e tyre mendojnë se ndikojnë në të mirë të vendit.

Pyetja 4: Në çfarë forme shteti i Shqipërisë i garanton investimet e huaja?

- a) Ligjit
- b) Ambient të sigurtë për të investuar
- c) Sistem politik stabil



Grafiku 10 – Forma e garantimit të IHD-ve


Mbrojtja e investimeve të huaja në Shqipëri dhe Kosovë garantohet nga Kushtetuta dhe Ligji për mbrojtjen e Investimeve të Huaja. Të dy vendet që të tërheqin sa më shumë investime duhet t’iu garantohet siguri për të investuar në bazë të ligjit si dhe sistemi politik në vend duhet të jetë stabil. Të mendimit për një ambient të sigurt për të investuar janë 33 përqind e të anketuarve, 45 përqind e tyre mendojnë se duhet t’i kushtohet rëndësi sistemit stabil politik, ndërsa 22 përqind mendojnë se me ligj rregullohet garantimi dhe interesimi sa më i madh i investimeve.

Pyetja 5: A ekzistojnë avantazhe dhe disavantazhe në të investuarit në Shqipëri?

Avantazhet

Disavantazhet

Indiferent



Grafiku 11 – Avantazhet dhe disavantazhet e investimeve në Shqipëri

Shqipëria ka avantazh, se është një treg në zhvillim, një vend me burime dhe resurse me potenciale zhvillimi për të ardhmen. Ka fuqi punëtore dhe burime njerëzore disponible që mund të mirëmenaxhohen në dobi të rritjes së efektivitetit të investimeve të huaja. Ka disavantazh për faktin se investimet e huaja janë të eksopozuara ndaj fenomeneve të përmendura më lart si: mungesa e transparencës në procedura, mungesa e zbatimit korrekt të ligjit, mitmarrja dhe korrupsioni. Nga përgjigjet e dhëna 50 përqind e respondentëve mendojnë se Shqipëria ka avantazh, 32 përqind janë të mendimit se Shqipëria ka disavantazh në investime, ndërsa pjesa tjetër janë indiferent ndaj kësaj pyetje ose thënë në përqindje 13 përqind e tyre.


Pyetja 6: Nga cilat vende kanë më shumë origjinë investimet e huaja në Shqipëri?

BE

USA

Vendore

Indiferent



Grafiku 12 – Origjina e investimeve të huaja

Pjesa më e madhe e të anketuarve mendojnë se origjina e investimeve të huaja direkt vie nga SHBA, 33 përqind janë të këtij mendimi, ndërsa 27 përqind e tyre shprehen se investimet e huaja në Shqipëri e kanë origjinën kryesisht nga vendet e BE-së, një pjesë e tyre janë indiferent 26 përqind dhe 14 përqind janë përgjigjur se investimet në Shqipëri janë më shumë vendore.


Pyetja 7: Cili prej këtyre institucioneve mendoni se ndikojnë më shumë në zhvillimin ekonomik të Shqipërisë:

FMN

BERZH

OBT

IHD vendore




Grafiku 13 – Ndikimi i institucioneve financiare në zhvillim ekonomik

Në zhvillimin ekonomik të Shqipërisë ndikojnë të gjitha këto institucione, mirëpo duke marrë për bazë përgjigjen e respondentëve 29 përqind mendojnë se FMN ka ndikimin më të madh në zhvillimin ekonomik të vendit, 36 përqind mendojnë se BERZH ndikon më masë më të madhe në ekonominë e Shqipërisë, 36 përqind janë të mendimit se OBT ka ndikim më të madh, ndërsa 32 përqind shprehen se investimet vendore kanë ndikim më të madh në ekonomi.

Pyetja 8: Çfarë ndikimi kanë institucionet financiare ndërkombëtare në investimet në vend?

- 1 Zhvillues të burimeve të brendshme vendore
- 2 Promotor për më shumë vende të reja pune
- 3 Promotor për nxitjen e tregut të brendshëm dhe zhvillues të resurseve
- 4 Mbeshtetës të fuqishëm finaciare
- 5 Pengues ose skllavërues të investimeve të reja




Grafiku 14 – Ndikimi i institucioneve në investimet në vend

Institucionet financiare ndërkombëtare kanë ndikim në zhvillime në vend, në radhë të parë sa i përket vendeve të reja të punës, zhvillimin e resurseve, bëjnë nxitjen e tregut të brendshëm si dhe janë mbështetës financiar. Duke u nisur nga ky fakt kemi marrë përgjigje të ndryshme nga të anketuarit gjatë realizimit të këtij hulumtimi. Një pjesë e tyre prej 14 përqind mendojnë se institucionet financiare ndërkombëtare janë zhvillues të burimeve të brendshme vendore, 23 përqind shprehen se këto institucione janë promotor për më shumë vende të reja të punës, 22 përqind mendojnë se këto institucione janë promotor për nxitjen e tregut të brendshëm si dhe 30 përqind mbështetës të fuqishëm financiar dhe një përqindje e vogël prej 3 përqind besojnë se institucionet janë pengues për tregun e brendshëm.

Pyetja 9: A kanë Shqipëria dhe vendet e rajonit pasoja dhe përparësi nga Institucionet Financiare Ndërkombëtare?

Po
Jo




Grafiku 15 – Pasojat dhe përparësit nga institucionet financiare

Vendet e rajonit dhe Shqipëria kanë përparësi nga nga Instucionet Financiare Ndërkombëtare si: Banka Botërore, Fondi Monetar Ndërkombëtar apo Banka Për Rindërtim dhe Zhvillim, pasi këto institucione financiare kanë dhënë dhe do të japin ndihmë nëpërmjet rekomandimeve, ekspertizave, financimeve të projekteve të rëndësishme qeveritare, financimeve për nxitjen e tregut të brendshëm dhe zhvillimit të resurseve, sidomos ndihmave të akorduara nga BE për përshpejtimin e procesit të aderimit në BE. Ndërsa respondentët tanë janë të mendimit se Shqipëria ka pasoja nga këto institucione financiare ose thënë më mirë 70 përqind e tyre janë shprehur në këtë mënyrë, kurse pjesa tjetër prej 30 përqind mendojnë se nuk ka pasoja Shqipëria prej këtyre institucioneve.

Pyetja 10: Cilat mendoni se janë motivet e investitorëve të huaj për të investuar në vendet e rajonit?

- a) Kushtet rajonale
- b) Lehtësitë investive
- c) Fuqia e lirë punëtore
- d) Nevoja për IHD



Grafiku 16 – Motivet e investorëve për të investuar në rajon

Në kuadrin e politikave të BE- së për zgjerim, vendet e rajonit janë të përfshira në projekte të ndihmave të BE-së të cilat garantojnë që këto vende do të manifestojnë qëndrueshmëri të sistemit politik, siguri të brendshme dhe të jashtme, garanci për forcim të shtetit të së drejtës dhe zbatim korrekt të legjislacionit. Gjithashtu këto vende kanë burime dhe resurse të cilat janë burim zhvillimi dhe fitimi për të bërë biznes. Gjatë hulumtimit kemi hasur në mendime të ndryshme sa i përket kësaj pyetjeje me ç’rast 45 përqind e të anketuarve mendojnë se janë kushtet rajonale që motivojnë investorët e huaj, 20 përqind janë për lehtësitë investive. 20 përqind besojnë që nevoja për IHD-të në rajon i motivon investorët për të investuar dhe 15 përqind besojnë se fuqia e lirë punëtore është motivuese për IHD-të.

Përfundimet e pyetësorit për individët

Në kuadrin e pyetësorit për investimet e huaja direkte drejtuar individëve, sa i përket Kosovës dhe Shqipërisë kemi bërë përpjekje që të shtjellojmë rëndësinë e investimeve tek individët, duke marrë mendimin e tyre si dhe duke krahasuar me qëllim që të arrijmë në një përfundim të caktuar. Për tërheqjen e investimeve të huaja direkte duhet të plotësohen disa kritere, të cilat janë mjaft të rëndësishme dhe luajnë rol kyç për investitorët. Respondentët tanë në të dyja shtetet që kanë qenë pjesë e këtij hulumtimi janë të mendimit se në radhë të parë duhet të sigurohet rendi juridik dhe politik, pra funksionimi i mirë i sistemit ligjor që është bazë për tërheqjen e investimeve.

Sa i përket pyetjes se në tërheqjen e investimeve cfarë roli luan shteti dhe cila është forma, të anketuarit kanë dhënë mendime të ndryshme, disa prej tyre janë të mendimit se si Kosova poashtu edhe Shqipëria kanë formë të ndryshme për tërheqjen e investimeve, mirëpo duhet të punohet më shumë nga organet shtetërore. Sa i përket Shqipërisë të anketuarit janë shprehur se është duke u punuar mirë në këtë drejtim, ndërsa të anketuarit në Kosovë nuk janë të këtij mendimi dhe kërkojnë më shumë përgjegjësi nga institucionet. Sa i përket pyetjes se a ekzistojnë avantazhe dhe disavantazhe të IHD-ve, në Shqipëri mendojnë se më shumë ekzistojnë avantazhe, kurse në Kosovë mendojnë se përveç avantazheve ekzistojnë edhe disavantazhet nga këto investime.


Na është dukur mjaft me rëndësi edhe mendimi i individëve sa i përket Institucioneve Financiare Ndërkombëtare si dhe ndikimi i tyre në tërheqjen e investimeve. Institucionet kanë ndikim në përmirësimin ekonomik të vendeve duke marrë parasysh ndihmat të cilat merren nga këto institucione sa i përket ekspertizave, rekomandimeve, financimit të projekteve të ndryshme. Sipas mendimit të intervistuarve Kosova dhe Shqipëria janë pjesë e këtyre insitucioneve, mirëpo nuk mund të themi se deri më tanë kanë parë vetëm anë pozitive nga antarësimi në to.

Analiza e pyetësorve për institucione lidhur me investimet e huaja në Kosovë

Kemi gjykuar se hulumtimi ynë do jetë sa më i kompletur poqese fillimisht marrim të dhënat personale të personave të investuar. Gjykuar në të dhënat që neve kemi mbledhur nga hulumtimi që kemi realizuar në bazë të pyetësorëve vijmë në këtë përfundim të cilin e kemi përmbledhur me anë të grafikoneve dhe shpjegimit të tyre.

GJINIA

- Mashkull
- Femër




Grafiku 17 – Gjinia në hulumtimin për Kosovën

Hulumtimin e kemi zhvilluar me persona të gjinisë femrore dhe mashkullore ku 60 përqind e tyre ishin të gjinisë mashkullore dhe 40 përqind e tyre ishin të gjinisë femrore.

MOSHA

1. 25 – 35
2. 36 – 50
3. 51 – 60
4. Mbi 60 vjeç




Grafiku 18 – Mosha në hulumtimin për Kosovën

Në është dukur e rëndësishme që respondentët tanë t'i pyesim edhe për moshën, sepse nga kjo mund të kuptojmë e mësojmë edhe për eksperiencën e tyre gjatë periudhës që kanë qenë duke punuar apo vazhdojnë të punojnë. Nga grafiku i paraqitur mund të kuptojmë se të moshës, 25-35 përqind janë në numër më të madh.


CILA ËSHTË POZITA JUAJ AKTUALE NË KËTË INSTITUCION?

1. Drejtor
2. Zv. Drejtor
3. Përfaqësues ligjor
4. Përfaqësues ekonomik
5. Tjetër: _____



Grafiku 19 – Pozita në institucion

A ofron Kosova siguri politike për investimet e huaja?




Grafiku 20 -Siguria politike për investorët

Për arsye të problemeve politike që ka Kosova, është krijuar një bindje tek investorët e huaj se nuk është vend stabil për të investuar. Nga të intervistuarit 60 për qind prej tyre mendojnë se Kosova ofron mesatarisht siguri politike për investimet e huaja, 20 për qind


prej tyre mendojnë se ofron siguri politike Kosova për investimet e huaja, ndërsa përqindja e atyre të cilët mendojnë se Kosova nuk ofron siguri politike për IHD-tw, është 20 përqind.

A jeni dakord me investimet që bëhen në Kosovë?



Grafiku 21- Investimet në Kosovë

Sa i përket pyetjes: “A jeni dakord me investimet që bëhen në Kosovë?” shumica e respondentëve janë përgjigjur: deri diku pajtohen apo 60 përqind janë dakord me investimet që bëhen në Kosovë, ndërsa përgjigjet pozitive dhe negative janë 20 përqind se pajtohen plotësisht, dhe 20 përqind se nuk janë dakord për investimet që bëhen në Kosovë.




Grafiku 22- Funksionimi i rendit juridik

I tërë hulumtimi është i përqendruar pikërisht në mbrojtjen juridike të investimeve të huaja direkte, prandaj edhe pyetja që kemi parashtruar ka qenë shumë e rëndësishme dhe, sidomos marrja e përgjigjeve nga respondentët. Disa nga të intervistuarit nuk duan të përgjigjen sa i përket kësaj pyetje, marrë në përqindje 40 përqind e tyre nuk duan të përgjigjen, ndërsa 40 përqind mendojnë se funksionin si duhet rendi juridik, dhe një përqindje tjetër janë indiferent sa i përket kësaj pyetje ose thënë më saktësisht 20 përqind e respondentëve.



Grafiku 23- Përfitimet e Kosovës nga IHD-të

Nga përgjigjet që kemi marrë 45 përqind e respondentëve mendojnë se Kosova ka përfitim ekonomik nga investimet e huaja, 33 përqind janë të mendimit se Kosova ka përfitim social, 22 përqind mendojnë se ka përfitim kulturor dhe sa i përket përfitimit politik asnjë nga të intervistuarit nuk janë dakord, sepse mendojnë se përfitimet politike nuk vijnë nga investimet e huaja. (Referuar pyetjes x të pyetësorëve të analizuar)



Grafiku 24- Përmirësimi ekonomik i Kosovës nga IHD-të

Sipas përfaqësuesve të institucioneve nga të cilët kemi marrë përgjigje lidhur me intervistën tonë sa i përket kësaj pyetje, përgjigjja e tyre më shumë qëndron në atë se IHD-të ndikojnë në cilësinë e jetës së individëve ose më mirë të themi 60 përqind e tyre kanë këtë mendim, ndërsa 40% e tyre nuk shprehen fare ose janë indiferent.



Grafiku 25 – Investimet nëpër sektorë

Qeveritë mund të ndërmarrin veprime specifike për nxitjen e investimeve të huaja direkte (IHD) në vend. Shumë vende kanë vështirësi për të tërhequr investimet e huaja për shkak të tregjeve të vogla ose kosto të lartë të shërbimit si një bazë për eksport, kështu strategjia për promovimin e investimeve që do të kontribuojë në zhvillim duhet të jetë në sektorë dhe aktivitete të veçanta.

Nga alternativat që kemi paraqitur nëpër sektorë shumica e të intervistuarve janë shprehur se sektorët të cilët duhet të investohet janë kryesisht në bujqësi, miniera, energjetikë dhe shërbime financiare tregtare, 45% e respondentëve janë shprehur se është me e nevojshme të investohet në ndërtim, shërbime financiare dhe në shërbime të tjera ku shihet nevoja më e madhe.



Grafiku 26 – Lehtësit për të investuar

Sikurse i gjithë rajoni, po ashtu edhe Kosova është vend tërheqës për investorët e huaj në fusha të ndryshme të biznesit dhe ekonomisë. Ndërsa mendimi i respondentëve sa i përket kësaj pyetje është: të mendimit pozitiv janë 40 përqind, 20 përqind nuk u ofrohen lehtësi për investim, 20 përqind janë indiferent ndaj kësaj pyetje, dhe 20 përqind mendojnë se nuk u ofron aspak lehtësi për të investuar.




Grafiku 27- Garantimi i investimeve dhe investorëve

Investimet e jashtme nuk duhet vetëm të pranohen dhe të mbrohen, mirëpo duhet t'u ofrohet garanci për investimet dhe investorët si dhe të bëhet sigurimi i tyre, pra, e tërë kjo ka të bëjë me çështjen e aplikimit të së drejtës së brendshme.

Për të krijuar klimë sa më të favorshme për tërheqjen e investorëve institucionet e vendit duhet të punojnë shumë në mënyrë që të kemi efikasitet në gjykata për zgjidhjen e rasteve. Sundimi i ligjit luan rol kryesor në tërheqjen e investorëve, që do të thotë se duhet të ketë ndëshkime për ata që shkelin ligjin, pra, nëse një kompani nuk punon në përputhje me rregullat dhe ligjin ajo duhet të ndëshkohet, mirëpo në të njëjtën kohë kompanitë që punojnë në përputhje me ligjin do të mbrohen prej ndëshkimeve arbitrare.

Sa i përket kësaj pyetjeje 60 përqind e respondentëve janë përgjigjur se pajtohen më pak se parashikimi, 20 përqind e tyre pajtohen plotësisht, ndërsa 20 përqind aspak nuk pajtohen.


Sa ndikojnë institucionet financiare ndërkombëtare në investimet në vend dhe rajon?



Grafiku 28 -Ndikimi i institucioneve financiare në investime


Nga analiza e pyetësorëve ne gjykojmë se qëllimi i antarësimit të Kosovës në institucionet financiare ndërkombëtare ka të bëjë me rritjen e besimit tek investitorët, se Kosova është një vend i sigurt ku mund të investohet, si dhe është parë si mundësi e mirë për zhvillimin ekonomik të vendit. Se a kanë ndikim institucionet financiare ndërkombëtare në investimet në vend dhe rajon kemi marrë përgjigje të ndryshme në hulumtimin tonë nga të intervistuarit. Mesatarisht mendojnë 40 përqind e të intervistuarve, 40 përqind janë të mendimit se ndikojnë shumë, 20 përqind mendojnë se nuk ndikojnë aspak në investimet në vendin tonë dhe vendet e rajonit.

Ndikimi i IHD-ve në Kosovë sjellë:




Grafiku 29 – Ndikimi i IHD-ve në Kosovë

Impakt pozitiv mbi popullatën vendore është përgjigja më e madhe që kemi marrë nga 60 përqind e respondentëve, 20 përqind e tyre mendojnë se kanë impakt negativ dhe 20 përqind e tyre japin mendimin se IHD-të ndikojnë në frenimin e zhvillimit vendas.



Grafiku 30 –Problemet që hasin investuesit e huaj

Nga pyetja që kemi parashtruar për të intervistuarit tanë nga institucionet e ndryshme të Kosovës dhe nga përgjigjet që kemi marrë, kemi arritur në përfundim se 50 përqind e tyre kanë probleme me infrastrukturën, 37 përqind e tyre mendojnë se problem më vete është rendi juridik 20 përqind e respondentëve mendojnë se investuesit e huaj hasin në probleme me institucionet vendore.



Grafiku 31 – Trajtimi i barabart i IHD-ve me ato vendore

Me qëllim të inkurajimit të investitorëve të huaj që të investojnë në vendin tonë, duhet të ndërmerren disa masa të cilat kanë për qëllim krijimin e një mjedisi miqësor për afarizëm dhe investime.

Investuesi duhet të bindet që investimi i tij është i sigurtë, do të trajtohet në mënyrë të drejtë, pa diskriminim, dhe në rast të mosmarrëveshjeve ato do të zgjidhen në mënyrë të drejtë. Investuesit pretendojnë që të trajtohen në mënyrë të barabartë me ndërmarrjet vendëse., një gjë të tillë e bëjnë vendet me shvillim të lartë ekonomik, pra i trajtojnë investuesit e huaj njëjloj me ndërmarrjet vendëse dhe kjo bën që të sigurojnë një mjedis më konkurrues.

Përgjigja e respondentëve në këtë pyetje ishte se nuk trajtohen në mënyrë të barabartë dhe në këtë mënyrë janë përgjigjur rreth 60 përqind e të intervistuarve, 40 përqind e tyre janë shprehur se pajtohen deri diku.

Çfarë mendoni: si duhet vepruar për eliminimin e këtyre problemeve?

Përgjigja: Sundim të rendit dhe ligjit, gjyqësori të jetë më efikas, ekonomia joformale të luftohet.

A mendoni se Investimet e Huaja kanë ndikuar pozitivisht në punësim?


Këtu kemi bërë një përmbledhje të mendimeve të të gjithë të intervistuarve dhe nga ajo se çfarë kemi arritur të kuptojmë: është se, investimet e huaja me vet faktin se hapin edhe vende të reja pune kuptohet se ndikimi i tyre është pozitiv sa i përket punësimit, kjo ka qenë përgjigja nga pyetja që u kemi parashtruar respondentëve.

ANALIZA E PYETËSORVE PËR INSTITUICIONE LIDHUR ME INVESTIMET E HUAJA NË SHQIPËRI

Pjesa e parë e pyetësit ka të bëjë me marrjen e informatave mbi të anketuarit për të vazhduar pastaj me pyetjet që neve na interesojnë të marrim përgjigje, me qëllim të pasurimit sa më shumë të këtij punimi.

GJINIA

- Mashkull
- Femër




Grafiku 32- Gjinia tek investimet në Shqipëri

Nga të intervistuarit sa i përket pyetësit për institucionet 47 prej tyre kanë qenë femra dhe 23 meshkuj.

MOSHA

5. 25 – 35
6. 36 – 50
7. 51 – 60
8. Mbi 60 vjeç




Grafiku 33 – Mosha tek investimet në Shqipëri

Sa i përket moshës, intervistën e kemi realizuar me moshë të ndryshme të cilat i kemi paraqitur edhe në grafikun ku 35 përqind e të intervistuarve kanë qenë të moshës 36 – 50, të moshës 25-35 kanë qenë 18 përqind, 25 përqind prej tyre kanë qenë prej moshës 51-60, ndërsa mbi moshën 60 vjeçare kanë qenë 22 përqind.

CILA ËSHTË POZITA JUAJ AKTUALE NË KËTË INSTITUCION


6. Drejtor
7. Zv. Drejtor
8. Përfaqësues ligjor
9. Përfaqësues ekonomik
10. Tjetër:_____



Grafiku 34 – Pozita në institucion

Arsyeja e kësaj pyetjeje ka qenë pikërisht marrja e informacionit sa më të saktë, sepse mendojmë se hierarkia më e lartë në një institucion ka më shumë të dhëna se punëtorët e tjerë, prandaj nga të interesuarit dijmë edhe pozicionin e tyre që kanë në institucionet të cilat i kemi intervistuar. Nga gjetjet tona sa i përket kësaj pyetje 15 përqind e tyre kanë pozitën e drejtorit, 28 përqind e tyre janë në pozicionin e zv. drejtorit, 40 përqind e tyre janë përfaqësues ligjor të ndonjë institucioni, 12 përqind janë përfaqësues ekonomik dhe pozita tjera brenda institucionit me të cilët kemi realizuar intervistën janë 5 përqind.

Cila është fusha juaj e shkollimit




Grafiku 35 – Fusha e shkollimit

Në këtë pyetje 42 përqind e të intervistuarve janë me shkollim të lartë, 31 përqind e tyre janë me shkollim akademik, 16 përqind kanë shkollim të mesëm dhe 11 përqind janë me kulturë tregtare.

Sa vite eksperiencë pune keni?


- 1-5
- ☐ 6-10
- ☐ Mbi 10 vite
- ☐ 20 vjet e më shumë



Grafiku 36 – Eksperienca në punë

Nga gjetjet tona 31 përqind e të intervistuarve janë deklaruar se kanë 1-5 vite eksperiencë pune në institucionin ku punojnë, 7 përqind e tyre janë deklaruar se kanë 6-10 vite eksperiencë pune, 34 përqind janë me mbi 10 vite eksperiencë ndërsa 28 përqind kanë më shumë se 20 vite eksperiencë.


Mendoni se roli i mbrojtjes së konsumatorit është esencial për zhvillimin e institucionit tuaj?



Grafiku 37 – Mbrojtja e konsumatorit

Pyetja se a mendojnë se roli i mbrojtjes së konsumatorit është esencial për zhvillimin e institucionit ku punojnë nga përgjigjet që kemi marrë 44 përqind e të intervistuarve janë përgjigjur se mendojnë që po ndërsa 52 përqind e tyre mendojnë se jo nuk është esencial dhe 20 përqind e tyre nuk kanë shprehur mendim fare sa i përket kësaj pyetje.

Çfarë efekte zhvilluese ka mbrojtja e konsumatorit në institucionin ku ju punoni?



Grafiku 38 – Efekti zhvillues i mbrojtjes së konsumatorit

Në pyetjen se çfarë efekti zhvillues ka mbrojtja e konsumatorit në institucionin ku personat e intervistuar punojnë, 10 përqind prej tyre janë përgjigjur se nuk kanë shumë efekt, 27 përqind janë shprehur se kanë efekt të mjaftueshëm dhe 33 përqind mendojnë se kanë efekt të kënaqshëm, ndërsa pjesa tjetër kanë qëndruar indiferent.


PYETËSOR PËR INSTITUCIONET NË SHQIPËRI

Pjesa e dytë e pyetësorit ka të bëjë me njohuritë që kanë këto institucione përsa i përket mbrojtjes së konsumatorit.

NJOHJA PËR MBROJTEN E KONSUMATORIT

1. A keni njohuri për Mbrojtjen e IHD ?

PO JO




Grafiku 39 – Njohuritë për mbrojtjen e IHD-ve

Mbrojtja ligjore e investimeve të huaja direkte ndikon pozitivisht në tërheqjen e investitorëve që investimet e tyre t'i investojnë në Shqipëri, nga të intervistuarit 56 përqind e tyre kanë njohuri sa i përket mbrojtjes së IHD-ve, ndërsa 44 përqind nuk kanë njohuri.

2. A mendoni se Menaxhimi Strategjik dhe Mbrojtja e IHD-ve ndikojnë pozitivisht në ekonominë e Shqipërisë ?

3. PO JO




Grafiku 40- Mbrojtja e IHD ndikim pozitiv në ekonomi

Në pyetjen se Menaxhimi Strategjik dhe Mbrojtja e IHD-ve ndikojnë pozitivisht në ekonominë e Shqipërisë 67 përqind e të intervistuarve janë përgjigjur me po, ndërsa 23 përqind mendojnë e thonë se nuk kanë ndikim pozitiv në ekonominë e Shqipërisë.

A ofron Shqipëria siguri për IHD dhe konsumatorët e huaj?

PO JO




Grafiku 41 – Siguria që ofron Shqipëria për IHD-të

Siguria për investitorët e huaj dhe investimet e tyre është primare e cila ndikon pozitivisht në tërheqjen e tyre, por gjithashtu rëndësi të madhe ka edhe për konsumatorët e huaj, nga gjetjet tona 70 përqind e tyre janë shprehur se po mendojnë që siguria ka ndikim në tërheqjen e konsumatorëve, ndërsa 30 përqind mendojnë se nuk ka ndikim siguria.

4. A jeni dakord me mënyrën se si funksionojnë bizneset në Shqipëri?

- ☐ Po
- ☐ Jo
- ☐ Indiferent




Grafiku 42 – Funksionimet e bizneseve në Shqipëri

Sa i përket menyrës se si funksionojnë bizneset në Shqipëri nga të dhënat që kemi arritur t'i grumbullojmë në bazë të pyetsorëve, 41 përqind mendojnë se bizneset po funksionojnë mirë në Shqipëri, 51 përqind mendojnë se nuk funksionojnë mirë, ndërsa 8 përqind janë indiferent ndaj kësaj pyetje, ose më mirë të themi se kjo përqindje e të intervistuarve nuk kanë informacion.

5. Si e vlerësojnë konsumatorët e huaj shërbimin e ofruar nga bizneset shqiptare?

- ☐ Shumë mirë
- ☐ Keq



Grafiku 43 – Vlerësimi i konsumatorëve në shërbim të bizneseve

Shërbimi i ofruar ndaj konsumatorëve të huaj është mjaft i rëndësishëm dhe këtë duhet ta kenë parasysh të gjitha institucionet që në njëfarë mënyre janë edhe promotorë në tërheqjen e investimeve të huaja direkt, të cilat bëjnë edhe kontrollimin e bizneseve shqiptare. Nga gjetjet tona sa i përket kësaj pyetjeje 66 përqind e të intervistuarve mendojnë se e vlerësojnë shumë mirë, ndërsa 34 përqind prej tyre e vlerësojnë keq.

Përfundimet e pyetësorit për institucionet

Në pyetësorin drejtuar institucioneve kemi realizuar intervista me përfaqësuesit e disa prej institucioneve në Kosovë dhe Shqipëri që janë të lidhura në mënyrë direkte me investimet e huaja. Në pjesën e parë të pyetësorit kemi kërkuar të dhëna sa i përket moshës, gjinisë, pozitës në institucionin ku punojnë, për të kaluar pastaj tek pyetjet që neve na interesojnë e që janë pjesë e këtij hulumtimi. Fillimisht kemi dashtë të dijmë se a funksionon si duhet rendi juridik, a zbatohet ligji dhe a mbrohen juridikisht investimet e huaja dhe investorët. Shteti mund të krijojë klimë të përshtatshme, relativisht të përshtatshme ose një klimë e cila nuk është aspak e përshtatshme për investorët e huaj dhe këtë mund ta bëjë me aktivitetin e vet ligjor. Krijimi i një klime të përshtatshme është detyrë e institucioneve të cilat janë të ndërlidhura direkt me investimet e huaja dhe të cilat duhet të punojnë

intensivisht në krijimin e kushteve sa më të mira, me qëllim të tërheqjes së investimeve të huaja.

I tërë hulumtimi ynë është i përqëndruar pikërisht në mbrojtjen juridike të investimeve të huaja direkte, prandaj edhe pyetjet që kemi parashtruar kanë qenë shumë të rëndësishme, sidomos marrja e përgjigjeve nga respondentët. Disa nga të intervistuarit nuk kanë dashur të përgjigjen në disa pyetje duke dashur të ruajnë privatësinë e punës që ushtrojnë. Në mënyrë më të detajuar përgjigjet që kemi marrë janë paraqitur në grafikone si për Kosovën po ashtu edhe për Shqipërinë. Në të dyja vendet nga rezultati që kemi arritur ta kemi, mund të themi se respondentët tanë janë të mendimit që për tërheqjen e investorëve siguria luan rol të rëndësishëm, pothuaj vendimarrës, ndërsa disa kanë qenë të mendimit se siguria nuk luan aspak rol ose nuk ka rëndësi fare. Një gjë e tillë mendojmë se nuk qëndron, sepse asnjë investues i huaj nuk do rrezikonte të humbiste kapitalin e investuar poqese nuk do të kishte siguri juridike.

Tek hulumtimi që kemi realizuar me institucionet, na ka interesuar të dijmë se cilët janë sektorët të cilët kanë nevojë më shumë të investohet duke pasur parasysh që nevoja për të investuar në të dyja shtetet është pothuajse në të gjithë sektorët.

Për të nxitur investimet e huaja direkte në Shqipëri dhe Kosovë qeveritë duhet të ndërmarrin veprime të caktuara. Vështirësi për të tërhequr investime të huaja kanë shumë vende dhe kjo vjen si pasojë e tregjeve të vogla dhe kostoja e shërbimit është shumë e lartë e që është bazë për eksport, do të thotë se përdorimi i strategjisë për promovimin e vendit për tërheqjen e investimeve duhet të jetë në sektorë të ndryshëm.

Nga alternativat që ne kemi paraqitur nëpër sektorë shumica e të intervistuarve janë shprehur se sektorët të cilët duhet të investohet janë kryesisht në bujqësi, miniera, energjetikë dhe shërbime financiare tregtare për arsye se mendojnë që nevoja më e madhe për të investuar është pikërisht në këta sektorë si dhe do ndikonte pozitivisht në zhvillimin ekonomik investimi në sektorët e cekur, ndërsa një pjesë e madhe e respondentëve janë shprehur se është më e nevojshme të investohet në ndërtim, shërbime financiare, dhe në shërbime të tjera ku shihet nevoja më e madhe.

Në pyetësorin drejtuar institucioneve pyetjet që kemi parashtruar për respondentët tanë si rezultat i përgjigjes së tyre kemi arritur në një përfundim ku pjesa më e madhe e tyre janë pro investimeve të huaja direkte dhe mbrojtjes ligjore të tyre. Ne kemi paraqitur disa nga

përmbledhjet e pyetjeve dhe përgjigjeve për të dyja vendet. Ajo çfarë neve na intereson më shumë ka qenë ndikimi pozitiv i IHD-ve, të mirat dhe përparësitë që po përfitojnë si Kosova po ashtu edhe Shqipëria. Kështu kemi arritur në përfundim se institucionet tona nuk punojnë mjaftueshëm në promovimin e vendeve tona dhe në tërheqjen e investitorëve duke pasur parasysh se këto investime do t'i mundësojnë të dyja shteteve një zhvillim ekonomik më të mirë dhe një paraqitje më të mirë në tregjet ndërkombëtare. Kjo gjithashtu ka edhe anën negative pasi që bizneset vendore, sidomos ato të vogla, dita ditës po pësojnë rënie të madhe dhe kjo si pasojë e pamundësisë që të konkurrojnë investimet e huaja, me teknologji, kapital e shumë e shumë të tjera që janë të rëndësishme në zhvillimin e biznesit.

Kosova si një shtet i cili ende nuk ka dal nga faza e tranzicionit duhet të bëjë të pamundurën që t'u krijojë klimë të mirë të biznesit për investitorët e huaj, kjo arrihet me krijimin e lehtësirave në të bërit biznes, shumë nga respondentët tanë janë të mendimit se Kosova u ka ofruar lehtësira për investitorët e huaj, mirëpo ka edhe të atillë të cilët mendojnë se investitorët e huaj nuk e kanë aspak të lehtë që të krijojnë biznesin e tyre dhe kjo është ana negative që shkakton ngecje në tërheqjen e investitorëve të huaj të cilët humbin interesimin. Një gjë të tillë mund ta themi edhe për shtetin e Shqipërisë edhe pse është një vend turistik dhe i plotëson të gjitha kushtet për zhvillimin e biznesit, interesimi i investitorëve të huaj nuk ka qenë i kënaqshëm krahasuar me vendet e rajonit.


Rendi juridik dhe sundimi i ligjit janë faktorët kyç për tërheqjen e investimeve të huaja. Shqipëria dhe Kosova e kanë të rregulluar me ligj mbrojtjen e investimeve dhe investitorëve, kjo do të thotë që kompania e cila nuk punon në përputhje me ligjin, rregullat dhe standardet duhet të ndëshkohet, sikurse duhet të mbrohet ajo kompani e cila i përmbahet këtyre rregullave. Se a ekziston sundimi i ligjit dhe sa zbatohet ishte pyetja e radhës që ne kemi parë të arsyeshme të parashtrojmë për institucionet dhe nga përgjigjet e tyre kemi arritur në përfundim se jo në të gjitha rastet ligji zbatohet në nivelin e duhur që është pasojë pse investitorët e humbin interesimin e tyre që të investojnë.

Trajtimi i barabartë në mes të investimeve të huaja dhe atyre vendore është çështje më vete që kërkon përkushtim nga institucionet vendore. Me qëllim të inkurajimit të investitorëve të huaj që të investojnë në vendin tonë, duhet të ndërmerren disa masa të cilat kanë për qëllim krijimin e një mjedisi miqësor për afarizëm dhe investime për një gjë të tillë është duke u punuar, mirëpo ende nuk kemi arritur të kemi një trajtim të plotë dhe të barabartë

për arsye se ndonjëherë ndodhë që firmat e huaja trajtohen shumë më mirë se sa ato vendore, kjo mund të nxit pakënaqësi tek investitorët e huaj dhe mundësia për zhvillimin më të madh të tyre zvogëlohet. Me qëllim që të marrim një përgjigje sa më të saktë dhe të bëjmë një analizë sa më të thellë me të dhëna kemi arritur të marrim përgjigje nga një numër i madh i të intervistuarve që janë shprehur se nuk mendojnë që investimet e huaja trajtohen në mënyrë të barabartë me ato vendore, dhe se investuesit vendor janë më të favorizuar si një regjistrimin e bizneseve, poashtu edhe në procedurat e tjera administrative, ndërsa një numër më i vogël janë shprehur se pajtohen në njëfarë mase jo plotësisht se investimet e huaja trajtohen në mënyrë të barabartë me ato vendore.


Me Ligjin për investimet e huaja në Kosovë, poashtu edhe në Shqipëri është e paraparë trajtimi i barabartë i investimeve të huaja me ato vendore, gjithashtu edhe mosdiskriminimi duke i trajtuar njëjtë investitorët e huaj pa marrë parasysh origjinën, vendbanimin apo shtetësinë. Mirëpo, investitorët e huaj përveç të drejtave, kanë edhe obligimet e tyre të cilat janë të parapara me ligjin e aplikueshëm për mbrojtjen e investimeve të huaja si në Kosovë poashtu edhe në Shqipëri.

ANALIZA E PYETËSORVE PËR FIRMAT E HUAJA DHE INVESTIMET E TYRE NË KOSOVË



Grafiku 44 – Rëndësia e IHD-ve në Kosovë


Ndërsa nga intervista që kemi zhvilluar me përfaqësues të firmave që janë në Kosovë 50 përqind e tyre mendojnë se IHD-të janë të rëndësishme për vet faktin se kanë karakter zhvillues, 33 përqind e tyre mendojnë se kanë karakter frenues dhe 17 përqind e të intervistuarve mendojnë se nuk kanë asnjë rëndësi në zhvillimin ekonomik të Kosovës.



Grafiku 45 – Mbështetja e rolit të IHD-ve nga qeveria


Nëse marrim për bazë numrin e bizneseve të huaja në territorin e Kosovës mund të themi se roli i qeverisë është i rëndësishëm në tërheqjen e IHD-ve, mirëpo duhet të punohet shumë më tepër se sa që është punuar deri më tani.

Nga respondentët tanë 67 përqind janë përgjigjur se nuk mendojnë se qeveria e Kosovës mbështet zhvillimin dhe rolin e IHD-ve në territorin e saj, ndërsa 33 përqind prej tyre mendojnë se qeveria mbështet rolin e zhvillimit të IHD-ve në Kosovë.




Grafiku 46 – Motivet për të investuar në Kosovë

Motivet e investuesve të huaj që të investojnë në Republikën e Kosovës janë të shumta, ndër to është edhe ato duke investuar në vendin tonë, rritin përfitueshmërinë e tyre duke rritur pasurinë e aksionerëve dhe zvogëluar kostot. Gjithashtu ndikon edhe popullsia e re dhe e arsimuar, klima liberale dhe reformiste, pozicioni strategjik gjeografik, potenciali i madh për investime si dhe sistemi i regjistrimit të bizneseve. Nga intervista me respondentët tanë shumica prej tyre janë të mendimit, motiv kryesor që investitorët e huaj të investojnë në vendin tonë është pikërisht popullsia e re dhe e arsimuar.



Kosova ka ndërtuar institucionet e veta, prandaj këto institucione duhet të punojnë dhe të kenë përgjegjësi në zhvillimin ekonomik të vendit. Kjo do të thotë se duhet të jemi të vetëdijshëm për rëndësinë e aspekteve politike që japin një imazh të mirë të vendit tonë tek investitorët.

Përfaqësuesit e firmave të huaja të cilat bëjnë biznes në Kosovë në këtë pyetje janë përgjigjur në këtë mënyrë: Vendi ynë ka lehtësi në të bërit biznes dhe këtij mendimi i janë përgjigjur 43 përqind të respondentëve, 29 përqind e tyre mendojnë se kanë mbrojtje juridike, 14 përqind e tyre janë të mendimit se struktura administrative është mjaft funksionale, ndërsa 14 përqind e respondentëve mendojnë se ka efikasitet në gjykata.




Grafiku 48 – Të drejtat dhe garancitë për IHD-të

Investitorët e huaj shpeshherë marrin trajtim ligjor më të favorshëm në vendet në zhvillim se sa investitorët vendor. Kjo mund të ndikojë negativisht sa i përket klimës së investimeve vendore. Megjithkëtë përmirësimi i kuadrit ligjor mund të ketë ndikim pozitiv në Investimet e Huaja Direkte.

Kosova dhe vendet e rajonit, duke marrë në konsideratë ndikimin pozitiv që mund të kenë IHD-të në zhvillimin ekonomik të vendeve, janë duke punuar në politikat favorizuese për të nxitur IHD-të, ndër to më e rëndësishmja është përmirësimi i kuadrit ligjor.

Nga intervitat që kemi zhvilluar me respondentët, ata janë të mendimit se u ofrohen të drejta dhe garanci investimeve të tyre sipas ligjit në fuqi në Kosovë me ç'rast në këtë mënyrë na janë përgjigjur 67 përqind e të intervistuarve, 16 përqind e tyre mendojnë se mesatarisht u

ofrohet garanci sipas ligjit në fuqi, 17 përqind janë të mendimit se nuk u ofrohet aspak garanci sipas ligjit në fuqi.




Grafiku 49 – Trajtimi juridikisht dhe ekonomikisht me qytetarët vendës

Nga të intervistuarit tanë 50 përqind e tyre janë shprehur se trajtohen njësoj si qytetarët vendës, 17 përqind e tyre mendojnë se trajtohen pak, 16 përqind janë të mendimit se trajtohen mesatarisht barabartë me qytetarët vendës, ndërsa 17 përqind e respondentëve nuk kanë dhënë fare përgjigje.



Investimet e huaja direkte duhet të mbrohen në bazë të ligjit për mosmarrëveshjet apo konfliktet që mund të kenë, qoftë me palën që kanë lidh marrëveshje apo edhe me administratën e shtetit. Një gjë e tillë parashihet edhe në ligjin për mbrojtjen e investimeve të Republikës së Kosovës.


Nga përgjigjet që kemi marrë prej respondentëve 34 përqind e tyre janë të mendimit se mosmarrëveshjet të zgjidhen në Gjykatat vendore, 33 përqind e tyre mendojnë se mosmarrëveshjet duhet të zgjidhen me ligjin e shtetit nga vijnë, ndërsa 33 përqind janë të mendimit se në rast të mosmarrëveshjeve ato duhet të zgjidhen me anë të arbitrazhit.



Grafiku 51 – Sektorët që ja vlen për të investuar

Shumë vende kanë vështirësi për të tërhequr investimet e huaja, për shkak të tregjeve të vogla ose kostove të larta të shërbimit si bazë për eksport, kështu strategjia për promovimin e investimeve që do të kontribuojë në zhvillim duhet të jetë në sektorë dhe aktivitete të veçanta.

Rezultatet nga intervista sa i përket kësaj pyetje kanë qenë në këtë mënyrë: 33 përqind e të intervistuarve mendojnë se duhet të investohet më tepër në turizëm, 34 përqind e tyre mendojnë se duhet të investohet më shumë në miniera, 22 përqind e tyre mendojnë se duhet të investohet në bujqësi, 11 përqind janë të mendimit se më shumë duhet të investohet në energjetikë.



Grafiku 52 – Investimet ndikim në rritjen e kapitalit

Nga repodentët tanë 33 përqind janë shprehur se ka ndikuar shumë në rritjen e kapitalit, 33 përqind mendojnë se ka ndikuar pak, 17 përqind janë shprehur se ka ndikuar mesatarisht, ndërsa 17 përqind e tyre nuk janë përgjigjur fare.


ANALIZA E PYETËSORËVE PËR FIRMAT DHE INVESTIMET E TYRE NË SHQIPËRI

Për realizimin e rastit të studimit kemi formuluar një pyetësor që përbëhet nga 20 pyetje, përmbajtja e të cilave ka të bëjë me rolin e liderit të orientuar drejt mbrojtjes individuale dhe shoqërore. Kemi paraqitur në këtë studim dy baza të dhënash primare dhe sekondare, duke lidhur në punim si të dhënat nga literatura dhe nga gjetjet në bizneset e rajonit të Jugut. Mesatarisht janë marrë 30 (tridhjetë) biznese të vogla dhe të mesme.

Hulumtimin është realizuar duke anketuar biznese të vogla dhe të mesme në territotin jugor të Vlorës.

Gjithsej kemi anketuar 30 biznese, përgjigjet e të cilave i kemi paraqitur në mënyrë grafike.

1. A punon udhëheqësi për të kuptuar industrinë ku operon dhe për të kontribuar në evolucionin e saj?




Grafiku 53- Udhëheqësi dhe kuptimi i industrisë

Liderët gjithmonë duhet të vlerësojnë mjedisin ku operon organizata si dhe të përfshihen në evolucionin e saj. Në pyetjet drejtuar të anketuarëve rreth kontributit të liderëve në industri, 49% të të anketuarve mendojnë se liderët kontribuojnë, 31% mendojnë se nuk angazhohen, 11% mendojnë se kontribuojnë pak dhe 9% mendojnë që nuk janë të përfshirë aspak.

2. Sipas mendimit tuaj, lidershipi a mbështetet vetëm tek lideri apo është një proces që përfshin liderin, pasuesit dhe situatën?


2. Sipas mendimit tuaj, lidershipi a mbështetet vetëm tek lideri apo është një proces që përfshin liderin, pasuesit, dhe situatën?



Grafiku 54. Lidershipi, pasuesi dhe situata

Lidershipi është një proces me të cilin një person ndikon tek të tjerët për të realizuar një objektiv. Sipas të anketuarve 14% zgjedhin se lidershipi mbështetet vetëm tek lideri, 36% zgjedhin se lidershipi mbështetet tek lideri dhe pasuesi dhe 50% mendojnë se mbështetet tek lideri, pasuesi dhe situata.


3. Në çfarë mase merren parasysh nevojat dhe kërkesat e individëve në kompaninë ku jeni pjesë?



Grafiku 55. Kërkesat dhe nevojat e konsumatorëve

Ka disa faktorë të cilët nxitin kërkesat e konsumatorëve. Nevojat dhe kërkesat e konsumatorëve janë ato të cilat vendosin në lëvizje prodhimin e produktit. Në këtë analizë vërejmë se 42% e të anketuarëve tregojnë se merren shumë parasysh kërkesat dhe nevojat e konsumatorit, 38% mjaftueshëm, 15% pak dhe 5% të të anketuarve tregojnë se nevojat dhe kërkesat e konsumatorëve nuk janë pjesë e organizimit të tyre.

4. Sa shpesh pyeten konsumatorët nëse janë të kënaqur ose të pakënaqur me punën punonjësve?



Grafiku 56. Kënaqësia e konsumatorëve

Kur matim kënaqjen e konsumatorëve është e rëndësishme të kuptojmë rëndësinë e parametrave të ndryshëm të cilësisë. Kënaqja e konsumatorëve përbëhet nga një numër i madh elementesh të cilët influencojnë në organizata. Punonjësit të cilët kanë kontakt të drejtpërdrejtë me konsumatorët duhet të jenë të orientuar për të kënaqur konsumatorët. Vërejmë se 33% pyeten shpesh dhe 20% asnjëherë. Sikurse mjedisi i brendshëm që ndikon në organizatat dhe klientët të cilët janë pjesë e mjedisit të jashtëm kanë ndikimin e tyre në organizatë, në qoftë se një faktor i mjedisit të

brendshëm apo të jashtëm nuk merret në konsideratë, do të ketë pasoja për organizatat.


5. Si duhet lideri të trajnojë punonjësit të sillen gjatë një kontakti me konsumatorin?



Grafiku 57. Trajnimi i punonjësve

Liderët duhet të aplikojnë programe trajnimi për punonjësit. Trajnimi i punonjësve jo vetëm ndikon në rritjen e tyre profesionale, por ndihmon dhe ndikon pozitivisht në organizatë. Në pyetjen drejtuar të anketuarve shohim se rreth 51% kërkojnë t'i trajtojnë me dhembshuri, kurse 49% t'u jap të drejtë.


6. Ju si lider mendoni se duhet ta mbështesni dhe favorizoni mbrojtjen individuale dhe shoqërore në organizatën ku ju drejtoni?



Grafiku 58. Mbrojtja individuale dhe shoqërore në organizata

Liderët luajnë rol të rëndësishëm për të arritur lumturinë e vërtetë të shoqërisë së tyre. Lideri i mirë dhe i aftë i udhëheq me paqe dhe prosperitet, ndërsa udhëheqësi mizor dhe i paftë krijon një imazh të keq. Udhëheqësi jo vetëm që duhet të jetë i arsimuar dhe me përvojë, por është e rëndësishme të jetë i mëshirshëm dhe i ndjeshëm ndaj problemeve me të cilat përballlet shoqëria. Sipas anketuesve, 45% mendojnë se duhet ta favorizojmë dhe të jetë pjesë e organizatës mbrojtja e individëve dhe shoqërisë, 37% e të anketuarve mendojnë se vetëm duhet mbështetur, 16% prej tyre mendojnë se nuk duhet mbështetur mbrojtja e individëve dhe shoqërisë në organizatë dhe 2% qëndrojnë indiferent.


7. Në ç'masë i keni përdorur komentet e ankesave të individëve për të përmirësuar performancën tuaj?



Grafiku 59. Ankesat e individëve dhe performanca organizative

Askujt nuk i pëlqen që të përballen me një shërbim negativ, por fatkeqësisht shumë organizata përfshihen me të. Duke mos marrë parasysh ankesat e individëve, kompanitë do të përballen me një reagim negativ dhe kjo do të përkthehet në një publicitet negativ dhe në një imazh të keq. Nga pyetja: në qoftë se përdoren komentet e ankesave të individëve për të përmirësuar performancën vërejmë se 37% analizohen vazhdimisht, 35% analizohen vetëm në situata të caktuara dhe 28% nuk analizohen aspak një tregues mjaft i lartë dhe kjo është me pasoja për organizatën.

8. Sa i përfshirë duhet të jetë lideri, apo sa kohë duhet të shpenzojë për sigurinë e individëve dhe shoqërisë?




Grafiku 60. Lideri dhe përfshirja në sigurinë e individëve dhe shoqërisë

Në bazë së përgjigjes së të anketuarve në lidhje me pyetjen se sa i përfshirë duhet të jetë lideri në sigurinë e individëve dhe shoqërisë, vërejmë se 30% mendojnë se duhet të përfshihen plotësisht, 37% mendojnë se duhet të përfshihen pjesërisht, dhe 21% e tyre mendojnë se duhet të përfshihen në masa të caktuara e 12% mendojnë se nuk duhet të përfshihen fare.

9. Sipas lidërsh cilat janë komponentet kryesore të ekperiencës së konsumatorëve?

9. Sipas lidershit cilat janë komponentët kryesor të ekperiencës së konsumatorëve?



Grafiku 61. Komponentët kryesor të ekperiencës së konsumatorëve

Eksperienca e konsumatorëve lidhur me cilësinë e një produkti ose shërbimi është rezultat i një numri të madh faktorësh lidhur me produktin, shërbimet dhe rrethanat në të cilat ai është shpërndarë tek konsumatori. Të anketuarit rreth kësaj pyetje deklarojnë se 28% e përbën besimi, 5% dhuratat, 26% siguria, 13% sakrificat dhe përpjekjet, kurse 8% emocionet pozitive dhe 20% personaliteti.

10. Sipas mendimit tuaj, cilat duhet të jenë qëllimet e liderit për të kënaqur përfitimet e konsumatorit?

10. Sipas mendimit tuaj, cilat duhet të jenë qëllimet e liderit për të kënaqur përfitimet e konsumatorit?




Grafiku 62. Qëllimet e liderit për të kënaqur përfitimet e konsumatorit

Në pyetjen drejtuar të anketuarëve lidhur me qëllimet e liderit për të kënaqur përfitimet e konsumatorit vërejmë se 8% mendojnë rreth ofrimit të produkteve të pranueshme nga konsumatorët, por me cilësi të ulët, 37% e tyre mendojnë të ofrojnë

një diversitet produktesh, 35% ofrojnë produkte me cilësi të lartë dhe me një çmim të lartë dhe 8% mendojnë të mbrojnë interesat e individëve dhe grupeve shoqërore.

11. A e shpërblen udhëheqësi punën e jashtëzakonshme dhe a di ai se si të shpërblejë njerëzit e "drejtë"?



Grafiku 63. Shpërblimi i punës nga udhëheqësi

Të gjithë udhëheqësit e mëdhenj shpërblejnë njerëzit e tyre dhe kjo i ndihmon ata për t'u bërë më efektiv. Në pyetjen drejtuar të anketuarve shohim se 72% shpërblejnë punën e jashtëzakonshme, 27% nuk e shpërblejnë dhe 1% qëndrojnë indiferent.

12. A kanë informacion liderët të dinë se cilët janë klientët e tyre më të rëndësishëm?

12. A kanë informacion liderët të dinë se cilët janë klientët e tyre më të rëndësishëm?




Grafiku 64. Liderët dhe klientët

Liderët duhet të kenë një paraqitje gjithëpërfshirëse të organizatës që ata drejtojnë. Sipas të anketuarve vërejmë se 57% janë gjithmonë në dijeni në lidhje me klientët më të rëndësishëm, 34% mendojnë se kanë pak informacion dhe 9% nuk kanë aspak informacion për klientët e rëndësishëm.

13. A mendoni se lidershipi është dizenuar dhe formuar në mënyrë tërheqëse në organizatën tuaj?


13. A mendoni ju se lidershipi është dizenuar dhe formuar në mënyrë tërheqëse në orgnizatën tuaj?



Grafiku 65. Formimi dhe dizenjimi i lidershipit

Lidershipi ka të bëjë me marrëdhënien ndërmjet liderit dhe pasuesve, ku lideri përmbledh dhe kanalizon motivet e pasuesve në mënyrë që të mundësojë realizimin e qëllimeve të përbashkëta. Vërejmë se 48% mendojnë se lidershipi është dizenuar në mënyrë atraktive dhe është tërheqës, 40% mendojnë se lidershipi mund të ishte programuar më mirë, dhe 12% nuk janë të sigurt në lidhje me mënyrën e dizenjimit dhe formimit të lidershipit.

14. A mendoni se programi i lidërshiptit do të sjell ndryshime të mëdha në organizatë?




Grafiku 66. Ndryshimet organizuese

Organizatat duhet të jenë të hapura ndaj ndryshimeve që mund të ndodhin në mjedisin ku ajo operon. Në pyetjen drejtuar të anketuarve lidhur me programin e lidërshiptit dhe ndryshimet në organizatë shohim se rreth 73% kanë një qëndrim pozitiv me organizatat të cilat janë të prira për ndryshime, 21% kërkojnë të ketë qëndrueshmëri dhe 6% janë indiferent.

15. Çfarë mendimi kanë individitët apo grupet shoqërore për ju si lider? Çfarë perceptimi kanë ata për ju?

15. Çfarë mendimi kanë individitët apo grupet shoqërore për ju si lider? cfarë perceptimi kanë ata për ju?




Grafiku 67. Përceptimi për liderin

Lideri është individ i cili drejton organizatën. Në pyetjen drejtuar të anketuarve vërejmë se 41% mendojnë se lideri është një individ i cili ka më shumë përgjegjësi, 34% mendojnë se lideri nuk angazhohet në çdo sektor të organizatës dhe 25% mendojnë se lideri ka kontakt vetëm me vartësit e tij.

16. Në një situatë komplekse, liderët duhet t'i lejojnë vartësit ta zgjidhin vet problemin?


16. Në një situatë komplekse, liderët duhet t'i lejojnë vartësit të zgjidhin vet problemin?



Grafiku 68. Zgjidhja e problemit

Në pyetjen drejtuar të anketuarve vërejmë se 60% mendojnë se liderët duhet të konsultohen me vartësit, 32% nuk janë dakord me këtë dukuri dhe 8% qëndrojnë indiferent.


17. Përpara marrjes së vendimeve, lidershipi merr në konsideratë se çfarë duhet thënë vartësve të tij/të saj?



Grafiku 69. Lidershipi dhe vartësit

Dëgjimi i të gjithë të vartësve, sa më shpesh të jetë e mundur aq më i rëndësishëm është për të ndërtuar një ekip besnik dhe të besuar. Të gjithë duhet të jenë pjesë e procesit. Ndërveprimi dhe dëgjimi i vartësve është diçka që harrohet shpesh nga drejtuesit, e justifikuar kjo me ngutjen dhe nxitimin në punë. Kjo nuk duhet të ndodhë. Vërejmë se 46% mendojnë se liderët marrin në konsideratë vartësit, 33% mendojnë se rrallëherë konsultohen dhe 21% mendojnë se liderët i marrin vetëm vendimet.

18. Sa të suksesshëm janë liderët në planifikimin strategjik?




Grafiku 70. Liderët dhe planifikimi strategjik

Liderët e mëdhenj janë të shquar për planifikime strategjike. Ata kanë aftësinë për të shikuar përpara si dhe për të parashikuar disa të dhëna të sakta se ku po shkojnë tregjet dhe industria.

Liderët kanë aftësinë për të parashikuar trendet e industrisë, në avancë të konkurrentëve të tyre. Me rritjen e konkurrencës, vetëm liderët dhe organizatat që mund të parashikojnë të ardhmen e tregjeve do të kenë mundësi për të mbijetuar.

19. Sipas jush cili model i lidershipit është më i përshtatshëm për drejtimin e një organizate?


19. Sipas jush cili model i lidershipit është më i përshtatshëm për drejtimin e një organizate?



Grafiku 71. Llojet e lidershipit

Në pyetjen se cili model i lidershipit është më i rëndësishëm, vërejmë se lidershipi transformues përbën 28%, nëpërmjet tij kemi nxitjen dhe frymëzimin te vartësit, rrit motivimin dhe bën që problemet e vjetra të shihen me mënyra të reja. 22% i përket lidershipi transaksional, i cili motivon dhe shpërblen, qartëson rolet dhe kërkon realizimin e objektivave. Lidershipi karizmatik përbën 26% i cili mbështet bindjen dhe vetëbesimin. 6 % sipas të anketuarve është lidershipi burokratik, të cilët komandojnë dhe kontrollojnë në mënyrë të vazhdueshme dhe lidershipi inovativ përbën 18%, ai frymëzon të tjerët dhe krijon një mjedis ku vlerësohen idetë.

20. Sa transparente janë organizatat ndaj individëve dhe shoqërisë?



Grafiku 72. Transparenca e organizatave

Organizatat duhet që të jenë transparente ndaj publikut. Transparenca është një ndër shtyllat më të rëndësishme për organizatat dhe atë duhet ta vlerësojnë më së miri. Në pyetjen drejtuar të anketuarve se sa transparente janë organizatat shohim se 52% janë shumë transparente, 29% janë pak transparente dhe 19% nuk janë aspak transparente.

Përfundimet e pyetësorit për firmat

Në pyetësorin sa i përket firmave të cilat kanë qenë pjesë e investimeve të huaja direkte dhe mbrojtjen juridike të tyre si dhe zhvillimin ekonomik të Kosovës dhe Shqipërisë kemi arritur në përfundim se shumica e të intervistuarve janë shprehur pozitivisht sa i përket investimeve të tyre në të dyja shtetet. Një përqindje e lartë janë shprehur të kënaqur lidhur me mbrojtjen juridike të investitorëve dhe investimeve të tyre si dhe ndikimin pozitiv në zhvillimin ekonomik të vendeve. Ndërsa problem shfaq situata politike e të dyja vendeve

me ç'rast një përqindje e lartë e të intervistuarve janë shprehur të pakënaqur sa i përket kësaj çështjeje.

Situata politike e një vendi luan rol shumë të rëndësishëm, mund të themi qenësor për tërheqjen e investimeve të jashtme, por edhe qëndrimin e tyre në vendin tonë.

Nëse marrim për bazë numrin e bizneseve të huaja në territorin e Kosovës mund të themi se roli i qeverisë është i rëndësishëm në tërheqjen e IHD-ve, mirëpo duhet të punohet shumë më tepër se sa që është punuar deri më tani.

Nga respondentët 67 përqind janë përgjigjur se nuk mendojnë se qeveria e Kosovës mbështet zhvillimin e rolit të IHD-ve në territorin e saj, ndërsa 33 përqind prej tyre mendojnë Po, sepse qeveria po mbështet rolin e zhvillimit të IHD-ve në Kosovë.

Kosova ka ndërtuar institucionet e veta, prandaj këto institucione duhet të punojnë dhe të kenë përgjegjësi në zhvillimin ekonomik të vendit. Kjo do të thotë se duhet të jemi të vetëdijshëm për rëndësinë e aspekteve politike, pra që të japim një imazh të mirë të vendit tonë tek investitorët.

Përfaqësuesit e firmave të huaja që bëjnë biznes në Kosovë në këtë pyetje janë përgjigjur në këtë mënyrë: Vendi ynë ka lehtësi në të bërit biznes dhe të këtij mendimi janë 43 përqind të respondentëve, 29 përqind të tyre mendojnë se kanë mbrojtje juridike, 14 përqind janë të mendimit se struktura administrative është mjaft funksionale, ndërsa 14 përqind e mendojnë se ka efikasitet në gjykata.

Nga anketimi kemi arritur të evidentojmë edhe problemin tjetër që ndikon mjaft negativisht tek firmat e huaja, e kjo ka të bëjë me mungesën e njerëzve që nuk i kanë aftësitë profesionale që kërkohen nga kompanitë. Kjo na bën të kuptojmë se duhet të punojmë më shumë sa i përket arsimimit dhe trajnimeve profesionale me ç'rast rëndësi të madhe ka edhe trajnimi i konsumatorit, pra kompania duhet të trajnojë punonjësit dhe të ndikojë pozitivisht, jo vetëm në aftësimin profesional të tyre, por gjithashtu do të ndikojë pozitivisht edhe tek firma.

Investimet e huaja direkte janë të rëndësishme si për Shqipërinë po ashtu edhe për Kosovën, sidomos në nënshkrimin e marrëveshjeve që mund të kenë të dyja vendet me vendet e tjera të rajonit.

Ndër motivet kryesore që kanë investitorët e huaj që të investojnë në Kosovë dhe Shqipëri pa dyshim është edhe popullsia e re, klima liberale dhe reformiste, pozicioni strategjik gjeografik, potenciali i madh për investime si dhe sistemi i regjistrimit të bizneseve.

Ndërsa faktorët kryesor të cilët ndikojnë që investitorët e huaj të shprehin interesimin e tyre për të investuar në vendin tonë janë kuadri ligjor dhe infrastruktura.

Mbrojtja e investimeve të huaja direkte

Mbrojtja ligjore e investimeve të huaja direkte ndikon pozitivisht në tërheqjen e investitorëve që investimet e tyre t'i bëjnë në Shqipëri, nga të intervistuarit 56 përqind e tyre kanë njohuri sa i përket mbrojtjes së IHD-ve, ndërsa 44 përqind nuk kanë njohuri.

Ndërsa nga intervista që kemi zhvilluar me përfaqësues të firmave që janë në Kosovë 50 përqind e tyre mendojnë se IHD-të janë të rëndësishme për vet faktin se kanë karakter zhvillues, 33 përqind e tyre mendojnë se kanë karakter frenues dhe 17 përqind e të intervistuarve mendojnë se nuk kanë asnjë rëndësi në zhvillimin ekonomik të Kosovës.

Të drejtat dhe garancitë sipas ligjit në fuqi

Investitorët e huaj shpeshherë marrin trajtim ligjor më të favorshëm në vendet në zhvillim se sa investitorët vendor. Kjo mund të ndikojë negativisht sa i përket klimës së investimeve vendore. Megjithkëtë përmirësimi i kuadrit ligjor mund të ketë ndikim pozitiv në Investimet e Huaja Direkte.

Kosova, Shqipëria dhe vendet e rajonit duke marrë në konsideratë ndikimin pozitiv që mund të kenë IHD-të në zhvillimin ekonomik të vendeve janë duke punuar në politikat favorizuese për të nxitur IHD-të, ndër to më e rëndësishmja është përmirësimi i kuadrit ligjor.

Nga intervistat që kemi zhvilluar me respondentët tanë ata janë të mendimit se u ofrohen të drejta dhe garanci investimeve të tyre sipas ligjit në fuqi në Kosovë si dhe ligjit në fuqi në Shqipëri me ç'rast në këtë mënyrë na janë përgjigjur 67 përqind e të intervistuarve, 16 përqind e tyre mendojnë se mesatarisht u ofrohet garanci sipas ligjit në fuqi, 17 përqind janë të mendimit se nuk u ofrohet aspak garanci sipas ligjit në fuqi.

Investimet e huaja direkte duhet të mbrohen në bazë të ligjit për mosmarrëvshjet apo konfliktet që mund të kenë, qoftë me palën që kanë lidh marrëveshje apo edhe me administratën e shtetit. Një gjë e tillë parashihet edhe në ligjin për mbrojtjen e investimeve të Republikës së Kosovës.

Nga përgjigjet që kemi marrë prej responentëve tanë 34 përqind e tyre janë të mendimit se mosmarrëveshjet të zgjidhen në Gjykatat vendore, 33 përqind e tyre mendojnë se mosmarrëveshjet duhet të zgjidhen me ligjin e shtetit prej nga vijnë, ndërsa 33 përqind janë të mendimit se në rast të mosmarrëveshjeve ato duhet të zgjidhen me anë të arbitrazhit.

Transparenca

Rëndësi mjaft e madhe për firmat e huaja për të lidhur marrëveshje me vendet tona është transparenca. Nga hulumtimi që kemi realizuar kemi ardhur në përfundim se si në Kosovë poashtu edhe në Shqipëri ekziston mungesa e transparencës gjë që nuk shkon në favor të asnjërës nga shtetet. Kosova dhe Shqipëria janë ende në fazën e privatizimit e cila duhet të kryehet në mënyrë shumë transparente, me tender që do të funksionojë në mënyrë të rregullt, por mënyra e përfitimit të tenderit do të jetë në bazë të rregullave pa asnjë shkelje.

Korrupsioni

Për firmat të cilat investojnë në Kosovë dhe Shqipëri korrupsioni mbetet sfida më vete edhe pse dita ditës po shkon duke u zvogëluar dhe nuk paraqet problem të madh, sikurse vitet e mëhershme, mirëpo mund të themi se vazhdon të jetë pengesa kryesore për zhvillimin ekonomik të dyja vendeve si të Kosovës poashtu edhe të Shqipërisë. Të marrësh mito pothuajse është bërë e zakonshme, sidomos kjo është bërë praktikë në institucionet publike shëndetësore, në dogana, në shërbimin i cili përfaqëson ligjin i cili është shërbimi policor. Të gjithë këta faktorë kanë ndikuar negativisht në tërheqjen e investimeve të huaja.

Infrastruktura

Megjithëse kohëve të fundit Shqipëria dhe Kosova kanë punuar në përmirësimin e infrastrukturës sa i përket transportit, prap nuk kanë arritur të kenë një transport më i zhvilluar në transportin rrugor dhe atë hekurudhor.

Sektorët e rëndësishëm për të investuar

Rezultatet nga intervista sa i përket kësaj pyetje kanë qenë në këtë mënyrë: 33 përqind e të intervistuarve mendojnë se duhet të investohet më tepër në turizëm, 34 përqind e tyre mendojnë se duhet të investohet më shumë në miniera, 22 përqind e tyre mendojnë se duhet të investohet në bujqësi, 11 përqind janë të mendimit se më shumë duhet të investohet në energjetikë.

Klientët më të rëndësishëm

Liderët duhet të kenë paraqitje gjithëpërfshirëse të organizatës që ata drejtojnë. Sipas të anketuarve vërejmë se 57% janë gjithmonë në dijeni në lidhje me klientët më të rëndësishëm, 34% mendojnë se kanë pak informacion dhe 9% nuk kanë aspak informacion për klientët më të rëndësishëm.

Lidershipi ka të bëjë me marëdhënien ndërmjet liderit dhe pasuesve, ku lideri përmbledh dhe kanalizon motivet e pasuesve në mënyrë që të mundësojë realizimin e qëllimeve të përbashkëta. Vërejmë se 48% mendojnë se lidershipi është dizenuar në mënyrë atraktive dhe është tërheqës, 40% mendojnë se lidershipi mund të jetë programuar më mirë dhe 12% nuk janë të sigurt në lidhje me mënyrën e dizenjimit dhe formimit të lidershipit.

Firmat duhet të jenë të hapura ndaj ndryshimeve që mund të ndodhin në mjedisin ku ajo operon. Në pyetjen drejtuar të anketuarve në lidhje me programin e lidershipit dhe ndryshimet në firmë shohim se rreth 73 përqind kanë një qëndrim pozitiv me firmat të cilat janë të prirura nga ndryshimet, 21 përqind kërkojnë të ketë qëndrueshmëri dhe 6 përqind janë indiferent.

KAPITULLI VIII

KONKLUDIME DHE REKOMANDIME

8.1 Konkludime

- ❖ Me anë të këtij punimi kemi arritur të studjojmë mbrojtjen juridike të investimeve të huaja në vendet e zhvilluara, disa nga ato janë pjesë e BE-së, në vende të rajonit dhe jemi përqëndruar më shumë në Kosovë dhe Shqipëri si vende të vogla të cilat ende janë në fazën e tranzicionit.
- ❖ Qëllim kryesor në këtë punim kemi pasur tri çështjet më kryesore:
 - *së pari* ndikimin e investimeve të huaja direkte në zhvillimin ekonomik të Kosovës dhe Shqipërisë,
 - së dyti, faktorët të cilët ndikojnë në tërheqjen e investimeve, dhe
 - së treti, mbrojtjen juridike të investimeve dhe investitorëve.
- ❖ Ndikimi i IHD-ve në zhvillimin ekonomik të Kosovës dhe Shqipërisë është vlerësuar nëpërmjet hulumtimit që kemi realizuar me institucionet e të dyja shteteve, firmat e huaja, si dhe individët të cilët në njëfarë mënyre janë pjesë e këtyre investimeve.
- ❖ Ndër faktorët kryesor të cilët ndikojnë në tërheqjen e IHD-ve janë analizuar nga këndvështrimi që kanë investitorët e huaj. Pra, firmat e huaja japin mendimin e tyre se si e shohin ato zhvillimin e biznesit të tyre në vendet tona dhe këtë e kemi realizuar nëpërmjet pyetësorit drejtuar tek një pjesë e këtyre firmave.
- ❖ Mbrojtja juridike është një ndër faktorët kryesor që ndikon në tërheqjen e investimeve dhe pothuajse pjesa më e madhe e hulumtimit është e përqëndruar në zbatimin e rendit juridik dhe sundimin e ligjit sa i përket investimeve dhe investitorëve të huaj.

- ❖ Paraqitja e një qasjeje teorike për IHD-të që ne të arrijmë ta kuptojmë më mirë rolin që kanë IHD-të në zhvillimin e vendeve pritëse.
- ❖ Kuadri ligjor në mbrojtjen e investimeve të huaja, marrëveshjet bilaterale dhe multilaterale që kanë lidh Kosova dhe Shqipëria me vendet e tjera, luajnë rol të rëndësishëm në zhvillimin e të dyja vendeve në përgjithësi.
- ❖ Rritjen e investimeve nëpër vite, si dhe sektorët në të cilët është investuar më shumë ka qenë pjesë shumë e rëndësishme e këtij studimi.
- ❖ IHD-të e kanë origjinën nga vende të ndryshme, pjesa kryesore e investimeve në Kosovë vije nga Gjermania, Turqia, Zvicra, ndërsa në përqindje më e vogël janë nga vendet e rajonit, ndërsa sa i përket Shqipërisë, pjesa më e madhe e investimeve vije nga Emiratet e Bashkuara Arabe, Austria, Zvicra, në përqindje shumë e vogël me investime drejt Shqipërisë janë Shtetet e Bashkuara të Amerikës.
- ❖ Sektorët potencial në të cilët është investuar më shumë në të dyja shtetet janë: sektori i ndërtimit, ai financiar, ndërsa më pak është investuar në sektorin e bujqësisë.
- ❖ Investimet e huaja direkte ndikojnë pozitivisht në rritjen ekonomike të Kosovës dhe Shqipërisë, prandaj tërheqja më e madhe e tyre do jetë në të mirën e të dyja vendeve.
- ❖ Mjedisi politiko-ligjor luan rol të rëndësishëm sa i përket investitorëve të huaj, sepse jostabiliteti i një vendi në udhëheqjen shtetërore do të ketë ndikim negativ sa i përket interesimit të investitorëve.
- ❖ Investimet e huaja direkte duhet të mbrohen dhe t'u garantohen të drejtat në bazë të ligjit në fuqi për investimet e huaja direkte, një gjë e tillë nuk themi se zbatohet si duhet nga institucionet vendore.
- ❖ Motivet kryesore që nxisin investitorët e huaj të investojnë në këto dy shtete janë fuqia e lirë punëtore, pasi që dihet se niveli i pagave si në Kosovë poashtu edhe në

Shqipëri, marrë mesataren nuk është në nivelin e kënaqshëm, shmangia nga tatimet e larta është njëri nga motivet në të cilën investitorët janë mjaft të interesuar, por gjithashtu edhe fitimi në shkallë të lartë.

- ❖ Nga analiza empirike kemi arritur në përfundim se investimet e huaja direkte me gjithë efektet negative që mund të kenë për vendet tona prapseprap janë një e mirë pa të cilat ekonomia e të dyja vendeve do pësonte një ngecje të madhe.
- ❖ Sigurimi i rendit dhe ligjit për investitorët e huaj është detyrë kryesore e qeverive, me ç'rast përveç të drejtave të cilat u siguron ligji investitorët e huaj kanë edhe obligime të përcaktuara po me ato ligje të vendeve ku investojnë.
- ❖ Në rast se vie deri të një mosmarrëveshje në mes tëinvestitorit të huaj me atë vendor apo edhe me vet insitucionet e shtetit, zgjidhja e mosmarrëveshjeve bëhët duke u bazuar në Ligjin për investime të shtetit përkatës apo nëse palët janë dakord edhe me Gjyktën e arbitrazhit.

8.2 Rekomandime

- ❖ Duke pasur parasysh se investimet e huaja direkte ndikojnë pozitivisht në zhvillimin ekonomik të Kosovës dhe Shqipërisë, mbrojtja juridike e tyre dhe ofrimi i kushteve sa më të mira duhet të jetë prioritet për insitucionet vendore.
- ❖ Niveli i lartë i teknologjisë tek kompanitë e huaja dhe mungesa e profesionalizmit tek punëtorët në Kosovë krijon pasiguri tek investitorët, prandaj duhet të mbahen trajnime profesionale nga fusha të ndryshme të udhëhequr nga insitucionet e shtetit me qëllim të përgatitjes së kuadrit sa më profesional për tregun e punës.
- ❖ Reformat në përmirësimin e klimës investive si në Kosovë, poashtu edhe në Shqipëri janë shumë të rëndësishme që të ndërmerren, sepse janë ndër faktorët e rëndësishëm në përmirësimin ekonomik të vendeve.
- ❖ Zbatimi i ligjit dhe rendit juridik mbeten ndër reformat kryesore të cilat duhet të ndërmerren nga qeveria si në Kosovë dhe në Shqipëri.
- ❖ Transparenca në procedurat e regjistrimit të bizneseve dhe marrja e lejeve është tjetër faktorë për të cilin duhet të punohet më shumë, sepse mungesa e transparencës jep hapësirë edhe për korrupsion.
- ❖ Duhet të punohet më shumë në nxitjen e IHD-ve në ato vende brenda Kosovës dhe Shqipërisë ku është investuar më pak, me qëllim që të kemi barazi në zhvillim ekonomik.
- ❖ Situata politike dhe ligjore në të dyja shtetet është faktori kryesor i cili ndikon që investitorët e huaj po humbin interesimin për të investuar, prandaj insitucionet e shteteve duhet të punojnë më shumë që të kthejnë në gjendje më të mirë dhe vendet tona të jenë vende më tërheqëse për investitort. Situata politike e cila është krijuar jo stabiliteti në organet udhëheqëse, mbajtja e shpeshtë e zgjedhjeve është ana më negative që mund të paraqet një shtet për veten e tij.

- ❖ Promotorët luajnë rolin kryesor sa i përket investimeve të huaja direkte dhe ata janë pothuajse ambasadorë për shtetet në raport me investimet, Kosova dhe Shqipëria duhet të kenë promotorë të trajnuar dhe të përgatitur pikërisht për këtë çështje.
- ❖ Jo transparenca në privatizimin e ndërmarrjeve publike nuk jep imazh të mirë për vendet tona, niveli i korrupsionit vazhdon të jetë në shkallë të lartë, në këtë drejtim duhet të punohet mjaft me qëllim të zëvendësimit të personave në krye të këtyre institucioneve.
- ❖ Si përfundim për gjithë rekomandimet e dhëna mund të themi se nevojitet sundimi i ligjit dhe siguria publike dhe funksionimi i gjykatave vendore në vendimmarrje, atëherë besojmë që interesimi i investitorëve të huaj do të jetë shumë më i madh.

BIBLIOGRAFIA

- Adnan Jashari- Aspekti juridik i investimeve të huaja në shtetet në tranzicion, Tetovë 2007
- Alfaro, L., (2003)" Foreign Direct Investment and Growth: Does the Sector Matter?."
- Alfaro, L., Chanda, A., Kalemli-Ozcan, S. and Sayek, S. (2001). "IHD and
- Anne van Aaken, "Ligji Ndërkombëtar i investimeve midis angazhimit dhe fleksibilitetit: Një kontratë Analiza teorike", Gazeta e së Drejtës Ekonomike Ndërkombëtare 507-2009,
- Anreu Stophlen, Oclahoma University Press, year 2006
- Anthony MCGrew and David Held – Globalization Theory: Approaches and controversies, Feb.
- Arbitration Under International Investment Agreements, 2010 – A guide to the key Issues Katia Yannaca- Small, OXFORD, University press
- Borensztein, E., De Gregorio, J., and Lee, J.W., (1995). How Does Foreign Direct Investment Affect Economic Growth?, NBER
- Brewer, T. L., (1993), "Government Policies, Market Imperfections, and Foreign Direct Investment", Journal of International Business Studies, First Quarter.
- Christoph Schreuer – Investments, International Protection, fq.6, Janar 2011
- Christoph Schreuer – Investments, International Protection, Janar 2011
- Chryssochoidis, Millar & Clegg, në 1997
- D.D. Bradlow. Legal aspects of FDI, Kluwer Law International,1999: Historial, Constitutional end International Bacground of Nigeria`s FDI Lae, p. 395-412.A. Gazanê
- Damages in International Investment, Sergey Ripinsky, Kevin Williams (2008), fq. 5, British Institute of International and comparative Law
- David Held and Anthony McGrew, David Goldblatt and Jonathan Perraton, Global Transformations: Politics, Economics and Culture, Polity, 1999,
- Economic Growth: The Role of Local Financial Markets", Harvard Business School.

- Foreign Direct Investment, Investment Treaty Arbitration, and the Rule of Law, Susan D. Franck, Anthony Broadman et al, 2004, University of British Columbia, Journal of Strategic Management Education 1(2) .© 2004, Senate Hall Academic Publishing
- Globalization of Markets (“Globalizimi i tregjeve”). Mehmet S. Audin: Küreselleşmeye Genel Bir Bakış”, në: grup autorësh, Siyasi, Ekonomik ve Kültürel Boyutlarıyla Kreselleşme, Ufuk Kitapları, Stamboll 2002,
- Glumak: Osnivanje mešovitih preduzeca u zemljama u razvoju, Lubljana, 1987
- Harvey S. Rosen, Public Finance, Tiranë, 2016
- Ilia Kristo - Biznesi Ndërkombëtar, Tiranë, 2004
- Imaad A. Mossa, IHD, Theory, evidence and practise, 2002
- Irwin and Stephen, Oxford University Press, year 2006
- Joseph E. Stiglitz: Globalization and its Discontents W W Norton Company
- Ledvinn Ourin, University of California, year 2017
- Mancellari Ahmet -Tregtia Ndërkombëtare, Teoria dhe Politika.
- Manfred B. Steger: Globalizimi – Hyrje e Shkurtër, Co-PLAN, Tiranë, 2005
- Mehdi J. Hetemi – Disa tema aktuale të ekonomisë së tregut, Prishtinë, 2005
- Mehdi J. Hetemi, “Pagesat Ndërkombëtare”, Prishtinë, 2001
- Moosa Imaad A. “FDI, Theory, evidence and practice”, Palgrave 2002
- Muhamet Dr. Mustafa “Qeverisja e projekteve Investive”, Prishtinë, 2003
- Muhamet Mustafa & Alban Zogaj, Thesis Kosova, nr. 1, 2009
- Pitelis, Christos; Roger Sugden (2000). The nature of the transnational firm. Caves (1971). Routledge.
- Public sector efficiency A. Afonso Perkhyyer V. Tanzi, Janar, 2008
- Randy Charles Eping: Një guidë e ekonomisë botërore (A beginner`s guide to the world economy), New York, 2001
- Schneider, F. and Frey, B. (1985) “Economic and Political Determinants of Foreign Direct Investment”, World Development,
- Selmanaj Selman: Globalizimi dhe tranzicioni – dilemat dhe sfidat, Prishtinë, 2006.
- Selmani Bedri: Globalizimi, Tranzicioni dhe Integrimet (Refleksionet në Kosovë), (Ekopolitika e Marëdhënieve Ekonomike Ndërkombëtare), Prishtinë 2006.

- Sezer, H. (2006) “Foreign Direct Investment”, in Piggott, J. and Cook, M. *International Business Economics: A European*, fq. 186-222, Palgrave Macmillan
- Smith Adam “An Inquiry into the Nature and Causes of the Wealth of Nations” (1776).
- Stiglitz Joseph E.: *Globalizimi dhe paknaqësitë e shkaktuara prej tij* (Globalization and its Discontents, New York, 2002.
- Susan D. Franck,
- Twomey, Michael J. (2000). *A Century of Foreign Investment in the Third World* (Book). Routledge
- *Understanding Media* (Routledge, Londër, 1964) nga autori M. McLuhan
- Vernon, Raymond (1966). *International Investment and International Trade in the Product Cycle*. in: *Quarterly Journal of Economics*. Cambridge. p. 191).

Konventat, ligjet, marrëveshjet, rregulloret

- Akti për Promovimin e Investimeve të Republikës së Bullgarisë
- Konventa ICSID nenet 53 dhe 54 të cilat detyrojnë çdo shtet kontraktues të njohë dhe zbatojë çmimet e ICSID
- Ligji Nr. 04/2013
- Ligjin për Investimet e Huaja të Malit të Zi
- Ligjit mbi Politikën e Investimeve të Huaja Direkte në Bosnje dhe Hercegovinë
- Ligjit për Investimet e Huaja në Republikën e Kosovës
- Marrëveshja e Asociimit BE- Kili, neni 195
- Rregullorja Nr. 2001/3

Burimet nga interneti

- aida.gov.al/faqe/marreveshjet_tregetare
- Andre Gunder “A Quick Guide to the World History of Globalization”, (*Globalization since the Future Century*) në: (www.sas.upenn.edu/~dlud),

- Banka Botërore, IFC, Të bësh biznes, 2011: Të sjellësh ndryshimin për sipërmarrjet, botim i përbashkët i Pagave MacMillan, IFC dhe Bankës Botërore (Uashington D.C.: Bank).
- Besjan Hajrullahu, Proteksionizmi tregtar (<http://www.qendra.info/opinione/648-proteksionizmi-tregtar.html>), fq. 1
- BQK – Raporti i stabilitetit financiar, nr. 3
- Burimi: BQK- Raporti i stabilitetit financiar, nr. 11, korrik, 2017
- Downloads/Investimi_i_huaj_direkt_ne_vendet_ne_zhvillim_te_Evropes_Lindore
- EBRD (Banka Evropiane për Rindertim dhe Zhvillim) Raporte mbi Investimet e Huaja
- Globalizimi ekonomik në Enciklikën “Dashuria në të vërtetën” Prof Emilian Karma, ([http://www.kishakatolikeshkoder.com/ Arqipeshkvia/ Cikel,Kumtesash mbi Dashuria ne te verteten.htm](http://www.kishakatolikeshkoder.com/Arqipeshkvia/Cikel,KumtesashmbiDashuria.neteverteten.htm)),
- Globalizimi - Problemet ndërkombëtare të cilat po shkaktohen si pasojë e Globalizimit <http://www.forumishqiptar.com/showthread.php>),
- <http://aida.gov.al/faqe/rreth-nesh>
- <http://citeseerx.ist.psu.edu/viewdoc/download?doi=10.1.1.124.8766&rep=rep1&type=pdf>
- <http://connection.ebscohost.com/c/articles/95718846/impact-globalization-kosovos-economy>
- http://d4d-ks.org/wp-content/uploads/2018/03/D4D_Analize_5_SHQ_FIN.pdf fq.17
- <http://iab.worldbank.org/~media/FPDKM/IAB/Documents/Overview-IAB.pdf>- BOX2.1: Characteristics of countries that score well on the IAB indicators,
- http://indep.info/wp-content/uploads/2015/01/14039_INDE2015_MARRËDHËNIET-TREGTARE-KOSOVË-SHQIPËRI.pdf
- http://kfos.org/wp-content/uploads/2015/04/Marr%C3%ABdh%C3%ABniet-Tregtare-mes-Kosov%C3%ABs-dhe-Bashkimit-Evropian_E-KOMPLETUAR.compressed.pdf.
- <http://riinvestinstitute.org/uploads/files/2016/October/17/shqip1476705266.pdf>

- <http://shtetiweb.org/2012/09/28/banka-boterore/>) 20.06.2018
- <http://shtetiweb.org/2012/09/28/fondi-monetar-nderkombetar/>
- <http://shtetiweb.org/2012/09/28/fondi-monetar-nderkombetar/>), 19.06.18
- <http://strategalb.org/globalizmi-vendet-ne-zhvillim-dhe-shqiperia/>
- <http://telegrafi.com/turqia-investoi-ne-kosove-82-8-milione-euro>
- <http://www.doktoratura.unitir.edu.al/wp-content/uploads/2012/09/Oltjana-Zoto-Fakulteti-i-Ekonomise.pdf>
- <http://www.imf.org/en/About>
- <http://www.osce.org> – Udhëzuesi i praktikave më të mira për një klimë pozitive për biznesin dhe investimet,
- <http://www.osce.org/sq/eea/19771?download=true>
- <http://www.riinvestinstitute.org/uploads/files/2016/October/17/shqip1476705266.pdf>.
- <http://www.sep.gov.mk/sq/content/?id=232#.Wy41ZaczbiU> 23.06.2018
- <http://www.slideshare.net/guest873eb3/globalizimi-3238659>
- http://www.ulqini-online.com/index.php?option=com_content&id=828:tregtia-nderkombetare-dhe-globalizmi&Itemid
- <http://www.worldbank.org/en/country/kosovo/overview> 10.05.2018
- <http://www.worldbank.org/en/news/press-release/2017/05/23/kosovo-cpf-2017-20>
- <http://www.worldbank.org/en/news/press-release/2017/11/16/wbrer12>)20.05.2018
- <https://aab-edu.net/assets/uploads/2018/03/Libri-i-abstrakteve-2017-Final.pdf>
Avantazhet dhe disavantazhet e investimeve të huaja direkte dhe roli tyre në Kosovë dhe Shqipëri, qasje krahasuese, Albana Pasjaqa, Phd, Ylber Prekazi, PhD, fq.53
- <https://ak.rks-gov.net/?cid5>
- <https://en.portal.standardertrade.com/establish-overseas/italy/foreign-investment>
- <https://enportal.standertrade.com/establish-overseas/france/foreign-investmen>
- <https://mti.rks-gov.net/desk/inc/media/6a8ce0e5-202d-4c98-92b1-153e4353c9a7.pdf>

- https://www.bankofalbania.org/web/pub/investimet_e_huaja_direkte_8751_1.pdf, Investimet e Huaja Direkte – Përshkrim Metodologjik dhe informacion statistikor për vitin 2015), Departamenti i statistikave financiare, shtator, 2016.
- <https://www.bqkkos.org/index.php?q=investimet+e+huaja+direkte+ne+Kosove+2017>
- <https://www.eolss.net/sample-chapters/RegulationofForeigninvestment>
- <https://www.globaltrade.net/international-trade-impact-exports/f/business/sweden/investing.html>).
- Komisioni Europian, Komunikimi për aspekte të caktuara ligjore, lidhur me interesat Brenda BE-së (97/C 220/06), 1997 220/15, <http://eur-lex.europa>
- Komisioni Europian, Komunikimi për aspekte të caktuara ligjore, lidhur me interesat Brenda BE-së (97/C 220/06), 1997 220/15, <http://eur-lex.europa>
- Komisioni Evropian, 2004.
- [kosid.org/file/respository/BERZH dhe Kosova.pdf](http://kosid.org/file/respository/BERZH_dhe_Kosova.pdf)
- Raporti_Statistikor_janar_17.pdf <http://open.data.al/sq/lajme/lajm/lang/sq/id/1939/Eksportet-importet-dhe-bilanci-tregtar-sipas-grupmallrave-2016>
- Shehu, E., Shqipëri – Kosovë, tregu që nuk funksionon, e qasshme tek: <http://www.gazetadita.al/shqiperi-kosovetregu-qe-nuk-funksionon/>
- Shihp.sh. Michel Chossudovsky, “GlobalFalsehoods, <http://en.wikipedia.org/wiki/Globalization>),
- The 1994 U.S. Prototype Bilateral Investment Treaty – SHBA-BIT)Shih adr. [Inter.www.ita.doc.gov/Legal/modelbit.html](http://www.ita.doc.gov/Legal/modelbit.html)
- The Oxford Handbook of INTERNATIONAL INVESTMENT LAW 2008